



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22, 23, 28 SHKURT
DHE MË 20, 21 MARS 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22, 23, 28. FEBRUARA I 20, 21. MARTA 2018. GODINE**

**SHKURT/MARS - FEBRUAR/MART
2018**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Dnevni red

1. Razmatranje N/zakona br. 06/L-060 o ratifikaciji Sporazuma o državnoj granici između Republike Kosova i Crne Gore

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara medie,

Më lejoni të theksoj optimizmin tim se jemi në rrugë të mirë që të arrijmë konsensus të përbashkët. Falënderoj në mënyrë të veçantë edhe një pjesë të opozitës, në të njëjtën kohë edhe kolegët nga pozita. E kemi një dakordim të përbashkët që seanca e jashtëzakonshme të shtyhet për nesër në orën 10:00.

Ajo çfarë dua të përçoj mesazh te qytetarët është se do të arrijmë që së bashku të jemi në këtë rrugëtim të përbashkët, në agjendën tonë pro Bashkimit Evropian dhe t'u hapim perspektivë qytetarëve tanë që të liberalizimin e vizave në një të ardhme shumë të afërt.

Pavarësisht çdo deklaratë, kjo është pjesa e cila do të jetë e optimizmit tonë të përbashkët dhe do t'i kryejmë obligimet ashtu siç presin qytetarët tanë.

Nesër në orën 10:00 e vazhdojmë seancën e jashtëzakonshme. Është vendim i përbashkët unanim i të gjithë kolegëve të grupeve parlamentare. Faleminderit!

* * *

E premte, 23 shkurt 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 22 shkurt 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas kërkesës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

Pika e vetme e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Të nderuar deputetë,

Për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi kërkohet vendimi i Kuvendit për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, do të thotë, na duhen 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

I kisha lutur kryetarët e grupeve parlamentare t'i thërrasin kolegët deputetë. Jemi në pauzë për pesë minuta, në pritje të deputetëve brenda sallës, po shoh se po vijnë deputetët.

(Pauzë)

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

T'i zini vendet, se na duhen 2/3 të pranishëm në votim, ose po të duan partitë, e kanë mundësinë e pauzës për konsultime.

E kisha lutur administratën, ta kemi numrin e saktë të deputetëve në sallë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për hir të opinionit publik, unë do të bëj disa qartësime.

Jemi në fillim të seancës së jashtëzakonshme, për të vazhduar tutje na duhet 2/3 e të pranishmëve në sallë.

Më lejoni të theksoj një fakt, pasi seanca ka të bëjë me një materie, e cila është edhe interes i gjerë qytetar, veçanërisht në këto momente, që ka të bëjë drejtpërdrejt me liberalizimin e vizave.

Në qoftë se nuk kalon me 2/3 e kolegëve deputetë prezentë, 90 ditë Kuvendi nuk ka të drejtë ta rikthejë të njëjtën çështje në seancë, vetëm për informim, ta keni parasysh. Kjo ishte për informim edhe të opinionit publik, të qytetarëve, po edhe të kolegëve deputetë.

93 deputetë janë aktualisht në sallë.

Qëndrimi politik është i partive.

Unë do të kërkoj deklarinimin e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Kryetar, kur e filluat për ta diskutuar këtë çështje, thatë që nëse nuk kalon kjo marrëveshje, atëherë nuk do të ketë liberalizim të vizave për Kosovën.

Unë mendoj që këtu janë dy ‘nëse’. Një ‘nëse’ tjetër është më e rëndësishme se kjo që e the ti. E ‘nëse’ tjetër është që nëse kalon kjo marrëveshje, duhet informuar qytetarët e Kosovës që shteti ynë humb territor.

E për Lëvizjen “Vetëvendosje” kjo ‘nëse’-ja tjetër, nëse kalon marrëveshja, është shumë më esenciale dhe më e rëndësishme se sa liberalizimi i vizave. Liberalizimi i vizave pa tjetër që është me rëndësi, ama kush e ka penguar deri tash liberalizimin e vizave, ai që e ka nënshkruar demarkacionin gabimisht dhe prej të cilit na dolën gabime. Këto gabime i konstatoi Komisionit Shtetëror i Qeverisë së tanishme, pse ne t’i kemi fajet për këtë gjë? Përgjegjësitë duhet t’i marrin ata që e kanë nënshkruar gabim demarkacionin.

Të kishte qenë një demarkacion i mirë, të kishte qenë ashtu qysh duhet, nuk do të vinim deri në këtë ditë. Pse opozita ta marrë këtë përgjegjësi? Përgjegjësinë duhet ta marrë ai që e ka nënshkrimin mbi demarkacion dhe nëse kalon kjo marrëveshje, Kosova humb territor. Do të zbulohet herë do kur që ka qenë gabim, e që vendi ka humbur territor.

Pra, duhet t’i thoni të dy ‘nëse’-t, e pastaj qytetarët e matin vetë, edhe deputetët e matin vetë cila ‘nëse’ është me e rëndësishme.

KRYETARI: Jemi te pjesa e një çështjeje, e cila ka të bëjë me Rregulloren, pastaj te qëndrimi politik si ta votojmë këtë pjesën e parë.

Lidhja Demokratike e Kosovës, Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ju përsëritet të gjithëve,

Kolegë deputetë,

Sot jemi mbledhur për një çështje të rëndësishme pas 2-3 ditë diskutimesh dhe pas gati 3 vjet pritjeje për t'i dhënë rrugë një çështjeje kapitale për qytetarët e Kosovës. Mua më vjen keq që ende shoh grupe parlamentare, deputetë që nuk reflektojnë plotësisht karshi interesit të qytetarëve.

Ne kemi negociuar me partitë e koalicionit në dy ditët e fundit për të arritur një marrëveshje që merr parasysh kërkesat e partive të koalicionit, por merr parasysh edhe pozicionin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Që nga dita kur është nënshkruar kjo marrëveshje më 2015, ne kemi qenë për këtë marrëveshjeje, edhe sot jemi për, 27 deputetë të LDK-së.

Ne e kemi përkrahur edhe deklaratën e përbashkët të dy presidentëve, duke qenë se ajo u referohet qartë neneve të marrëveshjes që lejon hapësirë për korrigjim të vijës kufitare kurdo që paraqiten fakte të reja.

Ne ua kemi dhënë opsionin dje partive të shumicës, me të cilat jemi dakorduar, me PDK-në, edhe me "Nismën", unë besoj që edhe partneri tjetër i koalicionit dakordohet dhe të lëvizim përpara. E kemi bërë të qartë pozicionin tonë karshi nenit 3 të këtij ligji, ku ndahen dokumente që i bashkohen kësaj marrëveshjeje në ato që janë pjesë përbërëse e këtij ligji, edhe raporte të tjera të Komisionit Shtetëror për shënimin e kufirit shtetëror, edhe raporti i Murat Mehës, edhe raporti i Bulliqit, edhe raporti i Komisionit nga Akademia e Shkencave, edhe raporti i Komisionit Ndërkombëtar, të gjitha të kaluarën në qeverinë paraprake dhe në këtë Qeveri për orientim, njoftim, informim të deputetëve, në mënyrë që deputetët pastaj, sipas ndërgjegjes së tyre, të votojnë për këtë marrëveshje.

Kjo është temë shumë e rëndësishme, ne nuk duhet të fillojmë seancën pa u arritur konsensusi se si të lëvizim përpara.

Nuk kemi hyrë në seancë për ta rrëzuar këtë Marrëveshje, duhet të fillojmë seancën për ta kryer këtë Marrëveshje, për të ratifikuar Marrëveshjen e demarkacionit të kufirit, për t'i hapur rrugë pastaj korrigjimit të kufirit në përputhje me deklaratën e dy presidentëve dhe në përputhje me Marrëveshjen.

Duke pasur parasysh këto fakte, grupi ynë parlamentar do të votojë kundër shmangies së procedurave për shqyrtim të shpejtë të këtij projektligji, për aq kohë sa nuk ka marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi e ka fjalën, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kanë kaluar më shumë se dy vjet që kemi pritur ta kemi këtë projektligj në seancë, për t'i dhënë një epilog, një prej temave që e kanë preokupuar më së shumti jo vetëm skenën politike, por para së gjithash qytetarët e vendit tonë dhe tash kur jemi kaq pranë për ta pasur shumicën e nevojshme kushtetuese për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, vërtet nuk mund të mos them se s'është për keqardhje që kemi dallime në finesa të terminologjisë për të arritur një tekst të përbashkët, i cili i adreson shqetësimet apo perceptcionet e secilit prej grupeve parlamentare, të cilët edhe publikisht i kanë shprehur qëndrimet pro marrëveshjes.

Partia Demokratike e Kosovës ka qenë konsistente në qëndrimin e vet dhe vazhdon të jetë, po ashtu edhe unike në mbështetje të Marrëveshjes së demarkacionit, veçanërisht tani pas deklaratës së përbashkët të dy presidentëve, të Kosovës dhe të Malit të Zi, të cilët realisht në mënyrë eksplicite, bilaterale, zyrtare i kanë adresuar shqetësimet, të cilat më herët i kanë pasur kundërshtuesit e kësaj marrëveshjeje. Dhe, sinqerisht ne sot e kemi vështirë të shohim arsye të forta për të vazhduar edhe më tutje këtë agoni për qytetarët e Kosovës, të cilët mbi të gjitha na kanë bërë të qartë që kërkojnë lëvizje të lirë. Dhe, kjo lëvizje e lirë është e pamundësuar pikërisht për shkak të moskalimit të ratifikimit të këtij projektligji.

Ju e thatë, zoti kryetar, që nëse ne sot votojmë për shmangie dhe kjo shmangie nuk kalon, ne do t'i kemi së paku edhe dhjetë ditë para se ta kthejmë në seancë këtë projektligj. Pas dhjetë ditësh, edhe nëse arrijmë këtë dakordim, unë kam frikën se do të jemi vonë, e kjo nuk është e drejtë as para qytetarëve të Kosovës, as para partnerëve tanë ndërkombëtarë, veçanërisht kur e kemi parasysh që së shpejti do të kemi vizita nga niveli më i lartë i Bashkimit Evropian, të cilët realisht, sidomos pas marrëveshjes apo deklaramentit të dy presidentëve, kanë pritur që ne do ta kemi këtë konsensus nën vëzhgim nacional për ta tejkaluar këtë problem. Ne si Parti Demokratike e Kosovës jemi të interesuar të gjejmë një zgjidhje, e cila me sukses i jep epilog kësaj çështjeje.

Andaj, me të vërtetë e shohim si shumë problematike, absolutisht edhe të papërgjegjshme nëse sot për çështje procedurale nuk arrijmë ta fusim në rend të ditës kalimin e këtij projektligji. Po e përsëris që ne jemi për një zgjidhje, e cila absolutisht nuk e prek në asnjë mënyrë substancën e projektligjit, sepse për substancë unë besoj që të gjithë tashmë kemi një pajtueshmëri. Ne sot, fatkeqësisht, kemi probleme ndërmjet palëve të caktuara vetëm për çështje terminologjike që më shumë kanë të bëjnë me formën, se sa me substancën. Unë shpresoj që do ta kemi mundësinë që ta kalojmë këtë projektligj se ky është qëllimi dhe besoj që këtu kemi qëllim të përbashkët shumicës dërrmuese. Në çfarëdo forme ne jemi të gatshëm për të vazhduar përpara, besojmë që

duhet të kalojë propozimi për shmangie, sepse kështu i japim mundësi kalimit të shpejtë të projektligjit, por po ashtu do të dëshironim dhe jemi në favor që kjo shmangie të pasohet nga konsensusi, i cili i jep mundësi kalimit të projektligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Ahmet Isufi e ka fjalën, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ka dy vjet e gjysmë që ne përballemi me këtë temë, duke e ditur pikërisht rëndësinë e kësaj çështjeje dhe duke pretenduar që kemi një zgjidhje çfarë e meriton populli i Kosovës.

Pikërisht pse e kemi një projektligj, i cili i saktëson elementet, të cilat në të kaluarën kanë qenë të kundërshtuara për shkak të gabimeve që kanë ndodhur, prandaj marrëveshja me dokumentacionin e Komisionit qeveritar me marrëveshjen e arritur nga dy presidentët, të Kosovës dhe të Malit të Zi, hap rrugën që Kosova të arrijë korrigjimin për gabimet që kanë mundur të lëshohen në të kaluarën dhe po ashtu hap rrugën për liberalizimin e vizave, si një proces shumë i kërkuar i qytetarëve. Prandaj, krejt angazhimi ynë ka qenë që të bëhet korrigjimi, i cili është pranuar edhe nga shteti i Malit të Zi. Nuk duhet të ketë hezitim në këtë drejtim, sepse përmes këtij projektligji ne arrijmë që në të ardhmen, nëpërmjet grupeve punuese të konkretizojmë përkufizimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

Nuk duhet asnjë hezitim në këtë drejtim, përkundrazi, duhet t'i jepet pozitivisht angazhim këtij procesi dhe ta përfundojmë me sukses. Njëkohësisht shmangia nga rendi i ditës është edhe obligimi yni, sepse duam ta kalojmë këtë proces, i cili është i domosdoshëm për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi, me aq sa po e shoh, kolegë nga Lista Serbe. Bilall Sherifi nga Grupi Parlamentar “Nisma” e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë,

Procesi i ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi ka një histori. Së pari, kemi një raport, mbi bazën e të cilit është arritur marrëveshja, pra raporti i Qeverisë Hoxha, Thaçi, se kanë qenë dy qeveri, domethënë ministër ka qenë një kohë Enver Hoxhaj, pastaj ka ardhur Hashim Thaçi dhe kemi një raport të zotit Meha dhe mbi bazën e atij raporti është arritur një marrëveshje, të cilën opozita e atëhershme e ka kundërshtuar fuqishëm. Herë me mjete demokratike, e herë me mjete jo vetëm demokratike. Si rezultat i një mospajtimi të thellë shoqëror, e besa edhe në skenën

politike, një ndarje e thellë, u krijuan rrethanat, në të cilat vendi shkoi në zgjidhje të jashtëzakonshme, pas të cilave erdhëm deri te një qeveri tjetër me zotin Ramush Haradinaj kryeministër.

Me PDK-në që ishte përkrahëse e asaj marrëveshjeje, e cila është edhe sot, me AAK-në, e cila ishte kundërshtuese, edhe me “Nismën”, e cila ishte kundërshtuese në kohën sa ishim në opozitë. Qeveria Haradinaj shkarkoi një komision dhe krijoi një komision tjetër, me kryetar zotin Bulliqi, ish-deputetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ai komision solli një raport, i cili u krijua si bazë apo u përdor, u shfrytëzua si bazë për të arritur te një marrëveshje mes dy presidentëve, Hashim Thaçit të Republikës së Kosovës dhe Vujanoviq të Malit të Zi.

Pra, ka një rrjedhë logjike i tërë procesi si është zhvilluar deri më sot. Tani, për të lëvizur përpara të gjithë së bashku, së paku partitë, të cilat janë zotuar se duke u shfrytëzuar këto dy momente të reja, pra raporti i Bulliqit dhe marrëveshja ndërmjet dy presidentëve, do të mund të arrijmë një unifikim të qëndrimit të përbashkët për të votuar demarkacionin me idenë dhe me qëllimin që në një proces të ardhshëm 2-3 vjeçar të gjitha shqetësimet e Komisionit të Bulliqit, të cilat janë ngritur në raportin e tyre, të rishikohen dhe të korrigjohen gjatë këtij procesi.

Në parim ne jemi për shmangie si “Nismë”, mirëpo mendojmë që duhet të arrihet së pari një unitet se si të lëvizim përpara, në mënyrë që raporti gjithsesi të jetë pjesë integrale e ligjit, mbi bazën e të cilit do të punonte nesër një komision, nuk kam sot një ide, tash momentalisht, se si, sepse 24 orë kemi punuar në drejtim të gjetjes së një formule të përbashkët, kemi qenë afër, jemi afër, nuk e di se si do të mund të lëviznin të gjithë së bashku, por nuk mendoj që ka këtu një front PDK, LDK, “Nisma”, në njërin anë, dhe AAK, në anën tjetër, nuk ka një pozicion të tillë. Ne kemi bërë përpjekje që të japim kontributin tonë të gjithë së bashku të gjejmë një, le ta quaj ashtu, një definicion të përbashkët, se si do të dukej ligji, apo një nen brenda ligjit që do të na lëvizte përpara, të vijmë në këtë pikë, të fillojmë debatin dhe pastaj të vijmë te momenti i votimit.

Në parim, thashë mbështesim shmangien, por nëse shmangia nënkupton hapjen e debatit, ku pastaj do të hynin fjalë në mes dhe jo vetëm që nuk do të afroheshim, por do të largoheshim edhe më shumë, atëherë më mirë të mos e bëjmë. Ndërsa, unë nuk shoh ndonjë dallim shumë të madh në mes të propozimit të LDK-së dhe AAK-së. Mendoj që ka ende hapësirë për të kërkuar një zgjidhje të përbashkët, por në asnjë mënyrë ajo zgjidhje nuk mund të përjashtojë bazën mbi të cilën është ngritur komisioni, është arritur marrëveshja mes dy presidentëve. Pa atë raport të zotit Bulliqi, ai do të ishte i thatë dhe vështirë do të ishte të ngriheshin shqetësime në procesin e rishikimit dhe korrigjimit, siç parashihet në deklaratën mes dy presidentëve që në një nga nenet e saj edhe i referohet edhe si aneks marrëveshje.

Kjo është ajo që desha të sqaroj për ju, kolegë deputetë, edhe për publikun në përgjithësi, ndërsa për rëndësinë e liberalizimit të vizave, për rëndësinë e interesave që të marrim vendime në interes të qytetarëve, nuk mendoj se kemi nevojë t'ia kujtojmë njëri-tjetrit, sepse deri më tani ka tre vjet që shtyhemi për këtë çështje dhe të gjithë tanimë e dinë se sa i rëndësishëm është liberalizimi i vizave. Faleminderit!

KRYETARI: Falënderoj zotin Bilall Sherifi për sqarimet të cilat i dha, por ne të gjithë e dimë si për tre minuta po të duam, merremi vesh, na ka mbetur veç një gjysmë fjale që të merremi vesh. Atëherë, kryeministër, a dëshiron ta marrësh fjalën, pas grupeve parlamentare a tash, e kemi vetëm edhe Albert Kinollin. Kur të doni, në bazë të Rregullores kryeministri e kërkon fjalën kur të dojë. Atëherë, kryeministri e merr fjalën, zoti Kinolli pastaj menjëherë.

Kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Media, kor diplomatik, qytetarë të Kosovës,
Të gjithë bashkëkombës, që na përcillni,
Ka dy vjet e gjysmë që jemi të ndarë si vend për një temë që ka të bëjë me territorin e vendit, e që ka të bëjë me kufirin me njërin nga fqinjët tonë, Malin e Zi, fqinj që sot është anëtar i NATO-s, me të cilin kemi pasur të kaluar edhe tragjike, edhe korrekte, por për të cilin ne në Kosovë kemi qenë të ndarë.
Pas një pune, po e quaj ashtu intensive, kemi mbërritur të vijmë me një, po e quaj “materie” para deputetëve, e kjo materie është kështu: e para, ligji që ka ardhur te ju e ratifikon Marrëveshjen e 26 gushtit 2015, pikërisht këtë.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Në qoftë se ka mundësi...

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Në qoftë se m'i leni, vetëm edhe dy minuta, po kthehem...

KRYETARI: Në qoftë se ka mundësi, kryeministër, vazhdo, ju kisha lutur, secili ka mundësi ta thotë mendimin e vet në këtë seancë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje, nëse m'i leni edhe dy minuta dhe vazhdojmë debatin. Shumë mirë! Ju lutem!

Nëse kolegët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, nëse nuk është kështu, më tregoni, a është duke e ratifikuar ky ligj këtë marrëveshje?

Qeveria e vendit tuaj, e taksapaguesve tuaj, e ka formuar një komision që t'i shohë dilemat. Ai komision e ka punuar një raport, nuk është i Ramush Haradinut, as i babës tim Hilmi. Është i Kosovës. Çka keni bre që po ju pengojnë të gjeturat e atij komisioni? Ku po ju dhemb, o vëllezër e motra? A aq kundër territorit tuaj jeni, a? Aq probleme keni me tokën e juaj të këtij vendi, që ua kanë lënë gjysh e stërgjysh, a? Marre ju qoftë! Marre ju qoftë! Marre ju koftë! Kurr gjë në rregull s'keni? S'po ju vjen marre? Jeni kundër raportit që po thotë se mund të gjendet e vërteta e territorit tuaj...

KRYETARI: Vazhdojmë me seancën e jashtëzakonshme, kryeministër, të lutem!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ky raport është kah ju pengon! S'po e doni këtë raport se kallëzon që po kthehet guri atje. Ku po ju dhemb? A keni problem nëse kthehet guri atje, a? Nëse keni problem, kallëzoni bre! Këtë e keni problem, po kërkon ta relativizoni, po doni ta quani dokument orientues. Jo, sa të jem unë. Jo! Komisioni shtetëror i Republikës suaj e ka prodhuar një raport. Pse po ju dhemb ai raport, o burra? Ku është problemi juaj? A keni problem ju me një raport të Komisionit Shtetëror të vendit tuaj, a?

Ju po e pranoni deklaratën e dy presidentëve, e veç raportin s'po e doni! Eh, po s'ka ligj tjetër! Asnjë germë s'i hiqet këtij ligji që e keni para jush. Bllokojini qytetarët, lini pa liberalizim, lini pa krejt!

KRYETARI: Kryeministër, faleminderit! Albert Kinolli, fjala për ju në emër të Grupit Parlamentar "6+7". Kisha kërkuar vetëm të kemi vëmendje të përbashkët, qetësi. Vetëm pak, unë po e shoh reagimin e grupit. Zoti Avdullah Hoti e dëshiron fjalën. Po, fjala për ju, replikë. Se e shihja reagimin e grupit, por jo tuajin. Ju lutem, a ka mundësi për qetësi. Në qoftë se ka mundësi, vëmendje. Avdullah Hoti e ka fjalën, replikë.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryetar,

Mua më vjen keq, ndihem keq që kryeministri i vendit tim del në foltore dhe përdor... Të kisha lutur shumë tani, unë e kam fjalën tash. Tash e kam fjalën unë, të dëgjova ty, tash e kam fjalën unë, të lutem shumë!

Kush është patriot e kush është tradhtar në këtë vend, dihet. Tre vjet e keni mbajtur këtë shoqëri të ndarë me kauza të rrejshme. Grupi ynë parlamentar nuk voton raporte me kauza të rrejshme. Jemi pajtuar që ai raport, bashkë me të gjitha raportet tjera, t'i bashkohet ligjit, le ta shohin deputetët dhe le të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre.

Nuk e kemi asnjë problem tjetër. Unë e lus kryeministrin, le të jetë i kujdesshëm kur u drejtohet 27 deputetëve, që janë tri herë më shumë se partia e tij, që përfaqësojnë qytetarët e Kosovës këtu. Ka njerëz që i kanë tokat atje, ku ti u referohesh, por që janë të arsyeshëm dhe të kujdesshëm, duke e respektuar çdo normë juridike. Unë ju lutem shumë! Me këtë gjuhë, mua më vjen turp për kryeministrin e vendit sesi u drejtohet përfaqësuesve të popullit.

Marrëveshja është e qartë, ka lënë hapësirë, që kushdo që ka një fakt se mendon, ose ka një fakt, unë i pari dhe grupi ynë ka për ta mbështetur atë fakt për ta rishikuar marrëveshjen, për ta kthyer edhe një herë në procedura të ratifikimit nga e para. Kushdo që ka një evidencë për çfarëdo veprë penale që ka bërë, kushdo që është marrë me marrëveshjen paraprake...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri i vendit, kundër-replikë! Albert bëhu gati. Shkojmë në pauzë menjëherë pas Albertit.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Jo, jo, po e vazhdojmë derisa të ketë nevojë!

KRYETARI: I kisha lutur kolegët deputetë, vazhdojmë. Kryeministri. Albert, fjalën në emër të grupit parlamentar.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Sot e keni para vetes një ligj, tri shtylla i ka: marrëveshjen e juaj, që e keni nënshkruar e që po ju pëlqen, të 26 gushtit 2015, dhe s'keni vërejtje në të, po ju pëlqen ajo; marrëveshjen e dy presidentëve, po ju pëlqen; vetëm raportin e të gjeturat e tij s'po ju pëlqejnë! A bën me e ditë, bre, ku po ju dhemb? Ani, leni pra e të shkojmë e të kryejmë punë! Pse, po i mbani qytetarët të bllokuar? Pse po lypni për ta relativizuar, ta quani dokument jorelativ? Hajde, pra të kryejmë punë!

KRYETARI: Albert Kinolli, fjala për ju! Fjala për ju, përfaqësoje qëndrimin.

ALBERT KINOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Grupi Parlamentar "6+", pasi e ka specifikën e vet dhe përbëhet prej komuniteteve pakicë, romë, ashkalinj, turq, boshnjakë, komunitetet pakicë në përgjithësi, duke e përjashtuar komunitetin serb, gjithmonë e ka pasur interes dhe parim interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe gjithmonë si të tillë jemi sjellë në Kuvend dhe do të sillemi prapë në vazhdimësi, duke pasur parasysh gjithmonë interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe duke pasur parasysh që

ky projektligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i hap rrugë një procesi jashtëzakonisht të rëndësishëm, i cili ka të bëjë me liberalizimin e vizave.

Me gjithë respektin për kolegët e mi të nderuar, ne sinqerisht jemi të befasuar me sjelljen e kolegëve tanë nga komuniteti shqiptar dhe kemi pritur që nga dje që do të ketë një unitet ndërmjet tyre dhe ne atëherë ta japim kontributin tonë me votën tonë pro demarkacionit.

Unë, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kërkoj dhe i lus kolegët e mi dhe ju lus juve për një pauzë pesëminutëshe, që të mos futemi, ju lutem, ju lutem, që të mos të futemi në procedurë të votimit për shmangie nga Rregullorja, për shkak se ne jemi të interesuar që këtë proces ta kryejmë sa më mirë që të jetë e mundur në dobi të qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Për procedura nënkryetari i Kuvendit, Kujtimi e ka kërkuar fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë do t'i jap dy-tri sqarime të shkurtra, por do të theksoj fillimisht që ne nuk e kemi hapur ende debatin politik, as të ballafaqimit të dokumenteve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, se jemi duke e diskutuar procedurën.

Projektligji të cilin e ka miratuar Qeveria dhe na e ka dhënë neve është në kundërshtim me Ligjin për marrëdhëniet ndërkombëtare, për marrëveshjet ndërkombëtare. Çka do të thotë kjo? Ai projektligj si mbështetje i ka dy raporte, të cilat e kundërshtojnë njëra-tjetrën. Është një raport, në bazë të të cilit është arritur një marrëveshje me Republikën e Malit të Zi, të cilën e ka ratifikuar Kuvendi i Malit të Zi, dhe është një raport tjetër, i cili thotë që marrëveshja e lidhur e dëmton Kosovën në territorin e saj dhe e cilëson si tradhti kombëtare.

Çka do të votojmë tani ne këtu, kjo është çështja. Ky projektligj, për këtë arsye, nuk mund të votohet me këto dy dokumente. Projektligji ratifikon një marrëveshje dhe marrëveshja duhet të jetë e qartë dhe argumenti duhet të jetë i qartë. Për pjesët tjera, unë besoj se do të kemi kohë të mjaftueshme që të bisedojmë. Unë do të kërkoja nga kolegët, ju kërkoj falje që po ju drejtohem kështu, në radhë të parë nga shumica, dhe nga kryeministri, që të prijë drejt gjetjes së zgjidhjes. Problemi nuk ka të bëjë me faktet, problemi konkret, problemi ka të bëjë më qëndrimet politike dhe zgjidhja është politike. Edhe unë pajtohem që jemi shumë afër dhe unë besoj shumë që do ta gjejmë atë zgjidhje.

Na jepni rast, ta keni parasysh që jemi opozitë, ta keni parasysh zoti kryeministër që jemi deputetë, përfaqësues të popullit të Kosovës dhe, edhe nëse e keni të pamundur të na respektoni

si persona, respektojeni funksionin tonë dhe na e bëni të mundur të ju respektojmë edhe ne ju për funksionin që e keni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në rrugë të mirë, bashkërisht të gjithë. Po, a ka mundësi për vazhdimin e seancës? Kisha kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare, pesë-dhjetë minuta pauzë e takohemi për vazhdimin e seancës. Vetëm le të shkojë veç me mbarëvajtje, s'kemi nevojë, qëndrimet do t'i thotë secili. Thjesht! Urdhëro, Glauk, vetëm pak! I kisha lutur kolegët deputetë, ta respektojmë njëri-tjetrin, kjo është me rëndësi.

GLAUK KONJUFCA: Zyrtarja e BE-së, Sesilia Malbstrom, nëse po ju kujtohet, ia ka sjellë Kosovës udhërrëfyesin për kushtet për liberalizim të vizave në vitin 2012. Domethënë, gjashtë vjet po bëhen. Tash, pesë minuta sot, pesë minuta nesër, pse po e shtyn liberalizimin e vizave, pra?

Ta bëjmë më shpejt liberalizimin e vizave, mbasi jeni aq të etur dhe le të dalë në votim kjo marrëveshja e demarkacionit dhe bëjini vizat shumë shpejt pasi po keni qejf dhe po ju ngutet kaq shumë. Mirëpo, atje mos harroni që është edhe një kriter tjetër shumë me rëndësi, korrupsioni. E njëri prej rasteve më të mëdha të korrupsionit sot në Kosovë është kthyer prapa. Është rasti i korrupsionit me tokat, 50 milionë euro fliten për atë korrupsion, se është bërë dëmi për Kosovën, tjetërsimi i pronave.

Pra, nuk keni kurrfarë garancie, as të lidhet ky proces thjesht me ardhjen automatike të liberalizimit të vizave. E nëse doni ta bëni më shpejt, lini këto pauza, hidheni në votim dhe e shihni qysh i keni votat.

KRYETARI: Kryetarët e grupeve parlamentare, 5 minuta konsultim. Pauzë pesë minuta, dhjetë minuta, edhe pastaj e vazhdojmë seancën në bazë të mbarëvajtjes. Edhe kisha pasur dëshirë që çështjet e gjyqësisë të mos tiren shumë, se...

(Ndërprerje e incizimit)

Mundësisht në Kabinet, shefat e grupeve parlamentare.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, jemi në vazhdimin e seancës.

Ne e patëm një takim konsultativ me shefat e grupeve parlamentare, për korrektësi shefi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" nuk ka bartur qëndrim, sido që të jetë për vazhdimin e seancës e bartim fjalën tash te shefat e grupeve parlamentare. Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ndoshta është shumë me rëndësi për opinionin publik ta sqaroj se përse Lëvizja “Vetëvendosje” nuk mori pjesë në këtë takim.

Ne i konsiderojmë të dyja qëndrimet, si atë të Qeverisë së Kosovës, si atë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, si qëndrime të gabueshme, për të cilat nuk ka shumë hapësirë negociimi. Qëndrimi i LDK-së është që marrëveshja të miratohet ashtu sikur 2015-ta dhe pa asnjë... përpos deklaratave të presidentëve, kurse qëndrimi i Qeverisë është që të jetë pjesë edhe raporti i Bulliqit, mirëpo kjo i bie kështu: “E di që ka pasur gabime, e di që ka pasur humbje të territorit, po duhet ta ratifikojmë humbjen e territorit, e pastaj të shikojmë nëse mund ta kthejmë territorin më vonë”.

Unë mendoj që të dyja pozicionet janë të gabueshme dhe i hapin Kosovës probleme të mëdha kurdoherë në vitet e ardhshme. Kështu që na janë dukur si pozicione, të cilat ndoshta mund të afrohen me njëri-tjetrin, mund të afrohet pozicioni i LDK-së me të Kryeministrit, por Lëvizja “Vetëvendosje” i konsideron të gabueshme të dyja.

KRETARI: Jemi duke folur për çështje procedurale, jo tematike. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Kryetar!

Sigurisht për çështje procedurale, por nuk mund të shkojmë më tutje pa e qartësuar edhe një herë për zotin Konjufca, qëndrimi i LDK-së është i qartë, ne e mbështetim marrëveshjen e vitit 2015, ne e mbështetim deklaratën e dy presidentëve, ne gjithashtu e mbështetim që këtij ligji t’i bashkëngjiten edhe raportet e të gjitha komisioneve deri tash që janë aprovuar në Qeverinë paraprake dhe në këtë Qeveri, për orientim, për informim të deputetëve dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës le të vendosin me ndërgjegjen e tyre kur ta japin votën për marrëveshjen për demarkacionin. Ky është qëndrimi ynë.

Ne në këtë çështje kërkojmë konsensus. Është aq e rëndësishme sa i tejkalon interesat e një partie politike, qoftë në pozitë, ose në opozitë. Në fakt, unë i ftoj edhe kolegët nga “Vetëvendosje” të ulemi të punojmë në draftin e ligjit, të dakordohemi dhe ta votojmë këtë sot, hiç pa pritur as nesër, as të hënë, ta kryejmë këtë çështje menjëherë, pa pasur nevojë fare të presim për votat e Listës serbe. Ky është qëndrimi ynë. Përndryshe, ne kërkojmë që të arrihet ky konsensus para se të hapet seanca dhe të organizohet procesi i votimit. Pra, jemi dakord që seanca të shtyhet për një kohë më të përshtatshme, pasi të mbërrihen të gjitha konsensuset. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Siç e thashë edhe në fjalën time paraprake, ne mendojmë që më e rëndësishmja është që të hyjmë në një proces të votimit, i cili mundëson ratifikimin e marrëveshjes dhe duke parë që sot një gjë e tillë duket e pamundur, qëndrimi i PDK-së është që ta vazhdojmë punën në arritjen e konsensusit nacional për sa i përket kalimit të projektligjit.

Andaj, ne jemi në favor të asaj që pesë shefat e grupeve parlamentare në takim edhe me ju u dakorduar që seanca të vazhdojë të hënën në orën 10:00, me shpresë që deri atëherë të arrijmë me të vërtetë tejkalimin e atyre dallimeve terminologjike që i përmendëm më herët. Faleminderit!

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ahmet Isufi, fjala për ju.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Siç e theksuam edhe më herët, ne kemi qenë që të rishikohet dhe të korrigjohet gabimi që është bërë në mandatin e kaluar nga Komisioni Shtetëror, i cili është vërtetuar se ka gabuar.

Prandaj, mendojmë që duhet të bëhen veprime të cilat janë të logjikshme, që t'i lejohej komisionit të tashëm të vërtetohet nëpërmjet dokumentacionit që e ka ofruar nëpërmjet ligjit. Prandaj, kthimi i territorit të humbur për ne është i domosdoshëm dhe duhet të bëhet nëpërmjet formës ligjore, siç është edhe në bazë të marrëveshjes që është arritur, nëpërmjet dy presidentëve. Pajtohemi që të ketë konsensus në këtë drejtim dhe pajtohemi po ashtu që të hënën, në orën 10:00, të ketë mbledhje.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Po, ashtu siç u dakorduar në mbledhjen e pesë shefave të grupeve parlamentare, kryetarëve, jemi që seanca të shtyhet. S’kam çfarë të shtoj më shumë, për të hënën, ashtu siç propozuam. Le të vendosë seanca, dëshiron apo jo?

KRYETARI: Faleminderit! Albert Kinolli nga Grupi “6+” e k fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Definitivisht po shihet që ka nevojë për pak kohë, ka nevojë për konsultime shtesë dhe për unitet politik.

Ne siç u dakorduar më herët, kur të arrihet konsensusi ndërmjet subjekteve të mëdha politike, edhe ne jemi që kjo seancë të mbahet atë ditë, përndryshe nëse të gjithë janë të pajtimit për të hënën, siç u dakorduar, edhe ne jemi të pajtimit për këtë ditë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës e ka fjalën. I kisha lutur kolegët deputetë për vëmendje.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar Veseli,
Kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

E mora vesh kohën, të hënën në orën 10:00 është një takim i kryetarëve të qeverive në Londër, në ABRD. Nëse s'e merrni për ofendim, atë ditë e kisha lënë një koleg, ose nëse bën ndonjë ditë tjetër. Edhe diçka, shikoni, unë këtë ligj që e kam sjellë sot, i mirë a i keq, kam qenë në gjendje ta votoj sot, Aleanca është në gjendje ta votojë sot, këtë që e kemi sjellë. Merreni përgjegjësinë për vonesat, ju lutem, kush po i vonon.

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, atëherë a ka mundësi, e kemi një propozim, një qëndrim nga grupet parlamentare dhe shkojmë në votim. Propozimi është i qartë, mbajtja e seancës së jashtëzakonshme, vazhdimi ditën e hënë, në orën 10:00.

Nënkryetari Kujtimi, urdhëro!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që për këtë çështje është e domosdoshme që kryeministri të jetë i pranishëm. Kështu që propozoj që ta japim një datë dhe një orë tjetër. Kryeministri duhet të jetë në seancë.

KRYETARI: Kryeministri ashtu-kështu do të kthehet të martën, kemi në propozim për të hënë. A shkojmë në votim? A shkojmë në votim apo jo, kjo është?

Kujtimi, edhe një herë nënkryetari, vetëm shpejt se do të shkojmë drejt vendimmartjes, përgjegjësia është e juaja.

KUJTIM SHALA: Zoti kryetar!

Unë po e përsëris që kryeministri duhet të jetë në seancë, kështu që ta caktojmë një ditë dhe një datë tjetër. Domethënë, për këtë çështje në seancë duhet të jetë kryeministri, është e domosdoshme.

KRYETARI: Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme ditën e mërkurë, në orën 10:00. E kemi edhe delegacionin e lartë të Bashkimit Evropian po atë ditë, në orën 10:00.

Vetëm pak, do të shkojmë në votim. Jo, jo...! Seanca vendos. Më mirë është të shkojmë me votim.

Në ora 10:00, ditën e mërkurë, kush është për? Me ngritje formale dore, kush është për? Ditën e mërkurë, në orën 10:00, kush është për? Vetëm pak, Administrata ju kisha lutur, të konstatohet. Ose, e bëjmë me elektronikë, pse ta komplikojmë?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, seanca e jashtëzakonshme - vazhdimi, të mërkurën, në orën 10:00. Ju lutem, votojmë tash!

91 deputetë kanë votuar. 60 janë për shtyrjen e seancës për të mërkurën, në orën 10:00, 30 janë kundër, 1 abstenim.

Të gjitha udhëtimet e parapara anulohen për ditën e mërkurë. Për kolegët deputetë, ta kini parasysh, të gjitha vendimet. Kështu ka qenë vendimi i Kryesisë.

Mirupafshim të mërkurën, në orën 10:00!

* * *

E mërkurë, 28 shkurt 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 22 dhe 23 shkurt 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Në sallë janë të pranishëm 67 deputetë.

Para se të vazhdojmë me punimet e seancës, zonja Ganimete Musliu e ka kërkuar fjalën.
Urdhëro, zonja deputete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,
Të nderuara medie,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Sot është 28 shkurti, një datë shumë e veçantë për historinë e Kosovës dhe për popullin tonë.

Prandaj, duke e kujtuar me epitelin më të lartë Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betejën e Likoshanit dhe Qirezit 20 vjet më parë, 28 shkurtin 1998, kur në Likoshan e Qirez, pikërisht te Gjash të Lisat e Likoshanit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës e fitoi betejën e parë frontale, kërkoj nga ky Kuvend që në pamundësi që sot të jemi pranë familjarëve të të rënëve, martirëve e dëshmorëve të asaj date, sot të rënë për liri t'i nderojmë me një minutë heshtje, ose me një minutë nderim.

KRYETARI: Faleminderit! Një minutë nderim!

(Një minutë nderim)

GANIMETE MUSLIU: Lavdi të gjithë dëshmorëve të Kosovës!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të thirrur me kërkesë të kryeministrit, zotit Ramush Haradinaj, të filluar më 22 e 23 shkurt 2018, me pikën e vetme të rendit të ditës: **1. Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi**

Të nderuar deputetë,

Për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi kërkohet vendimi i Kuvendit për shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Do të thotë, për shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit është diskutuar edhe në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, e mbajtur më 21 shkurt 2018.

Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare për t'iu shmangur Rregullores.

Tani kërkohet deklarimi i kryetarëve të grupeve parlamentare.

Nga Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Lëvizja “Vetëvendosje” është kundër shmangies për procedura të përshpejtuara lidhur me trajtimin e kësaj marrëveshjeje për shkak që ne mendojmë se një version i tillë i demarkacionit duhet të tërhiqet krejt nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Këtu kemi të bëjmë me një demarkacion, për të cilin Komisionit Shtetëror, i emëruar nga kryeministri, ka ardhur deri te gjetje shumë problematike sa i përket shënimit të vijës kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës, dhe ky raport, me 600 faqe që i ka, ka sjellë të dhëna shumë kredibile që Komisioni i Murat Mehës ka bërë shkelje serioze sa u përket procedurave teknike, edhe negociatave bile, me Komisionin e Malit të Zi për përcaktimin e vijës kufitare.

Në momentin që neve në Kuvend na vjen një raport i tillë, siç është raporti i Komisionit Shtetëror, kryeministri me automatizëm do të duhej ta kishte tërhequr demarkacionin aktual - marrëveshjen aktuale, e arritur nga Qeveria e kaluar dhe ta kthente mbrapsht.

Hedhja në votim dhe ardhja në shqyrtim e kësaj marrëveshjeje është paradoks në vetvete për shkak që ju e keni marrëveshjen dhe e keni po ashtu në të njëjtën kohë edhe raportin, i cili thotë “nëse votohet kjo marrëveshje, deputetët marrin automatikisht mbi supet e tyre një barrë shumë të rëndë sa i përket edhe aspektit penal”.

Kështu që ne, për këtë arsye, jemi kundër shmangies nga rendi i ditës, sepse mendojmë që një pikë e tillë nuk do të duhej të kishte ardhur fare.

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar vetëm në aspektin procedural, para se të hyjmë në debat, pastaj e bartim edhe qëndrimin politik.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Avdullah Hoti, fjala për ju.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Duke qenë se ka marrëveshje sesi të procedojmë përpara, grupi ynë parlamentar e përkrahë këtë shmangie prej Rregullores. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah mocionin për shmangie nga Rregullorja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës pajtohet për shmangie nga Rregullorja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, zoti Bilall Sherifi, fjala për ju.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i “Nismës” pajtohet me mocionin për shmangie nga Rregullorja.

KRYETARI: Zonja Duda Balje, nga Grupi Parlamentar “6+”, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Edhe Grupi Parlamentar “6+” pajtohet me mocionin për shmangie nga Rregullorja.

KRYETARI: Faleminderit, kolegë deputetë!

Tani kërkohet deklarimi me votim për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

Kanë votuar 62 deputetë, 62 për. Konstatoj se Kuvendi vendosi që shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të bëhet me shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit.

Tani jemi në procedimin e shqyrtimit të Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërkohë e kemi edhe një tekst të marrëveshjes nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Urdhëroni, për shtim të kësaj, zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Neve na vjen mirë që pas diskutimeve të LDK-së me partitë e koalicionit, përfshirë edhe minoritetin joserb, është arritur të dakordohet teksti i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes.

Më lejoni ta lexoj tekstin dhe të kërkoj pastaj nga Komisioni për Politik të Jashtme që të tërhiqet menjëherë për ta sjellë para deputetëve projektligjin sipas kësaj marrëveshjeje.

Pra, neni 3 i projektligjit bëhet kështu:

1. Pjesë përbërëse e këtij ligji janë Marrëveshja për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë, më 26 gusht 2015.
2. Deklarata e përbashkët e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, dhe presidentit të Malit të Zi, Filip Vujanoviq, e datës 16. 2. 2018.
3. Dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e kufirit shtetëror për orientim.

Pra, ky është teksti për të cilin jemi dakorduar. Kërkoj që Komisioni të tërhiqet menjëherë, ta sjellin tekstin e ri para deputetëve dhe pastaj të procedojmë në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo është në fakt marrëveshja. Kisha kërkuar që Komisioni për Punë të Jashtme të mblidhet dhe të na sjellë material për procedim, pastaj në seancën e jashtëzakonshme për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Ndërkohë do t'i lajmërojmë kolegët deputetë derisa Komisioni ta kryejë punën e vet për vazhdimin e seancës. Faleminderit!

Kryetare e Komisionit sa kohë të duhet minimum? Vetëm pak! Komisioni e përfundon, pastaj duhet të shpërndahet materiali në tri gjuhë, përkthimi në tri gjuhë. Do të ju lajmërojmë me kohë. Jemi në pauzë.

* * *

E martë, 20 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 22, 23 dhe 28 shkurt 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Në sallë janë të pranishëm 85 deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të thirrur me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, e filluar më 22, 23 dhe 28 shkurt 2018, me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin.

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Media,

Qytetarë të Kosovës,

Kam nderin të paraqes para jush Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të popullit,

Kemi kaluar një fazë jo të lehtë për të adresuar para jush një çështje ndër më të rëndësishmet për shtetin.

Pas shumë përpjekjesh, bisedash e negociatash me partnerët dhe miqtë e Kosovës, por edhe me Malin e Zi, kemi arritur të gjejmë një formulë të pranueshme për të gjitha palët. Kemi arritur që

edhe ta ruajmë të drejtën për tokën tonë, ta ruajmë cilësinë me Malin e Zi dhe partneritetin me aleatët strategjikë të Kosovës.

Jam i bindur se marrëveshja ndërmjet dy presidentëve dhe të gjeturat e Komisionit shtetëror e plotësojnë marrëveshjen e nënshkruar më 2015 dhe krijojnë bazë të pakontestueshme ligjore për korrektimin e gabimeve të bëra në procesin paraprak, posaçërisht në drejtim të Kullës dhe Çakorrit, siç është specifikuar edhe në ankesë marrëveshjen e presidentëve.

Vota pro këtij ligji sot më shumë se kurrë është votë për shtetin e Kosovës, është votë për perspektivën euro-atlantike të vendit, është votë për liri të lëvizjes. I kemi analizuar të gjitha faktet dhe rreziqet dhe ju garantoj se ratifikimi i këtij projektligji me dokumente përcjellëse nuk e rrezikon territorin e Kosovës.

Të nderuar deputetë.

Vendimi është në dorën tuaj dhe vota pro e këtij projektligji sot është edhe kërkesë e shumicës së qytetarëve.

Ju bëj thirrje, pa dallim partie a etnie, edhe bindje ideologjike, të votoni pro këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Ftoj kryetaren e Komisionit për Punë të Jashtme, zonjën Vjosa Osmani-Sadriu, për arsyetimin e raportit të komisionit. Urdhëro, zonja Osmani!

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Komisioni për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar marrëveshjen për kufirin shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi në një sërë takimesh, kemi pasur së paku katër takime, përfshirë një takim të përbashkët me Komisionin shtetëror për shënimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

Në takimin e fundit Komisioni ka shqyrtuar amendamentin e propozuar në seancë nga shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, zotit Hotit, dhe ky amendament ka kaluar me shumicë votash, për më tepër, raportin e kanë përpara vetes të gjithë deputetët.

Ta sqaroj, kjo që e thashë është në emër në komisionit, ndërkaq si deputete e LDK-së do të flas më vonë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dua të shpreh kënaqësinë që më në fund, gati tre vjet pas nënshkrimit, Kuvendi i Kosovës është mbledhur për të votuar marrëveshjen për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Me këtë shtet fqinj, me këtë shtet mik, anëtar të NATO-s që e ka njohur shtetin e Kosovës qysh në fillim, pa asnjë hezitim.

Për dallim prej herës së kaluar, seanca e sotme, siç po shihet, do të zhvillohet pa gaz lotsjellës, e pa dhunë ndaj kryeministrit, deputetëve dhe policisë.

Një nga ata që nxiste dhunë sot është kryeministër, por ne nuk do ta sulmojmë atë, edhe pse kemi të drejtë morale për ta bërë këtë gjë. Për më tepër, kësaj radhe si duket nuk ka as plan për të lejuar futjen e gazit lotsjellës në Kuvend, së paku deri tash.

Sidoqoftë, Lidhja Demokratike e Kosovës i gëzohet faktit që Kuvendi i Kosovës sot nuk po bëhet gaz i botës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne besojmë se marrëveshja është e drejtë, përmes neneve 7, 9 dhe 11 të marrëveshjes palët obligohen të rishikojnë marrëveshjen në rast se paraqiten fakte të reja, pra formohen trupa të përbashkëta, shqyrtohen fakte të reja, nëse faktet validohen, përpilohet marrëveshje e re dhe ne shkojmë në proces të ri të ratifikimit.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës e ka mbështetur këtë proces qysh në fillim, prandaj miqtë tanë na kanë mbështetur në këtë proces.

Lidhja Demokratike është parti e themeluar nga presidenti Rugova, kauza jonë për shtet të pavarur dhe sovran ka filluar para tre dekadash, asnjëherë në asnjë moment nuk kemi ndërmarrë veprime që mund të dëmtojnë shtetin e Kosovës, pavarësisht faktit a kemi qenë në pozitë apo në opozitë.

Të nderuar deputetë,

Deklarata e presidentëve është konfirmim i marrëveshjes, i neneve 7, 9 dhe 11. Ndërkaq marrëveshja është ajo e vitit 2015, asnjë shkronjë e asaj marrëveshjeje nuk ka ndryshuar, rrethanat kanë ndryshuar dhe më vjen mirë tani që po mbështetet nga një pjesë e opozitës së atëhershme, megjithëse qytetarët kanë mbetur të izoluar për tre vjet.

Të nderuar kolegë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, edhe ju e dini që ratifikimi i kësaj marrëveshjeje siguron lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës, marrëveshja kontribuon shumë në rritjen e

dinamikës së proceseve euro-integruese të Kosovës, marrëveshja hap rrugë për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Në frymën e saj që thashë më lart lidhur me nenet 7, 9 dhe 11 të marrëveshjes, unë ju garantoj se ne do të jemi këtu bashkë me juve në rast se ka nevojë t'i sjellim edhe një herë këtë marrëveshje për ratifikim në Kuvend, në rast se ka fakte të reja.

Pa votën tuaj ratifikimi i kësaj marrëveshjeje varet nga Lista serbe, prandaj ju ftoj që të bashkoheni që të shmangim çfarëdo rreziku për koncesione që mund të bëhen në dëm të shtetit të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur Lidhja Demokratike e përkrahte këtë marrëveshje, zoti Haradinaj përdorte fjalë fyese për Lidhjen Demokratike dhe kryetarin Mustafa. Nuk do të merrem me to, ata fyerje të mbesin në ndërgjegjen e tij. Po atë që dua të them tash, çfarë duhet të bëjë zoti Haradinaj pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Prapë, nuk do t'i referohem zakonisht, sepse është i ashpër në situata të tilla dhe ai e di këtë. Por, me rregullat e demokracisë, pas ratifikimit të marrëveshjes ai duhet të japë dorëheqje, Kuvendi duhet të shpërbëhet, vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja, sovranit le të vendosë se kush do ta udhëheqë Kosovën drejt integrimeve evropiane.

Kosovës i duhet një Qeveri normale që punon për qytetarët, e jo për politikanë, Kosovës i duhet Qeveri proevropiane, civilizuese, me të cilën qytetarët ndihen mirë, të cilën Lidhja Demokratike mund ta sigurojnë.

Qeveria e re do ta kthejë debatin në këtë Kuvend për jetën e qytetarëve, për arsim, për shëndetësi, për bujqësi, për punësim, për ushtrinë, për integrimin e komuniteteve, për avancimin e agjendës evropiane, e jo debat për fatin e politikanëve dhe të ardhurave të tyre.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni në fund që edhe një herë të konfirmoj mbështetjen unanime të deputetëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për këtë marrëveshje, të konfirmoj gjithashtu mbështetjen për deklaratën e përbashkët të dy presidentëve, e cila bazohet në këtë marrëveshje, e shpreh vullnetin e dy shteteve që në mirëbesim të adresojnë kontestet eventuale.

Na vjen mirë që koalicioni qeverisës, përfshirë edhe partinë e kryeministrit, është pajtuar që i gjithë dokumentacioni zyrtar i Komisionit shtetëror, i aprovuar në Qeverinë e Kosovës në këtë mandat dhe në mandatin e kaluar, të jenë në dispozicion vetëm për orientim të deputetëve, t'i

lënë deputetët e Kosovës që duke pasur parasysh të gjitha argumentet e ofruara në këtë dokumentacion të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar nënkryetarë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Çështja të cilën edhe një herë e kemi sot në shqyrtim në Kuvendin e Kosovës, është një temë që në tre vjetët e fundit pothuajse është diskutuar dhe është thënë gjithçka ka për t'u thënë për këtë temë.

Në këtë Kuvend kemi parë edhe skena, të cilat s'i kanë takuar as jetës parlamentare, as një shtetit të ri si Kosova që ballafaqohet me shumë probleme dhe gjithë kjo ka ardhur pikërisht për shkak të mendimeve, mospajtimeve dhe kundërshtimeve që kemi pasur për këtë çështje.

Sot, gati tre vjet më vonë, pas zhvillimeve të cilat secili qytetar i Kosovës tashmë i di, e mbi të gjitha pas edhe një marrëveshjeje, një letre të nënshkruar nga presidentët si udhëheqës të dy shteteve, të Kosovës dhe të Malit të Zi, ku në mënyrë zyrtare merren përsipër obligime bilaterale për të rishqyrtuar dhe për të përmirësuar, nëse ka fakte, pikërisht ato pika të marrëveshjes që janë kundërshtuar në të kaluarën, ne besojmë që kanë pushuar edhe ato arsye që dikush ka mundur t'i ketë në të kaluarën për ta kundërshtuar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi.

Pra, gati tre vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes për demarkacionin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, ne sot jemi mbledhur prapë për t'i dhënë drejtim përmes, unë besoj, ratifikimit me 2/3 të kësaj marrëveshjeje, të këtij projektligji dhe për t'i çliruar qytetarët e Kosovës më në fund nga kjo temë, e cila për fat të keq është shndërruar në një lloj traume kolektive dhe që ka pamundësuar për një periudhë tepër të gjatë në mënyrë krejt të padrejtë edhe lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës, duke i lënë njerëzit sikur vrimën e fundit të zezë në Evropë që s'mund të lëvizin lirshëm në zonën Shengen.

Sot, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, kërkojmë nga të gjithë kolegët deputetë që në vendimin e tyre të kenë parasysh interesat e qytetarëve të Kosovës, interesat e këtij shteti, dhe jo interesat e politikave ditore apo qëndrimet të cilat dikush mund të mendojë se mund t'i sjellin më votë më shumë ose më pak.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës unë konfirmoj se ne unanimisht do të votojmë për miratimin e Projektligjit për marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe i ftojme të gjithë që ta bëjnë të njëjtën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Kryeministër i Kosovës zoti Ramush Haradinaj, Këtu t’i kemi sjellë në këtë Kuvend zërat e 205 mijë qytetarëve, nënshkrimet e të cilëve i ke mbledhur bashkë me ne dhe të cilët kanë bërë thirrje të qartë që në këtë Kuvend të Kosovës të rrëzohet ky demarkacion i gabueshëm, i cili Kosovës i humb territor.

Edhe vetë personalisht ke bërë shumë përpjekje fizike të futësh këtë peticion këtu brenda në Kuvend, t’i kemi sjellë këtu për ta kujtuar se me çfarë premtimesh ke ardhur në krye të Qeverisë së Kosovës.

Prandaj, e kemi një lutje për ty dhe një kërkesë: mos ua kthe shpinën këtyre qytetarëve!

Unë u bëj thirrje deputetëve të “Vetëvendosjes” që ta sjellin këtu përpara atë peticion.

Sot do ta marrim një vendim këtu, prandaj ndodhemi përpara një zgjedhjeje, zgjedhja pa dyshim që është vendimtare, por unë mendoj që është shumë e lehtë, sepse do të përcaktohem a t’i mbrojmë gabimet e Murat Mehës apo do ta mbrojmë territorin e shtetit.

Nuk kam dyshim që bindjet tuaja më të thella ju thonë që duhet ta mbron Republikën, ama interesi i pushtetit është që t’i mbron gabimet.

Unë besoj dhe ju inkurajoj që të vendosni sipas bindjeve dhe jo sipas autoriteteve apo sipas interesit të pushtetit.

Një prej vendimeve të para dhe të mira të kësaj Qeverie ka qenë shkarkimi i Komisionit të Murat Mehës dhe emërimi i Komisionit të ri shtetëror për vlerësimin e punës së komisionit paraprak.

Komisioni i ri gjeti se Komisioni i Murat Mehës ka bërë shkelje të rënda dhe ka krijuar një vijë të re kufitare me Malin e Zi në dëm të territorit të Kosovës. Sot po votohet për këtë demarkacion, me shkeljet që i ka gjetur Komisioni Bulliqi.

Po të lexohet raporti i Komisionit të Ramush Haradinajt, aty thuhet: “Kurrësi të mos votohet ky demarkacion i Murat Mehës”.

Qëndrimi se një herë duhet ta votojmë këtë marrëveshje, e pastaj e ndryshojmë, është një tallje me qytetarët, me shtetin dhe me sovranitetin e vendit.

A ma thoni një shtet, i cili me dorën e vet ka dhënë territor dhe pastaj e ka kthyer atë territor me lutje apo me deklarata politike? Ju ftoj të mos bëheni kaq naivë.

Sot kryeministri e ka për borxh vetëm të na tregoj një gjë, drejt, ama, pa i rënë rrotull. Personalisht, a pajtohet me raportin e komisionit që e ka emëruar vetë. Të na tregojë a pajtohet me Komisionin Bulliqi apo nuk pajtohet. Kaq. Sepse deputetëve u mjafton ky informacion për ta ditur edhe më saktë si të votojnë.

Nëse kryeministri pajtohet me Komisionin Bulliqi, marrëveshja do të hedhet poshtë, marrëveshja e vitit 2015.

Po nëse kryeministri pajtohet me Komisionin Meha, le të dalë këtu në foltore e të thotë se e ka ndryshuar qëndrimin, le t'u kërkojë falje qytetarëve të Kosovës për këto që po i bën, pra për ndryshimin e qëndrimit.

Ne i patëm thënë Ramushit në atë kohë që të mos hynte në koalicion me PDK-në, sepse i patëm thënë që kur të hyjë aty, nuk ndryshojnë ata, po ndryshon ti dhe doli ashtu, bash qysh i kemi thënë.

Ramushi erdhi në Qeveri me premtimin se ky version duhet të rrëzohet me vota në Kuvend të Kosovës, por mendoj që ka rezistuar vetëm gjashtë muaj.

Sot po shkon drejt te qëndrimi i PDK-së dhe i Murat Mehës.

Sot kryeministri duhet t'i kërkojë falje Murat Mehës, pse ia përplasi për fytyrë hartat e demarkacionit, të cilin sot po e mbështet vetë.

Paradoksalisht unë mendoj që kësaj Qeverie i konvenon më së pakti të kalojë demarkacioni. Pse po e them këtë? Sepse duke e mbajtur si top temë nacionale tash e tre vjet përmes demarkacionit, është fshehur korrupsioni, të gjithë e dimë.

Po të kalojë ky demarkacion, qytetarët dhe shteti do të pësojë më së shumti. Do ta marrin vesh që korrupsioni është kusht edhe më i rëndësishëm se demarkacioni, para atëherë e marrim vesh.

Territorin do ta humbim nëse kalon kjo marrëveshje, ta keni të qartë, hajnat mbesin, kurse vizat nuk hiqen. E kur të ndodhë kjo, do të vajtojmë si popull, por do të jetë shumë vonë. E unë po kërkoj që kjo të mos ndodhë.

Meqë po flasim dhe jemi te territori i shtetit, dua t'u drejtohem edhe deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Qeveria e kaluar e LDK-së u rrëzua nga PDK-ja me arsyetimin se ju nuk mund të merrni vendime të mëdha. Tash po jua kërkojnë votën e gatshme për të njëjtën arsye për të cilën ju kanë rrëzuar. Ju ka rrëzuar dhe tash për të njëjtën arsye po jua kërkojnë votën. Aq sa e kuptoj unë politikën, vota e LDK-së për këtë skenar, mendoj që është vetëvrasje politike, sepse mesazhi është ky:

Ju nuk dini të qeverisni, ne ju rrëzojmë kur të duam, kështu që detyra juaj është të strukeni në pozitë dhe të na jepni votën hazër, prej pozicionit të opozitës, kurdo që ne jua kërkojmë atë.

Unë mendoj që mesazhi, nëse LDK-ja e voton këtë demarkacion, për të cilin PDK-ja e ka rrëzuar, unë mendoj që qytetarëve ua jepni këtë mesazh.

Unë mendoj që kjo është fatale për Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Pas këtij vendimi, harrojeni rrëzimin e Qeverisë. Nëse LDK-ja e voton këtë demarkacion, nuk ka kurrfarë të drejte morale më të flasë për rrëzimin e Qeverisë, sepse thënë të drejtën, ky propozim i Qeverisë edhe ta ofendon inteligjencën.

Këta po thonë, ka gabime, po njëherë duhet të ratifikohen gabimet, pastaj shikojmë në mos po mund t'i rregullojmë ato!

Unë mendoj që e kundërta është e drejtë, nëse paska gabime, nëse edhe presidenti bile ka dalë një ditë në televizor e ka thënë se mund të ketë gabime. A nuk do të ishte rruga më e drejtë t'i përmirësojmë gabimet një herë, e pastaj ta ratifikojmë marrëveshjen e përmirësuar.

Ta dini një gjë, nëse i çoni duart për këtë marrëveshje, nuk ka më përmirësime. Përmirësime ka veç sa i lejon neni 7 i marrëveshjes. Ato janë disa metra në thellësi të territorit të Malit të Zi ose disa metra në thellësi të territorit të Kosovës. Kudo që ka ndonjë shkrep apo terren të papërshtatshëm. Ama nëse votohet kjo marrëveshje, në këtë mënyrë harrojeni Kullën e harrojeni Çakorrin, nuk ka më Kullë e Çakorr, ta keni parasysh, sepse marrëveshja e presidentëve në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk ka kurrfarë obligimi juridik Mali i Zi përtej asaj që e kanë çuar dorën 80 deputetë të Malit të Zi në Kuvendin e tyre. Këtu nuk mund të bëhemi naivë dhe fëmijërorë e të themi “nuk e kemi ditur”, se vetë fëmija juaj do t'u thonë “i keni ditur, krejt e keni pasur të qartë, po e keni dhënë me vullnet edhe paturpësisht territorin e Republikës së Kosovës”.

Pra, unë kërkoj të mos votohet kjo marrëveshje sepse është e vetmja mënyrë që të kemi shpresë për përmirësim të gabimeve, a nëse e votoni këtë marrëveshje me këtë version të Murat Mehës, mbyllet, ta dini, çdo mundësi për përmirësime që është vetë pozicioni, të cilin po e mban Qeveria e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Vazhdojmë. Nënkyetar, fjala për ju, replikë!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Unë çmoj jashtëzakonisht shumë këtë komunikim ndërmjet subjekteve politike, sidomos kur shtrohet kështu, kur është i kësaj natyre, kur komunikimi është i qetë dhe normal, kërkohen aq më shumë argumente dhe duhet t'i shohin të gjithë.

Unë dua t'i them shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" se atë ditë kundër Qeverisë së LDK-së keni qenë të gjithë bashkë, domethënë ju që jeni këtu, përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë dhe ai ka qenë një konstruksion i jashtëzakonshëm, i cili s'ka mundur të bëhet atë ditë dhe kjo i bie që keni qenë së paku muaj përpara partnerë, domethënë kjo është e vërteta, sepse nuk shkohet aq shpejt te ato rezultate, domethënë s'është punë e thjeshtë që një qeveri, me gjithë atë shumicë, ta humbë shumicën, ta humbë besimin. E dyta, ju keni parasysht patjetër që ne do të ratifikojmë një projektligj, i cili është projektligji që ratifikon vërtet marrëveshjen e gushtit të vitit 2015. Këtë e thotë neni 1, ai është neni bazë dhe këtë marrëveshje e solli kryeministri dhe Qeveria. Pse e solli këtë? Sepse, s'ka marrëveshje tjetër, të kësaj natyre, me këtë status juridik, kur ke parasysht të drejtën ndërkombëtare, ligjin ndërkombëtar.

Juve ju duket paradoksale, por edhe këtë e çmoj që kryeministri e solli këtë marrëveshje, e çmoj shumë që e pranojnë që kjo është marrëveshja, dhe kjo është marrëveshja e vetme. Nëse ka materiale të tjera shtesë, sepse ka pasur keqkuptime...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nënkyetar, kërkoj falje, po filluam, pastaj vazhdojnë të tjerët. Vazhdojani edhe një minutë, ju lutem!

KUJTIM SHALA: Tani LDK-ja nuk kundërshton asnjë fakt tjetër të ri pas asaj marrëveshjeje, as pas nëse sot do të arrijmë të ratifikojmë këtë marrëveshje, do të mbështesim Qeverinë që jo vetëm ato fakte që pretendon, por t'i gjejë dhe faktet e tjera, qoftë dhe 1 milimetër nëse lëviz territori në favor të Kosovës, por në kuptimin që i kthehet territori i saj, ne do ta mbështesim.

Pra, e gjithë ajo që po tentojmë ne është që t'i japim kësaj marrëveshjeje një legalitet në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Glauk, kundër-replikë!

GLAUK KONJUFCA: Megjithatë, unë mendoj që sa për numrat e opozitës të mandatit të kaluar, ajo qeveria e kaluar nuk do të ishte rrëzuar kurrë. Atë qeveri e rrëzoi koalicioni juaj, atë qeveri e rrëzoi partneri juaj, Kujtim. Ne u gjendëm përpara një momenti që me votën tonë ta rrëzojmë Qeveria Mustafa. Ku ka kënaqësi më të madhe, ajo ka qenë sikur penalltia në futboll. Njëqind herë e kisha votuar të njëjtën unë, mirëpo brenda ju rrëzoi PDK-ja, dhe arsyeja tash nëse ju e votoni këtë demarkacion, vetëm po i kthehem prapë argumentit, ju për herë të dytë po e rrëzoni vetveten, nëse e votoni këtë demarkacioni, mos harro. Ju për herë të dytë po e votoni, sepse ju kanë rrëzuar për këtë arsye, ju kanë thënë që s'keni lidhje me qeverisje, rrini aty dhe na e jepni votën kurdo që t'jua kërkojmë, ky është mesazhi i votimit të LDK-së.

KRYETARI: Visar Ymeri, në emër të Grupit të Deputetëve të Pavarur, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Përshëndetje për qytetarët e Republikës së Kosovës,

Deputetët e Kuvendit të Republikës,

Pak a shumë mund të konstatohet që prej fillimit, mbase, e veçanërisht tash që kjo qeveri aktuale e Kosovës, ngjashëm edhe me qeveritë e kaluara, vuan nga, do ta quaja "kompleksi i multipersonalitetit". Këtu nuk po flas për ego të kryeministrit e të ministrave që janë aty, por po flas për mënyrën se si kolektivisht përfaqësojnë qëndrime diametralisht të kundërta dhe ekskluzivisht përjashtuese për njëra-tjetrën.

Edhe mendoj që më së miri kjo shihet në këtë ligjin që e kanë sjellë në Kuvend për ta ratifikuar marrëveshjen. Pra, aty praktikisht janë përmbledhur të gjitha dëshirat e Kabinetit qeveritar, ose individëve brenda Kabinetit qeveritar. Në njërën anë është marrëveshja për demarkacion, e cila ishte nënshkruar në vitin 2015 nga Hashim Thaçi si ministër i Jashtëm dhe Skënder Hyseni si ministër i Brendshëm, me homologët e tyre malazezë, e cila vjen si rezultat i punës së Komisionit shtetëror drejtuar nga Murat Meha, i cili ka pasur mandat zyrtar që ta shënjojë vijën kufitare, pra mandat zyrtar për demarkim dhe mirëmbajtje të kufirit, e jo për të caktuar kufi të ri apo delimitim, siç kanë bërë.

Dhe, e kemi edhe raportin e Komisionit të ri shtetëror, i cili është emëruar nga kryeministri Haradinaj, e drejtuar nga profesor Shpejtim Bulliqi që konstaton që marrëveshja paraprake, pra për atë për të cilën fola, është e gabuar dhe se Komisioni shtetëror në përbërjen e kaluar e ka tejkaluar mandatin dhe ka caktuar kufi të ri, në vend të shënimit të atij ekzistues, si dhe ngre dyshime aty ose aludon se ka pasur ose mund të dyshohet se ka pasur falsifikim dokumentesh e

hartash gjatë procesit të negocimit të vijës kufitare, për ta arritur këtë vijë kufitare siç janë dakorduar. Në fund e kemi një deklaratë të dy presidentëve, e cila praktikisht thotë se do të ketë korrektime të kufirit gjatë shënjimit të tij në terren, e që në mënyrë implicite mendoj unë konfirmon se procesi i marrëveshjes së vitit 2015 ishte proces delimitimi, e jo demarkimi. Pra, në mënyrë implicite konfirmohet në fakt atë që e thotë edhe raporti Bulliqi që ka pasur tejkalim të mandatit nga komisioni i kaluar.

Natyrisht, që ka korrektime kur vendosen gurët kufitarë në terren. Pra, në secilin rast të shënjimit të vijës kufitare në terren, të dyja palët obligohen që me marrëveshje të kenë korrektime për shkak të relievit, gjeografisë, e kështu me radhë që e përcakton dhe e kushtëzon një lloj korrektime. Mirëpo, këto lëvizje asnjëherë nuk marrin përmasa të hektarëve, qindra hektarëve apo mijëra hektarëve, siç po pretendohet këtu në rastin tonë me këtë marrëveshje të demarkacionit. Pra, këto korrektime nuk do t'i kthejnë 8 200 hektarë që janë konstatuar se Kosova i humb me këtë marrëveshje të demarkacionit. Pra, po them, nuk i kthejnë përveç në një rast, e ai rast për t'i kthyer këto do të ishte nëse kjo treshja zyrtare e Republikës së Kosovës do të zhvendosej për ta drejtuar procesin nga ana malazeze, për shembull nëse nga ana e Malit të Zi politikisht drejton Hashim Thaçi, do t'i kthenim 8 200 hektarë.

Nëse teknikisht e zbaton Murat Meha, do t'i kthenim 8 200 hektarë dhe nëse institucionalisht e pranon Ramush Haradinaj veç pse u bë kryeministër, do t'i kthenim 8 200 hektarë. Mirëpo, ne e dimë që kjo nuk do të ndodhë, këta do të mbeten në anën tonë, në anën e Kosovës dhe, rrjedhimisht 8 200 hektarët nuk ka gjasë të kthehen. Mendoj që kjo duhet të bëhet e qartë, pra mendoj që duhet, kushdo që e ka ndërruar mendjen për demarkacionin, kushdo që mendon që kjo marrëveshje mbase tash duhet të votohet për cilindo arsye, të paktën të jetë i sigurtë me qytetarët dhe t'u tregojë se ato 8 200 hektarë konstatohen se do t'i humbë Republika e Kosovës në këtë marrëveshje me Malin e Zi.

Çështja e demarkacionit, u tha edhe më parë, ka zgjatur tash e tre vjet në skenën publike të Republikës së Kosovës, sepse është bërë kriter në procesin e liberalizimit të vizave. Mirëpo, kjo është njëra prej kriterëve, edhe demarkacioni, diskutimi për të, tentim votimet për të njëfarë mënyre e kanë paralizuar dhe po e paralizojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe asnjëherë ky Kuvend nuk u mor me tema të tjera që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me interesin e qytetarëve, e që janë tema të zhvillimit, të mirëqenies e të shtetndërtimit. Pra, tash e tre vjet demarkacioni është temë, sepse asnjëherë s'po bëhet temë arsimit, shëndetësia, vendet e punës, zhvillimi i prodhimit, shpërndarja më e mirë e pasurisë, krijimi i kushteve për ndërmarrësit e rinj, e kështu me radhë. Pra, ne po flasim për demarkacionin jo se është çështja më e rëndësishme në Republikën e Kosovës, por se e kemi një qeveri, e fatkeqësisht edhe e kemi pasur një qeveri, e cila nuk ka pasur asnjë përgjigje për temat kryesore, më të rëndësishme të Republikës së Kosovës dhe e gjen një temë me të cilën më lehtë merret dhe më lehtë e diskuton, e që e zhvendos plotësisht debatin për interesin publik, në një rrafsh dhe dimension krejt tjetër.

Grupi ynë nuk e voton këtë marrëveshje, sepse ne jemi kundër disa fenomeneve që janë të materializuara në këtë marrëveshje. Kundërshtimi i parë është natyrisht që Republika e Kosovës në asnjë mënyrë nuk bën të caktosh precedent të heqjes dorë nga pjesë të caktuara të territorit, pavarësisht sipërfaqes dhe pavarësisht rëndësisë së tyre strategjike e ekonomike, sepse një shtet i tillë, i cili nuk ka aftësi ta menaxhojë dhe ta kontrollojë territorin e vet, njëkohësisht nuk mund të vlerësohet si shtet sovran. E dyta, edhe marrëveshja për demarkacionin, sikur në fusha të tjera po e kërkon ose vota për të e kërkon një gjë. Pra, përkundër faktit që Qeveria aktuale i ka konstatuar përmes komisionit disa “gabime” që po i quajnë tash në këtë marrëveshje, prapëseprapë kërkohet një votë ratifikimi, në mënyrë që të ecim tutje dhe kjo është ajo që e ushqen dhe e mirëmban atë ciklin e vazhdueshëm që e kemi pasur në Republikën e Kosovës, e në të cilin nuk ka asnjë dimension të përgjegjësisë politike e ndëshkueshmërisë për ata që bëjnë gabime, qofshin ato të qëllimshme apo të paqëllimshme.

Pra, po kërkohet që të ecim tutje gabim pas gabimi, pa pasur edhe pa kërkuar kurrë përgjegjësi nga personat apo strukturat politike, të cilat në këtë marrëveshje qartazi janë konstatuar se kanë bërë gabime, madje edhe të vetëdijshme e të qëllimshme dhe ky cikël i mosndëshkimit na përvidhet e përsëritet në secilën sferë të jetës politike e ekonomike të vendit. Pra, këtu nuk ka ndëshkim as për korrupsionin, edhe kur zihen rastet, nuk ka ndëshkim as për papërgjegjësinë tani të organeve shtetërore edhe kur ato rezultojnë me fatalitet, nuk ka kurrfarë përgjegjësie e as ndëshkimi, as për gabimet të cilat rezultojnë me heqje dorë ose falet një pjesë e territorit, nuk ka kurrfarë përgjegjësie për shkatërrimin e plotë të bazës dhe kapacitetit industrial të Republikës së Kosovës përmes privatizimit, edhe pse dihen emrat që janë marrë me të, pra asnjë përgjegjësi, asnjë ndëshkim nga askush për të gjitha këto të këqija që ia kanë sjellë Kosovës. Dhe, kjo duhet të përfundojë, pra Republika e Kosovës mund të bëhet Republikë sovrane nëse fillon të implementojë dhe të instalojë mekanizma shtetërorë dhe politikë, e që varen goxha shumë, mendoj unë, prej Kuvendit, të cilat garantojnë ndëshkueshmërinë e personave, të cilët kanë bërë gabime ose kanë bërë dëme ndaj këtij vendi, prapë po e përsëris, me vetëdije ose pa vetëdije. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Ka tre vjet që është kjo temë në opinionin e Kosovës, madje edhe në opinionin ndërkombëtar dhe duke qenë se s’është zgjidhur deri tani, janë ofruar mundësitë që përmes ligjit, të cilin e ka sjellë Qeveria e Kosovës në Parlament, të aprovojme këtë projektligj, duke pasur parasysh se marrëveshjes së vitit 2015 i ofrohet materiali ose dokumentacioni i Komisionit shtetëror aktual

që tregon për gabimet e gjetura nga komisioni i kaluar dhe, po ashtu, është deklarata e dy presidentëve, të Kosovës dhe të Malit të Zi, që jep mundësinë për korrigjimet e duhura.

Unë po i lexoj vetëm dy pika, të cilat tregojnë saktë se cilat janë obligimet e kësaj qeverie në të ardhmen që ekzistojnë në marrëveshjen e dy presidentëve. Palët pajtohen se gjatë këtij procesi trupi i përbashkët punues do të identifikojë dhe do të adresojë mosmarrëveshjet potenciale gjatë shënjitimit të kufirit, sipas kësaj aneks marrëveshjeje. Trupi i përbashkët punues, në mënyrë specifike do të rishikojë dhe do të korrektojë sektorët në drejtim të Çakorrit dhe Kullës së Zhlebit. Obligim i kësaj qeverie është që ta kryejë punën sipas ligjit që do të hyjë në fuqi dhe ne si deputetë i japim obligim kësaj Qeverie përmes Komisionit shtetëror dhe grupeve punuese që u përmendën për të ndryshuar gabimet, të cilat kanë ndodhur.

Njëkohësisht, deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dhe ju ftoj të gjithë juve që pa asnjë ndryshim të votoni propozimin ose projektligjin, të cilin në Kuvend e ka sjellë Qeveria e Republikës së Kosovës, me të vetmin ndryshim te pika 1.2. dokumentacioni zyrtar i Komisionit shtetëror për shënjitimin e kufirit, si orientim. Unë besoj se me këtë marrëveshje mund ta korrigjojmë gabimin, të cilin e ka bërë Komisioni i Qeverisë së kaluar dhe ju ftoj të gjithëve të votojmë, në mënyrë që të rregullohet ky gabim, njëkohësisht marrëdhëniet mes Kosovës dhe Malit të Zi të vazhdojnë e të thellohen edhe më tutje për interesat e qytetarëve të dy vendeve dhe po ashtu, që qytetarët e Kosovës, duke e parë se ka ndryshuar gjendja të kenë edhe atë që e kanë të saktësuar edhe me normat ndërkombëtare, lëvizjen e lirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, kryeministri ndërkohë kërkon fjalën. Atëherë, po vazhdojmë “Nisma për Kosovën”, Bilall Sherifi, urdhëro, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, deputete,
Ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi mbledhur këtu për të diskutuar, besoj edhe për të votuar një nga çështjet që më së shumti ka ngjallur debat në këto tre vjetët e fundit, dhe njëkohësisht më së shumti e ka polarizuar shoqërinë jo vetëm në Kosovë, por në përgjithësi edhe në nivel të kombit.

Mendoj që rreth kësaj çështjeje dhe për këtë çështje është debatuar mjaftueshëm, madje është debatuar jo vetëm në Kuvend, është debatuar nëpër të gjitha studiot televizive me ditë, orë, javë, muaj dhe vite të tëra. Është debatuar nëpër shtëpitë tona, në rrugë, në kafene, kudo që dy apo tre qytetarë të Republikës së Kosovës janë gjendur së bashku. Prandaj, duke pasur parasysh këtë fakt që kjo temë është një çështje për të cilën është debatuar mjaftueshëm dhe nuk besoj që sot, pas gjithë këtyre viteve dhe pas rrethanave të reja të krijuara, ende kemi njerëz që nuk e dinë se si duhet të veprohet, se cili duhet të jetë vendimi. Mendoj që sot në këtë pikë që jemi sot, të gjithë

që jemi këtu e kemi ndarë mendjen, e dimë se cili do të jetë vendimi ynë. Dikush për një arsye, dikush për një tjetër e ka ndarë mendjen të votojë po, dikush e ka ndarë mendjen të votojë jo. Është e drejtë e secilit që të veprojë ashtu siç është i bindur se është duke vepruar drejt.

Prandaj, deputetët e “Nisma për Kosovën”, “Nisma për Kosovën” si parti dhe Grupi i saj Parlamentar, kurdo që vjen në votim, sot apo nesër, kurdo që të vijë pas shterimit të debatit, sepse për ne mendoj që debati është shteruar, do të votojë pro këtij ligji, në mënyrë që përfundimisht t’i japim epilog kësaj çështjeje që ka pothuajse tre vjet që e kemi në tavolinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne si Grupi Parlamentar disa orë para fillimit të kësaj seance, sot kemi marrë një porosi apo një mesazh nga disa qytetarë të komuniteteve, të cilët ne i përfaqësojmë dhe qytetarë normalë të Republikës së Kosovës, ku kemi një porosi nga ta që shumë më pak të flasim dhe shumë më shpejt të veprojmë. Në këtë kontekst, ne nuk do t’i zhgënjejmë qytetarët tanë, elektoratin tonë, prandaj këtë mesazh po e përcjell edhe te kolegët tanë deputetë që sa më shpejt të veprojmë, t’i zvogëlojmë mundimet dhe hallet e qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë, të votojnë këtë demarkacion, ne si Grup Parlamentar “6+” dhe si komunitete pakicë jemi shembulli më i mirë si duhet të sillemi përgjegjshëm si qytetarë të Republikës së Kosovës, konform përgjegjësive që i kemi si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Edhe një herë, konfirmoj votën pro këtij projektligji të Grupit Parlamentar “6+” dhe i ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani futemi në radhën e debatit në bazë të deputetëve që janë paraqitur. Do të shkojë në bazë të grupeve parlamentare dhe deputetëve. Kryeministri i Republikës së Kosovës ndërkohë e ka fjalën, zoti Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Në ekspozenë hyrëse për ligjin që e kemi sot para vetes dhashë disa argumente bazë pse e kërkoj përkrahjen tuaj për këtë ligj si kryetar i Qeverisë. E vërteta dhe historia e këtij ligji në jetën tonë parlamentare dhe politike nuk besoj që ka nevojë të përshkruhet ose të shpjegohet prapë, sepse të gjithë e dimë edhe rrugëtimin e këtij procesi deri në ditën e sotme, deri në këtë moment. Sa u përket pikëpamjeve të mia si kryetar i Qeverisë dhe

si kam vepruar, është kjo: derisa kemi qenë në opozitë, në atë që kemi besuar, kemi shfrytëzuar instrumentet opozitare për të shprehur pikëpamjen tonë.

Instrumentet opozitare, të lejuar në demokraci, si protesta, peticioni i respektuar e plot instrumente të tjerë që i ka demokracia, në disa raste kemi qenë edhe krijues, pra kemi krijuar edhe instrumente të rinj, gati të panjohur në demokracitë parlamentare. E di se në këtë kundërshtim dhe në këtë prezantim të pikëpamjeve shoqëria është e ndarë në mendime, sa është vepruar drejt, sa gabim, sa ka tejkalime, secili do t'i ruajë bindjet e veta për këtë. Gjatë marrjes së përgjegjësive në Qeveri, pikëpamjes ose bindjes tënde i shërben me instrumentet qeverisës, ndoshta e meriton një respekt, rruga e ligjit nga nisja e kësaj qeverie të përbashkët me PDK-në, me "Nismën", me komunitetet që jemi bashkë. Edhe çka ka ndodhur? E di se nga pikëpamja e një opozitari ndoshta duket e pamjaftueshme ose joadekuate, por mos harroni, në dakordim, në koordinim të plotë me partnerët e koalicionit qeverisës kemi emëruar një Komision të ri shtetëror për ta trajtuar materien. Emërimi i tij nuk është bërë me njerëz të dëgjueshëm, të njërit nga ne, por mundësisht me ekspertët që janë sa më vetvetja dhe që kanë integritetin e vet profesional, moral, politik, e tjerë.

Ky komision e ka bërë punën, besoj, me përgjegjësi të lartë e profesionale, morale, njerëzore, e kombëtare, besa. I falënderoj të gjithë ata që kanë punuar, edhe kryesuesin e komisionit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, regjia!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më falni, se s'po u bie në fije procedurave, ky komision po ashtu është me rëndësi që ka thënë se ne e kemi kryer pjesën profesionale, ne s'japim përgjegjësi për pjesën politike. Pjesa politike ju mbetet ju për atë materie që e kanë punuar me shumë kujdes, mendoj që është materie e Kosovës, e të gjithë neve, e brezave. Duke parë zhvillimet e mëhershme, po ashtu kam kërkuar ndihmën e partnerëve politikë në koalicion, edhe të Presidentit Thaçi, për korrigjim.

Këtë ndihmë e kam kërkuar në Uashington, në Berlin, në Londër, në të gjitha qendrat vendimmarrëse që të mundësohet korrigjimi, jo veç për shkak të ndonjë egoje ose për shkak të ndonjë manovrimi politik, por për hir të së vërtetës, sepse jemi dy popuj që kemi interes të jetojmë në fqinjësi të mirë, Kosova dhe Mali i Zi. Nuk kemi interes të jemi në armiqësi, jemi në të ardhmen partnerë strategjikë. Rezultat i një procesi të këfillë, sot kemi në Parlament ligjin për ratifikimin e marrëveshjes me Malin e Zi, po të njëjtin që është bazuar në Komisionin Meha, që e ka nënshkruar në të kaluarën, nuk ka asnjë presje të prekur. Është po ajo e njëjta, mendoj se kjo tregon ndryshe, thënë pikënisjen e këtij procesi dhe unë e falënderoj LDK-në dhe zotin Shala për qëndrimet që dhanë, që do të jemi të kujdesshëm që cilado materie që ndihmon, që qoftë një

milimetër ose diçka e territorit t'i kthehet vendit, do ta respektojmë, pra nuk do ta mohojmë dhe mendoj se kjo është një pozicion vërtet i arsyeshëm, racional.

I kuptoj kalkulimet politike “kush është rrëzuar, kush është çuar”, ndonjëherë më vjen edhe mua rendi të rrëzohem, rrëzohen e çohen plot, e kemi folur këtë, kur është vakti, edhe unë jam me ju, kurdo që e vlerësojmë bashkë ose pjesë-pjesë, këtu jemi, për t'u rrëzuar e çuar në politikë. Bile po ju tregoj, ka të tillë që janë rrëzuar e kanë shkuar në shtëpi, unë e kam përjetuar rrëzimin e shkuarjen në Hagë, nuk besoj që ka më kiamet se ajo, këto të tjerat nuk i bëj dert hiç.

Sido që të vijë, kurdo që të vijë, qysh të vijë, se të rrëzohem prej Qeverisë e të shkoj te fëmijët në mbrëmje, edhe kjo ndoshta është kiamet, por të rrëzohesh prej Qeverisë e të shkosh të nesërmen në mëngjes atje ku kam qenë në pushim, besoj e dini çka po dua t'ju them, është pak më vështirë se të shkohet deri në Lipjan, a deri në Mitrovicë, a deri në Prizren, pasi ta gjuajmë do gaz a sende të tjera, se ka një karakter tjetër. Për fund, kolegë, dëgjoni, unë tash e di që jam në një pozicion jo të lehtë, unë i kërkoj LDK-së votën për këtë ligj, bazuar në deklaratimet e tyre të mëhershme, bazuar në procesin të cilin këta e kanë gjykuar si të tillë, i kërkoj po ashtu PDK-së votën bazuar në bindjet e tyre të mëhershme, në procesin që e kanë gjykuar si të tillë, i kam kërkuar votën Aleancës, duke u bazuar në procesin që e ceka më herët, në rrugëtimin prej marrjes së përgjegjësive, ndryshimet substanciale, pra faktike që kanë ndodhur, në mënyrë që t'i përkrahim këto ndryshime e të korrigjojmë, e t'ia kthejmë territorin vendit tonë.

Unë mendoj, i sigurt po e them, jo për hatër të votës, sikurse “Vetëvendosje”, Albini e Glauku, e kolegët, ose Visari e kolegët, do ta votonin sot këtë ligj dhe të deklaroheshin që ne nuk po e votojmë për shkak të marrëveshjes së 25 gushtit 2015, as për shkak të marrëveshjes të presidentëve, se nuk i besojmë, e di që ashtu e kanë pikëpamjen, por po e votojmë veç për një kusht, veç për raportin Bulliqi, edhe po ju mbajmë në obligim ta bëni korrigjimin, e nëse s'e bëni korrigjimin në këtë afat a në atë afat kohor, do të keni probleme me ne, do të dalim në rrugë, do të protestojmë, do t'i bëjmë këto, do t'i bëjmë ato, por pasi ju po e synoni korrigjimin, të cilin edhe raporti e përkrah. Po jua jap mundësinë për ta korrigjuar, e po vij me ju deri diku. Mos e harroni edhe një temë tjetër, kolegë. Nuk po flas më për ato që i ceka, po shiheni, nëse rrëzohet ky ligj në variantin që u rrëzua, procesi për ta nxjerrë një të drejtë të Kosovës është bukur i gjatë dhe mund të jetë po aq substancial sa e kemi sjellë sot këtu. Po aq një mundësi korrigjimi bazuar në diçka, bazuar në një raport. Pra, nuk është se e ka bërë një revolucion të jashtëzakonshëm dhe e drejta jonë do ta fitojë një epërsi të jashtëzakonshme.

E kuptoj arsyetimin, e kam dëgjuar dhe është arsyetimi më me vend që e kam dëgjuar prej kolegëve opozitarë të “Vetëvendosjes”, “pse s'po i korrigjoni përpara?”. Kjo është përmbajtjesore, kjo ka tamam peshë, kjo është diçka që “ku ta marrim”, që do të ishte më e mira e mundshme. Tash po ju tregoj me pak fjalë, aq sa arrij të ju tregoj pse është kështu.

Unë kam dashur të jetë kështu, sikur po flasim, mirëpo ka diçka. Mali i Zi thotë se “mund ta korrigjojmë një marrëveshje të ratifikuar dypalëshe”. Korrigjimi, përderisa s’ka marrëveshje të ratifikuar, nënkupton vetëm korrigjimin e vendimit tonë. Kryeministri i Malit të Zi, sipas asaj që unë kam mundur ta shoh, dhe mund të gaboj, edhe e di që korrigjimi s’do të jetë proces i lehtë që të dalësh në Çakorr e në Kullë me kufij, por mendoj se e ka vullnetin politik dhe është një fqinj si ata që ndahen me razi, ose si fqinjët që e kanë vendosur të mos jenë në qejf. Nuk mendoj se është interes i Malit të Zi që të mbetet në sherr për territor me Kosovën dhe me shqiptarët. Të paktën, kështu është bindja ime.

Duke qenë kështu, kolegë, unë s’do të ju ndërhyj shumë në debat në vazhdimësi, por edhe një herë po ju them, është një moment bukur i ndjeshëm në jetën e popullit tonë, jemi bllokuar si Kosovë. Nuk është vetëm liberalizimi i vizave, kemi plot procese... E keni hetuar që mezi kemi marrë pjesë në strategjinë e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE, mezi na kanë vendosur atje kah fundi. Krejt proceset që lidhen me fatin e Kosovës, do të thotë me perspektivën e Kosovës, për të qenë vetvetja, janë në moment bukur të vështirë, bukur të vështirësuar, jo veç Interpoli, UNESCO, e tjera... Nuk janë rezultat vetëm i një klase politike, ose i një brezi, ose i një qeverie, ose e gjashtë muajve a një viti punë, janë rezultat i plotë zhvillimeve që kanë ndodhur gjeopolitike e gjeostrategjike, ku Ballkani bën pjesë në to. Është interes i Kosovës për të mos u ndalur vetë. Nëse na fle në zemër bashkimi kombëtar shqiptar neve si Kosovë, mënyra më e mirë për t’i ndihmuar çështjes shqiptare është duke e avancuar Kosovën. Nëse ne e ngecim Kosovën tonë, nuk besoj se e ndihmojmë çështjen shqiptare, nuk e ndihmojmë as rajonin, as botën, por më së paku kombin tonë, nëse jemi kaq të ngadalshëm në procese.

Edhe një herë ju them, me gjithë respektin për krejt pikëpamjet që janë, sikur ta jepnit votën për korrigjim, vetëm për korrigjim, e ta obligonit këtë Qeveri që t’i thotë: “Mendojmë se jeni duke na mashtruar, por ne po jua japim votën për korrigjim, ama korrigjimin do t’ua kërkojmë dhe s’u lëmë rehat ditë e natë, derisa nuk e sillni korrigjimin.” Atëherë, jam i bindur se korrigjimi do të forcohej dhe ideja për t’u korrigjuar territori atje ku është cekur do të ishte më reale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, Ndërkohë e vërejtët edhe vetë, e patëm një shkëputje. Është hera e parë që ka ndodhur, më duket. Kërkoj falje. Kisha kërkuar që të paraqiteni edhe një herë për diskutim. Ne kemi arritur, duke iu falënderuar regjisë të marrim një listë, në bazë të së cilës unë do të shkoj. Ilir Deda ka qenë i pari prej kolegëve deputetë, por të njëjtën kohë e kemi edhe këtë listën e re.

Ju kisha lutur, kërkojeni fjalën edhe një herë mundësisht, se e patëm një shkëputje. Nuk i di arsyet, janë teknike, por, sido që të jetë, kërkojeni prapë. Zoti Deda, fjala për ju!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderua Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas gati tre vjetëve, ne më në fund po e debatojmë çështjen e demarkacionit, jo në medie, jo në rrugë, jo me dhunë, jo me akuza, jo me inate politike, por siç po duket kjo Kosovë paska avancuar në tre vjetët e fundit, apo politika e Kosovës paska avancuar dhe këtë duhet ta përshëndetim.

Gjëja më normale është që të debatohet, por duhet ta dimë çka kemi marrë sot para nesh. Para nesh është një dokument, një kompromis dhe një projektligj, i cili është arritur me konsensusin e gjerë politik, jo me konsensusin e plotë politik, por me konsensusin e gjerë politik. Këtë duhet ta përshëndetim.

Ne sot para vetes e kemi projektligjin apo marrëveshjen për demarkacion, e cila është nënshkruar nga ish-Qeveria e Kosovës, e ku është edhe një obligim ligjor me të drejtën ndërkombëtare, i cili del prej deklaratës së dy presidentëve. Ne nuk mund të themi që s'ka efekt juridik, kur të gjithë njerëzit e së të drejtës ndërkombëtare thonë që ka efekt juridik dhe kjo thotë që, në qoftë se gjenden faktet, do të korrigohet kufiri në drejtim të Çakorrit dhe të Zhlebit.

Në këto tre vjet, politika në Kosovë ka mbetur e izoluar brenda këtyre kufijve tanë, ashtu siç jemi izoluar mendësisht brenda kësaj Kosove, ndërsa koha po kalon. Në këto tre vjet, Mali i Zi e ka ratifikuar marrëveshjen, është bërë anëtar i NATO-s, e po avancon drejt integritit evropian. Në këto tre vjet, Shqipëria e ka marrë statusin e kandidatit, këtë vit i fillon negociatat për anëtarësim në BE. Në këto tre vjet, edhe në Maqedoni ka pasur lëvizje, kur ata do ta bëjnë ndërrimin e emrit të tyre dhe do t'i fillojnë negociatat për anëtarësim në BE. Në këto tre vjet, madje edhe Bosnja jofunksionale ka arritur t'i ndërmarrë hapat dhe do ta fitojë statusin e kandidatit për në Bashkimin Evropian.

Ajo çfarë është, apo çka duhet të na mësojë të gjithëve, e këtu shpresoj kryeministër që ti e ke kuptuar më së miri këtë punë, është se ne më nuk mund të qëndrojmë të bllokuar karshi njëri-tjetrit, duke parë se si po lëviz rajoni. Ne sot, zonja e zotërinj, sikur ta kishim pasur këtë pjekuri politike që është sot në vitin 2018, sikur ta kishim pasur vullnetin të bisedojmë me njëri-tjetrin në vitin 2015, sikur t'i kishim pranuar katër propozime që kanë qenë kompromis ndërmjet Qeverisë së atëhershme dhe opozitës, ne do ta kishim pasur liberalizimin e vizave, e sot do të ishim duke diskutuar nëse Kosova ka mundësi në një mënyrë që ta marrë një lloj statusi kandidati sikur vendet tjera në Ballkanin Perëndimor. Por, një mendësi e injorancës politike, e cila mendon që absolutisht s'ka asnjë efekt çfarë ndodh jashtë kufijve të Kosovës nëse ratifikohet demarkacioni, dhe unë shpresoj se do ta ratifikojmë projektligjin sot, dhe ajo mendësi më në fund sot dështon.

Dhe, unë shpresoj që sot hapet një kapitull i ri në atë se si diskutojnë ndërmjet tyre forcat politike të vendit tonë në Kuvendin e Kosovës. Mirë është që po mund të diskutojmë, por duhet të mësojmë që në proceset e tjera të mëdha që janë para nesh, ne nuk mund të jemi të barrikaduar, nuk mund të jemi përjashtues, nuk mund të jemi kërcënues, ashtu siç ka qenë këto tre vjetët e kaluara, po duhet të vijë deri tek shtrirja e dorës dhe pajtimit tonë për ecjen e Kosovës, apo për arritjen e konsensusit nacional për çështjet tjera madhore.

Është për keqardhjen më të madhe që shumica e përfaqësuesve të popullatës serbe në Kosovë nuk janë këtu që t'u ndihmojnë bashkëkombësve të tyre që të udhëtojnë lirshëm si pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës. Dhe, unë mendoj që kryeministri i Kosovës, nëse demarkacioni kalon sot me 80 vota, duhet t'ua bëjë të qartë partnerëve të tij qeverisës se kështu më nuk vazhdon kjo punë. Nuk mund të kërkosh koncesione prej Qeverisë ku je, e në anën tjetër të mos i respektosh obligimet që i ke karshi këtij shteti. Lista serbe po, ata i përgjigjen Beogradit, por janë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, prandaj edhe dikujt tjetër, përpos zyrtarëve në Beograd, duhet t'i japin përgjegjësi. "Business as usual" nuk mund të vazhdojë nga dita e nesërme. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E ardhmja prosperuese e shoqërisë kosovare kurrë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë më e stagnuar se sot. Nëse vërtet nuk shohim përtej asaj që quhet reflektim kohor ku ishim, si erdhëm dhe ku jemi, gjithashtu edhe për shkak të një johomogjeniteti dhe veprimeve jo të koordinuara mirëfilli të kësaj politikëbërjeje, e që, për fat të keq, këtu duhet shtuar edhe agjenturat nga jashtë.

Shoqëria kosovare ka pësuar shumë nga demarkacioni me Malin e Zi për të mos u ripërsëritur të gjitha zhvillimet, por duhet ta dijë të vërtetën për këtë çështje, sepse vërtet është krijuar një amulli dhe një ndjesi jo e mirë e këtij procesi si obligim ynë shtetëror. Në të tilla situata, qytetarët nuk meritojnë një justifikim të paqëndrueshëm dhe të zvarritur në afat kohor deri në zenit. Konsideroj se përtej ratifikimit të demarkacionit, qytetarëve të Republikës së Kosovës u interesojnë veprimet konkrete të shtetit të tyre, ose, thënë më mirë, çka konkretisht pas ratifikimit të demarkimit, respektivisht cilat janë agjendat konkrete të Kosovës dhe të Bashkimit Evropian për plotësimin e procedurave në afat sa më të shpejtë dhe më të lehtë për lëvizjen e lirë. Sa është afati kohor? Cili është zotimi i Bashkimit Evropian? Cilat mund të jenë kushtet tjera ndërlidhëse me përmbylljen e këtij procesi? Në cilat shtylla të shtetit do të ndikojë pozitivisht demarkimi i kufirit me Malin e Zi? Dhe, pa e anashkaluar asnjëherë gjendjen se si do të veprohet konkretisht në të ardhmen me vijën kufitare të demarkimit me Malin e Zi. Prandaj, konsideroj se është

interes jetik që t'u shpjegohet qytetarëve nga njerëzit kompetentë se sa të shesim patriotizëm folklorik këtu në Kuvend, apo edhe jashtë Kuvendit, duke marrë parasysh se historia shkruhet, por edhe rishkruhet me vendime të mëdha, ashtu siç është shkruar në vitin 1912, e në vitin 2008. Prandaj, e kam bindjen e thellë se me këtë ratifikim nuk përfundon asgjë, por fillon një epokë e re.

Çështja e integritit të vendit tonë në Bashkimin Evropian dhe në strukturat euroatlantike është një proces në vazhdimësi, por që gjithnjë konsideroj se duhet ta gjejë gatishmërinë tonë për të kontribuar të gjithë ne si Qeveri dhe si Kuvend pa asnjë rezervë në këtë aspiratë. Asnjë çështje madhore me interes të përgjithshëm, përfshirë këtu tani edhe liberalizimin e vizave, nuk mund të përkthehet në lojëra të brendshme politike për poenë politike. Qytetarët tanë na njohin mirë të gjithëve që jemi këtu. Prandaj, sërish bëj apel që të reflektojmë duke rezonuar bashkërisht i gjithë spektri politik dhe të mos luajmë as me qytetarët, e as me interesin e përbashkët të shtetit tonë, duke e ratifikuar dokumentin e propozuar konsensual, i cili e përshpejton heqjen e vizave.

Mendësia e përfaqësuesve të popullit, përkatësisht e deputetëve, çdoherë duhet të reflektojë në kuptimin kohor dhe të konsistojë me veprime konkrete konform interesave të përgjithshme të qytetarëve të vendit dhe thirrjeve të miqve tanë që punuan e na përkrahën për lirinë tonë. Orientimi ynë shtetëror është i qartë dhe i palëkundur, sepse, edhe po të donim, nuk mund të kemi aleatë të tjerë. Në këtë kontekst, është i mirëseardhur edhe aneksi i marrëveshjes së re ndërmjet presidentëve të të dyja vendeve për demarkimin e kufirit, i cili garanton mundësinë e rishikimit dhe përmirësimit eventual dhe që do të shënojë kthesën historike për zhvillimin dhe integrimin e shtetit tonë në strukturat euroatlantike.

U bëj thirrje të gjithë kolegëve deputetë, si asnjëherë më parë, që të gjejnë një konsensus dhe ta votojmë këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,

Më 26 gusht 2015, Hashim Thaçi, në atë kohë ministër i Jashtëm, në mandatin e kaluar, dhe Skender Hyseni si ministër i Punëve të Brendshme, pa e pyetur fare Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndonëse kishte një rezolutë për këtë, pra të miratuar në qershor të vitit 2015, nënshkruan një marrëveshje, e cila i falëmbi 8 200 hektarë Malit të Zi.

Kishte një rezistencë të fuqishme kundër këtyre marrëveshjeve nga qytetarët dhe opozita e mandatit të kaluar, të cilën e përbënin “Vetëvendosje”, AAK dhe “Nisma” dhe falë atij bashkimi opozitar, por edhe me kontributin e disa deputetëve të LDK-së, ne edhe e shpëtuan Kosovën nga bosnjëzimi nëpërmjet “Zajednicës”, por edhe e shpëtuan territorin.

Është për keqardhje që ata të cilët e mbanin flamurin e kundërshtimit sot janë bërë për faqe të zezë dhe e përkrahin pa asnjë rezervë një marrëveshje që e fal territorin e Republikës së Kosovës.

Për këtë peticion këtu, të cilin e kemi mbledhur bashkë edhe me zotin Haradinaj, edhe me zotin Limaj, i cili paska ikur tash, ai tha që “është peticion i respektuar”. Zoti Haradinaj, po ta respektoje këtë peticion, pra po ta respektoje vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës kundër kësaj marrëveshjeje, sigurisht se sot do të ishte këtu duke e jetësuar raportin Bulliqi, i cili ka evidentuar që Kosova ka humbur territor dhe njerëzit që e kanë nënshkruar atë marrëveshje kanë bërë vepër penale dhe i cili thekson se me atë marrëveshje janë dëmtuar interesat strategjike dhe ekonomike të Republikës së Kosovës, pra do të ishte duke e jetësuar atë raport dhe jo këtë marrëveshje, të cilën e kundërshtojë bashkë me ne.

Unë dua të ju pyes këtu, ju deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku e merrni këtë të drejtë, pra ku e merrni të drejtën për ta falë territorin e Republikës së Kosovës? Kush jua ka dhënë atë të drejtë? A e dini që secili prej jush, që sot mendoni ta përkrahni këtë marrëveshje, po e shkëlmi me të dyja këmbët betimin që e keni dhënë!

Unë ju ftoj sot juve që ta lexoni edhe një herë betimin, të cilin e keni nënshkruar në fillim të kësaj legjislature dhe aty ju keni thënë se do ta mbron integritetin territorial. Pra, ju s’keni të drejtë ta falni territorin e Republikës së Kosovës.

Sikur në vitin 2015 dhe në vitin 2016 të mos ishte kryeneçësia e Isa Mustafës, sigurisht se ajo marrëveshje do të kthehej në pikën zero, duke marrë parasysh faktin se Mali i Zi para ratifikimit në Kuvendin e Malit të Zi kishte shprehur dy herë me radhë gatishmëri për ta rishqyrtuar këtë marrëveshje. Në shtatorin e vitit 2016, Lëvizja “Vetëvendosje” i ka paraqitur pesë pika se si ecet tutje. Secila prej këtyre pikave është shpërfillur nga qeverisja e kaluar, përfshirë edhe qeverisjen aktuale. Ja ku jemi sot, afro tre vjet pas, për shkak të njerëzve të papërgjegjshëm, ne ende përballemi me këtë çështje thujse në Kosovë s’ka as papunësi, as varfëri, as mjerim, as krim e korrupsion. Pra, duke u marrë me këto çështje po shmangen problemet jetike të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Duhet thënë hapur që Kosova është kushtëzuar për liberalizimin e vizave me demarkacion për shkak se kështu ka kërkuar Hashim Thaçi. Pra, ai në Bruksel ka kërkuar që ta vendosin si kusht çështjen e demarkacionit, sepse, siç ka thënë ai, kalon më lehtë. Qëllimisht, përgjatë gjithë kësaj kohe nuk është përmendur fare kushti i dytë, e që është luftimi i krimit të organizuar e korrupsionit dhe jo luftim dosido, jo sa për të thënë, por luftim i “jakave të bardha” dhe atë me vendime të formës së prerë të gjykatave.

Aq shumë propaganda keni bërë sa qytetarët sot mendojnë që ne sot këtu do ta votojmë një projektligj për liberalizim të vizave, e jo për falje të territorit. Pse s'i jepni aq shumë zor për ta luftuar korrupsionin? A mund të më tregoni se si mund ta luftojë korrupsionin Qeveria Haradinaj? Qysh do të mund ta luftojnë korrupsionin njerëzit e korruptuar, apo institucionet e kapura të drejtësisë, që njerëzit e korruptuar i dënojnë me kusht, ose i lënë lëndët e korrupsionit të parashkruhen, ose që fare nuk kanë guxim që të merren me të korruptuarit, ndonëse janë në dijeni për pasurinë e pajustificuar të tyre.

Shtrohet pyetja, përse qytetarët e duan kaq shumë liberalizimin e vizave? Sepse, Kosovën, sikur kjo Qeveri, edhe të kaluarat, pra qeveritë e kaluara, po flas për Qeverinë Mustafa, po flas për Qeverinë Thaçi 1 dhe 2, kanë bërë aq shumë dëme, sa e kanë kthyer Kosovën nga shpresa e të gjithëve në një vend të pajetueshëm. Askush më shumë, madje as pushtuesi, nuk ua gërditi vendin e tyre qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për këtë mbani përgjegjësi të gjithë ju.

Së fundmi u bë publik indeksi i perceptimit të korrupsionit për vitin 2017. Ministrat e kësaj Qeverie dhe RTK-ja si televizion në shërbim të pushtetit u munduan që rangimin dhjetë vende më poshtë se viti 2016 ta shesin si të arritur. Unë vetëm po dua t'jua kujtoj disa prej rasteve kur sistemi i drejtësisë ka hequr komplet dorë për t'i luftuar kriminelët e korruptuar. Tash së fundmi e kemi rastin "Toka", u lirua nga paraburgimi Azem Sylja. Hezitimi i hetimeve për Devollin dhe Z-Mobile në dëm të Telekomit të Kosovës. Heshtja e aferës "Pronto", ndonëse ka pasur premtime nga kryeprokurori Lumezi që do të merret me aktakuzat dhe dënimet ndaj protagonistëve. Mosfillimi i procesit hetimor për aferën e sistemit informativ shëndetësor. Lirimi i shefit të prokurimit për veprime korruptive dhe tash ai është bërë drejtor në prokurim në Ministrinë e Infrastrukturës, të zotit Lekaj. Harrimi i rastit "Stenta". "Medikusi". Enver Hasani u dënua me kusht!

Kujt po mundoheni t'ia hidhni? Neve deputetëve, qytetarëve të republikës, Bashkimit Evropian? Jo, ju lutem! S'mund të na e hidhni, sepse edhe ne do të donim që sistemi i drejtësisë ta luftonte korrupsionin, por nuk ka ndodhur kështu, fatkeqësisht, për shkak se e keni kapur sistemin e drejtësisë.

Shtrohet pyetja më tej se pse deklarata e Thaçit është mashtrim? Kuvendi, pavarësisht marrëveshjes ndërmjet presidentëve, me rastin e votimit e pranon që kufiri ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi është ai që ka vendosur Thaçi - Meha. Kjo edhe nëse Kuvendi e bën pjesë të ligjit marrëveshjen e nënshkruar nga presidentët, pra Kosova e vulos apo e pranon, përveç tjerash, se territori ynë Çakorri e Kulla i takojnë Malit të Zi, sipas të së drejtës ndërkombëtare, nga ai moment, kufiri i njohur ndërkombëtarisht ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi do të jetë ai Thaçi - Meha. Për ta ndryshuar atë nevojitet një marrëveshje e re, pra ratifikim i ri edhe në Kuvendin e Malit të Zi, dhe ju e dini shumë mirë që kjo nuk do të ndodhë asnjëherë.

Së dyti, sipas të së drejtës ndërkombëtare, marrëveshja e nënshkruar nga presidentët është vetëm zotim i të dyja palëve që ta themelojnë një trupë të përbashkët për ta rishikuar kufirin. Me pak fjalë, kjo nënkupton që palët janë dakorduar që të shikojnë nëse mund të gjejnë ndonjë të metë në këtë proces, por kjo assesi nuk nënkupton që ky trupi i përbashkët mund ta ndryshojë kufirin Thaçi - Meha dhe as që mund të nënkuptohet që Mali i Zi e ka pranuar që Kosovës i takojnë ato 8 200 hektarë. Praktikisht kjo marrëveshje nuk e vë asnjë detyrim juridik për Malin e Zi për ta ndryshuar kufirin e përcaktuar me marrëveshjen bazë Thaçi - Meha, e aq më pak që të lëvizë kufiri deri në Çakorr apo Kullë. Ata thjesht janë zotuar që të shikojnë se çfarë mund të bëjnë në ato dy drejtime, por nuk është përcaktuar se Mali i Zi do ta lëvizë kufirin në atë drejtim.

Të nderuar deputetë,

Ju e dini që mbështetja e kësaj marrëveshjeje është pazar në kurriz të Republikës së Kosovës.

Unë ju ftoj që sot të dilni kundër kësaj, sepse territori ynë është shumë më i rëndësishëm se sa kolltuku i Haradinajt apo i Limajt e të tjerëve. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministër, e ka kërkuar fjalën.

Ndërkohë të bëhet gati Blerim Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti nënkryetar,

Shumë të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zoti zëvendëskryeministër Limaj,

Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Tema që e kemi sot është diskutuar në këto 2-3 vjetët e fundit në të gjitha forumet e mundshme politike, 2-3 herë në Kuvend të Kosovës, po jo me një qartësi se kah do të lëvizë si një temë drejt përmbylljes së saj.

E dimë edhe përmbajtjen e projektligjit që e keni para jush, e dimë edhe punën e komisioneve, të cilat deri më tash janë marrë me këtë temë, sikurse i dimë edhe dallimet, të cilat deri më tash dihen jo vetëm në Kosovë, po edhe jashtë Kosovës.

Çfarë po dua të them është që debati për këtë temë është një debat i shterur, por nëse deputetët e Kuvendit të Kosovës dëshirojnë të shkojnë në thellësi, natyrisht që ne e respektojmë vullnetin e tyre dhe ta trajtojmë këtë temë edhe sot, edhe sonte deri në orët e mëngjesit në thellësinë e duhur.

Sot, në fakt, i kemi dy pritje: një është pritja apo skenari pozitiv, që e presin edhe qytetarët e Kosovës, ata që janë jashtë Kuvendit të Kosovës, që sot shumica e deputetëve, jo vetë të

koalicionit qeverisës, por edhe të opozitës, të të dy krahëve, do ta votojnë këtë marrëveshje dhe do ta shndërrojnë këtë seancë në një pikë kthese pozitive për Kosovën.

Por, sa dëgjova kolegët e tjerë, ka edhe një pritje tjetër që kjo marrëveshje të mos kalojë.

Të dashur deputetë,

Deklarata që është nënshkruar ndërmjet dy presidentëve, natyrisht që paraqet një zhvillim të ri edhe politik, edhe legal, në mes të dy vendeve tona se si të verifikohet dhe të korrigjohet çfarëdo lloj lëshimi eventual për pikat të cilat kanë qenë nocione politike dhe gjeografike në këto tre vjetët e fundit.

Çfarë po dua të them është kjo. Nëse publikisht është kërkuar të rishikohet çështja e Çakorrit dhe e Kullës, edhe ne si partnerë të koalicionit, si Parti Demokratike e Kosovës, jem të interesuar që një gjë e tillë të ndodhë.

Po përtej kësaj deklaratë, e cila është një zhvillim shumë pozitiv politik, është arritur edhe një lloj konsensusi politik, po i cili nuk është i plotë, në mes të partive që janë në Qeveri dhe fal qëndrimit që ka Lidhja Demokratike e Kosovës.

Por ky konsensus mund të jetë i plotë nëse edhe kolegët nga subjekte të tjera politike, të cilat janë të pranishme në Kuvend, me votën e tyre do ta ratifikonin këtë marrëveshje.

Çfarë kemi dëgjuar në këto tre vjetët e fundit dhe çfarë mund të dëgjojmë sonte është që ka një dallim mes fakteve konkrete reale, edhe politike, edhe juridike, të matshme dhe në mes të opinionëve të cilat mund të shfaqen.

Por, për ne si partner të koalicionit, për ne si Parti Demokratike e Kosovës, edhe marrëveshja e vitit 2015 është një fakt i rëndësishëm politik, edhe raporti i vitit 2017, por edhe deklarata e vitit 2018 në mes të dy presidentëve.

Çka po dua të them është kjo: nuk është kjo deklaratë ndonjë përpjekje për mashtrim, por ka një vullnet politik në Podgoricë që trupi i përbashkët, i cili duhet të themelohet, e trupi i përbashkët nuk është asgjë tjetër veçse komisionet shtetërore që merren me shënimin e vijës kufitare, do të duhej vërtet të shohin se çka mund të korrigjohet drejt sektorëve të Çakorrit dhe të Zhlebit.

Por unë e kam një ftesë, sot nuk duhet ta lëshojmë këtë sallë për pa e ratifikuar këtë marrëveshje. Sikurse nëse vjen vota prej kolegëve të opozitës, edhe peticioni do ta kishte peshën nëse kolegët e opozitës e votojnë marrëveshjen dhe në bazë të saj se çfarë parashihet në marrëveshjen e 2015-ës, që nëse ka fakte të reja duhet të korrigjohet dhe në bazë të deklaratës, ne do ta kemi një bazë edhe politike, edhe juridike se si ta trajtojmë këtë temë.

Po e dini pse dola në foltore, jo të them diçka të re, se është thënë mjaft për këtë temë. Dola më shumë të shpreh njëfarë shqetësimi që e kam në këto tre vjetët e fundit. Disi jemi mbyllur në vetën tonë, e kam përshtypjen që kur të vijmë në këtë sallë mendojmë që graviteti kryesor i botës është kjo sallë, ky Kuvend, se graviteti kryesor i botës është ky kryeqytet.

E kam përshtypjen që para 20 vjetësh, 30 a 10 vjetësh kemi qenë më të hapur t'i lexojmë drejt dhe saktë zhvillimet në botë.

Çfarë po dua të them është kjo. Në këto tre vjetët e fundit nuk ka pasur vullnet prej Bashkimit Evropian të mbështetet Kosova në asnjë temë konkrete. Sikurse nuk ka pasur vullnet prej nesh brenda, në këtë Kuvend dhe në këto institucione, t'i kryejmë disa tema të mëdha.

Por, sot e kam përshtypjen se si e kemi filluar debatin po krijohet një vullnet i ri për një konsensus të ri politik. Çka nuk kisha dashur është që konsensusi politik të mos jetë pasojë e lodhjes fizike, po të jetë qëllim i pjekurisë politike. Nëse ne fizikisht jem lodhur me këtë temë në tre vjetët e fundit dhe tash pajtohem, po jo për shkak të qëllimit dhe pjekurisë politike, kjo nuk do të duhej t'i ndodhë Kosovës.

Vota që jepet sot pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, të nderuar deputetë, nuk i jep vetëm fund izolimit, nuk e hap vetëm perspektivën e liberalizimit, po në fakt, është vota më e rëndësishme që mund të japë Kosova në 10 vjetët e ardhshme. Nuk do të ketë ngjarje më të rëndësishme në raportin Kosovë-Bashkim Evropian në 10 vjetët e ardhshme se sa procesi i liberalizimit të vizave.

Unë e di që pas një kohe Kosova do të jetë pjesë e BE-së, por Bashkimi Evropian nuk do të jetë ai që është sot, kur ne do të jemi pjesë e BE-së.

Sikurse sot e kuptoj votën që ne e japim për ratifikim dhe për liberalizim si votë që çdo qytetar, të paktën individualisht, të jetë pjesë e Bashkimit Evropian.

Prandaj, shqetësimet të cilat mund t'i keni do t'i marrim në konsideratë, votoni marrëveshjen, ta krijojmë një kulturë të re të konsensusit politik dhe të lëvizim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Blerim Kuçi, fjala për ju.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Debati i sotshëm për këtë temë ndoshta edhe është i shterur, sepse asnjëherë nuk është debatuar më shumë në Kosovë se sa për këtë temë.

Çuditërisht, procesi i shënimit të kufirit mes Malit të Zi dhe Kosovës ka filluar shumë i heshtur, i mbyllur dhe jotransparent me qytetarin.

Sot, në përfundim të këtij procesi, do të themi për këtë proces, i zhurmshëm, shumë i zhurmshëm, i hapur, shumë i hapur dhe transparenca në maksimumin.

Ky projektligj i formës së sotshme, po them edhe një herë, i formës së sotshme, për mua është një nxjerrje maksimale e diplomacisë sonë për rrethanat e tanishme.

Nxjerrje maksimale është kur kemi parasysh rrethanat, si:

1. Marrëveshjen tashmë të lidhur mes Kosovës dhe Malit të Zi, pra marrëveshja e lidhur në vitin 2015.
2. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje nga ana e Malit të Zi në Kuvendin e tyre.
3. Përhëndetja dhe përkrahja e kësaj marrëveshjeje me një dozë të shtuar nga SHBA-të dhe BE-ja.
4. Raportet e mira me Malin e Zi, e sidomos kur dihet parasysh se Mali i Zi ka dalë nga ai shtet, me të cilin Kosova dhe NATO ka bërë luftë. Njohja e Kosovës si shtet në vitin 2008 nga Mali i Zi ka qenë si njohje e rëndësisë së veçantë.
5. Hyrja si kusht për liberalizimin e vizave, edhe marrëveshja e Malit të Zi me Kosovën e vitit 2015.
6. Edhe shumë kushtëzime të kësaj marrëveshjeje nga miqtë tanë ndërkombëtarë.
7. Zgjatja apo stërzgjatja e këtij procesi.

Duke pasur parasysh këta faktorë, unë personalisht mendoj se ky projektligj i sotshëm, i formës së sotshme, i propozuar për miratim, është një nxjerrje maksimale, sepse me këtë projektligj dhe me përmbajtjen e tij, kur dihet se ky projektligj përmban marrëveshjen e vitit 2015, raportin e Komisionit të sotshëm, pra raportin që është në krye zoti Bulliqi, pastaj deklaratën e dy presidentëve për mundësi korrektimi dhe korrigjimi, me këtë projekt-propozim të këtij draft-ligji të sotshëm nuk i largohemi Çakorrit dhe Kullës dhe i afrohem liberalizimit të vizave dhe perspektivës evropiane. Përveç kësaj, është edhe një konsensus i brendshëm, u tha nga disa kolegë.

Nuk ka dilemë se më e pastër dhe më e mirë do të ishte që në kohën e duhur t'i kishim thënë "jo" kësaj marrëveshjeje, ose të mos bëhej fare marrëveshja e vitit 2015. Por gjërat janë çfarë janë dhe, për ato çfarë janë, kjo është pa dilemë një ngjarje maksimale e diplomacisë kosovare, pra një ngjarje ku ka si koncept të mos i largohemi Çakorrit dhe Kullës dhe t'i afrohem perspektivës evropiane. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka e ka fjalën. Po shkojmë në bazë të radhës së grupeve parlamentare siç janë paraqitur.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Gjithmonë kur ndodhemi përpara sfidave tepër të mëdha që janë në interes kombëtar dhe shtetëror, sigurisht edhe dilemat janë të mëdha: ta votojmë apo të mos e votojmë.

Këto dilema kanë ekzistuar që në vitin 1981, kur studentët në atë kohë janë ngritur në demonstratë, pjesa dërmuese në atë kohë e kanë kënduar këngën e Marshall Titës, "Marshall Tita në kali të bardhë".

Po u ngritën studentët edhe avash-avash u bashkua popullata, në vitet '90-ta Milosheviqi, nën parullën e mbrojtjes së unitetit të Jugosllavisë dhe të Federatës të ish-Jugosllavisë, nën parullën e rrezikimit të kombit serb na ka vrarë, na ka burgosur, na ka dëbuar nga trojet tona.

Do të thotë, Milosheviqi e krijoi një gogol kundër kombit serb, kur tha: "Juve kanë me ju hëngër shqiptarët, kanë me ju hëngër boshnjakët, kanë me ju hëngër kroatët, sllovenët". E sot historia po e vërteton që Milosheviqi është armiku më i madh i kombit serb.

Milosheviqi ka qenë arkitekti numër një i shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe i shkatërrimit të kombit serb.

Kur kemi ardhur te Marrëveshja e Rambujesë, po t'i pyeste delegacioni i Kosovës disa komandantë nëpër male, a të nënshkruhet a të mos nënshkruhet ajo marrëveshje, ne sot s'ishim hiq gjallë, sepse kurrë ata njerëz nuk kishin pranuar të nënshkruhej Marrëveshja e Rambujesë, sepse e kanë konsideruar si tradhti të pastër kombëtare.

U nënshkrua Marrëveshja e Rambujesë dhe u bënë shumë zhvillime pozitive në Kosovë, sot jemi këtu ku jemi. Rexha thotë s'është ashtu, ky ka qenë për Marrëveshjen e Rambujesë, po disa kolegë të tu nuk kanë qenë. Mirë, Rexhë, del këtu dhe më kundërshton.

Kemi ardhur te një diçka që unë pikërisht për shkak të diskutuesve paraparakë, sidomos të Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe të deputetëve të pavarur, jam shumë i nxitur dhe i predispozuar ta

votoj marrëveshjen e demarkacionit, ku tekstualisht thuhet që në bazë të nenit 8 do të rishikohet kjo marrëveshje. Pse?

Kolegët e mi deputetë, me shumë të drejtë po thonë se do të vijmë te një pikë shumë e ndjeshme dhe pika më e ndjeshme është lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar, lufta për ‘shkapjen’ e shtetit. Atëherë vërtet në qoftë se ne e dëshirojmë një gjë të tillë, ejani ta votojmë demarkacionin dhe t’i japim drejtim zhvillimit të Kosovës, t’u japim drejtim atyre 300 mijë të rinjve që e pritën në koncert Rita Orën, e që të gjithë me padurim presin lëvizjen e lirë në Bashkimin Evropian e në vende të tjera.

Unë personalisht nuk jam bindur nga raporti i Bulliqit absolutisht të votohet kjo marrëveshje.

Unë jam bindur nga bisedat të cilat janë zhvilluar në kuadër të Qeverisë së Kosovës, nga zoti Limaj dhe Qeveria e Malit të Zi, ku ata kanë rënë dakord që të rishikohet marrëveshja dhe në qoftë se vërtet ka gabime, atëherë të vijmë te përmirësimi i këtyre gabimeve.

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj që është moment historik për Kosovën, për qytetarët e vendit dhe për inati të Listës serbe, për inat të Listës serbe ta votojmë këtë marrëveshje.

Lista serbe është duke e trajtuar Kosovën si vend armiqësor. Lista serbe hobin më të madh e ka ta bllokojë këtë vend, fatkeqësisht këta të huajt, këta të huajt që nuk dinë të mbajnë shumë fjalime, po dinë të shkruajnë mirë, kanë juristë të zotë, na e kanë bërë ligjin edhe Kushtetutën që s’mund t’i heqim prej Qeverie, sillu-pështillu, dreqin rreth këmbëve e kemi.

Se, po të kishte ndonjë farë zgjidhje të mundshme, në mënyrë absolute ata që nga sot nuk meritojnë të jenë pjesë e Qeverisë së Kosovës. Po ne s’mund ta ndryshojmë Kushtetutën tash, çka të bëjmë, i kemi pjesë, na ka rënë dreqi komshi e s’kemi çka bëjmë.

Sepse, është absurde që deputetët e Listës serbe të bllokojnë çdo proces të Kosovës, është absurde që deputetët e Listës serbe ta izolojnë Kosovën, të luajnë me kartat më të tmerrshme, vetëm e vetëm që ata kanë nënshtetësinë e Serbisë, kanë pasaporta, kanë mundësi të lëvizjes së lirë dhe thonë: “Kosova le të vazhdojë të ngelë si kopsht zoologjik”.

Prandaj, unë të nderuar deputetë,

Juve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, prapë po them, po të isha në vendin tuaj, pikërisht për inat të Listës serbe, me kushtin që e tha kryeministri që të rishikohet marrëveshja, të rishikohet përcaktimi i kufirit dhe, në qoftë se Qeveria nuk sillet serioze në drejtim të përmirësimit të kësaj marrëveshjeje, në përmirësim të gjetjeve të gabueshme që janë bërë, atëherë të jeni të bindur që deputetët e “Nismës” do të bashkohen së bashku me ju dhe do ta rrëzojmë këtë Qeveri.

Por, edhe një herë ju bëj thirrje që për inat të tyre ta votoni këtë marrëveshje, veç “me ua kupë zemrën”.

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Përfaqësues diplomatikë,

Përfaqësues të mediave,

Më lejoni t'i them disa fjalë si deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ajo që unë në fillim mund të them është se kjo seancë e sotme, e besoj thellë ka mundur të mbahet edhe pra 2-3 vjetësh. Fatkeqësisht dhuna brenda dhe jashtë këtij Kuvendi pamundësuan mbajtjen e një seance të tillë, e pse jo edhe votimin e kësaj marrëveshjeje.

Mua më vjen mirë që sot nuk ka një kundërshtim të tillë, sepse as atëherë, as sot e as në të ardhmen s'do të na bënte nder si Kuvend dhe si Kosovë.

Pa dyshim që nuk do të doja edhe shumë të kthehem pas, sepse atëherë dhe tash qytetarët e Kosovës e kanë pasur, e kanë të qartë se kush ishin pengesa, kush ishin ata që e pamundësuan, ose së paku e prolonguan plotësimin e një kushti dhe të një tjetri që vjen më vonë, që është pak më gjatë, që sot qytetarët e Kosovës të lëvizin lirshëm.

Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës, si Grup Parlamentar, si subjekt politik, atëherë dhe sot po dëshmojmë se interesi ynë i vetëm janë interesat e qytetarëve, interesat jopolitike e joditore, dhe LDK-ja me votat e saj, ndoshta nuk po paragjykoj, po pengon pse jo edhe që të bëhen pazare më të rënda me një subjekt politik, i cili sot nuk qenka i pranishëm, një subjekt politik i një komuniteti, pra atij serb, dhe kjo është e mirë për vendin tonë, sepse ne duhet të faktorizohemi si shumicë, pa e anashkaluar, mohuar edhe të drejtat e atyre që i përfaqësojnë komunitetet e tjera në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pavarësisht se obligimi bie mbi partnerët e koalicionit, më së lehti për ne si LDK, si deputetë, do të ishte të themi, ashtu siç ne thuhej: “Bonja qarën veti, jeni koalicion, bëni votat”. Por, mendojmë që edhe atëherë kjo sjellje e ish-opozitës ka qenë joracionale, jo e drejtë, jokorrekte, sikur që do të ishte edhe sot në një masë kjo jona po të vepronim ndryshe, e ne nuk mund të veprojmë ndryshe, sepse jemi të tillë, kemi qenë dhe mbetemi të përkushtuar të punojmë për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit, pra, nuk po themi: “Neve nuk na intereson dhe bëni çfarë të doni”.

Këtë e bën vetëm një subjekt serioz politik, një subjekt, i cili e vë interesin e vendit mbi interesat ditore dhe politike.

Po shihet qartë që edhe ky Kuvend, edhe kjo skenë politike, edhe ky vend, pa Lidhjen Demokratike të Kosovës po dëshmohej që në asnjë rrethanë as nuk do të ishte një shtet stabil, e aq më pak do të ishte shtet demokratik.

Është e qartë se kemi, për mendimin tonë, një marrëveshje të njëjtë, është e qartë se ka qenë dhe ka munguar, më mirë të thuhet, një vullnet, një gatishmëri e një pjese të atëhershme të opozitës, besa të them, edhe të disave nga partnerët e koalicionit, sidoqoftë, është për të ardhur mirë që sot ata po reflektojnë dhe po e shohin që interesi i vendit është përtej interesit të një mandati ose një partneriteti momental.

Lidhja Demokratike e Kosovës, ne si deputetë, po dëshmojmë, edhe në të ardhmen secili prej nesh duhet të dëshmojmë se mbetemi shtyllë dhe garanci e këtij vendi dhe nuk veprojmë me inercion dhe as me inate politike, sepse dorën në zemër, arsye kemi ta bëjmë këtë, sepse skenat e mëhershme që të gjithë qytetarët i mbajnë në mend.

Mbi të gjitha, ruajtja e shtetit dhe e interesave të qytetarit tanë, ruajtja e sovranitetit dhe e integritetit të vendit, ndërtimi dhe zhvillimi i vendit, ruajtja e miqësisë me partnerët tanë, siç janë SHBA-ja dhe shtetet e Bashkimit Evropian, janë dhe mbeten përcaktim i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe, sinjerisht po e them, bëj pjesë sikur edhe të gjithë deputetët, e besoj thellë, në grupit e atyre që do të donin që në të ardhmen të ketë përmirësime, këtë e ka garantua në një masë edhe marrëveshja e mëhershme, të ketë reduktime, të ketë korrektive të Kuvendit, edhe pse pak besoj, sidoqoftë uroj që kjo të ndodhë, e mbi të gjitha, u tha edhe nga disa kolegë deputetë, ky vend ka shumë probleme dhe ta heqim nga rendi i ditës vetëm këtë problem që po e mundon, e ky është ratifikimi i marrëveshjes për shënjimimin e kufirit mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Faleminderit!

KRYETARI: Albin Kurti, fjala për ju!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Kabinet i Qeverisë,
Kryeministër,
Qytetarë të Republikës,

Ky votim sot përcakton fatin e gjeneratave të ardhshme, sepse pyetja është: ka apo nuk ka Kosova kufij? Demarkacioni i Murat Mehës e i Thaçit, i Skënder Hysenit e i Mustafës, e tash edhe i Haradinajt nuk është demarkacion, por kufi i ri. Me logjikën e Mehës, Kosova nuk ka kufij fare dhe ajo duhet t'i përcaktojë ata duke u bazuar në librat kadastralë, me ç' rast ne marrim

barrën e provës: aty ku nuk kemi ne mbulesë kadastrale, toka i takon palës tjetër, pavarësisht nëse ata kanë dëshmi apo jo.

Në bazë të një studimi të brendshëm të KFOR-it, të cilin unë e kam parë, janë rreth 200 konteste kufitare me Serbinë, prej majës së Pançiqit e deri në Karaçevë. Rreth 50 konteste të tilla kufitare ka ose prona private, ose popullsi, ose të dyja këto. Me këtë lloj delimitimi, që quhet demarkacion, bëhet një precedent i rrezikshëm për Kosovën anembanë kufijve të saj. Pra, ky nuk është demarkacion, por delimitim. Nuk është shenjim i vijës kufitare, por caktim i vijës së re kufitare, ndryshim i kufirit të Kosovës. Komisioni shtetëror i Kosovës i udhëhequr nga Meha ka pasur të bëjë shenjim e mirëmbajtje të kufirit, ndërkaq ai i Malit të Zi “përcaktim kufiri, kufizim dhe vendosje”. Dy komisione, me misione të ndryshme, me ç ‘rast komisioni ynë ka përfunduar në misionin e huaj. Murat Meha ka punuar dhe negociuar sipas kushteve të Komisionit të Malit të Zi.

Ky ndryshim kufiri duket sikur të kishim pasur luftë me Malin e Zi, e të cilën e kemi humbur dhe tash erdhi kapitullimi. Por, nuk ka pasur luftë me Malin e Zi. Nuk humbëm kurrfarë lufte me Malin e Zi. Delimitimi Meha është kapitullim pa luftë. Le të mos kapitullojë edhe Kuvendi, le të mos e ratifikojmë ndryshimin e kufirit.

Edhe vetë harta që e ka punuar Murat Meha dhe e ka botuar “Rilindja” në vitin 1998, e ka kufi Çakorrit dhe Bjelluha është në territorin e Kosovës. Në deklaratën Thaçi-Vujanoviq thuhet “në drejtim të Çakorrit e Zhlebit”, jo “në Çakorr e Zhleb”. Kjo deklaratë fare nuk e përmend Bjelluhën si burim uji. Të reshurat në pellgun e lumit Bjelluha janë gati 1 200mm, pra 1200 litra/m², që është sa dyfishi i Prishtinës. Aneks marrëveshja, apo deklarata për Lëvizjen “Vetëvendosje” është mashtrim. Ajo është nënshkrim për së dyti i së njëjtës marrëveshje. Lëvizja “Vetëvendosje” voton vetëm dokumentin që korrigjon kufirin, e jo dokumentin që premtion korrigjimin eventual të kufirit.

Sipas profesorëve Florim Isufi dhe Shpejtim Bulliqi bëhet ndryshimi madh i kufirit, sepse ai kah ana e Qafës së Çakorrit në distancë ajrore lëviz rreth 4 mijë e 100 m në brendi të Kosovës, duke lënë jashtë territorit e Kosovës Pellgun e Bjelluhës, Vaganicën dhe Shipovicën. Ndërsa, nga ana e Kullës rreth 4 mijë metra në brendi të territorit të Kosovës, duke lënë jashtë anët veriperëndimore të Zhlebit, tëbanet e Lloqanit dhe një pjesë të tëbaneve të Gllogjanit. Nuk mund të korrigjohet kufiri më vonë me disa kilometra apo mijëra hektarë, por vetëm me dhjetëra metra apo disa hektarë. Të dorëzohet shteti e Kuvendi sot para Murat Mehës, në mënyrë që më vonë ta korrigjojë, është vetëmashtrim.

Raporti Bulliqi nuk mund ta ketë statusin sikurse Marrëveshja e Vjenës. Kot thuhet se ajo përbën orientim në projektligj, sikur ai raport të ishte njëmend për orientim, atëherë Thaçi e Meha do të

ishin në burg sot. Pas raportit Bulliqi s'ka punë Kuvendi këtu, por prokuroria. Pas raportit Bulliqi, seanca e sotme është pengim i drejtësisë.

Mu në këtë sallë, më 25 qershor të vitit 2015, kemi miratuar me shumicë votash rezolutën e Kuvendit pas interpelancës për çështjen e demarkacionit, pika 4 e së cilës thotë: “Qeveria të raportojë në Kuvend para miratimit të elaboratit ndërkufitar Kosovë-Mali i Zi”. Pra, kjo rezolutë është shkelur. Ish-Qeveria kurrë nuk erdhi në Kuvend para nënshkrimit në Vjenë, më 26 gusht 2015. Integriteti territorial varet nga integriteti institucional. Duke mos e votuar këtë marrëveshje, ne e refuzojmë edhe shkeljen e Kuvendit, edhe faljen e territorit.

Deputetë të Kuvendit,

Liberalizimi i vizave nuk është prioriteti i qytetarëve të Kosovës, por prioriteti i Qeverisë për qytetarët e Kosovës. Qytetarët e Kosovës duan vende pune, drejtësi, liri, mirëqenie, barazi në Kosovë. Kjo nuk është marrëveshje për liberalizim të vizave, por për falje të territorit. Sikur të ndodheshim në prag të liberalizimit të vizave, siç po na premtojnë, atëherë do të ishte shumë më kollaj që të merren vizat nëpër ambasadat e vendeve të BE-së. Mirëpo, jemi dëshmitarë se kurrë s'ka qenë më vështirë, apo jo?

Para së gjithash, pse Qeveria nuk i jep zor që ta përmbushim kriterin tjetër: lufta kundër krimit e korrupsionit? Pse janë ngujuar te demarkacioni dhe mu te demarkacioni i Murat Mehës? Pse? Janë afro 40 raste gjyqësore, që duhet të shkojnë deri në fund, duhet të aprovohet Ligji për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, duhet të ketë arrestime të reja, por këta nuk duan ta plotësojnë kriterin tjetër, sepse nuk duan ta luftojnë vetveten. E mbani mend qysh Isa Mustafa, vetëm që të mos ketë zgjedhje të reja, i mbështeti të gjitha vendimet e këqija të Thaçit, edhe më shumë sesa vetë Thaçi. Mustafa e bëri Thaçin president, Mustafa e bëri Veselin kryeparlamentar, e mori barrën e “Zajednicës” e demarkacionit dhe në fund e rrëzuan. Ngjashëm, Haradinaj po përpiket të hajë me dy lugë, edhe me Mehën, edhe me Bulliqin. Po del që është më shumë i uritur se sa i zemëruar. Dhe, për postin e kryeministrit po e merr barrën që nuk i takon, e për të cilën nuk ka faj. Nuk ka ndryshuar demarkacioni i Mehës, por kanë ndryshuar AAK e “Nisma”. Nuk bëhet fjalë për korrigjim kufiri në drejtim të Çakorrit e Zhlebit, por për devijim qëndrimi të Haradinajt në drejtim të Murat Mehës.

8 200 hektarë kanë vlerë e nuk kanë çmim. Kjo Qeveri s'ka vlerë, sepse ka çmim. 82 kilometra katrorë po jepen për çerek metri katror të karriges së kryeministrit.

Kryeministër Haradinaj,

Kjo që po bëni është mashtrim dhe vetëmashtrim. Por, nëse duan të ta rrëzojnë Qeverinë, pse ju nuk po i falni tokë Malit të Zi, unë ju mbroj, ne ju mbrojmë. Kur ta bllokojmë “demarkacionin” e Mehës, nuk po e lejojmë Thaçin që t'ua rrëzojë juve Qeverinë. Mospajtimet e dallimet tona mbeten, por unë nuk dua që ju të rrëzoheni pse nuk i dhatë 8 200 hektarë Malit të Zi. Më vonë

duhet të rrëzoheni për aq shumë gjëra për të cilat nuk është koha të flasim sot, por jo për këtë temë. Kundërthënia pozitive-opozitive në mandatin aktual nuk shter gjithçka. Ka gjëra kombëtare e shoqërore, të interesit publik e të peshës historike, që janë më të rëndësishme sesa partitë tona apo postet tona. Pra, nëse po të thonë që “po deshe ta vazhdosh qeverinë, duhet ta legjitimosh tradhtinë”, këtu dhe tash të dalim në ndihmë e në mbrojtje, mos e legjitimo tradhtinë. Ndonjë mocion mosbesimi që ta nisin, ndoshta kësaj radhe nuk është “Nisma”, ndoshta, pse nuk po i falë 8 200 hektarë, ne nuk e përkrahim. Tash është momenti i fundit, deputetë, të bëjmë diçka pa pëlqimin e Malit të Zi. Pas ratifikimit, asgjë s’bëhet pa pëlqimin e të Malit të Zi.

Mali i Zi po sillet butë dhe mirë. Kjo duhet shfrytëzuar për bisedime të reja, e jo për dyfishim nënshkrimi të njëjtë, siç bëri presidenti. Nuk kemi pasur nevojë të përsëritet Vjena në Podgoricë. S’ka kuptim njëherë ratifikim, e pastaj korrigjim. Anasjelltas duhet: korrigjim kufiri, mandej ratifikim.

A e dini pse Mali i Zi po sillet butë tash? Jo pse kjo është në kulturën a traditën e tyre, por së pari, Mali i Zi nuk ka hesap t’i prishë marrëdhëniet edhe me Rusinë, edhe me shqiptarët, që i ka rrotull shtetit e brenda shtetit. Dhe, e dyta Mali i Zi po sillet butë derisa ta marrë këtë ratifikim në Kuvendin e Kosovës, pastaj egërsohet ca, ndoshta jo shumë, por do të egërsohet pak. Përfundimisht, ne propozojmë:

1. Debat parlamentar për raportin e Komisionit Bulliqi,
2. Deklaratë të Kuvendit të Kosovës për fqinjësi të mirë dhe kërkesë për rishqyrtim të marrëveshjes,
3. Nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta diplomatike t’i kumtohet mospajtueshmëria Malit të Zi me metodologjinë e përcaktimit të kufirit dhe nisja e iniciativës së re për një proces të ri të demarkimit,
4. Hetim parlamentar për marrëveshjen, gjithë rrjedhën, rolin dhe përgjegjësinë e faktorëve të involvuar në këtë proces,
5. Konferencë ndërkombëtare lidhur me procesin e përkufizimit (delimitimit) dhe shënjimit (demarkacionit) të kufirit në Kosovë, regjion e më gjerë, si rast për shpalosjen e gjithë të vërtetës.

Tashmë i kemi dy zhvillime pozitive: pranimin implicit të gabimit nga Thaçi dhe pranimi implicit nga Mali i Zi për bisedime të reja. Këto duhen të mirëpërdoren.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Po të ishte nënshkruar marrëveshja në Vjenë nga Behxhet Pacolli ose nga Enver Hoxhaj, nuk do të ndodheshim në këtë nxitim sot dhe kollaj ishte rrëzuar demarkacioni i Mehës. Kështu, me Thaçin nënshkrues po bëhet gjithë ky nxitim që na i humb menjëherë 8 200 hektarë dhe na e premtton heqjen e vizave dikur. Madje, i njëjti Thaçi, më 27 dhjetor 2010 premtonte që vizat hiqen për 13 muaj, tash e nënshkroi faljen e tokës dhe kërkohet prej jush t'i besoni e t'i nënshtroheni sërish?!

Le ta bëjmë njëherë korrigjimin me komision të përbashkët, pastaj ratifikimin. Ndërkohë, e plotësojmë kriterin për luftimin e korrupsionit e krimin. Në fund, të dy kriteret i plotësojmë përafërsisht njëkohësisht, për shembull, në të njëjtën javë të të njëjtit muaj kah fundi i vitit. Ky nxitim do të kishte kuptim, po të ishte kriteri i fundit për liberalizimin e vizave. Pse e pengon mosratifikimi luftimin e krimin dhe korrupsionit? Lidhja e marrëveshjes për demarkacion me lëvizjen e lirë është veçse shantazh i qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Time Kadrijaj, fjala për ju!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryeparlamentar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Se procesi i demarkimit dhe i marrëveshjes ka shkuar pa transparencë dhe s'ka pasur llogaridhënie, ndoshta na ka sjell në këtë momentum. Është e vërtetë se duke e parë se kjo marrëveshje nuk është bërë drejt dhe saktë, ka filluar edhe kundërshtimi. Andaj, kjo marrëveshje dhe kjo mostransparencë duhet t'i shërbejë kësaj Qeverie se për temat e ndjeshme dhe temat nacionale duhet të zhvillohet debat i brendshëm dhe duhet të gjendet një konsensus.

Është e vërtetë se jemi angazhuar dhe për petitionin, por edhe organizimin e vazhdueshëm të protestave kundër këtij demarkimi. Sa herë kemi kundërshtuar, kemi kërkuar që të negociohet për korrektim të vijës kufitare, të bisedohet për negociim dhe për korrektim. Kemi organizuar tryeza dhe ka pasur ballafaqim faktesh për çështjen e kufirit, por tash kemi një momentum të ri. Vendimi i parë i Qeverisë Haradinaj ka qenë shkarkimi i komisionit të vjetër dhe formimi i një komisioni të ri, një komisioni profesional dhe jopolitik. Në bazë të raportit të ri dhe të gjeturave, negociatave me Malin e Zi, produkt e kemi deklaratën e dy presidentëve, me të cilën lejohet korrektimi. Pra, duke qenë pjesë të ligjit marrëveshja e 2015, raportit Bulliqi dhe deklarata e presidentëve janë materie e mjaftueshme që na mundëson ta përkrahim.

Pse nga disa deputetë pranohet raporti i Bulliqit, por prapë s'po e përkrahni. Ne me këtë kemi të drejtën që të kërkojmë nga Qeveria që të punohet deri në kthimin e kufirit deri në Çakorr dhe Kullë. Andaj, ne si grup parlamentar dhe si deputetë e përkrahim këtë marrëveshje.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryesues, faleminderit!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Pas sa kohe, tashmë më tepër se dy vjet, në rrethana të përshpejtuara dhe të çuditshme vendi ka mbetur në këtë situatë dhe kjo temë e papërfunduar.

Besoj që sot të gjithë bashkë duhet ta diskutojmë mundësinë ose këtë projektligj të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës si mundësi për ta përmyllur këtë temë dhe ta përmyllim këtë temë, duke mos pasur dilema rreth vendimit tonë, votës sonë, për të ecur tutje. Projektligjin dhe marrëveshjen për të cilën sot është propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta shohim si mundësi për të rishikuar e biseduar me palën malazeze për të përmirësuar eventualisht gabimet dhe lëshimet që janë bërë gjatë kohës së bisedimeve të komisionit të parë. Vetë marrëveshja ose deklarata mes të dy presidentëve i jep mundësi Kosovës dhe është një marrëveshje, është një deklaratë e ndërtuar mbi bazën e marrëveshjes paraprake, në nenet përkatës, të cilat i detyron të dyja palët që të rishikojnë, eventualisht të korrektojnë pikat, vijat kufitare kudo që është gabuar ose janë bërë lëshime.

Dhe, kur po flasim për korrektim, nuk jemi duke folur për korrektim në një pjesë të caktuar, por mundësitë që nesër grupet e punës të korrektojnë janë gjatë gjithë vijës kufitare. Unë mendoj se sot ne duhet ta zhvillojmë debatin ndoshta në këtë frymë, të mundësitë, një, dhe e dyta, të angazhimet që duhet t'i marrë grupi ynë punues për të mos bërë gabime dhe lëshime gjatë bisedimeve dhe negociatave që do të kemi me palën malazeze. Dhe, të mos përsëriten gabimet e jotransparencës së ndërtimit të marrëveshjeve të kaluara. Ajo që unë besoj që duhet të ishte shumë me rëndësi dhe besoj që është me rëndësi sot ta diskutojmë është formimi i grupit të punës, cili do të jetë roli i Parlamentit nën mbikëqyrjen transparente të gjithë aktivitetit dhe punës e angazhimit që grupet punuese do ta bëjnë njëra me tjetrën.

Ne, është e vërtetë, e kemi një raport të ekspertëve, të cilët kanë qenë kundër variantit të kaluar dhe kjo është e rëndësishme që sot është pjesë e dokumentacionit që ne duhet ta miratojmë. Gjithashtu, jemi një pjesë e njerëzve që ne duke u mbështetur në deklaratimet e qëndrimet e atyre ekspertëve që kanë qenë kundër, kemi mbajtur dhe qëndrimin tonë hezitues dhe kundërshtues. Ama, duhet të jemi të qartë, asnjëherë deri më tani nuk janë testuar provat, faktet që ka komisioni ynë me komisionin e Malit të Zi. Ne besojmë që nuk kemi çka të fshehim, dhe nëse janë provat e mjaftueshme, unë besoj se ka prova dhe nëse ka fakte, unë besoj në nxjerrjet ose gjetjet që ka

bërë ai komision, le të shkojnë me palën malazeze të ulen, të bashkëbisedojnë dhe përmes argumenteve, ekspertizës, të vlerësohet ku është gabuar dhe të korrigohet.

Nuk mjafton ne këtu të nxjerrim konkluzione dhe të themi: “Kështu është dhe ndryshe s’bën”. Ne çka po bëjmë? Po japim një mundësi, disa mundësi vendit sot. E para, dikush kemi qenë përpara me mendimin që duhet të shkohet në arbitrazh, nëse Mali i Zi nuk pajtohet shkojmë në arbitrazh. Unë besoj, kjo marrëveshje këtu që ka ardhur, kjo e fundit mes të dy presidentëve, jep një mundësi më mirë se vetë arbitrazhi, sepse edhe një herë e ul Malin e Zi në tavolinën e bisedimeve dhe, edhe një herë u jep mundësi këtyre ekspertëve tanë për t’u ulur me ta së bashku, për t’i trajtuar deri në detale lëshimet dhe gabimet eventuale që janë bërë gjatë përcaktimit të vijës kufitare.

Mendoj që kjo është shumë më mirë se sa arbitrazhi. Tjetra, është një mundësi tjetër që ne sot po ia ofrojmë vendit tonë, hapjen e perspektivës evropiane dhe largimi nga tema ose nga kjo pengesë që vazhdimisht është duke na mbajtur për kohë të gjatë. Nuk ka asnjë dilemë që ne kemi qenë dy taborë dhe ne, detyra jonë është për ta nxjerrë nga ky ngërç vendin. Nga ky ngërç vendi nxirret nëse jemi të gjithë së bashku për t’ua dhënë një mundësi organeve kompetente, për t’ua dhënë një mbështetje këtyre organeve, që të rishikohet, të rivlerësohet, në fakt, çka ka ndodhur në vijën kufitare. Shikoni, pas votimit të këtij ligji është obligim ligjor krijimi i komisioneve. Dhe, edhe pasi komisionet bashkëbisedojnë atje, nuk ka mundësi të vihen pikat kufitare pa pajtimin e të dy palëve, nuk ka mundësi. Pse po them është një mundësi më e mirë kjo marrëveshje që kemi nxjerrë, se arbitrazhi. Arsyeja është e thjeshtë, sepse ne e pamë në arbitrazh se si shkoi çështja e Kroacisë dhe Sllovenisë, një.

Dhe, e dyta, argumenti i dytë është, po qe se Mali i Zi nuk do të shkojë në arbitrazh, çfarë arbitrazhi mund të ketë. Prandaj, unë mendoj është një mundësi që duhet ta shfrytëzojë maksimalisht me përgjegjësi dhe njerëz ekspertë, pro e kundër, të ulen, të bashkëbisedojnë me vendin fqinj dhe të shohin ato të gjeturat të prezantuara neve a qëndrojnë apo jo. Ne të gjithë mund të supozojmë, por ekspertë të asaj fushe asnjë ne s’jemi këtu, ne duhet t’u besojmë njerëzve tanë dhe njerëzit tanë të gjeturat që kanë prezantuar para opinionit publik dhe që është raport sot dhe po bëhet pjesë e ligjit, duhet t’i ballafaqojnë me ekspertët e Malit të Zi, jo me neve këtu. Kjo është mundësia që e kemi ofruar me këtë variant sot.

Të nderuar kolegë,

Është edhe një mundësi tjetër që po e afrojmë me votimin e këtij projektligji. Hapja e një perspektive tjetër për vendin, hapja e mundësisë që Kosova të ecë drejt rrugëtimit të vet, drejt integriteteve evropiane. Vetë fakti që ky debat që sot zhvillohet në këtë formë e në këtë mënyrë, unë mendoj që është një e arritur e jashtëzakonshme për këtë temë të nxehtë, e që na ka rënduar për dy vjet. Po edhe varianti dhe forma në të cilën kemi ardhur këtu besoj që ka kontribuar për të ardhur këtu ku jemi sot, për të pasur këtë diskutim në këtë formë. Prandaj, ju kisha lutur dhe ju

kisha ftuar të gjithë deputetëve të Parlamentit të vendit që sot t'i japim me votën tonë, t'i krijojmë disa mundësi për vendin. E, unë e di që me votë sot ne krijojmë disa mundësi, e para: grupi punues për ta rishikuar e për të hequr çdo dilemë ka pasur apo s'ka dhe sa ka dëm në vijën kufitare.

E dyta, mundësinë e lëvizjes së lirë të njerëzve të Kosovës dhe e treta, nisjen e re drejt integriteteve të vendit. Gjithashtu, do të doja që Parlamenti i Kosovës nga këtu të involvohet tërësisht në këtë proces, e jo vetëm Qeveria dhe jo vetëm grupi punues. Ky involvim në këtë proces është përmes komisioneve parlamentare, përmes propozimit nga opozita të anëtarëve që duhet qenë në grupet punuese, qoftë nevojta edhe të udhëhiqen grupet punuese, vetëm e vetëm që ta kemi vërtet një proces transparent e të shohim se çka ka ndodhur atje dhe të përmbillet kjo çështje si duhet.

Ne nuk marrim përgjegjësi se si do të përfundojë punën komisioni, është detyrë e profesionistëve, ne e kemi dhënë këtë mundësi si politikë, kemi krijuar një rast, një mundësi për të rishikuar, kjo ka qenë detyra e politikanëve. Se sa ka humbur, a ka humbur apo s'ka humbur, ata do të ballafaqohen, ekspertët, atje në vendin e ngjarjes dhe do të vijnë me rekomandime për të na treguar kemi humbur territor apo s'kemi humbur territor, sa kemi humbur, nëse kemi humbur. Prandaj, ju ftoj që në këtë rast të dalim nga kjo temë të bashkuar, t'i japim një mundësi vendit tonë. Jam i bindur që e ka arritur qëllimin e vet që herëve të tjera marrëveshjet kur e fusin vendin në obligime, të jemi të kujdesshëm. Ne e dimë si do të ishte më mirë, por ka qenë e pamundur nga një marrëveshje e ratifikuar nga vendi, të kthehet në përmbysje duke pasur vullnetin e tyre. Nuk janë të vullnetshëm ta përmbysin e të kthehemi nga pika zero, prandaj besoj nga krejt këta muaj që është biseduar ia kemi ofruar një mundësi vendit tonë. Nëse jemi të përgjegjshëm, nëse jemi të mençur, nëse jemi të pjekur, nëse jemi të gatshëm dhe nëse dimë, nuk ka asnjë dilemë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, ta përmbyle diskutimin!

FATMIR LIMAJ: Nëse jemi të përgjegjshëm, thashë unë nuk kam asnjë dilemë që ne këtu do të jemi me ndërgjegje të qetë se ai grup atje do ta bëjë punën si duhet. Mbi të gjitha, besoj që kjo është detyra jonë që vendit tonë t'i hapim rrugë, t'i japim mundësi edhe kur është në ngërçin më të madh dhe kur ka vështirësi për t'i tejkaluar vështirësitë. Është një vendim i madh, i rëndësishëm që mund të përcillet e të mos e lëmë të gabojë rrugës. Të bashkohemi për t'ia dhënë këtë mundësi jo një grupi, jo një qeverie, por t'ia japim mundësinë vendit të gjithë së bashku, sepse kjo është temë nacionale, nuk është e rezervuar për një grup njerëzish. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Rexhepi.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uvažene kolege,

Svi smo danas u ovoj Sali, predstavnici naroda, i kao takvi smo direktno odgovorni našim građanima. Naša misija je da obezbedimo što bolje uslove za život građana, a jedan od tih uslova je i današnje izglasavanje Zakona o demarkacije, koji će omogućiti slobodu kretanja za naše studente, biznesmene, našu rodbinu koja će moći slobodno da putuje i posećuje svoje najmilije u zemljama Evropske Unije, a svi znamo da broj naši ljudi nije tako mali.

Zašto se ne zapitamo kao odgovorni ljudi, da li imamo prava da ovo već tri godine držimo kao status kvo, a naše građane u potpunoj izolaciji. Naime, samo Republika Kosovo i naše stanovništvo je izolovana u čitavom regionu.

Treba da pokažemo ozbiljnost, ne samo prema našim građanima, već i prema čitavoj međunarodnoj zajednici da smo zreli da donosimo važne odluke ove države. Da, mislim da treba da izglasamo demarkaciju, da sami sebi skinemo izolaciju, da našim građanima omogućimo slobodu kretanja, našim učenicima i studentima omogućimo studiranje van naše zemlje, tamo gde oni žele, našim biznismenima olakšamo poslovanje, i na kraju da našim ljudima sačuvamo milionske sume novca koje potroše prilikom apliciranja za dobijanje viza, i spasimo ih poniženja čekajući u ogromne redove ispred svih ambasada.

Ja mislim da je sve ovo dovoljan razlog da pokažemo zrelost i ozbiljnost i izglasamo Zakon o demarkaciji.

Poštovani kolege poslanici,

Ako ja kao predstavnik manjinskih naroda, konkretno Bošnjacke nacionalne zajednice, glasam za, zbog čega svi ostali ovde prisutni u sali ne želite to da uradite, bez obzira iz koje albanske političke opcije dolazite. To je nacionalni interes ove države. Lista srpska danas nije ovde, mada i za njih mislim da bi trebali glasati, jer su kosovski Srbi, ustavna kategorija. Ovo je i njihova zemlja. Svi zajedno smo poslanici ovog Parlamenta, i trebamo biti odgovorni prema svim građanima Kosova.

Poštovani građani Goranske nacionalne zajednice,

Ne vidim u ovoj sali ni mog kolegu Adema Hodžu, vašeg predstavnika u ovom Parlamentu, a znam sigurno da i vi želite slobodu kretanja i poslovanja u regionu. Te takođe znam da gorani konstantno formiranje opštine Gora. Ako je ova sala mesto gde treba da se donese takva odluka, onda ja prosto ne razumem njegov bojkot ove sale i ove institucije, te ga molim, ne kao kolegu, nego kao prijatelja, da pokaže političku zrelost, da se vrati se u sali i glasa za ovaj zakon.

Poštovani kolege poslanici,

Ja vas molim da danas ostavite svoje partijske nesuglasice. Pokažemo svi zajedno političku zrelost i glasajmo Zakon o demarkaciji, kako bi smo se svi zajedno kasnije fokusirali na našu vojsku, koja nam je takođe od prioriternih nacionalnih interesa. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të paktë të Qeverisë së Kosovës, e ende më pak deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Të nderuara medie,

Qytetarë të Republikës,

Një fakt shumë i thjeshtë, që kur e kanë pyetur Gjon Keins, ekonomist britanik “pse po i ndryshon qëndrimet?”, ose e kanë kritikuar oponentët e tij se pse po i ndryshon qëndrimet, u është përgjigjur “kur ndryshojnë faktet, unë e ndërroj mendimin”, “kur ndryshojnë rrethanat, unë prezantohem ndryshe”.

Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Qeveria Haradinaj po që e kanë ndryshuar qëndrimin, por faktet nuk kanë ndryshuar. Dhe, nëse ai e ka ndryshuar qëndrimin pa u ndryshuar faktet, gjë që ka qenë dashur sot të ndodhë me hapjen e kësaj seance, është dashur që kryeministri, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, t’i kërkojë ndjesë popullit të Kosovës për këto tre vjet të humbura, për skenat e dhunës në këtë Kuvend, pjesë e të cilave ishte edhe ai vetë, vendi ku ulem ka ende shenja të armëve, ose gazit të përdorur, lëndëve djegëse, e kështu me radhë... Të kërkojë ndjesë për humbjen e një shprese që i ka ndodhur këtij vendi në këto vite që nuk mund ta marrë barrën kjo Qeveri, është evidente, por të gjitha radhazi nga pak e mbajnë peshën e asaj se çfarë i ka ndodhur Kosovës.

Çka është shumë e rëndësishme të trajtohet sot është konteksti i trajtimit të një çështjeje shumë teknike, siç është matja e vijës kufitare me një shtet fqinj miqësor. Dëgjova se u përmend këtu, zoti Kurti më duket e tha që Mali i Zi mund ta ndërrojë qëndrimin pas ratifikimit të demarkacionit në Parlamentin e Kosovës. Vetëm një, t’ua rikujtojmë të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, që po flasim për një pjesë të Evropës Juglindore, e cila edhe kur ishte pjesë e Unionit Serbi-Mali i Zi i hapi dyert për refugjatët shqiptarë, të sulmuar nga po ai shtet, pjesë e të cilit ishte dhe nuk e di, ose nuk kam informacion se dikujt i ka ndodhur diçka e keqe në vitin ‘99 në Malin e Zi.

Po flasim për një vend që me një kulturë miqësore në momentet më të vështira ka pritur njerëz nga Kosova. A është kjo arsye për të falë territor? Natyrisht se jo! Po, a jemi duke falur territor? Kjo është pyetja dhe përgjigjen në këtë çështje teknike nuk mund ta japim me argumente

politike. Përgjigjen në këtë pyetje teknike mund ta bëjnë ekspertët, por ne i kemi dehumanizuar edhe ekspertët që janë marrë me këtë çështje.

E përmendën Komisionin “Bulliqi”. Të gjithë e dimë, unë e di se Komisioni “Bulliqi” është munduar, kryeministri dhe Qeveria, që ta përdorin si argument, ose si ai fakti që e përmenda i Keinsit, që ka ndryshuar. Jo, nuk ka ndryshuar, se ata nuk kanë dalë në terren për të matur asgjë, ata e kanë dhënë një konkluzion të bazuar në diçka që ata e kanë analizuar prej zyrës. Domethënë, t’i kemi faktet e drejta për çështje teknike, të mos diskutojmë ne, ose të interpretojmë.

Konteksti i raportit rajonal dhe politik, ose gjeostrategjik, prapë ne jemi duke folur për një kufi me një shtet anëtar të NATO-s. Një shtet anëtar i NATO-s, nëse ke ballafaqim me një shtet anëtar të NATO-s është si të kesh ballafaqim me krejt Aleancën e NATO-s. Dhe, në Malin e Zi në ndërkohë, prej vitit 2015 deri në vitin 2018, ka ndodhur ky ndryshim dhe ky është fakt, që sot duhet të merret në aspektin e trajtimit. Po flasim për vijën kufitare të Republikës së Kosovës me një shtet anëtar të NATO-s, marrëveshje kjo e ratifikuar që të dërgohet, përfshirë këtu edhe Kombet e Bashkuara dhe të shkruhet emri i Republikës së Kosovës, edhe pse për Kombet e Bashkuara jemi entitet ende i panjohur.

Konteksti politik, krejt çka ka mundur të shkojë gabimisht dhe të menaxhohet keq është menaxhuar keq me demarkacionin prej momentit të mungesës së transparencës, prej momentit të mungesës së raportimit në Kuvend. Po, mban përgjegjësi Qeveria e kaluar, mban përgjegjësi edhe atëherë ministri i Punëve të Jashtme, sot president i shtetit. Është duke e bërë gabimin tjetër sa i përket dialogut me Serbinë, jashtëligjshëm, në një proces i cili ka nevojë për transparencë prej hapit të parë.

Por, gjithë kjo që po ndodh nuk është duke u ndihmuar qytetarëve të Republikës së Kosovës, ose këtij Kuvendi. Në fakt, është një mbulesë e mirë për të mos u trajtuar problemet e mirëfillta të qytetarëve të Republikës së Kosovës, për t’u tërhequr vëmendja prej atyre problemeve të cilat secili në baza ditore i kanë, përfshirë këtu edhe lirinë e lëvizjes. Rrëzimi i Qeverisë dhe kauza politike e lidhur me çështjen e rrëzimit të Qeverisë së kaluar ka qenë ndoshta kauza e fundit që është dashur të përdoret në formën sesi është përdorur, por është e kaluar. Çka neve na takon sot është të nxjerrim mësimet, se mësimi që duhet nxjerrë është që në tema të kësaj natyre duhet të ndërtohet konsensus politik. Mungesa e ndërtimit të konsensusit politik të të gjitha partive shqiptare po e sjell Kuvendin në këto kriza. Për një agjendë reformatore, për një agjendë proeuropiane duhet ta bëjmë praktikë të mirëfilltë të këtij Kuvendi, t’ia kthejmë kredibilitetin Kuvendit të Republikës së Kosovës, që partitë shqiptare shumicë të kenë konsensus pas procesit zgjedhor.

Procesi zgjedhor dhe gara politike janë të ndara. Përfundon gara politike, fillon procesi i Legjislacionit dhe i Ekzekutivit dhe është esenciale që të kthehet konsensusi i mirëfilltë, që të kthehet besimi ndërmjet partive politike në Kosovë dhe të organizohen në formën e mirëfilltë tryeza të përbashkëta. Për demarkacionin, takimin e vetëm të përbashkët të të gjitha partive në Kosovë e ka organizuar shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian, nuk e ka organizuar Presidenti i vendit, ndoshta sepse është frikësuar se nëse ai i thërret në takim liderët politikë, një numër i konsiderueshëm i tyre nuk i shkojnë, është problem i tij, se ka mungesë kredibiliteti institucional. Por, duhet të kthehemi në pikën që dikush të ndiejë që për këtë vend duhet të marrë përgjegjësi dhe ne si shumicë e kemi obligimin ta heqim më në fund perden e asaj çfarë po mbulojmë. Sot në Kosovë shumë më tepër se problemi i matjes së vijës kufitare është lufta kundër korrupsionit. Është problem i cili sot e shumë vite po e han vendin. Sot shumë më tepër në Kosovë është agjenda reformatore e biznesit. Të gjitha premtimet elektorale për njëqindmijë, dyqindmijë vende pune po i shohim se përfundojnë me ditën kur kryhen zgjedhjet. Ku është agjenda reformatore e zhvillimit ekonomik?

Sot duhet të ketë guxim të mirëfilltë që të sillet në Parlamentin e Kosovës Ligji për Qeverinë. Nuk mund Kosova me 1,7 milion banorë të ketë 22 ministri. Sot, mu për atë që agjenda politike në vazhdimësi ka mbisunduar në të gjitha partitë politike para agjendës shtetërore ne jemi në këtë situatë dhe kjo agjendë është mu edhe në këtë Qeverinë Haradinaj, e cila ka ardhur me argumentin e vendimeve të forta. Jo, argumenti i vetëm i fortë i Qeverisë Haradinaj janë interesat politike. Të njëjtin ai e thotë vetë, kur e pyet përse janë gjithë ata zëvendësministra. Pse duhet të gjitha partitë politike të shërbehen në njëfarë mënyre, për shkak se ia kanë dhënë votën për ta bërë kryeministër. Sot të njëjtat përmenden në vazhdimësi kur emërohen sekretarë jashtëligjshëm, kur emërohen anëtarë në borde, bile tash janë bllokuar krejt. Të gjitha ndërmarrjet publike janë të bllokuara për arsye se nuk arrijnë që agjendat politike t'i servojnë para agjendës shtetërore.

Ne, të dashur kolegë deputetë, nuk kemi agjendë shtetërore. Neve agjendën shtetërore na e bëjnë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sikur ne të kishim agjendë shtetërore, t'i paraqesim pikat të cilat janë të rëndësishme jetike për qytetarët tanë. Dhe, pika e parë është sundimi i rendit dhe ligjit dhe luftimi i korrupsionit. Pika e dytë është zhvillimi ekonomik dhe reforma e Administratës Publike, ndërtimi i një konsensusi ku të gjitha palët pajtohen që do të jetë e dhembshme, ta kemi një sundim të mirëfilltë të ligjit dhe ulje të burokracisë, por që është e domosdoshme.

Sot, ky debat është i domosdoshëm për t'u lënë hapësirë të gjitha temave tjera me rëndësi për qytetarët e Kosovës. Ky debat sot është vetëm edhe një çështje rutinore, sepse siç e pamë kryeministrin edhe gjumi e merr në këtë karrige, se nuk ka më as koncentrim të vazhdojë me këtë debat, se i ka kryer të gjitha argumentet që i ka pasur, se e vetmja arsye që e ka përdorur këtë debat ka qenë për të ardhur në këtë karrige. Tash kur e ka marrë karrigen, e merr gjumi në

karrige. Por, është shumë e rëndësishme për t'u kthyer kryeministri në këtë karrige dhe për të diskutuar me ne se sa raste të korrupsionit janë trajtuar në formën e mirëfilltë, se cila është ideja e tij për reformë të Administratës Publike, se cila është ideja e tij për vendime të guximshme politike në raport me dialogun.

Sot, kryeministri duhet të kthehet dhe të na tregojë se çka po diskutohet me Serbinë, se edhe më i dhembshëm, ende më i vështirë do të jetë demarkacioni me Republikën e Serbisë. Ku janë këto çështje, të cilat ne na presin në vazhdimësi dhe tash ne mbahemi në një pikë, e cila e ka mundësinë e korrigjimit, nëse ka hapësirë për korrigjim. Krejt çka ka ndodhur ka ndodhur, e kaluara nuk mund të kthehet. E sotmja dhe e ardhmja mund të ndryshohen dhe ne me votën tonë sot e kemi mundësinë për t'u dhënë hapësirë të gjithëve në këtë Kosovë, që duan të jetojnë me dinjitet dhe ndoshta t'u kthehet shpresa që gjërat po kthehen në normalitet. Ky Kuvend ka nevojë për normalitet, ka nevojë për agjendë të mirëfilltë legislative dhe për prioritet, prioritet ato të njëjta që i kanë edhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Të mos vijnë të tjerët të na tregojnë se përderisa Qeveria është e zënë me interesa politike, për ne janë disa obligime shtetërore që i kemi secili prej nesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë, që me padurim po e përcillni epilogun e kësaj seance,

Debati për këtë temë sot po rikthehet për herë të parë në Kuvend pas tre vjetësh përplasjesh e përgazjesh. Shpresoj që sot më në fund ta arrijmë atë konsensus, aq shumë të pritur, në interes të qytetarëve.

Tre vjet fjalë e lloj-lloj aktiviteteve u zhvilluan në këtë sallë e jashtë kësaj salle në lidhje me këtë marrëveshje me Malin e Zi. Të jem e sigurtë, shumë opinione të ndërtuara nga politikanë dhe politika të papërgjegjshme hutuan dhe i manipuluan edhe qytetarët që ishin mbështetës pastaj të këtyre kauzave, që ndikuan në bllokadë të gjatë, por edhe dëmtime të shumë proceseve, por edhe dëmtime në kuptimin fizik e material të institucioneve tona, të policëve tanë, që ishin në krye të detyrës për mbrojtje e siguri dhe shumë proceseve tjera shtetndërtuese.

Personalisht kam qenë e bindur në profesionalizmin e Komisionit "Meha" dhe kur sot po diskutoj për këtë marrëveshje, lexoj komente dhe deklarata në medie, edhe nga ata qytetarë dhe analistë që ishin dikur të hutuar nga propaganda e politikanëve të papërgjegjshëm, që sot njëzëri të gjithë e kanë një kërkesë nga ne, pra votimin pro të kësaj marrëveshjeje. U lodhëm ne dhe i lodhëm edhe qytetarët tanë nga kjo temë, e cila ka ngecur për shkak të ambicieve politike, edhe të individëve të caktuar në këtë sallë, të cilët krijuan përplasje dhe ngatërresa të papara deri sot

për këtë temë, për të cilën në çdo vend normal do të kishte diskutime më logjike, shumë më shumë profesionale sesa emocionale. Mirë që u pamë në situata të ndryshme secili nga ne këtu brenda institucioneve në veprimet tona dhe brenda partive tona.

Kush arriti t'i bindë qytetarët se kjo marrëveshje është e padrejtë? Kush u bind në këto tri vite që ne po bëjmë një vepër patriotike duke lënë peng njerëzit tanë, duke mos e ratifikuar një marrëveshje e cila mbyll kapitullin e izolimit dhe u hap rrugën edhe shumë proceseve, të cilat në një mënyrë edhe e forcojnë shtetësinë tonë.

Si deputete e këtij Kuvendi, e falënderoj Malin e Zi për vullnetin e mirë që ta mirëkuptojë situatën tonë dhe ta kemi edhe një marrëveshje shtesë të re ndërmjet dy presidentëve, e cila mundëson edhe sigurinë shtesë për korrigjime në ndonjë pikë.

Sot, drejt nesh janë mijëra sy që luten në heshtje, por edhe me zë, për votën tonë, por për votën pro. Fillimisht, studentë e studente të cilët e patën të pamundur t'i provojnë mundësitë e tyre për studime, me përjashtime të vogla të disa bursistëve për të qenë studentë në universitete, që i deshën ëndrrat e tyre. Sa profesorë universitarë e patën të pamundur të aplikojnë e të marrin vizë në kohë për të qenë pjesëmarrës në konferencat e domosdoshme, e të cilat mund të ishin jetike për karrierën e tyre akademike? Sa sipërmarrës kanë dështuar ta marrin një vizë, e cila do t'ua mundësonte marrjen e përvojave të mira në bizneset e tyre dhe sa peripeci i sprovonjë ata për të qenë më afër Evropës me prodhimet e tyre. Të mos flasim për artistë e sportistë, për të cilët shpesh shkak ishte një vizë e shkretë që të mos jenë pjesëmarrës në gara, a në evenimente tjera artistike. Për çka? Për një vizë.

Edhe sot kur ne flasim e secili secilit mundohet t'ia hedhë fajin për këtë vonesë, e ndiej se shumë nga ta do të thonë "Boll ma! Votojeni dhe nisini temat që janë edhe më të rëndësishme për vendin, e për të cilat nesër edhe mund të jenë vonë", sepse duke u marrë me një kauzë të shpikur i lamë të katandisem shëndetësinë e arsimin, e nuk e ndihmuam as kulturën dhe fare pak sportin. Një muaj gaz dhe bomba, një tjetër arrestime. Në sytë e qytetarit ishim të njëjtë, edhe unë që kisha vullnet ta votoj këtë marrëveshje, edhe kolegja ime e cila ma hidhte gazin në fytyrë, pra "për ta mbrojtur territorin". Në thonjëza, sepse askush s'e dinte më mirë se tjetri se cila ishte e vërteta në këtë mes. E ku jemi sot? Të gjithë bashkë në këtë sallë, sepse asnjëri nga ne s'i bën dot vetë 80 vota, e asnjëri si parti e vetme nuk do të arrijë t'i bëjë 80 vota për dhjetë vjetët e ardhshme, nëse nuk do të kemi një unifikim.

Kushdo që mendon se po del më patriot se tjetri në këtë sallë e ka gabim, e më së paku ata që në kohën e duhur nuk ishin aty për ta dëshmuar patriotizmin e tyre në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare. Lavdia dhe nderi për patriotizëm e sakrificë u shkon të rënëve për liri, pastaj edhe bashkëluftëtarëve të gjallë e familjeve të dëshmorëve. Kjo votë për këtë marrëveshje na e çliron frymëmarrjen secilit. E fundit, ta kryejmë secili detyrën tonë. Ne po i plotësojmë kriteret dhe t'ua

lëmë institucioneve ndërkombëtare të vlerësojnë përpjekjet tona këtë herë, që do të ishte edhe një mësim i mirë, që për çdo proces tjetër, nëse kryeneçësia jonë e ngulfat si në këtë rast, të dënohemi ne si politikanë, e jo një popull, o një vend.

Vota ime është pro marrëveshjes. Dëshira ime si deputete në këtë mandat do të ishte që kjo votë të ishte me konsensus të plotë, ndërmjet ne deputetëve shqiptarë së paku, sepse ka të bëjë me një të arritur që ka karakter dhe përfitim nacional. Vota ime do të ishte për edhe para tre vjetësh, por ishin bllokadat që nuk e lanë këtë proces të shkojë në fund. Edhe pse me vonesë, të bëhet diçka e mirë për vendin nuk është vonë. Sot, jo vetëm për një votë, por qytetarët tanë presin unifikimin e faktorit shqiptar për këtë marrëveshje, sepse mbyll kapitullin e padrejtë të izolimit të një populli. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Përshëndetje, kolegë!

Jam i detyruar të flas, ndoshta ekskluzivisht më shumë për t'i sqaruar qytetarët, sesa për të ju sqaruar juve, se tek e fundit ju e dini më së miri se çfarë mund të humbë Kosova nëse ratifikohet kjo marrëveshje për demarkacionin e kufirit. Pra, ju e dini.

Qytetarët ende nuk e dinë të gjithë, sepse ju e dini, e sidomos ju që po kërkonit që ta votojmë këtë dhe ju që po kërkonit që duke e votuar këtë t'ia bëjmë njëfarë ambalazhimi kësaj marrëveshjeje të keqe me disa anekse, të cilat, siç edhe thanë ekspertët e mëhershëm, nuk kanë ndonjë fuqi juridike. Por, për aq sa dimë ne të gjithë së bashku këtu, marrëveshjet ndërkombëtare nuk mund të ndryshohen njëanshëm. Pra, ne sot këtu nuk votojmë as për integrimin e Kosovës në BE, as për heqjen e vizave, pra as për marrëveshjen, që ju po e quani marrëveshje, e në fakt është deklaratë e dy presidentëve, të Kosovës dhe të Malit të Zi, as për raportin që LDK-ja ka kërkuar të jetë si orientim, e të tjerët kanë kërkuar të jetë si bazë mbi të cilën mbështetet.

Pra, ne sot thjesht këtu e kemi në procedim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi dhe asgjë tjetër.

Por, po të ishte një shembull që ne mund t'i ndryshojmë marrëveshjet njëanshëm do ta bënim në raste tjera, për shembull në rastet kur kemi marrëveshje ndërmjet dy shteteve, nëse e paskemi këtë mundësi mund t'i ndryshojmë njëanshëm dhe t'i kthejmë në favor tonin, kur ato marrëveshje ndoshta nuk janë me kushte të mira. Sido që të jetë, unë s'po futem andej. Ia kam borxh njërit prej gazetarëve t'ia kthej një përgjigje këtu nga foltorja, i cili më pyeti: "Çfarë të tha zëvendëskryeministri në momentin kur ne i sollëm pranë tyre kutitë e peticionit?" Iu dukën sikur pako picash, kështu më tha ai. Më tha: "A janë pica këto?". Por, atë çka unë dua t'i them, që Enver Hoxhaj, me "j" në fund, normalisht që ai duhet ta dijë nëse turpi hahet me bukë apo me

pica, le ta kthejë përgjigjen vetë para qytetarëve, por sidoqoftë këto janë petitionet e 205 mijë qytetarëve, e jo kuti picash.

Në anën tjetër, unë, por edhe ju, si përfaqësues të qytetarëve, duhet ta kemi parasysh se, tek e fundit, nuk ia kemi kurrkujt borxh t'i japim territor, edhe eventualisht nëse do të kishim dyshime. Unë për vete nuk kam dyshime. Unë e di dhe Lëvizja "Vetëvendosje" e di që kjo marrëveshje është e keqe. Dikush mendon se është e mirë, por edhe për ata që mendojnë ose që nuk e dinë nëse është e mirë a e keqe, do të mjaftonte dyshimi për t'i thënë jo kësaj marrëveshjeje.

Por, me gjithë këto që unë dëgjova nga kolegët e mi, nganjëherë mund të ju them, "ju lutem mos na fyeni, duke u munduar ta kamufloni këtë gjë të keqe si diçka të mirë". Mos, sepse, tek e fundit, kemi aq vetëdije sa ta kuptojmë edhe ne si deputetë, por edhe qytetarët, që krejt kjo është një tendencë për ta kamufluar një diçka që shumë prej jush, që sot i thoni po, i kemi pas thënë bashkë jo kësaj marrëveshjeje sikur diçkaje të keqe.

Unë mund ta kuptoj ndoshta pozicionin e Grupit Parlamentar të PDK-së. Këta nuk kanë lëvizur nga qëndrimi i tyre, që nga fillimi kanë qenë për, kryetari i atëhershëm i tyre ka nënshkruar dhe e mbrojnë pozicionin e tyre dhe e mbrojnë nënshkrimin e atij që e ka nënshkruar këtë. Mund ta kuptoj edhe LDK-në, sepse edhe LDK-ja ka pasur pozicion të përhershëm në të njëjtën vijë. Unë s'po i kuptoj ata me të cilët protestuam dje. Unë s'po i kuptoj se si kaq shpejt e ndërruan mendjen ata me të cilët ishim në protestë edhe këtu në Kuvend, edhe në shesh. Ata me të cilët i mblodhëm me qindra mijëra njerëz nëpër sheshe. Në Lëvizja "Vetëvendosje" kemi si t'u dalim përballë atyre, nuk di çfarë ata mund t'u thonë atyre që i ftuan të dalin në shesh.

Unë i kam pas dëgjuar disa nga shokët, disa nga kolegët e atëhershëm, disa janë deputetë, disa s'janë deputetë, disa janë të rinj, që thoshin se ne nuk falim territor, ne u kemi besuar por patëm harruar t'i pyesim se ata ndoshta nuk falin, por harruam t'i pyesim se a shesin, apo jo?

Sido që të jetë, sot ne e kemi para nesh një marrëveshje, e cila varet nga vota jonë, nga qëndrimi ynë, nga mënyra se si do t'i qasemi.

Por, në mesin e arsyetimeve të shumta të Qeverisë para deputetëve e dëgjova Qeverinë dhe përfaqësuesit e saj duke thënë që LDK-së i drejtohen, kjo është marrëveshja e 26 gushtit dhe ju thoni po, thonë në rregull jemi me juve, po ashtu edhe PDK-së.

Opozitës po i drejtohen që shihni dhe votoni për raportin e Bulliqit, po harrojnë që këtu s'mund të votojnë për të dyja. E aq më tepër nuk mund të jemi me të dyja.

Pra, në një farë forme po kujdeset Qeveria që t'i kënaqë të gjithë dhe në fund ta kënaqë vetveten me një votë pro këtij demarkacioni.

Por, Qeveria në këtë rast mund t'i kënaqë vetëm të pakënaqurit, sidoqoftë ne e kemi për detyrë t'ua sqarojmë qytetarëve, t'ua themi troç, ne duhet t'ua themi atyre a po i humbim 8 200 hektarë apo jo. Pastaj, mund t'ju themi se duke i humbur këta, çka fitojmë nga kjo humbje. Po paraprakisht Qeveria dhe mazhoranca duhet t'u tregojë po i humbim apo nuk po i humbim, se nganjëherë po thonë nuk po i humbim, nganjëherë po thonë se na duhet kjo marrëveshje, ky kompromis, sepse po na duhen vizat. Ne duhet t'i ndajmë këto. Sot nuk bëhet fjalë për heqjen e vizave, sot bëhet fjalë për marrëveshje: po ose jo kësaj marrëveshjeje, e cila është e nënshkruar më 26 gusht 2015.

Normalisht që ne jemi shumë të angazhuar, jemi të përkushtuar në mbrojtje të territorit, e në anën tjetër, përballë nesh Qeveria është e përkushtuar dhe e angazhuar në mbrojtje të pushtetit, por ne duhet të japim njërin që ta kemi tjetrën, në këtë rast ne po japim Qeverinë, duam ta mbajmë territorin, përkundër Qeverisë që po do ta japë territorin që ta mbajë pushtetin.

Në fund, nëse doni vërtet ta korrigjoni, s'mund as t'i referoheni, as nuk duhet t'i referoheni raportit Bulliqi si orientim, as nenit 7 të marrëveshjes, e vetmja mundësi për ta korrigjuar këtë marrëveshje është mosratifikimi i kësaj, sepse kjo marrëveshje nuk mund të korrigjohet duke e vënë në fuqi. Pra, nëse keni diçka të korrigjoni, duhet ta korrigjoni para ratifikimit, nëse e ratifikoni, harrojeni që mund ta korrigjoni.

Pra, unë nuk kam të drejtë, edhe nëse do të doja, nuk kam të drejtë ta bëj një gjë të tillë, ashtu siç edhe ju nuk keni të drejtë as t'i falni, as t'i shitni e as t'i aneksoni territor Kosovës.

Pra, unë edhe po të doja, edhe po të çmendesha nuk kam të drejtë. Prandaj, vota ime, vota e Lëvizjes "Vetëvendosje" do të jetë kundër kësaj marrëveshjeje, e cila sot duhet të mos ratifikohet në këtë Parlament që t'i hapet rrugë korrigjimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, e ka fjalën, Dauti.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

E dëgjova me kujdes mikun tim të vjetër, natyrisht edhe patriot, e mora vesh që tha nuk ndërrohen marrëveshjet njëanshëm, të njëjtën kohë thoshte nuk duhet, a ndërrohen njëanshëm a nuk ndërrohen njëanshëm?

E dëgjova kur tha këtë peticion e kemi bërë për shkak që jemi duke humbur territor dhe ne kemi kërkuar ringocim.

Dikur tha marrëveshjet janë letër, ndërsa nëse e lexon ai, nuk i del bash letër, se palët obligohen të krijojnë komision të përbashkët për rishikimin e pikave në drejtimin Kullë dhe Çakorr.

Por, edhe një herë, meqenëse kemi të kaluar shumë të gjatë me Rexhën, Rexha e di shumë mirë qysh ndërrohen kufijtë, po s'ke ushtarë pas vete, o Rexhë, lej ato pallavra.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Më the s'ke ushtarë pas vete, unë kam menduar që ka ushtarë ende, duke të llogaritur edhe ty. Sido që të jetë, mos ju referoni patriotizmit si diçka negative, bre, po, jemi patriotë, edhe ti, edhe unë, jemi patriotë dhe duhet pasur patriotizëm, nuk ka asgjë të keqe të jesh patriot, nuk di pse po i referoheni patriotizmit.

Dhe, në anën tjetër, nëse doni të ndryshoni, hajde ulemi e ndryshojmë para se ta ratifikojmë, sepse po u ratifikua, harroje që mund të ndryshosh pastaj, aq më tepër kur njëra palë nuk pranon të diskutojë, si do të pranojë të diskutojë kur t'ia vejë gurin kufirit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Republika e Kosovës si shtet i ëndrrave nga gjenerata në shekuj e arritur në shkurt të vitit 2018 nga përkushtimi i grave e burrave shqiptare, jo rrallëherë ka ditur të jetë para sfidave.

Sfidat me të cilat u ballafaqua sollën një realitet të ri në trojet tona, në Republikën e Kosovës së pavarur e sovranë.

Ne këtu jemi gjenerata që na ngarkohet përgjegjësia e vendimeve të mëdha, ashtu siç ishte lufta e negociatave, Rambujeja, negociatat e Vjenës, e tash edhe negociatat Kosovë-Serbi.

Shpesh situatat e ndërlikuara kanë qenë sfida në mesin tonë, ashtu siç është edhe kjo marrëveshje e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi.

Pozicionimet dhe interesat politike shpesh kanë krijuar kaos politik në vend dhe kjo është e pamohueshme.

Lidershipi politik shpeshherë ka treguar se mbi shtetin e kanë veten, e jo rrallëherë kanë tentuar që duke shkelur mbi shtetin dhe demokracinë, të ndërtojnë karrierën e tyre politike dhe kjo është e vërtetë e dhimbshme.

Kosova sot ka dy detyra: të mbrojë territorin e vet dhe të integrohet në Evropë. Kosova nuk duhet të falë territorin, sepse atë e fituam me gjak e sakrificë. Njëjtë siç Kosova duhet të gjejë mënyrën në garantimin e të ardhmes së lirë për gjeneratat e reja.

Para nesh sot kemi një zgjedhje kreative, që nga një sfidë na çon në sfidën tjetër, para së cilës duhet të vendosim për të mbrojtur interesat e shtetit tonë.

Unë besoj në tejkalimin e sfidave, ashtu siç besojmë ne, vizionin e një skeme, e cila i hapi rrugë rinegociimit të pikave të cilat janë të kontestuar, si Kulla e Zhlebit dhe e Çakorrit.

Unë besoj në fqinjësinë e mirë të shtetit malazez dhe kjo u dëshmuar nga gatishmëria e lidërshipt të tyre për t'i ndihmuar Kosovës në zgjedhjen e kësaj sfide.

Ne nuk mund të parashikojmë të ardhme, mirëpo juridikisht kemi bazë për të konsideruar që gabimet të cilat mund të jenë bërë, do të rishikohen.

Vendime të tilla kemi detyrë t'i marrim, sepse jemi të zgjedhurit e popullit dhe përgjegjësia mbi zhvillimin e rinisë sonë.

Sot duhet të kemi unitet mbi perceptimin e kësaj sfide që po na afrohet përmes nënshkrimeve të kësaj marrëveshjeje, sot duhet të marrim një vendim për ardhmërinë, duke hapur shtegun e liberalizimit të vizave dhe integriteteve të tjera euroatlantike.

Sot duhet të mendojmë për rininë, e cila ka nevojë t'i shfaqë cilësitë e veta e të jetë në hap me civilizimin ndërkombëtar.

Sot duhet të mendojmë për kuadrot që meritojnë t'u lehtësohet rruga për të studiuar aty ku ata besojnë e të gjejnë veten më mirë.

Sot duhet të veprojmë për sportistët, të cilët kanë nevojë t'i shfaqin talentet e tyre në arenën ndërkombëtare.

Sot duhet të marrim vendim për qytetarët e Republikës që kanë nevojë të çlirohen përfundimisht nga vetoja e Evropës.

Mirëpo sot nuk duhet ta harrojmë që toka jonë dhe interesat tona shtetërore pas këtij ratifikimi duhet të mbrohen deri në fund, duke përmbushur marrëveshjet e shtuara.

Kjo ditë le të shënohet si dita e kthesës politike, kjo seancë le të kujtohet si dita kur përfundimisht demarkacioni mbetet punë e kryer, që mori epilog.

Detyra jonë është të krijojmë kushte që populli ynë të jetojë dhe të trajtohet i barabartë, andaj edhe kemi detyrë të marrim vendime të vështira në kohë të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Haxhi! “6+” nuk ka. Vazhdojmë. Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Shumë të çmuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Sot e kemi një sfidë, ndoshta më të madhen të politikëbërjes sonë reale, asaj politike që shkon anë për anë të historisë dhe vjen e ulët sot këtu për një vendim goxha sfidues për Parlamentin e Republikës së Kosovës.

Çdo milimetër e territorit të vendit tonë është më i madh se secila politikë. Andaj, sot nuk jemi këtu për politikën, por për fatin tonë të përbashkët.

Një politikë e keqe, me logjikë ballkanike, përçarëse, me mungesë të plotë të konsensusit nacional që edhe ditëve të vështira arrinim ta gjenim, mbase 10 vjet pas bërjes shtet nuk po mund të ulem në sofrën e përbashkët për interes të shtetit, për interes nacional, për interesin dhe ardhmërinë e fëmijëve dhe brezave të ardhshëm të Kosovës.

Kosova është ndalur në rrugëtim të saj edhe për fajin e politikëbërjes së keqe vendore, sepse nganjëherë po gjejmë adresa kanë faj ndërkombëtarët për këtë apo atë, por faji ekskluzivisht bie mbi klasën politike. Dhe, ky është dimension i ku unë do të përpiqem sot të kërkoj një konsensus, t’i kërkoj vetes votën për një demarkacion të kësifarshëm, dhe besoni se e kam shumë të vështirë. Konfuzionet janë shtuar dita-ditës, në veçanti në këta tre vjetët e fundit.

Pak a shumë opinioni e di se një duzinë deputetësh të LDK-së, të cilët nuk janë pajtuar në të shkuarën me marrëveshjen e 26 gushtit të vitit 2015 dhe si pasojë e asaj kundërshtie që iu bashkëngjiten edhe një numër i PDK-së, numër modest, mund të themi, ishte pamundësuar ratifikimi i asaj marrëveshjeje.

Para tre vjetësh edhe ata deputetë e patën afruar një nen të tillë për rishikim dhe mundësi të korrigjimit të vijës kufitare Kosovë-Mali i Zi. Pse nuk u gjet atëherë konsensusi? Dhe kur po i dëgjoj tani disa deputetë dhe disa ish-deputetët, tani në Kabinetin qeveritar, që po flasin këtu për konsensus, po flasin për marrëveshje dhe po bëjnë apel, do farë apelesh të çuditshme, vërtet po befasohem shumë, sepse i dimë deklaratimet e tyre, i dimë qëndrimet e tyre, i dimë veprimet e tyre, sepse ishte duke shkuar vendi dhe shoqëria kosovare në luftë vëllavrasëse. Për çka tani, dhe

çka mund t'u themi atyre qytetarëve, të cilët i ftuam edhe në rrugë, besa edhe i futëm në përleshje me policinë e shtetit tonë, me motrat e vëllezërit tanë.

Kosova nuk guxon të ndalet, askush nuk e ka këtë të drejtë dhe është goditur mjaft nga një politikëbërje e keqe. Pyetja është: Si ta ndihmojmë Kosovën në këtë çështje?

Unë vij me gjenezë nga Rugova, janë stërnip i Haxhajve, atje ku kufiri po vjen deri te Shehu i Haxhajve dhe unë, si rugovas, mendoj që ai nuk guxon të bie poshtë Qafës së Çakorrit, por edhe si dukagjinat mendoj që ai nuk guxon të bie, të themi, mbi Jabllanicë të Madhe.

Qytetarët e vendit tonë që vijnë nga ajo anë e kanë këtë bindje dhe këtë bindje nuk po e them për populizëm, por Qeveria dhe dy komisionet qeveritare, sepse i kemi dy komisione qeveritare, sepse vetëm Parlamenti dhe kjo klasë politike i bie dy marrëveshje, të dy komisioneve shtetërore, një ligj, të cilat po të kishte prokuror normal të shtetit do t'i thërriste në intervistë ose Hashim Thaçin e Skender Hysenin e Murat Mehën, ose këta që e sollën tash që akuzojnë për tradhti kombëtare dhe e kemi izoluar vendin, e kemi futur vendin në rrugë pa krye. A dini si na konsiderojnë miqtë tanë strategjikë që na kanë ndihmuar të çlirohemi?

Të mos më keqkuptojnë disa ish-luftëtarë të spikatur këtu. Po ta kishim çliruar vetë, ishte kënduar tjetër këngë, por na kanë ndihmuar dhe na kanë ndihmuar shumë. Këta që na kanë ndihmuar shumë i kemi irrituar tej mase me politikën tona më tepër se të këqija, nuk po kam fjalë t'i përshkruaj.

Më duhet ta pranoj që kam deklaruar publikisht se nuk votoj version tjetër përveç atij Kullë-Çakorr, ashtu si pati deklaruar kryeministri i vendit dhe kam thënë: "Çfarëdo propozimi që sjell kryeministri Ramush Haradinaj, do ta votoj", kam deklaruar në një televizion publik.

Dhe tani, Mali i Zi na priti mjaft, na luti si një vend me specifika, si ish-pjesë e Republikës Federale Jugosllave në atë kohë, që e ka pasur një qasje dukshëm më të mirë edhe gjatë luftës, por kjo klasë politike nuk gjeti kurajë, nuk pati guxim as politik, as qytetar, as intelektual të ulen dhe ta orientojnë në një rrugë kompromisi dhe çka po ndodh tash? Mali i Zi e ka ratifikuar atë marrëveshje, Mali i Zi ka hyrë në NATO dhe na ka sfiduar shumë, sepse ajo marrëveshje po të negociohej atëherë kur ata kërkonin, por ishin të gjithë, edhe opozita, por edhe pozita që nuk gjetën kurajë, nuk patën fuqi as politike, as intelektuale, ta ndërtojnë një politikë të konsensusit dhe ta shtyjnë tutje këtë çështje.

Nuk dua të jap vlerësim as gjykim për punën e dy komisioneve, sepse tek e fundit, ratifikimi i kufirit mes dy shteteve është marrëveshje politike.

Prandaj, unë sot kërkoj nga zoti Fatmir Limaj, zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës, i cili tentoi të na e shpalosë atë bërthamën e negociatave që ai ka bërë me Malin e Zi. Por unë dua të besoj që marrëveshja e dy presidentëve nënkupton që ai që e ka nënshkruar këtë marrëveshje e pranoi gabimin, do të thotë, kryeministri vetëm sa u deklarua për këtë çështje dhe ne si deputetë jemi vënë para aktit të kryer, çka tutje?

Në qoftë se ky projektligj, me ato dy marrëveshje, realisht me ato dy raporte të komisioneve qeveritare bie ndesh me Kushtetutën, atëherë çka, cili është veprimi ynë, ku jemi ne si deputetë?

Dhe krejt në fund, e kemi rastin Shqipëri-Greqi, të cilin e rrëzoi Gjykata Kushtetuese, prandaj, jo nga presioni i miqve tanë strategjikë, por nga prodhimi i politikave tona jokonsensuale, jo në interes të etapave të shtetndërtimit, nga neglizhenca, mendësia dhe logjika ballkanike kemi ardhur këtu kemi ardhur.

Prandaj, unë kërkoj që 100 deputetët të mos bëjnë ndarjen, i bëj apel edhe Albinit e Glaukut, edhe kolegëve të tjerë, me të cilët ka mjaft pika që na largojnë, por kjo do të duhej të na bashkonte, para se të marrim vendim të ulemi bashkërisht dhe të shikojmë bashkë me Ramushin, nuk po i them zoti kryeministër, as me mbiemër, por me emra, të ulemi, sepse kjo është çështje jetike për vendin.

Prandaj, zoti kryeministër, unë dua të besoj që ju jeni i bindur dhe e keni kalkuluar mirë këtë marrëveshje, kërkoj që Komisioni shtetëror, sepse marrëveshja që është nënshkruar dikush po thotë nuk ka efekt juridik, duhet të ketë efekt juridik, sepse unë jam i bindur që shteti mik i Malit të Zi do të ketë qasje tjetër pas të gjitha këtyre ndodhive.

Kërkoj që Komisioni shtetëror për kufirin e Malit të Zi të udhëhiqet nga opozita, të ketë përbërje konsensuale të plotë, komplet spektër politik, ekspertët më të mirë vendës, të ftojme ekspertizë ndërkombëtare.

Dhe, krejt në fund, kërkoj që në komision të jenë dy përfaqësues të trevës së Rugovës, dy përfaqësues të trevës të Podgurit dhe një përfaqësues i komunitetit të fshatrave të Deçanit. Pjesëmarrja e tyre në këtë përbërje jep një shpresë, në kundërtën, nuk do të na këndohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht me vjen mirë që për këtë temë, për herë të parë, pas pothuajse tre vjetëve po na jepet mundësia të japim qëndrimin tonë lirshëm, pa presion, pa tym e gaz lotsjellës, sot në këtë tempull të demokracisë.

Diskutimet, debatet, replikat e kundër-replikat e sotme për temën e demarkacionit edhe të atyre deputetëve që janë dënuar nga gjykata për hedhje të gazit lotsjellës, të cilët dhunuan fjalën e lirë, na e pamundësuan debatin që në raportimin e parë të ish-kryeministrit, e kjo konfirmon se metodat e tilla kanë qenë tërësisht të panevojshme, të paarsyeshme, sepse edhe atëherë, sikurse sot, kemi mundur të debatojmë dhe të arrijmë konsensusin e nevojshëm për këtë çështje dhe Kosova të mos mbetet peng i kësaj teme për rreth tre vjet dhe qytetarët e saj të izoluar.

Kur flas për izolimin, mendoj të pengesat që ka shkaktuar tema e demarkacionit për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe proceset e tjera integruese evropiane.

Të nderuar, këtu dua të sqaroj një fakt, se askush në këtë Kuvend nuk është duke dhënë tokë të Kosovës për liberalizim të vizave, siç po tentohet të mashtrohet e të manipulohet një pjesë e opinionit publik.

Pra, me votimin e demarkacionit me Malin e Zi, Republika e Kosovës dëshmon se është e gatshme të marrë obligime ndërkombëtare dhe se nuk ka pretendime territoriale ndaj fqinjëve të saj, që e kanë njohur shtet sovran dhe të pavarur.

Prandaj zgjidhja e problemit të demarkacionit Kosovës i hap rrugën evropiane dhe në këtë rrugë do të jetë edhe lëvizja e lirë e qytetarëve.

Rruga evropiane e Kosovës nuk mund të mbetet peng e padrejtësive historike që u janë bërë shqiptarëve ndër shekuj dhe në ish-Jugosllavi, çka do të thotë se nuk mund të rrezikojmë raportet tona me aleatët dhe partnerët strategjikë për vijën kufitare që është shënjuar jo në vitin 2015, por në vitin 1947, nga Komisioni i udhëhequr nga Milovan Gjilasi, i cili ka shënjuar atë vijë kufitare pas ndarjes administrative të republikave të ish-Jugosllavisë. Pra, ajo vijë kufitare pas Luftës së Dytë Botërore është shënjuar në mes të Republikës së Serbisë dhe Republikës së Malit të Zi, pa prezencën e shqiptarëve.

Është fakt i ditur që historia nuk ka qenë e drejtë me ne në shekujt e kaluar, por as ne nuk mund ta mbajmë peng të ardhmen e Kosovës për shkak të atyre padrejtësive që na janë bërë ndër shekuj. Ne duhet të punojmë fort së bashku për të ardhmen e vendit.

Komisioni i udhëhequr nga Meha, Komisioni ndërkombëtar i ish-presidentes Jahjaga, i Departamentit amerikan të Shtetit dhe Komisioni i Akademisë së Shkencave vërtetojnë se vija kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi e shënjuar nga Gjilasi dhe e konfirmuar në

Kushtetutën e vitit 1974 dhe në marrëveshjen e Kumanovës të vitit 1999, është e njëjta, e pandryshuar.

Pra, të jemi të qartë, tokat shqiptare nuk shtriheshin vetëm deri në Kullë e Çakorr, por edhe në Plavë e Guci deri në Ulqin e Dalmaci, bile po befasohem se si këta që me demokraci kanë kapur “bajrakun e patriotizmit”, pse po ndalen në Çakorr, e nuk po kërkojnë që padrejtësia historike ndaj shqiptarëve të korrigjohet në tërë Gadishullin Ballkanik.

Të nderuar kolegë,

Nuk e kam ndërmend të bëj vlerësime mes komisioneve shtetërore për shënjimin e vijës kufitare, por si deputet më duhet të them një gjë që më ka brengosur jashtëzakonisht shumë, një tentativë nga Komisioni i udhëhequr nga z. Bulliqi që për shënjimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Malit të Zi ka kërkuar të përdorej “kontrolli efektiv i territorit”, bazuar në disa fakte që ata i kanë paraqitur për mirëmbajtje të rrugëve, ruajtje të pyjeve dhe bagëti, por jo në fakte pronësore të pranueshme kadastrale.

Të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë të Kosovës,

Nëse autoritetet e Kosovës insistojnë të aplikojnë këtë kriterin e “kontrolli efektiv të territorit”, po të çoheshin në këmbë krejt Serbia dhe Rusia bashkë nuk kishin ditë të mendonin e të vepronin më keq për këtë vend se sa kanë bërë këta të Komisionit Bulliqi.

Sepse po të merrej për bazë një kriter i tillë për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, e jo ai kadastral, më pas kur do të vinim të demarkacioni me Serbinë, ky kriteri Bulliqi, “i kontrollit efektiv të territorit” do t’i jepte Serbisë adut të kërkonte vendosjen e kufirit në hapësirën që ka pasur kontrollin efektiv edhe pas luftës së vitit 1999, d.m.th., në veri deri të ura e lumit Ibër, ngase Serbia me institucionet e saj paralele kishte kontroll efektiv të atij territori deri para disa viteve, kur u shuan një pjesë e pikave paralele dhe u rivendosën pika kufitare 1 dhe 31 falë vendosmërisë së shtetit tonë, Policisë së Kosovës, për çka ka rënë Heroi Enver Zymberi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është më se e vërtetë se tani marrëveshja ndërmjet presidentit të Republikës së Kosovës dhe atij të Malit të Zi i jep një mundësi korrigjimit të padrejtësisë historike të asaj pjese të territorit tonë, e cila pas Luftës së Dytë është shkëputur nga ne. Ta kuptojmë një fakt, se këtu në këtë Kuvend jemi përfaqësues të qytetarëve, për t’u ndihmuar atyre dhe për t’ua lehtësuar jetën, e jo për t’ua vështirësuar atë. Ata sot i kanë sytë nga ne dhe po kërkojnë që këtë problem ta zgjidhim e ta votojmë demarkacionin, në mënyrë që vendit t’ia hapim rrugën evropiane.

Folklorizmat dhe çjerrjet patriotike të disave këtu, që kanë vendosur pllakate e tabela në kufi me Malin e Zi, u panë posa ka ardhur Policia e Malit të Zi, jo që nuk janë ndalur në Çakorr, por as Peja nuk i ka ndalë deri në Prishtinë. Patriotizëm dhe heroizëm janë ato veprimet e policëve tanë

në Veri të Kosovës bashkë me heroin Enver Zymberi. Patriotizma dhe trimëri të matura i kemi gjithsecili këtu dhe qytetarët nuk janë të interesuar t'i dëgjojnë ato, ata po kërkojnë votim për demarkacionin, problem ky që po e mban peng të ardhmen e tyre.

Ne si ligjvënës, por edhe si subjekte politike parlamentare, e kemi për obligim ta ruajmë partneritetin me Bashkimin Evropian dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne nuk guxojmë të lejojmë që ambiciet ruse për destabilizim të rajonit të zënë vend dhe të propagandohen si të mira për këtë vend. Se elementi serb dhe rus është shumë i angazhuar në problematikën e demarkacionit e vërteton edhe fakti se posa u arrit marrëveshja ndërmjet dy presidentëve ishte opozita pro serbe në Mal të Zi që kërkoi t'i fillonte trazira atje dhe ishte një i dekoruar i Milosheviqit ai që e sulmoi Ambasadën e Amerikës në Podgoricë.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Faktet janë të njohura, pozicionet tanimë po shihen, prandaj le t'i thërrasim mendjes për interesin e qytetarëve. Ne jemi këtu me votat e qytetarëve, andaj le të jetë vota jonë pro demarkacionit, pro interesave të qytetarëve, pro Kosovës dhe të ardhmes saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë,

Zoti kryeministër,

Thënë më së thjeshti, është paradoksale që të shohim sesi kjo Qeveri, e udhëhequr nga zoti Haradinaj, e ka thirrur në orët e vonshme të ditës këtë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit për ta ratifikuar Marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, të njëjtën marrëveshje të cilën me ngulm e kishte kundërshtuar sa ishte në opozitë, marrëveshje kundër së cilës u organizuan protestat më të mëdha në dy dekadat e fundit dhe për të cilën pati më se 205 mijë nënshkrime të qytetarëve.

Në fakt, këtë peticion zoti Haradinaj, i cili në atë kohë ishte opozitë, e pati sjellë dhe e pati futur pothuajse dhunshëm në Parlament dhe për më tepër për këtë marrëveshje i kemi dy subjektet politike, derisa deputetët nga Lidhja Demokratike thonë se është e njëjta Marrëveshje e vitit 2015, partnerët qeverisës thonë se është një marrëveshje e rishikuar dhe pak më ndryshe. E vërteta është se ajo që kemi parë gjatë gjithë këtyre ditëve nuk ka qenë justifikim për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, por është dhënë kryesisht arsytimi për liberalizimin e vizave. Tashmë pothuajse nuk po flitet për marrëveshje. Ajo si subjekt ka kaluar në rend të dytë dhe i gjithë diskutimi po bëhet për kushtin, përkatësisht për liberalizimin e vizave. Vetë ky presion i jashtëzakonshëm, ky kalim nga diskutimi parimor e profesional për vetë marrëveshjen dhe

procesin e demarkimit në diskutimin e kushtëzuar për liberalizim të vizave, në fakt shpjegon gjithçka.

Tashmë dihet fare mirë se kriter po aq i rëndësishëm për liberalizimin e vizave është luftimi i krimit dhe korrupsionit.

Të nderuar qytetarë,

Këtë tashmë e kanë bërë të qartë edhe përfaqësuesit kompetentë të shteteve të BE-së, e së fundi ishte vetë zonja Apostolova, e cila theksoi se anëtarësimin në BE nuk do të bëhet me automatizëm, por vetëm me merita. Prandaj, sipas saj, dialogu Kosovë-Serbi është i rëndësishëm, e në veçanti lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe administrata e pavarur. E këtë kriter, as Thaçi, e as kjo Qeveri nuk mund ta realizojnë, pasi do të thotë se ato duhet të luftojnë kundër vetes së tyre.

Sot duhet të jetë e qartë për të gjithë ne se me votën tonë do të votojmë për një shtet ligjor, ose jo. E pa shtet ligjor nuk ka liberalizim të vizave, e as integrim evropian. Mendoj se është e qartë dhe tashmë ka fakte e argumente të mjaftueshme për të arritur në përfundim se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje në gusht të vitit 2015 ishte i gabuar dhe se kërkesa për ratifikimin e saj nuk do të bënte gjë tjetër, veçse do ta legalizonte këtë gabim me pasoja të rënda, jo vetëm për të sotmen, por edhe për të ardhmen e vendit. Paradoksi i kësaj seance është edhe vetë mënyra sesi është proceduar me dokumentet, pra na është sjellë një projektligj kontradiktor dhe me gabime për ratifikimin e Marrëveshjes së Vjenës të vitit 2015, është sjellë deklarata e dy presidentëve, atij të Republikës së Kosovës dhe të Malit të Zi, që në fakt vetëm se e pranon se marrëveshja ka gabime dhe na është sjellë si orientues raport i Komisionit të ri shtetëror për shënjimimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror, që e ka vlerësuar punën e ish-Komisionit shtetëror për shënimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror, e që në fakt të dyja komisionet e kanë të njëjtin emër, dhe kjo po ashtu mund të shkaktojë probleme dhe paqartësi në të ardhmen dhe e vërteta është se komisioni i ri ka evidentuar më shumë se 25 raste të shkeljeve në aspektin e së drejtës ndërkombëtare, kushtetuese, historike, gjeografike dhe gjeodezike.

Të gjitha këto kanë reflektuar në humbjen e pjesëve të caktuara të territorit të Kosovës, me ç'rast kufiri ekzistues ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi është zhvendosur në dy pikat më të rëndësishme strategjike. Për mua është e pakuptueshme se si një deputet që i ka lexuar këto dokumente që na janë sjellë do të mund të votojë pro kësaj marrëveshjeje, edhe sikur të mos i kishte përcjellë fare gjithë zhvillimet që kanë ndodhur gjatë këtyre tre vjetëve.

Dua të ftoj këtu për vëmendje dhe kolegët deputetë nga opozita, përkatësisht nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Në vitin 2002, ishte vetë presidenti Ibrahim Rugova i cili kishte deklaruar se kufiri me Malin e Zi do të jetë pika e Çakorrit, madje në një hartë të botuar nga Qendra për Informim e Kosovës, kufiri i Kosovës me Malin e Zi ishte në Kullë dhe Çakorr,

ndërsa Bjelluha ishte brenda territorit të Kosovës, ashtu edhe siç duhet të jetë. Deklarata e Presidentit Rugova ishte në vijë të njëjtë dhe me argumente të njëjta të ekspertëve të komisionit, të udhëhequr nga zoti Bulliqi, që kanë konstatuar dhe dëshmuar se nëse kufiri i Kosovës me Malin e Zi nuk përcaktohet atje ku ishte vazhdimisht, Kosova do të humbë territor.

Në takim të Presidentit Rugova me delegacionin nga fshatrat e Rugovës, të cilët i ka pritur për t'i dëgjuar shqetësimet e tyre lidhur me çështjen e kufirit me Malin e Zi, ai citohet t'u kishte thënë rugovasve se "pika e Çakorrit do të jetë kufiri dhe përtej kësaj pike malazezët nuk kanë çka të kërkojnë".

Çakorri, Mokna, Qafa e Dasmorëve dhe këto pjesë tjera nuk do të preken, kishte thënë Presidenti Rugova, se është edhe ndarja natyrale dhe aty ka qenë kufiri përherë. "Ne nuk mund të pretendojmë në ato pjesë tjera që kemi pasur më përpara. Ato kanë shkuar dhe në këtë kohë nuk mund të bëjmë diçka, por njëherë për njëherë me Malin e Zi duhet të kemi raporte të mira, dhe Mali i Zi besoj do ta njohë pavarësinë tonë të shtetit. Atëherë do të formohen komisione, një komision prej Kosove, një prej Malit të Zi, me mbikëqyrje ndërkombëtare dhe kufiri në Çakorr nuk do të kalojë këndeje". E përsëris, citohet të ketë thënë Rugova në këtë takim.

Se kufiri me Malin e Zi duhet të jetë në Çakorr dhe se Bjelluha duhet të ndodhet brenda territorit të Republikës së Kosovës, nuk ka pasur asnjëherë asnjë dyshim në Kosovë. E kundërta ishte gabim dhe është e papranueshme, por 16 vjet pas deklaratës së Presidentit Rugova, deputetët e LDK-së nuk po mendojnë më si Rugova. Ata po mendojnë si Thaçi dhe po e mbështetin Thaçin pro kësaj marrëveshje. Pra, po dalin në mbrojtje të Thaçit, duke e hedhur poshtë qëndrimin e Presidentit Rugova.

Në këto rrethana, duke i pasur parasysh të gjitha faktet që tashmë janë të ditura, duke qenë se jemi republikë parlamentare, ne nuk jemi të obliguar ta ratifikojmë këtë marrëveshje të demarkacionit domosdoshmërisht. Për më tepër, ne si deputetë me votimin tonë kundër e kryejmë obligimin tonë, duke e shqyrtuar marrëveshjen si të tillë. Është detyrë dhe përgjegjësi jona të veprojmë me integritet të plotë për të mirën e vendit, pa u ndikuar nga asnjë ndikim dhe presion i jashtëm. Ne duhet të vendosim ta mbrojmë territorin, ujin dhe sigurinë e Republikës së Kosovës, ashtu siç na obligon edhe Kushtetuta e vendit tonë.

Sot, interesin më të madh që demarkacioni të kalojë e ka presidenti Thaçi, i cili e ka nënshkruar Marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi në gusht të vitit 2015, dhe i njëjti ratifikimin e demarkacionit e ka kthyer në një kauzë politike personale. Mosratifikimi do ta komprometonte politikisht, ndërsa ratifikimi do të perceptohej si sukses personal i tij.

Dhe, natyrisht, i interesuari tjetër është edhe kryeministri Haradinaj, i cili, edhe pse sa ishte në opozitë për dy vjet rresht e pati kthyer në kauzë politike, personale e partiake mosratifikimin e

demarkacionit, duke e shfrytëzuar si mjet për të ardhur në pushtet, tani e ndien se kjo po bëhet mënyra e vetme për të mbetur në pushtet. Vlerësimi i tij për deklaratën ndërmjet Thaçit dhe Vujanoviçit si një arritje e madhe për gjithë vendin, dëshmon se te ky dokument Haradinaj e sheh një instrument nëpërmjet të cilit ai do të mund ta braktisë kauzën e Çakorrit, duke u munduar ta ruajë disi kredibilitetin e tij. Por, ne nuk duhet të lajthitemi. Dokumentet që kemi para vetes e dëshmojnë qartë se ky proces është i kompromentuar. Marrëveshja e vitit 2015 e cenon integritetin territorial të vendit. Marrëveshja e presidentit Thaçi nuk do të kishte ndodhur asnjëherë sikur të mos kishin ndodhur gabimet, andaj ajo që duhet të ndodhë sot në fakt është Marrëveshja për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi e nënshkruar në Vjenë, më 26 gusht 2015, dhe e sjellë tani, e të gjithë personat e përfshirë në komisionin e kaluar dhe përfaqësuesit politik, pra nënshkruesit e asaj marrëveshje aktualisht do të duhej të ishin para një procesi gjyqësor që do ta shqyrtonte tërë këtë proces.

Në një shtet demokratik dhe ligjor, dikujt as që do t'i shkonte ndërmend të merrte veprime të tilla kundërkushtetuese, sepse do ta dinte se do të gjykohej moralisht dhe penalisht. Është e vërtetë se fati i të rinjve tanë dhe e secilit prej nesh është i lidhur pashmangshëm me ditën e sotme, por jo për liberalizim të vizave, siç po mundohen ta paraqesin, por për sistemin e drejtësisë, që ne duhet dhe duam ta kemi, për respektimin e të drejtave bazike të njeriut, për një vend ku askush nuk mund të bëjë çfarë t'i teket, ku nuk tregtohet me territore, e ku nuk sillen marrëveshje të korruptuara me qëllim mashtrimi në këtë institucion më të lartë të vendit. Sot duhet ta kalojmë këtë ngërç politik duke votuar kundër këtij projektligji për të rinisur demarkimin në mënyrë profesionale dhe që secili prej nesh duhet që të angazhohemi me urgjencë që të fokusohemi në përmirësimin e sistemit të arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, luftimin e krimit të korrupsionit, e pas kësaj ne mund të presim liberalizimin e vizave dhe integrimin evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Medie e qytetarë,

Vizitorët që kanë ardhur prej BE-së ose prej qeverive tjera, kur ka dalë në konferenca për shtyp, edhe te Qeveria, edhe te kolegët opozitarë, u kanë thënë udhëheqësve të Kosovës të gjithëve, “votojeni marrëveshjen për demarkacionin, çlirojini qytetarët tuaj të udhëtojnë lirshëm”.

Mendoj që në këtë pikë të gjithë pajtohemi se evropianët i kanë shtuar pritjet e qytetarëve të Kosovës, pra u kanë dërguar porosi njerëzve të vendit që nëse Kosova, Parlamenti i vendit e ratifikon këtë ligj duhet të ndodhë liberalizimi. Ndoshta një pjesë e qeverive të BE-së edhe besojnë ashtu, por ne e dimë që prapë do të jetë një proces. Pra, askush prej nesh nuk vjen para deputetëve dhe para qytetarëve t'u thotë që liberalizimin e kemi në dorë. Mendoj që kjo tash

është më se e vërtetë, që plot zyrtarë shtetërorë e të institucioneve të BE-së, pra të qeverive nacionale të institucioneve të BE-së, u kanë thënë udhëheqësve të Kosovës “kryejeni këtë, e mundësojuani njerëzve tuaj të qarkullojnë, të lëvizin lirshëm”. Parlamenti i Kosovës në këtë rast e ka parasysh këtë edhe e di që kjo pritje është e krijuar.

Njëkohësisht, tema e rendit, e ligjit dhe e luftës kundër korrupsionit është një temë që nuk është një akt, ose një vendim i njëhershëm. Është një temë që çdo shoqëri e ka rrugëtim të jetës së vet sa më demokratike, sa më të avancuar në shoqëri. Fokusimin e kanë më të madh në rend dhe në ligj, në luftë kundër korrupsionit, në lloje të ndryshme të krimit e të devijimeve tjera. Mirëpo, besoni, Kosova nuk është edhe pa rezultate në luftimin e korrupsionit dhe BE-ja, në rastin konkret, me Kosovën ka të drejtë që të kërkojë të rritet efikasiteti, të rritet fokusimi në rend dhe ligj dhe në luftën kundër korrupsionit dhe në çdo lloj krimi. Mirëpo, do të ishte shumë e padrejtë nëse Kosovës i thuhet “e tani rrugëtojmë bashkë dhe ne ju tregojmë kur e konsiderojnë se ju e keni kryer kushtin e dytë”. Do të ishte gabim nëse i drejtohen kështu Kosovës. Pse? Edhe një herë po e përsëris, nuk ka një zyrtar i BE-së që ka ardhur në Kosovë, që s’u ka thënë qofshin pozitarëve, qofshin opozitarëve, “kryejeni këtë temë dhe çlirojini njerëzit tuaj, se i keni mbyllur njerëzit”. Neve na kanë thënë, ne i kemi mbyllur, jo ata, jo që s’na kanë dhënë liberalizimin, por “ju i keni mbyllur”.

Do të ishte krejt e palogjikshme dhe do të ishte një e padrejtë e madhe për qytetarët e këtij vendi pastaj t’u thuhet “epo tash s’jemi ende këtu”. Pra, ne nuk heqim dorë dhe nuk mendojmë që duhet ta heqim vëmendjen nga lufta kundër korrupsionit, edhe nga rendi e ligji, forcimi i rendit dhe ligjit, por një pozicion i këtitillë i evropianëve do të ishte zhgënjyes për qytetarët e Kosovës, e do të ishte vërtet porosi e gabuar për njerëzit e këtij vendi. Atëherë të gjithë ne, në rast se kalon kjo pikë, pra nëse votohet ky ligj dhe kjo marrëveshje, atë që kemi para vetes sot mendoj se e kemi të drejtën e fuqisë që t’i kërkojmë BE-së për të lëvizur në liberalizim, e jo ta falim Qeverinë ose Gjyqësorin që të mos e luftojë korrupsionin, por nuk mund të zëmë shkas, siç thotë populli, në luftën kundër korrupsionit e t’i vonojmë qytetarët e Kosovës. Në fund të fundit, nuk po ndëshkohen politika dhe elita, çfarëdo elite tjetër në vend, por është kah ndëshkohet qytetari i zakonshëm me mungesë të liberalizimit.

Dola ta them këtë për faktin se, shikoni, çdo sukses i vendit tonë, mua më kujtohet kur Shqipëria është anëtarësuar në NATO, ose kur e ka marrë liberalizimin, ne kemi përjetuar sukses. Dola ta them këtë që liberalizimi nuk është sukcesi i një grupi politik, cilitdo qoftë, për liberalizim ne jemi duke punuar plot 20 vjet, vendi ynë, të gjithë, kushdo nga pikëpamja e vet, nga mundësia e vet. Kosova ka dëshmuar që është euroatlantike, që është proevropiane, që vërtet shkojmë kah vlerat evropiane euroatlantike. Mendojmë se liberalizimi i vizave është diçka e drejtë e qytetarëve, e drejtë të këtij e vendi, dhe nuk mendoj që ajo duhet t’i shkojë një grupi politik, cilitdo qoftë, nëse arrihet liberalizimi. Vështirësitë që mund t’i hasim, ne se unë i dëgjova disa diskutues, me vështirësitë për korrigjim, sa do të jetë gatishmëria, a do të jenë disa metra, a është

neni 7, a është neni 12, dhe sa do të bëhet korrigjim. I dëgjova këto, të gjithë i kemi këto shqetësime.

Po si duam ne të ecim përpara? Unë ju fola më herët. Nëse varianti për t'u rrëzuar ky ligj, ku mbërrimë dikur ne? Sa kohë kalon për Kosovën? Prapë do të mbërrimë te një ide, te një korrigjim. Edhe bazuar në këtë, pra duke i parë tre vjet të shkuara dhe pozicionin e Kosovës sot, unë vërtet mendoj që ia vlen të kemi guxim politik për ta votuar këtë ligj, me rezervat që ka, se ka rezerva, si të mos ketë? Ka rezerva, por për t'i dhënë një mundësi vendit për të ecur përpara, për t'ua dhënë një mundësi qytetarëve për të lëvizur lirshëm, por edhe politikës, edhe neve, një mundësi për ta bërë korrigjimin. Unë jam thellë i bindur që nëse vërtet besojmë në këtë korrigjim dhe e ndiejmë dhe e kemi seriozisht, nuk e kemi vetëm sa për ta kaluar ditën e sotme në seancë, që do të ndodhë korrigjimi. Por, as nuk po them që është lehtë, as që është thjesht, as që do të vijë vetë. As nuk çohet guri vetë të lëviz prej vendit në vend. Njerëzit e kanë bërë, njerëzit e bëjnë.

E di që ka plot diskutime të lajmëruara, e thashë dhe një herë, nuk dua të ju marrë kohën në vazhdimësi, mirëpo besoj dhe shpresoj që këtë seancë janë duke e përcjell edhe përfaqësuesit e BE-së, edhe porositë i kanë të qarta pse është tepër e padrejtë të mbeten qytetarët e Kosovës në pakufi pa liberalizim, në emër të një procesi të një kushti të caktuar tjetër, sepse vetë u kanë thënë qytetarëve në vazhdimësi "po, ta kryejë politika juaj këtë, e ju çlirohemi, lirohemi e dilni për të qarkulluar lirshëm". E, po në rregull, nëse politika e Kosovës e ka kryer, atëherë atë mirë të jenë ata që kanë premtuar.

KRYESUESI: Faleminderit! A ju ka përmendur emrin? Po, a? Në rregull, Arbërie Nagavci replikë!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti Haradinaj,

Ju jeni kryeministër i Republikës së Kosovës dhe obligimi juaj i parë është që të kujdeseni për integritetin dhe sovranitetin territorial të vendit i të cilit ju jeni kryeministër. Unë pajtohem plotësisht me ju që kemi nevojë për përkrahje të miqve tanë ndërkombëtarë, por përkrahja që na bëjnë duhet të jetë në funksion të një shteti ligjor, të një shteti të së drejtës dhe të një shteti që i fiton betejat kundër krimit e korrupsionit, e jo përkrahje ku mbahen të izoluar qytetarët e Republikës së Kosovës, qytetarët e ndershëm të këtij vendi, ndërsa ka tolerancë, mirëkuptim dhe madje përkrahje të jashtëzakonshme për personat, të cilët dihen se janë të korruptuar dhe të pandershëm.

Betejën politike duhet ta fitojmë bashkë në të mirë të këtij vendi, andaj edhe guximi ynë politik nuk duhet të jetë në nënshkrimin e marrëveshjeve të dëmshme, por duhet të jetë guxim politik në të mirë të vendit.

KRYESUESI: Po, edhe Albulena Haxhiu e ka fjalën për replikë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Zoti Haradinaj,

Kur e kemi kundërshtuar demarkacionin, domethënë ende pa e ratifikuar Mali i Zi këtë version të demarkacionit, natyrisht ka qenë shumë më e lehtë që të kthehemi pas, por në atë kohë, siç e thashë edhe më përpara në fjalimin tim, ishte kryeneçësia e Isa Mustafës ajo që bëri që të mos rikthehemi, edhe përkundër faktit që kishte dy apo tri gatishmëri të Malit të Zi për t'u tërhequr dhe për t'u kthyer në pikën zero. Pasi Mali i Zi e ka ratifikuar këtë marrëveshje, natyrisht është bërë pak më e vështirë, por jo e pamundur, dhe unë sot po ju them këtu zoti Haradinaj, ka edhe medie jashtëzakonisht shumë në këtë sallë, ka deputetë, ka mijëra qytetarë që po na ndjekin, në qoftë se lejoni që të ratifikohet ky version i demarkacionit, mos mendo që do të mund ta kthesh Çakorrin apo Kullën ndonjëherë, dhe natyrisht deputetët do të kenë përgjegjësi, edhe morale, edhe politike, edhe penale, por përgjegjësi më i madh do të jesh ti.

Mos manipuloni me Konventën e Vjenës, sepse në qoftë se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e ratifikon këtë marrëveshje, Marrëveshja që e ka ratifikuar Mali i Zi është “nul”, pra është e pavlefshme. Nuk bëhet fjalë si të them për 100 metra, po bëhet fjalë për 4 apo 5 kilometra, andaj unë edhe një herë sot po të bëj thirrje zoti Haradinaj - tërhiquni nga kjo marrëveshje. Neve na keni aleat edhe për luftën ndaj kimit të organizuar dhe korrupsionit, por edhe për ta kthyer Kullën e Çakorrin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti. S'është këtu? Atëherë, fjalën e ka Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të gjithë ju të pranishëm në sallë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot po e diskutojmë Marrëveshjen për kufirin me Malin e Zi, temë me relevancë të veçantë, moment historik siç jemi mësuar të themi, por edhe temë e cila e ka krijuar një histori meskine në vend.

Është e vërtetë që Kosova po kalon momente historike. Për herë të parë në historinë mijëvjeçare të dhembshme të shqiptarëve, ne po diskutojmë për kufijtë e shtetit tonë. Faktikisht, kufijtë administrativë që i vuri dikush tjetër për ne, në kohën e ish-Jugosllavisë, ne po i kthejmë në kufij shtetërorë. Pa mëdyshje, për çdo shtet në botë, çështja e kufirit është çështje e territorit, sovranitetit, andaj kërkon përkushtim, korrektësi, patriotizëm, profesionalizëm dhe transparencë.

Kërkon klasë politike, sepse ne nuk kemi krijuar ende elita politike, që vërtet ta duan vendin dhe popullin e vet më shumë se pushtetin.

Çështja e kufirit me Malin e Zi e ka historikun nga viti 2002, atëbotë kur Kosova administrohej nga UNMIK-u. Në vitin 2002, Mali i Zi i zhvendosi fizikisht tabelat e kufirit në Kullë dhe në Çakorr, përveç kësaj, që ishte edhe më e papranueshme dhe johumane, shembja e varrezave shekullore të shqiptarëve në Zhleb dhe humbja e gjurmëve të tyre.

Kjo na jep të kuptohet se dikush po përgatitej që t'i humbiste gjurmët faktografike, historike, gjeografike, juridike e topografike.

Kosova e shpalli pavarësinë e vet në vitin 2008 mbi Pakon e Ahtisarit dhe me kufijtë e vitit 1974-1988, kufij të cilët ishin administrativë bazuar në harta topografike, ushtarake, turistike, e të tjera, që ishin të ish-Jugosllavisë. Kufij dhe harta që i njihte çdo institut hartografik botëror. Në bazë të kësaj dhe atyre dokumenteve të pakta që kishim në dispozicion, në shkurt të vitit 2015, pra para nënshkrimit të Marrëveshjes gusht 2015 unë e ngrita këtë çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe iu drejtova zotit Thaçi, atëherë zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme. Askush nuk më dha asnjë përgjigje. Një muaj më vonë, pra në mars të vitit 2015, bëra pyetje parlamentare prapë drejtuar zotit Thaçi. Pyetja u përsërit në dy seanca dhe zoti Thaçi nuk mori mundimin asnjëherë që të na japë asnjë përgjigje dhe në gusht të po këtij viti ai e nënshkroi këtë marrëveshje. Kjo vërtet ishte papërgjegjësi, arrogancë, fyerje e nënçmim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, por si për ironi kësaj papërgjegjësie në atë kohë iu bashkëngjit opozita me arrogancë, me dhunë, me fyerje e nënçmim të deputetëve të mazhorancës së mandatit të kaluar. Opozita e mandatit të kaluar e kapi këtë temë të ndjeshme dhe nacionale, duke e bërë armë për të ardhur në pushtet.

Ne deputetët që nuk e kishim hall pushtetin, por debatin rreth marrëveshjes, nuk na u mundësua kjo e drejtë dhe obligim yni nga ish-opozita në bashkëpunim me PDK-në. Çështja doli në rrugë, u shpallën tradhtarët dhe patriotët, ndërsa vendi po vendnumëronte dhe po izolohej çdo ditë e më shumë. Imazhi i Kosovës me tym dhe kërcënime ishte më i keqi nga paslufta. Sot, pas tre vjetësh, prapë po u drejtohem me pyetje zotit Thaçi, zotit Haradinaj, zotit Enver Hoxhaj, zotit Veseli dhe zotit Kurti.

Zotëri Thaçi, a ishte Marrëveshja e vitit 2015 me Malin e Zi e drejtë, apo jo? Nëse marrëveshja ishte e drejtë, pse u desh të bëhet një aneks-marrëveshje, deklaratë e cila thekson se gjatë shënimit të kufirit Kosovë - Mali i Zi të rishqyrtohen pikat Çakorr dhe Kullë? Cilin version tuaj t'i besojmë ne, se dy të vërteta nuk janë, është vetëm një.

Zoti Haradinaj, zoti Veseli, zoti Hoxhaj, pse nuk u pajtuat me aneks-marrëveshjen të cilën e bëri Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilën ia prezantuam kryeministrit

Mustafa në praninë e ambasadorit Delavie, marrëveshje e cila ishte shumë më e avancuar se kjo, e kam këtu me vete. Pra, ju theksova edhe juve, zoti Enver Hoxha, sepse ju takova personalisht në Bruksel më 2 maj, në Parlamentin Evropian, ju kërkova edhe ju luta që ta negocioni propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në BE, e nuk e bëtë. Pse nuk e pranuat propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës? A ishte më i rëndësishëm territori i vendit e liberalizimi i vizave, apo pushteti për ju?

Këto po i theksoj për qytetarët që të mos lajthiten nga mashtrimet e juaja, sepse po të ishit korrektë me popullin dhe hallin për territorin, ju do të ishit pajtuar me propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe tani vendi do të kishte liberalizimin e vizave dhe do të ishte një situatë shumë më e mirë për vendin.

A po e shihni sot Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës? Nuk ka sabotazh, nuk ka inat, nuk kërkon të përfitojë politikisht në kurriz të proceseve vendimtare për vendin. Kjo është Lidhja Demokratike e Kosovës me filozofinë e Ibrahim Rugovës. Gjithë angazhimin në shërbim të popullit e të vendit, e jo si ju, që marrëveshjet ndërkombëtare janë bërë dokumente personale tuajat, që i sillni kur të doni, i tërhiqni ato, i sillni prapë, siç është rasti konkret me rastin e Gjykatës Speciale, me Ligjin për ushtri, edhe vetë tema që po e diskutojmë.

Ju manipuloni me Kuvendin e Republikës së Kosovës sipas situatës politike që silllet rreth personaliteteve tuaja. Ky poshtërim që po i bëni ju popullit nëpërmjet të zgjedhurve të tij është i papranueshëm dhe i patolerueshëm. Kosova nuk është pronë e individëve matrapazë, dhunues dallkawkë, nuk është as pronë e partive politike. Këtë shtet e bëri populli shqiptar me shumë sakrificë, ranë shumë dëshmorë; e bëri presidenti Rugova duke pasur vizion e vetëdije shtetërore, lidhi aleancë të fortë me Shtete të Bashkuara të Amerikës dhe me shumë shtete evropiane, prandaj jemi këtu ku jemi dhe neve na mbetet t'i ruajmë këto aleanca dhe të ecim tutje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto vite, secili prej nesh është dashur ta ushtrojë juristin, historianin, gjeografin, gjeodetin, e të tjerë, që të merret seriozisht me këtë marrëveshje. Këtë gjë jam munduar ta bëj edhe unë në këto vite, që të jem e saktë në vendimin tim. Nuk premtom koha dhe nuk besoj se ka nevojë t'i risjellim të gjitha ato argumente që na dëshmojnë se kufiri me Malin e Zi duhet të jetë në Kullë dhe në Çakorr.

Dua ta jap vetëm një argument të shkurtër dhe të thjeshtë. Marrëveshja e vitit 2015 thotë: Pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ky kufi të shënohet në harta topografike... Kjo na jep të kuptojmë se ne po bëjmë kufij të rinj dhe harta të reja. Ne jemi shumë të interesuar që të kemi marrëdhënie dhe fqinjësi të mirë me Malin e Zi. Jemi shumë të bindur se Mali i Zi është i gatshëm ta rishikojë këtë marrëveshje dhe të përmirësohen gabimet e dy komisioneve shtetërore Kosovë - Mali i Zi, duke u bazuar edhe në nenin 7 të kësaj

marrëveshjeje apo këtij ligji dhe duke u bazuar në deklaratën e nënshkruar nga dy presidentët e vendeve tona. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E di që është një ditë e gjatë dhe qytetarët presin më shumë se çdo gjë tjetër që të votohet dhe jo që të deklarohemi në Kuvend. Megjithatë, ne që e patëm të pamundshme të flasim atëherë, kur ka qenë koha të diskutojmë në Kuvend, do ta shfrytëzojmë këtë të drejtë që të diskutojmë sot.

Pati deklarime të shumta nga kolegët deputetë, deklarime të ndryshme, ndër të cilat edhe aso që liberalizimi i vizave nuk është prioritet i Republikës së Kosovës. Liria e lëvizjes nuk është prioritet e as problem për ata të cilët nuk e kanë problem lëvizjen e lirë, meqë ata dhe familjet e tyre janë të privilegjuar dhe nuk kanë pse të presin në radhë dimër e verë para ambasadave të Republikës së Kosovës. Ata që deklarohen se liberalizimi nuk është prioritet i Kosovës nuk e kanë hallin e mijëra qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët, jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Diaspora po na shkruajnë sot me kërkesën e vetme që ne ta mbyllim njëherë e mirë këtë çështje.

Ata, në vend të votës pro liberalizimit të vizave, në vend të votës pro hapjes së perspektivës evropiane të qytetarëve të Kosovës, kanë zgjedhur që sërish ta bllokojnë këtë lëvizje të lirë dhe të veprojnë në shpërputhje me interesat e qytetarëve, të cilët i kanë votuar.

Kolegë deputetë,

Unë do të shpreh qëndrimin tim në lidhje me çështjen e shumë diskutuar dhe mendoj se është njëra prej çështjeve më esenciale për të ardhmen integruese të Republikës së Kosovës në mekanizmat euroatlantikë dhe të lëvizjes së lirë pa viza në zonën e Bashkimit Evropian, si dhe fqinjësisë së mirë dhe partneritetit strategjik me Republikën e Malit të Zi nëpërmjet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje të demarkacionit të kufirit ndërmjet dy shteteve.

Çështja për të cilën ne sot po diskutojmë, e pranoj se është konsumuar, sepse tashmë kanë kaluar tre vjet që kur ne nën tymin, nën gazin lotsjellës, kemi provuar që ta diskutojmë këtë çështje. Është diskutuar aq gjatë, sa që herë është informuar mirë opinioni publik, e jo në raste të rralla është dezinformuar opinioni publik, por asnjëherë nuk kemi arritur që këtë çështje ta debatojmë aty ku është vendi i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për shqyrtimin dhe për dhënien e një epilogu përfundimtar kësaj çështjeje.

Edhe përkundër gjithë mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë, Komisioni për Shënimin e Kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, komisioni i themeluar asokohe nga zonja Jahjaga, Komisioni Vlerësues i Ekspertëve, i themeluar nga ish-kryeministri Mustafa, deklaratat e Departamentit Amerikan të Shtetit, të cilët njëzëri deklaruan se marrëveshja është në përputhje të plotë me të gjitha dokumentet relevante dhe praktikën ndërkombëtare të vendosjes së kufirit dhe se me këtë marrëveshje Kosova nuk humb territor, megjithatë ende nuk pati një rrugëzgjdhje dhe mungoi konsensusi politik për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Si pasojë, deputetët u privuan nga një e drejtë për t'i hapur rrugë perspektivës së tyre dhe qytetarët u privuan po ashtu nga e drejta themelore për të lëvizur lirshëm. Do të thotë, si pasojë e kësaj gjendjeje, me qëllim të shfrytëzimit politik të kësaj kauze, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm që është njëra prej kauzave që është shfrytëzuar më së keqi politikisht nga grupe të caktuara, të cilat kanë harruar se qytetarët i kanë sjellë në këtë Kuvend me votën e tyre. Kjo gjendje e vështirësoi pozitën e Kosovës karshi procesit integruar dhe lirinë e lëvizjes pa viza në vendet e Bashkimit Evropian për qytetarët tanë.

Si pasojë, kolegë deputetë, ju jeni të vetëdijshëm që u shty në afat të pacaktuar dhe rekomandimi i Komisionit Evropian për heqje të vizave dhe u vu parakusht kryesor që deri në zgjedhjet përfundimtare dhe ratifikimin e kësaj marrëveshjeje qytetarët e vendit, qytetarët e Republikës së Kosovës, nuk do të mund ta përfitojnë këtë të drejtë të lëvizjes së lirë në Bashkimin Evropian.

Kemi pasur zhvillime të reja në Qeverinë e re me një konstelacion të ri politik, me një përbërje të re në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e cila i dha një kah tjetër zgjidhjes së këtij problemi, njëri ndër problemet më të mëdha politike. Kësaj çështjeje që nga fillimi i krijimit të institucioneve të reja, që dolën nga zgjedhjet e vitit 2017, e pranoj që iu dha një dinamikë e shtuar me qëllim të vetëm zgjidhjen e ngërçit politik. Atëherë partnerët e koalicionit për herë të parë e proceduan këtë marrëveshje për debat dhe ratifikim. Paralelisht me këtë, e pas një aktiviteti intensiv të përfaqësuesve të Qeverisë me palën malazeze dhe pas dakordimit të të dy kabinetëve presidenciale të të dy shteteve, iu dha një kah tjetër kësaj çështjeje. Kjo për faktin se edhe ato pak dyshime që ekzistuan në lidhje me marrëveshjet nga partitë opozitare, u hap mundësia e rishikimit të kësaj marrëveshjeje si rrjedhojë e dakordimit dhe mirëkuptimit të fqinjëve dhe partnerëve tanë nga Mali i Zi me nënshkrimin e deklaratës së përbashkët ndërmjet dy presidentëve, zotit Thaçi dhe të zotit Vuçanović.

Konsideroj se procesi i ratifikimit të kësaj marrëveshjeje skajshmërisht është politizuar, është neglizhuar dhe ka prodhuar pasojë të pariparueshme, duke ua mbyllur perspektivën qytetarëve tanë, sidomos rinisë, e cila për tre vjet me radhë ka qenë e mohuar nga e drejta për të lëvizur lirshëm, nga e drejta për ta gëzuar të drejtën sikur secili moshatar i tyre nga rajoni, të cilët e gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë.

Dua të përmend, po ashtu, edhe aktivitetin intensiv të Partisë Demokratike të Kosovës që nga themelimi i kësaj marrëveshjeje, e cila si bartëse e këtij procesi dhe në vazhdimësi gjatë gjithë kohës ka tentuar që të kontribuojë në gjetjen e një konsensusi të gjerë politik për zgjidhjen e kësaj çështjeje shumë të rëndësishme për vendin dhe ka qenë pro ratifikimit të saj, qëndrim i cili u tha edhe sot nga kolegët deputetë të partive opozitare.

Vota pro demarkacionit mendoj që është votë pro pozicionimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe me kalimin e saj Kosova do të dëshmojë edhe një herë se është partner i denjë dhe i gatshëm të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe në kultivim të marrëdhënieve fqinjësore në rajon. Vota pro nënkupton hapje të mundësive për secilin prej nesh, hapje të mundësive veçanërisht për të rinjtë dhe të rejat tona, mundësi për të avancuar në aspektin e edukimit, mundësi për shumë të rinj që të kenë qasje në studime.

Për fund, mendoj se votimi i sotëm është njëri ndër votimet më të rëndësishme në shkëmbim të përvojave dhe e bën Kosovën shtet me pozicion tepër të rëndësishëm, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Ali Lajçi e ka fjalën.

ALI LAJÇI: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Të respektuar deputetë,
Kryesues!

Kjo tashmë është një temë sa historike, etnike, politike, kadastrale, pronësore, e tjera, e tjera, dhe u fol mirë. Dhe, është mirë që po zgjat debati dhe duhet të zgjasë, por koha ka qenë faktikisht jo shumë e favorshme për të kaluar tre vjet e të mos mund të zgjidhet ky problem. Pse?

Sigurisht se një punë që nis mirë edhe përfundon mirë, thotë populli, por kjo punë është nisur keq dhe nuk ka përfunduar edhe për shkaqe të shumta që ne i kemi thënë. Jemi përballë me debate të shumta dhe vazhdon kjo gjithnjë e më tej. Por, sot shtrohet kjo temë si çështje e perspektivave të institucioneve të Republikës së Kosovës, po edhe e Kosovës si tërësi, në drejtim të integriteteve dhe të fuqizimit të shtetit të Kosovës, e që është sigurisht njëra prej tyre, por shtrohet edhe si çështje e integritetit, territorit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës. Ndonjëherë është politizuar me qëllime të njëanshme, kurse shpesh, pra jo krejt, pjesa tjetër, që këto të dyja shkojnë bashkë sigurisht. Por, sidoqoftë, duhet të jemi të qartë se kufijtë e një shteti nuk maten me kadastra, sipërfaqja e tyre, por maten me kufij shtetërorë. Prandaj, orvatja për t'i bërë kufijtë e Kosovës me kadastrë e humb sipërfaqen e Republikës, apo të shtetit të Kosovës dhe dallohet koncepti i bërjes shtet, apo i bërjes së kadastrave komunale, që dallojnë, e që të dyja e kanë rolin e vet sigurisht, dhe shumë faktorë të tjerë, por jo e njëanshme.

Në këtë mes, tre vjet kaluan dhe si kaluan ato? A jeni dëshmitarë se edhe koalicioni i hershëm, por edhe i tashmi, nuk e ka sjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ta ratifikojë këtë marrëveshje, por e ka afruar dhe kur ka konsideruar që nuk i ka votat është tërhequr. Dhe, është tërhequr vazhdimisht dhe, në këtë rast, sigurisht e ka marrë përgjegjësinë edhe të shtyrjes së kohës. Nuk duhet Qeveria, dhe asnjë institucion, që ta marrë për bazë “i kemi a s’i kemi votat”, por duhet të vijë në Kuvend dhe t’i jepet fund, por jo gjithherë se “nuk i kemi dy-tri vota a katër”, e tjera. Prandaj, merreni përgjegjësinë për menaxhim të keq të këtij projekti, për shtyrjen e kohës, merreni përgjegjësinë, kurse ne e kemi pasur që plotësisht arsyeshem të kundërshtojmë dhe vazhdojmë atje. Pse?

Kosova me këtë marrëveshje, duhet të jemi të sigurt, ka humbur territor në përmasën e saj 78 km në pjesën Kosovë dhe Mali i Zi, e që shtrihet në njërën pikë Çakorr dhe Kuçishtë 6 km, të jeni të sigurt. Dhe, në pjesën e Kullës shtrihet 5 km e gjysmë, të jeni të sigurt, sepse atje kemi punuar me përkushtim të madh që të mund ta hetojmë këtë çështje dhe të mund ta vendosim një demarkim të sigurt, të qartë, stabil dhe perspektiv. Por, kjo nuk ka ndodhur.

Çfarë ka ndodhur? Ka ndodhur pas protestave, pas tërheqjes së vërejtjes nga komisioni, në të cilin ishim, dhe pas dhënies së fakteve ka qenë një injorancë e paparë e vetë komisionit dhe e vetë përfaqësimit të Qeverisë së asaj kohe dhe në vazhdim me Qeverinë pasuese, e cila faktikisht e ka krijuar krizën politike, me protesta, me peticione, e edhe me gazin që nuk është vetëm demokratike, por ishte i vetmi mjet, i cili faktikisht tregoi se vija kufitare është bërë gabimisht. Edhe vetë marrëveshja e Thaçit dhe presidentit të Republikës së Malit të Zi faktikisht, në qoftë se e keni marrë seriozisht atëherë, tregon se e ka pranuar gabimin, sepse është bërë. Ajo është një deklaratë, por faktikisht ju e interpretoni si aneks-marrëveshje. Prandaj, një njeri i nivelit institucional nuk mund t’i shkruajë dy marrëveshje të kundërta, sepse duhet të trajtohej ajo. Ne ende nuk i trajtojmë ato ashtu, por dëshirojmë të mbulojmë një kohë të bjerrë, një kohë që i ka shkaktuar dhe vazhdon t’i shkaktojë dëme të mëdha Kosovës.

Në këtë mes, duhet të jeni të qartë, sot, nesër, apo edhe kurdo, është synuar të votohet Marrëveshja 2015, e cila dihet dhe tash me nenin 1 të po kësaj marrëveshjeje, shtuar edhe dy nene tjera, raporti i Bulliqit e të tjera, por të cilësuar si informativë apo drejtues, është prapë problematik. Pse? Është problematik, sepse i keni futur në kornizë dy çështje që nuk qëndrojnë, sepse do të duhej edhe raporti i Bulliqit, siç i themi, me 500 faqe dhe me 64 harta, që gjithnjë është mohuar nga të gjitha qeveritë, se gjithë këto të dhëna nuk janë të dhëna, nuk janë argumente.

Dhe, tash shtrohet çështja, a thua edhe më tutje, edhe pas këtyre komisioneve do të thuhet se nuk janë të gjetura ato? Ky është ajo problemi dhe dyshimi dhe në qoftë se dikush ka menduar se do të bëhen komisione pas kësaj Marrëveshjes 2015 për korrigjime të detajuara, nganjëherë thuhet edhe me metra, joo, sepse atëherë do të krijohet një komision mikst sipas Marrëveshjes 2015,

sepse ne i kemi përcjellë këto ecuri dhe atëherë do të jenë komisione kadastrale, të cilat veç do t'i shënojnë pikat teknike, por jo korrigjimet. Dhe, kur kjo do të aprovohej, të jeni të sigurt se do të kërkohet edhe zbatueshmëria e saj. Zbatueshmëria e saj kërkohet vetëm 2015. Kjo duhet të jetë e qartë se çka bëjmë dhe çka votojmë.

Kurse, në qoftë se kjo ezaurohet ose "sosen", siç thotë vetë populli, atëherë kemi një marrëveshje cullak, në lëndinë, 2015, për të cilën janë bërë protesta, për të cilën janë bërë peticione, për të cilën ka ndodhur krejt ajo rezistencë bashkë me subjektet, të cilat tashmë janë në koalicion. Kurse, LDK-ja, kjo çfarë thotë? Kjo thotë se ne e mbrojmë dhe ne jemi në rrugën e Ibrahim Rugovës dhe të projektit të LDK-së. Duhet t'u themi shkurt, se jo, sepse Rugova më 2004 ka thënë, u përsërit bukur prej Nagavcit, "kufijtë janë të pandryshuar dhe janë të vetmit ata Çakorr - Kullë - Mokna dhe si të tillë do të bëhen me komisione të përbashkëta. Interesi i Malit të Zi nuk është që të bjerë poshtë".

Kurse, sot çka kanë dashur të votojnë? Kanë dashur ta votojnë marrëveshjen dhe këtë e kanë kërkuar bile edhe pa projektin, edhe pa vetë raportin e Bulliqit, shumë qartë, vetëm 2015-ën. Ju lutem, nuk janë në programin e LDK-së, i kanë hequr simbolet dhe e kanë hequr vetë identifikimin e tyre, vetë me votën e tyre po duan ta votojnë një marrëveshje të 2015-ës, me të cilën nuk e pranojnë as raportin e Bulliqit dhe duan të thonë se "jemi në LDK". Me ato mos u merrni më, mos u merrni me Ibrën, e ta përdorni në fushata zgjedhore e tjera, respektoni programin, dinjitetin, respektoni se nuk është këtu puna e një projekti të vizave. Ju lutem!

Po të jetë projekti i ndarë me viza, sillna raportin e një projektligji i cili do të ishte që t'i votojmë vizat. Me të gjitha duart dhe këmbët do ta votonim, por sot mos harroni, keni për të votuar një tekst, i cili shkruan: "Shënimi i vijës kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës", nuk do të votojmë viza, ju lutem, vizat janë mekanizëm tjetër i dikujt tjetër dhe në qoftë se ne e votojmë atë tekst, e vetëm ashtu është, atëherë i kemi votuar qartë 6 kilometra a pesë kilometra e gjysmë nën vijën kufitare, e cila është tashmë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, i është marrë një minutë, të lutem.

ALI LAJÇI: Kurse unë do të thosha tash, për fund, sepse mund të flitet gjashtë orë këtu.

Ju lutem, kur kemi pasur ekspansione ushtarake, militare, të sllavëve, respektivisht të Serbisë apo të Malit të Zi, shikoni, i kemi pasur ushtarake dhe kanë marrë territor. Sot po votohet, hera e parë në Kuvendin e Republikës, për kufij, të cilët faktikisht ne po i rrudhim nëpërmjet votës apo gishtit vullnetar, që është e papranueshme, sepse atëherë ne në '45-ën jemi aneksuar në Serbinë federale dhunshëm dhe e ka pasur kuptimin. E sot, kur ne po votojmë vijat kufitare me Malin e

Zi, mos harroni, po e rrudhim me vullnetin tonë, me gishta, pa dhunë dhe po marrim përgjegjësinë, e cila ju siguroj se mund të ndodhë që këta kufij, të cilët do të vendosen, nuk do të jenë kufij paqësorë, nuk do të jenë kufij reciprokë, nuk do të jenë kufij që garantojnë një qetësi të brezave, por do të jenë kufij të ngatërresave, do të jenë kufij të konfliktit dhe unë ju kisha lutur deputetëve të Republikës së Kosovës sot të mos hyjnë në hak me procese të pastajshme, të cilat nuk do t'i kemi të dëshirueshme.

Prandaj, ju lutem, mendoni mirë, mendoni, se kjo marrëveshje duhet të zbresë në zero, kur të bëhet korigjimi, të bëhet faktikisht si duhet, të jetë obliguese edhe Mali i Zi, sepse me këto deklarata politike nuk është obligues Mali i Zi dhe ne do të mbetemi në kufijtë e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, vetëm pak, një replikë të shkurtër,

Fillimisht me kolegë nga Lëvizja “Vetëvendosje”, pothuajse të gjithë, ama të gjithë pa dallim po flasim për LDK-në, për Ibrahim Rugovën, po harrojnë që LDK-ja nuk është në Qeveri, LDK-ja është në opozitë. Po mirë që po binden edhe më tutje që LDK-ja është e vetmja forcë graviteti që të gjitha subjektet e tjera dhe ngjarjet në Kosovë sillen rreth saj.

E, nga ana tjetër, njëri prej deputetëve më herët, i Lëvizjes “Vetëvendosje”, mori të drejtë për të interpretuar çfarë mesazhi jep jashtë vota pro e LDK-së.

Dhe, unë tash po e marr të drejtën të interpretoj edhe mesazhin që e bart sjellja e kulturuar e tyre sonte.

Çka mendojnë njerëzit, thonë kështu: “Vetëvendosja” ose paska qenë e koordinuar me kryetarin e Kuvendit, kur shkaktonte dhunë ose paska frikë nga zoti Haradinaj, sepse sot vërtet po sillen shumë mirë. Por, unë mendoj kështu që këta as nuk kanë frikë, po as nuk janë bashkë me PDK-në, por po emancipohen, po pjekën politikisht, po muturohen dhe kjo është për t'u vlerësuar.

Sot po diskutojmë njërën ndër temat që për tre vjet kanë ngufatur pa të drejtë jetën institucionale, politike dhe shoqërore në Kosovë dhe e kanë shndërruar në pengesën kryesore, duke i mbajtur njerëzit të izoluar.

Të nderuar deputetë,

Kjo temë tashmë do ishte harruar po qe se e njëjta nuk do të bëhej kauzë e rrejshme politike e disa prej liderëve politikë të subjekteve të caktuara politike në vend.

Po të kthehemi në retrospektivë e unë si deputet të provoj të imitoj sjelljet e para disa viteve në këtë sallë të Kuvendit, kur provohej të trajtohej kjo tematikë e rëndësishme, atëherë unë nuk do të duhej të flisja sot, por do të duhej të përdorja mjete jopolitike për qëllime politike, do të duhej të hidhja gaz lotsjellës, do të duhej të sulmoja kryeministrin me vezë dhe me sprej, do të bëja zhurmë të padurueshme me filikaqë në gojë, do të fyeja sigurimin e Kuvendit, duke i quajtur “horra”, do të shëtisja nëpër sallë të Kuvendit me një shishe alkool në dorë dhe do të thosha që është çaj, derisa dikur më vonë do të kotesha në ulëset e përshtatshme në korridoret e Kuvendit nga deja që do të më shkaktonte ‘çaji’.

Të gjitha këto do të ndodhnin para syve të kryetarit të Kuvendit, i cili përkundër që ka mandat kushtetues që të kujdeset për sigurinë e deputetëve në sallë, ai do t’i përzinte sigurimin nga salla dhe kur ata do të futeshin për të mbrojtur kryeministrin e vendit nga sulmet e paskrupullta që mund të çonin deri në përleshje fizike. Dikush do të mendonte: mos e gjithë kjo paska qenë një lojë e koordinuar mes opozitës së atëhershme dhe udhëheqësish së Kuvendit? Sjelljet e mëvonshme të këtyre aktorëve sikur na e dëshmuon këtë.

Po normalisht, unë si deputet këto sjellje të papranueshme dhe të liga nuk do t’i bëj, sepse do të veproja kundër kulturës politike dhe demokratike që ka subjekti im, do të veproja kundër interesave të shtetit tim dhe kundër interesave të njerëzve që jetojnë në vendim tim.

Harxhuam tre vjet, mbajtëm njerëz të izoluar, sulmuam, dogjëm policë, sulmuam dhe dogjëm objektin e Qeverisë, sulmuam objektin e Kuvendit të Kosovës, sulmuam shtëpinë dhe eskortën e kryeministrit, sulmuam dhe dogjëm makina private të zyrtarëve publikë, vëmë në pikëpyetje raportin me miq ndërkombëtarë, vëmë në pikëpyetje procesin e integritit, vëmë në pikëpyetje sigurinë individuale dhe kolektive, me një fjalë vëmë në pikëpyetje gjithçka që kishim arritur si shtet, si shoqëri, me shumë mund dhe gjak.

Dhe ku jemi sot, jemi pikërisht në pikën ku ishim në 2015-në, pra para nesh e kemi të njëjtën marrëveshje, me të njëjtën materie, me çdo shkronjë, me çdo presje.

Por çka ka ndryshuar? Ka ndryshuar vetëm një gjë. Nuk është kryeministër Isa Mustafa, po sot është kryeministër Ramush Haradinaj, i cili ishte kreator dhe dizajneri kryesor i të gjithë kësaj kauze mashtruese politike, normalisht i mbështetur edhe nga disa liderë të tjerë të partive politike.

Për ta konfirmuar këtë është edhe fakti që detyruat Malin e Zi që përmes një manovrimi politik të involvohet edhe një herë për këtë tematikë vetëm për të provuar që t'ju nxjerrë me fytyrë para popullit. Normalisht që është për të ardhur keq se na u deshën malazezët për të na e zbardhur fytyrën.

Deklarata politike nënshkruar nga presidentët Vujanoviq dhe Thaçi, përtej një shprehje vullneti për respektim të marrëveshjes bazë, nuk ka asnjë efekt legal, thjesht nuk derivon asnjë obligim ndërkombëtar.

Këtë e konfirmon edhe vetë ministri i Jashtëm i Malit të Zi, i cili deklaron që deklarata politike e Thaçit dhe Vujanoviqit është një konfirmim i asaj që tashmë është në marrëveshje në bazë në nenin 7.

Marrëveshja për kufirin ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës do të mundësojë të bëhen korrigjime teknike të vijës kufitare, por nuk ka ndryshime të theksuara.

Kjo është e vërteta, të nderuar deputetë dhe të nderuar njerëz që jetojnë në Kosovë.

Na i humbën tre vjet vetëm e vetëm për realizimin e interesave të ngushta politike për të ardhur në pushtet dhe këtë e arritën.

Me që ky mashtrim tashmë doli sheshazi, apo siç thotë populli, 'doli për lëndinë'. Më e pakta që ky kryeministër dhe ky koalicion qeverisës duhet të bëjë është t'i kërkojë falje publike popullit dhe pas ratifikimit, të ofrojë dorëheqje.

Megjithatë, rasti i tillë le të na shërbejë si mësim për ata që kanë aftësi për të mësuar, se shteti është mbi të gjitha. Se ky shtet nuk mund të cenohet sa herë që dikujt i teket, si interesat personale në asnjë rrethanë nuk guxojnë të vejnë në pikëpyetje sigurinë individuale dhe kolektive të shoqërisë sonë.

Kosova është vendi ynë dhe këtë duhet ta ruajmë të gjithë. Nuk kemi atdhe tjetër rezervë. Faleminderit!

KRYETARI: Sami Kurteshi. A ka përmendur emër? Të kujt? Emri veç i kryetarit të Kuvendit nja 10 herë iu ka bërë si modë, si thes të gjuani te unë, thjesht, po gjuani sa të mundeni, se vijmë edhe te kjo pjesë.

A të shkojmë te Sami Kurteshi, veç kryetarin e Kuvendit e ka përmendur për replikë. Jo, krejt diskutimet do të jenë me grupe. Sami Kurteshi, më vjen keq, po me qejf jua kisha dhënë fjalën

gjithë ditën, po puna është si të shkojmë në procedurë. Sami, nuk e lë keq ti, e di atë punë, edhe për replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë të nderuar,

Republika e Kosovës, si një shtet i ri ka interes jetik për përcaktimin e kufijve ndërkombëtarë me fqinjë.

Përcaktimi i kufirit shtetëror është pjesë e kufizimit reciprok të sovranitetit dhe të integritetit territorial me fqinj.

Ky është një veprim i domosdoshëm, i ligjshëm dhe sjell stabilitet.

Po ashtu, përcaktimi i kufijve ndërkombëtarë është obligim ndërkombëtar, i cili kërkohet për të plotësuar njërin nga kushtet themelore të përcaktimit të territorit dhe sovranitetit shtetëror mbi të.

Çdo proces i delimitimit, përcaktimit të kufijve, është i normuar dhe bëhet sipas kritereve të njohura dhe të pranuara ndërkombëtarisht.

Unë kam tri pika që dua t'i theksoj këtu.

Një, në vitin 1992, me rastin e konfliktit në ish-Jugosllavi, pas konflikteve mes Serbisë dhe Kroacisë, Komisioni i Badinterit, që atëherë ka qenë komision evropian, ka vënë një parim, se kufijtë ndërkombëtarë nuk mund të ndryshohen me dhunë.

Kufijtë ndërkombëtarë të ish-Jugosllavisë janë të garantuar me të drejtën ndërkombëtare, aty nuk ka diçka.

Mirëpo, për të mos ndezur luftën edhe të kufijve midis njësive administrative që atëherë kanë qenë republikat dhe krahinat, Komisioni i Badinterit ka vendosur që kufijtë administrativë dhe republikanë të ruajnë 'status quo'-n dhe të mbeten ashtu siç kanë qenë dhe do të njihen në rast të ndarjes si kufij ndërkombëtarë. Ky ka qenë njëri nga kushtet. Edhe kjo është bazuar domethënë në Kushtetutën e ish- Republikës së Jugosllavisë.

Komisioni Meha ka bërë përcaktim të kufijve të rinj, duke e thyer këtë parim, domethënë parimin që e ka vënë Komisioni i Badinterit.

Komisioni Meha nuk ka pasur as kompetencë ligjore, as kompetencë politike, as kompetencë morale, po as intelektuale profesionale të bëjë përcaktimin e kufijve të rinj, po ka pasur kompetencë për demarkimin, shënimin e kufirit të ri.

Ndërsa Komisioni tjetër i Malit të Zi ka pasur tjetër karakter, ka pasur kompetencë politike dhe ligjore për përcaktimin e kufirit të ri, edhe ky është dallimi thelbësor që njihet edhe me të drejtën ndërkombëtare.

Rrjedhimisht, shtrohet pyetja, meqenëse Komisioni Meha ka bërë përcaktimin e kufirit të ri, kush i dha të drejtën, kompetencën apo legjitimitetin Komisionit Meha për të ndryshuar kufijtë e Kosovës?

Pushtetmbajtësit e atëhershëm kanë qenë Isa Mustafa, si kryeministër dhe Hashim Thaçi, si zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme që kanë nënshkruar marrëveshjen.

Përveç kësaj, Komisioni i ashtuquajtur Meha pikërisht për shkak të injorancës profesionale, të theksuar sidomos në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka pranuar kriterin kadastral, kriter krejtësisht i pavlefshëm dhe irrelevant në të drejtën ndërkombëtare për përcaktimin e kufijve.

Pse po e them këtë? Shumë kam dëgjuar ekspertë të së drejtës ndërkombëtare, Gjykata e Arbitrazhit në rastin e konfliktit të kufirit Slloveni-Kroaci, në rastin numër 2012/4, në këtë çështje në vendimin përfundimtar nxjerr këto konkluzione:

Thotë: “Në terma të përgjithshëm, arsyet për vijim për mospajtimin janë këto sa i përket të konfliktit Slloveni-Kroaci:

- a) Kufijtë kadastralë të përshkruar në hartat kadastrale, nëse ata mbivendosen ose lënë hapësira të zbrazëta.
- b) Kur nuk ka kufij kadastralë, dhe
- c) Kur kufiri duhet të përcaktohet duke aplikuar instrumente apo kritere të tjera.

Sipas gjetjeve të raportit për vlerësimin e punës të Komisionit Bulliqi, për shënimin e kufirit shtetëror, pranohet një fakt, thotë: në faqe 57 të Komisionit Bulliqi thuhet kështu: “Pranohen për të dhëna kadastrale, pa pasur bazë ligjore, siç janë listat detale të reprodukuara nëpër pjesë jokompatible me ato të Kosovës, si dhe procesverbale të mangëta të përkufizimit të zonave të kohës së Banovinës së Zetës, të ofruara nga pala malazeze, por pa të dhëna se kur, nga kush dhe si janë miratuar ato”.

Tash e kemi Projektligjin për demarkacionin.

Neve na ka ardhur një projektligj që nesër mendohet ose dikur të shndërrohet në ligj, që është paradoksal, domethënë ka kundërshti thelbësore. Pse? Ky ligj përmban tri çështje, përmban dy raporte, raportin Meha që është shndërruar në marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruar më 25 gusht 2015 nga Hashim Thaçi dhe përmban raportin e Komisionit Bulliqi që i kundërshton të gjeturat e Komisionit Meha, domethënë e kundërshton marrëveshjen ndërkombëtare.

Një, ligji, një ligj nuk përmban raporte, një ligj duhet të jetë i qartë, i saktë, i shkurtër dhe përmban norma detyruese për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ligji ose projektligji është i vlefshëm vetëm për ne brenda, sepse na detyron, nëse e miratojmë, që t'i respektojmë këto marrëveshje, e këto marrëveshje janë paradoksale, është konstatuar raporti "Bulliqi", për të cilin aleatët tuaj, zoti Haradinaj, thanë se e kanë porositur Serbia dhe Rusia, pak më parë ju s'e dëgjuat, kurse ju keni dhënë nënshkrimin, nënshkrimi juaj gjendet në këtë peticion diku, domethënë thonë se juve ju ka shtyrë Serbia dhe Rusia që të bëni Komisionin Bulliqi. Dëgjoni fjalimin më vonë, edhe e shihni.

Sidoqoftë, ky ligj përmban paradokse, kundërshti thelbësore mes njëra-tjetrës dhe nuk mund të vlejë për një jurist, edhe për një qytetar normal në Republikën e Kosovës si ligj, për arsye se nesër askush nuk e di çka ka votuar: ka votuar raportin Bulliqi, apo ka votuar marrëveshjen ndërkombëtare.

Po ligji neve na detyron të respektojmë një marrëveshje ndërkombëtare, e cila është lidhur në kundërshtim me normat e të drejtës ndërkombëtare që i përmenda. Merreni raportin, vendimin përfundimtar të Gjykatës së Arbitrazhit për konfliktin Slloveni - Kroaci, lexoni me vëmendje dhe do ta shihni që norma, kriteri kadastral nuk është as kriter parësor, as dytësor, për përcaktimin e kufijve ndërkombëtarë. Këtë duhet ta mbani në mend.

Unë mendoj se kjo çështje mund të zgjidhet, edhe zoti Limaj, edhe kryeministri thanë. Mund të zgjidhet, të formojmë Komisionin ad hoc si Parlament, asgjë nuk kemi kundër.

E formojmë një komision që merret me korigjimin e kufirit, i cili është i gabuar, që e ka pranuar edhe presidenti me nënshkrimin e një deklaratë me presidentin malazez, që sipas Ligjit për marrëveshjen ndërkombëtare të Kosovës nuk obligon askënd që të respektohet. Ta bëjmë një komision para ratifikimit, t'i gjejmë të gjitha ato mangësi të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare, ta nxjerrim edhe një herë ku janë ato shkarje, t'i bëjmë përmirësimet, e madje të vijmë këtu dhe ta ratifikojmë.

Unë pajtohem plotësisht nëse kjo radhitje e hapave vjen, po me këtë ngutje për ratifikim sonte vërtet kjo është vetëm një përpjekje për të bërë diçka që nuk ka ndonjë vlerë.

Tash, po lidhet me liberalizimin e vizave. Unë e di, kjo shpifje, kjo gënjeshtëri, kjo poshtërsi që bëhet nga mediat e paguara, edhe nga shteti, po edhe nga patronë të ndryshëm, lidhja e demarkacionit me liberalizimin është krimi më i madh që bëhet kundër qytetarëve të Kosovës. Sillni ligjin për heqjen e vizave, menjëherë e votojmë, e thanë edhe kolegët përpara.

Bëni Komisionin ad hoc të Parlamentit për korrigjimin e marrëveshjes, edhe ne marrim pjesë, po jo ratifikimin para korrigjimit të vijës kufitare që është shënjuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Elmi Reçica, le të bëhet gati Doruntinë Maloku-Kastrati.

ELMI REÇICA: I nderuar dhe shumë i respektuar kryetar Veseli,

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të gjithë i dëgjova deri tash që jemi duke pritur tre vjet për ta ratifikuar demarkacionin me Republikën e Malit të Zi.

Unë them që ky popull ka pritur 96 vjet për ta pasur shtetin e vet. Në vitin 1912 të largët janë ndarë padrejtësisht këto territore nga trangu mëmë. Dhe, të gjitha përpjekjet e të gjitha gjeneratave, të të gjitha gjinive, të të gjitha proviencave politike dhe të gjithë atyre që e kanë dashur këtë vend kanë punuar që Kosova të jetë e pavarur. Dhe, mendoj që rëndësia kyçe, rëndësia vendimtare është që ne jemi bërë, kemi ardhur në një situatë që të bëjmë shtet. Kemi bërë shtet dhe ne duhet t'i bëjmë kufijtë e shtetit.

Dua të theksoj edhe diçka. Ju e dini që Mali i Zi ka qenë pjesë integrale e Serbisë. Serbia malazetët për kohë të gjatë, deri në pavarësi, i ka quajtur ose 'Sparta serbe' ose 'Iulja serbe' ose 'piemonti serb'. Ju e dini, ju që jeni më të pjekur në moshë, nga vitet '89 e tutje i kanë quajtur "dy sy me një kokë". A ka sukses më të madh për ne se sa që Mali i Zi është pavarësuar dhe po jua ritheksoj kërkesat çfarë i ka pasur nga Brukseli Mali i Zi për t'u pavarësuar.

I vetmi shtet që ka pasur referendum që duhet të dalin 50% të qytetarëve dhe nga ata 50% , 55% votojnë pro pavarësisë së shtetit të tyre. Pse, pse ka pasur shumë kundërshtarë që kanë qenë kundër pavarësisë së Malit të Zi dhe ata e kanë realizuar.

Mali i Zi e ka realizuar me mbështetjen e shqiptarëve në Mal të Zi, në Kosovë dhe në Shqipëri dhe ky ka qenë lehtësimi i madh për ne.

Ne e kemi parë që Mali i Zi është një nga shtetet e para që e ka njohur Kosovën dhe e ka mbështetur në të gjitha projektet e mundshme, të cilat i ka pasur Kosova dhe unë besoj që nuk ka kënaqësi më të madhe, nuk ka moment më të rëndësishëm se sa për ta bërë përcaktimin e kufirit me Malin e Zi. E kemi bërë me Maqedoninë, e kemi problem të vetmin me Serbinë, që do të duhej të gjithë së bashku të orientohemi atje kur të vijë puna e demarkacionit për ta bërë me Republikën e Serbisë.

Kjo mendoj që është çështja kyçe pse ne duhet ta ratifikojmë këtë marrëveshje. Është shumë me rëndësi marrëveshja e nënshkruar mes dy presidentëve, nuk është marrëveshje sa për të thënë, është marrëveshje mes dy burrshtetasve, është marrëveshje e atyre të cilët kanë fituar mbështetjen e qytetarëve të tyre.

Po e përsëris edhe një herë, e kam thënë disa herë, pas kësaj marrëveshje beteja është për argumente. Ne të gjithë, djathtas, majtas, qendrës, mbrapa kudo që jemi, duhet të hidhemi në veprim për të siguruar argumente. Duhet të angazhohen ata të cilët janë bujq të asaj ane, blegtorët e asaj ane, pylltarët e asaj ane. Ata të cilët kanë dalë me stane në atë pjesë që të sigurojnë argumente e të ndryshojë kjo vijë e kufirit.

Të gjithë jemi deklaruar dhe po deklarohe mi këtu, e admiroj kryeministrin Haradinaj që e tha thënë shumë qartë dhe shumë drejtpërdrejt, e ka pasur më së vështiri, po është i gatshëm të ballafaqohet me secilën situatë, me secilin moment që të sigurojë argumentet dhe të mos japë asnjë arë truall që është i Kosovës, po ne duhet të jemi bashkë në këtë proces, kjo është më e rëndësishmja.

Ne duhet të mendojmë për qytetarët tanë. Unë e respektoj shumë këtë peticion, kryeministri ka qenë në ballë, dhe nuk besoj që kishin mundur të mblidheshin këto nënshkrime pa qenë ti në ballë, kryeministër. Po, megjithatë, megjithatë kur po i shoh tash opinionet e qytetarëve: nga 10 nga të anketuarit, 8 thonë votoni demarkacionin për liberalizim, votoni, hapni rrugë Kosovës të ecim përpara dhe kjo është ajo që ne duhet të na shërbejë si mësim dhe kjo është ajo që duhet neve të na shërbejë si orientim. Faleminderit!

Dashtë Zoti që sonte e përmbyllim këtë proces dhe kemi shumë punë për të bërë, dakordohem plotësisht: zhvillim ekonomik, lufta kundër korrupsionit, sundimi i ligjit dhe çdo gjë tjetër janë pjesë e këtyre kriterëve, po deklarativisht e kanë thënë këtu dhe në Bruksel dhe kudo qoftë, nuk ka lëvizje përpara pa e votuar demarkacionin, kjo është më se e qartë dhe më se e drejtpërdrejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Doruntinë Maloku le ta marrë fjalën.

DORUNTINË MALOKU-KASTRATI: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht, unë dua të them se ne të LDK-së po ndjehemi të lumtur se edhe këtu në Parlament po rritet dita-ditës komuniteti i rugovistëve, edhe pas gati dy dekadave është për t'ju përgëzuar që keni filluar t'i referoheni, megjithëse me shumë vonesë, dy institucioneve: Presidentit historik Ibrahim Rugova dhe Qendrës për Informim të Kosovës, por për t'ju besuar në vërtetësinë e deklaratave tuaja, duhet të shkoni t'i përkuleni para varrit Presidentit Ibrahim Rugova, sikur këta të tjerët.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarët të Republikës së Kosovës,

Ju që me të drejtë sot, pas më shumë se tre vjetësh, prisni që fjalimet tona të jenë të shkurtra dhe ju që sot pas tre vjetësh prisni epilogun e një sage që padrejtësisht u është bërë qytetarët më të izoluar në Evropë. Jam sot para jush, siç mund të kem qenë edhe tre vjet më parë, në përpjekje për të dhënë një mendim në raport me çështjen që po del të jetë sprova më e rëndësishme, e jashtme dhe e brendshme, përballë të të dëshmuarit të shtetësisë së Kosovës. Në fakt, përgjegjësia përballë shtetit nuk është sfiduar asnjëherë më shumë se sa këto tre vjet për të ratifikuar një marrëveshje, që përtej luftës sonë politike, po mban të izoluar qytetarët tanë që në rastin tonë, janë edhe zgjedhësit tanë, duke e bërë Kosovën ndër vendet më të izoluar në botë.

Pavarësisht konstatimeve në ishte kusht i drejtë apo i padrejtë demarkacioni në kompensim të vizave, mendoj që në historinë e re të Kosovës, ajo që ne po diskutojmë sot, përbën turpin më të madh që një elitë politike, pa përjashtim, do të përfaqësonte përballë qytetarëve të saj. Pra, ajo që ne kemi bërë që tre vjet rresht përballë interesit tonë nacional, përballë obligimeve ndaj partneritetit ndërkombëtar, përballë vetvetes, në fund të ditës, në regjistrin e kujtesës sonë historike e në memorien e fëmijëve tanë do të jetë referencë turpi, dhe për këtë duhet të skuqemi të gjithë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po konsumojmë debatin parlamentar, të cilin ne do të duhej ta konsumonim fiks para tre vjetësh. Të njëjtat gjëra që po bisedojmë sot, ne mund t'i kishim biseduar atëherë kur bartësit aktualë të një pjese të pushtetit, bashkë me disa të tjerë në këtë Kuvend, refuzonin edhe të bisedonin nga kjo foltore për të njëjtën gjë që po e bëjmë sot. Shumë pyetje dhe dilema do të shpërfaqja sot nga kjo foltore sikur të mos ndiqja parimin themelor të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës ndër vite, që në procese të mëdha asnjëherë të mos sillemi si të vegjël. Paramendojeni sikur ne të braktisnim sot seancën, siç bënin dikur të lartcekurit, sikur të hidhnin gazin lotsjellës ose të provokonim trazira. Këta tre vjet, nëse për asgjë tjetër, nuk u kanë shërbyer qytetarëve të Kosovës, u kanë shërbyer për të kuptuar që për disa pushteti nuk ka çmim, ose thënë më mirë, pushteti gjithmonë vlen më shumë se qytetari. Domethënë të qenit peng i pushtetit, ka lënë peng për tre vjet edhe qytetarin.

Dhe, tani kur penga u pushtetit po hiqet, u ka rënë në mend edhe për pengun e qytetarit, çfarë ironie, kështu do të ndodhë edhe me juve. Nuk jam sot këtu për të apostrofuat askënd, mos më keqkuptoni, jo as për poenë politike që në këtë rast, pra politikisht është rast i jashtëzakonshëm, përfitimi në secilin version mund të jetë dobësi politike, mungesë strategjie ose mund ta quani si të doni. Në fakt, Lidhja Demokratike e Kosovës përballë qytetarëve të Kosovës nuk ka kalkuluar asnjëherë, as në rrethanat kur pikërisht për qytetarin ka dorëzuar edhe pushtetin dhe jorastësisht sot përbën partinë më të madhe në Kuvendin e Kosovës dhe partinë numër një në vend. Nuk kam dalë po ashtu sot këtu para jush për të konstatuar dhe as kontestuar të dhënat shkencore të një linje kufitare të njohur tashmë. E kanë bërë ekspertët disa herë, bile e kanë thënë njëzëri të gjithë përfaqësuesit e të të gjitha vendeve mike, pa të cilat shtetësia jonë do të ishte e pabëshme.

Kam dalë sot këtu që sikur në të gjitha mësimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës që Kosovën e ka vënë historikisht mbi veten, t'u bëj thirrje të gjithë atyre që këtë gjë e kuptojnë drejt, që para qytetarit që sot pret shumë prej nesh, gjësë që na ka bërë me turp si jashtë, ashtu edhe brenda Kosovës, t'i japim përgjigje sot. Pra ta ratifikojmë marrëveshjen e demarkacionit. Ky nuk është vetëm detyrimi që ne e kemi si përfaqësues politikë të të zgjedhurve tanë, është më tepër se kaq. Është detyrimi për të dëshmuar shtetësinë tonë përballë atyre që na besuan për shtet dhe atyre që sot më nuk janë dhe bënë shumë për ne që sot ne të jemi këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

E konsideroj të nevojshme të konstatoj sot këtu dy gjëra: e para, në lidhje me këtë projektligj, ndërhyrjet nga jashtë që po ndodhin në punët tona si deputetë. Duhet të konstatojmë se projektligji që sot po trajtohet, nuk është projektligj i demarkacionit, por është projektligj i delimitacionit, pasi që me këtë ligj nuk po shënohet kufiri ekzistues në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, por në mes të dy vendeve të lartpërmendura ka ndodhur tërheqja e një vije të re të kufirit, pra në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, që për pasojë ka humbjen e 8 mijë e 200 hektarëve të tokës së Kosovës dhe tejkallim të kompetencave të Komisionit të parë shtetëror të Kosovës.

Po ashtu, është me rëndësi të konstatohet se deputetët e Kuvendit të Kosovës ka kohë që i janë ekspozuar një presioni të madh që do të ndikojë në përcaktimin e tyre karshi këtij projektligji sot. Shpesh kemi dëgjuar konstatimet se ky ose ai institucion është kapur ose kemi dëgjuar kërkesën të mos ndërhyjmë ose të mos diskutohet për punën e këtij ose atij institucioni të pavarur se mund ta cenoni pavarësinë e tij, se pushtetet janë të ndara, e kështu me radhë. Por, asnjëherë ne si deputetë nuk po reagojmë kur hapur po ndërhyhet nga jashtë në punët e Kuvendit të Kosovës si institucioni më i lartë në vend. Sa është i pavarur Kuvendi, mund të shihet pikërisht nga ndërhyrja në punët e Kuvendit që kanë të bëjnë edhe me këtë projektligj.

Marrëveshja me Malin e Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015, Projektligji për demarkacionin, që në të vërtetë është delimitacion, është përgatitur po atë vit. Tani jemi në vitin 2018, përgjatë tërë kësaj kohe ky projektligj është sjellë vetëm një herë në Kuvend dhe është tërhequr nga Qeveria, pa e futur në votim, për arsye se nuk ka pasur vota të mjaftueshme për ratifikim. Kanë kaluar 3-4 muaj që kur Qeveria Haradinaj e ka sjellë këtë projektligj në Kuvend, por i njëjti nuk është futur në rend të ditës për arsye se nuk janë siguruar votat e nevojshme për ta përmbushur synimin e Qeverisë. Kjo dëshmon se qeveria dhe ndërhyrësit e tjerë nuk e pranojnë qëndrimin e pandikuar të këtij Kuvendi, në këtë rast ata “jo”-në nuk e pranojnë si përgjigje. A mund të quhet i pavarur Kuvendi kur Qeveria vendos varësisht nga votat kur duhet ta sjellë një projektligj në Kuvend.

A është i pavarur Kuvendi që detyrohet ta përsërisë votimin e ligjeve të votuara që janë votuar ndryshe nga ajo që kanë dashur dirigjuesit e Kuvendit, siç pati ndodhur me Ligjin për Gjykatën Speciale. A është i pavarur Kuvendi kur krerët institucionalë, opinionistët e paguar dhe ambasadorët bëjnë presion publik mbi deputetët për të votuar sipas diktatit të tyre. A nuk është dirigjim i Kuvendit fakti që me muaj të tërë po llogariten votat dhe po bëhen përpjekje që ato të sigurohen me çdo kusht. Se ndërhyrja nga jashtë për demarkacionin është evidente, flasin edhe shembujt në vijim: deputetët e LDK-së dhe PDK-së që nuk e kanë përkrahur këtë formë të demarkacionit në mandatin e kaluar, si: Adem Salihu, Fatmir Rexhepi, Shpejtim Bulliqi, Shaip Muja e të tjerë, nuk janë futur në listat e kandidatëve për deputetë si dënim për mosdëgjueshmëri dhe mësim për ata që nuk u nënshtrohen kërkesave arbitrare të shefave të tyre partiakë në të ardhmen. A nuk është ndërhyrje devaluimi i të gjeturave të Komisionit të Bulliqit që asnjëherë nuk janë diskutuar në Kuvend, e që po trajtohen vetëm si materiale orientuese, pra po shfuqizohen për mashtrimin e opinionit.

A nuk është presion takimi i një nga një i deputetëve nga krerët e Qeverisë dhe Kuvendit dhe kërkesa e tyre që ata të votojnë sipas kërkesës së Qeverisë dhe të krerëve të tjerë qeveritarë? A nuk është ndërhyrje instrumentalizimi dhe involvimi i Akademisë së Shkencave, opinionistëve, mediave, aplikuesve për viza, e të tjerë, që çon në fajësimin e Kuvendit për këtë gjendje nga shkaktarët e gjendjes së krijuar? A nuk është presion kushtëzimi i liberalizimit të vizave si kusht për ratifikimin e demarkacionit? A nuk është ndikim në punën e deputetëve fajësimi i deputetëve për gjoja izolimin e vendit. Presioni mbi deputetët është bërë edhe përmes deklaratave të ambasadorëve për këtë çështje. Kërkesa e deputetit Nait Hasani për votim të fshehtë dëshmon qartë se deputetët nuk janë të lirë të votojnë sipas bindjeve të tyre. Arsyetimi se ratifikimi duhet të ndodhë si kusht për liberalizimin e vizave dhe se deklarata e presidentëve e mundëson korrigjimin e gabimeve, është dëshmi e mjaftueshme se marrëveshja është e padrejtë dhe e dëmshme për Kosovën. Shpjegimi se marrëveshja duhet të ratifikohet, e pastaj të korrigjohet, është përpjekje për ta arsyetuar ndryshimin e qëndrimit të deputetëve që e kanë kundërshtuar këtë marrëveshje, në të kaluarën, dhe përpjekje për t'i mashtruar qytetarët e Kosovës se gjoja korrigjimi do të ndodhë pas ratifikimit.

Sa i përket korigjimit, po jua përkujtoj vitin 2006 dhe Marrëveshjen për decentralizim, e cila ka pasur po ashtu, një pretim për korigjim, por kjo gjë kurrë nuk ka ardhur në shprehje dhe tash natyrisht, decentralizimi do të kalojë në “Zajednicë”, e që është një variant edhe më i keq. Votimi nën presion i një projektligji të rëndësishë së veçantë, siç është Projektligji për përcaktimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, nuk kontribuon në avancimin e marrëdhënieve të mira në mes të dy vendeve fqinje, përkundrazi është pengesë për kultivimin e marrëdhënieve të mira. Ndërhyrja në punët e Kuvendit nga jashtë nuk e ndihmon as Kuvendin, as vendin, prandaj i ftoj të gjithë ata që hapur ose fshehurazi po e diktojnë punën e Kuvendit, të heqin dorë nga kjo metodë e dëmshme për funksionimin demokratik të këtij institucioni.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pavarësisht ndërhyrjeve, joshjeve dhe presionit me të cilin ne po përballemi këto ditë, të mos harrojmë se deputetët do të mbahen në mend si kanë votuar sot dhe jo pse kanë votuar ashtu si kanë votuar. Në këtë situatë, ne si deputetë duhet ta kemi parasysh interesin e vendit dhe të votojmë në përputhje me këto interesa. Në jetë ka gabime që edhe mund të korigjohen dhe ka të atilla që kurrë nuk kemi mundësi t’i zhbëjmë. Vizat janë të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, por këmbimi i liberalizimit të vizave me faljen e tokës nuk është as e drejtë dhe as kompetencë jona, prandaj të votojmë për fqinjësi afatgjate me Malin e Zi, të votojmë për interesat e vendit duke votuar kundër kësaj marrëveshjeje të dëmshme për vendim. Zgjidhjet e imponuara nuk janë zgjidhje, prandaj ta kundërshtojmë këtë formë të padrejtë të caktimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Faleminderit!

KRYETARI: Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

E vërteta është që në mungesë të strategjisë për të gjetur tema dhe çështje, për të përmirësuar gjendjen e qytetarëve, si: temat e arsimit, shëndetësisë, ekonomisë, drejtësisë, ambientit dhe në paaftësi për të diskutuar për këto tema të rënda ndonjëherë që për përgatitjen profesionale janë tema goxha të vështira për t’i trajtuar, atëherë gjenden tema më të kapshme, tema më të lehta, siç është tema e territorit, tema e tradhtisë, e patriotëve dhe në këtë mënyrë, me këto tema tentohet që më lehtë të manipulohen masat.

Duke e parë që pushtetarët e sotshëm, një pjesë e tyre edhe opozitarët e djeshëm kanë gjetur që tema më e ndjeshme të shqiptarët e Kosovës është tema e territorit, sepse ky popull në vazhdimësi për 2 mijë vjet ka qenë popull që ka vuajtur për territor, ka qenë i struktur në një pjesë të Ballkanit dhe vazhdimisht ka humbur territor dhe, në këtë mënyrë, tema e territorit është parë si temë e lehtë dhe temë për të luajtur me emocionet dhe për të ardhur në pushtet. Por, pushteti doli që nuk është i lehtë dhe nuk kapërdihet kur t’i jepet një qeverisjeje, e cila merret me tema të sajuara dhe në këtë mënyrë ka ardhur deri te gjendja që qeverisja e tillë është një qeverisje e

dobët. Por, tani koha do të mbetet për të treguar se kush është tradhtar dhe kush do të jetë patriot, por një është e ditur, që Kosova tani është në nivelin më të ulët të pozitës së saj gjeostrategjike dhe në rrugën e integritit evropian është e fundit, është e fundit në të gjitha aspektet dhe jo vetëm në rrugën e integritit, por është e fundit edhe në zhvillimin ekonomik, me një papunësi të madhe, me një shkallë të korrupsionit dhe në aspektin e integritimeve evropiane nuk shihet asgjë që Kosova do të arrijë sadopak të përafrohet me vendet e rajonit, ndërsa ne e dimë se si popull jemi populli më proevropian dhe e dimë që historikisht, edhe nga koha e Presidentit Rugova, por edhe më vonë, vazhdimisht e kemi pasur temën e integritit evropian si strategji, rrugë e ardhmërisë tonë.

Tani këto tema të territorit po jepen si tema, edhe po ndryshohen në qëndrime, por tani ne duhet të shikojmë përpara dhe, në këtë mënyrë, ne nuk duhet të veprojmë nga ajo që është thënë dhe është vepruar në të kaluarën, sepse kryeministri Ramush Haradinaj vazhdimisht e ka cekur që kjo temë apo ky ligj duhet të rrëzohet në Kuvend dhe duhet të fillohet prej fillimit, edhe pse ne e dimë që një numër i madh i deputetëve të LDK-së, edhe në atë kohë kanë dhënë propozime të duhura për të dalë nga kriza dhe për të gjetur mënyra të korrektimit të marrëveshjes dhe gjetjes së zgjidhjeve që do ta përmirësonin këtë kufij, por kjo nuk ka ndodhur, sepse kryeministri i atëhershëm Ramush Haradinaj me çdo kusht ka dashur që ta rrëzojë këtë marrëveshje dhe përmes saj, ta dëmtojë qeverisjen e kaluar. Por, ne duhet që përkundër kësaj nga demarkacioni, por edhe tema të tjera të nxjerrë mësim gjithë klasa politike që kauza me çështje nacionale është e dëmshme dhe shpeshherë mund të kthehen si bumerang politik.

Kosova dhe interesi i qytetarëve të saj duhet të jetë prioritet dhe kjo kauzë duhet të na shërbejë që të mos shfrytëzojmë këto kriza edhe kur jemi në opozitë, por edhe në pozitë, në dëm të interesave të qytetarëve. Duke e përfunduar këtë ne duhet të bëjmë apel që të gjejmë konsensus për këto tema, duke përfshirë edhe konsensusin për demarkacionin, por në të njëjtën kohë, në këtë konsensus ne duhet ta përfshijmë edhe konsensusin për zgjedhje të parakohshme, sepse kjo qeveri nuk është e aftë për të menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme temat e mëdha dhe shumë tema, të cilat po rëndojnë në shpatullat e qytetarit. Faleminderit!

KRYETARI: Fitore Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të dashur qytetarë të Republikës,
Të nderuar deputetë,

Kosova ka ngecur prapa, korrupsioni dhe krimi i organizuar mbetet shumë i përhapur, drejtësia mbetet selektive si pasojë e ndërhyrjeve politike, liria e shtypit është gjithnjë në rënie, ndërsa zhgënjimi i qytetarëve ka arritur majat.

Këto fjali i gjeni në secilin raport për Kosovën, të njëjtat janë përsëritur çdo vit që nga shpallja e pavarësisë. Të njëjtat përsëriten edhe sot, sepse asnjëherë nuk keni pasur vullnetin që keni sot për

ta ndryshuar për të mirë këtë vend, siç e keni sot për të falur tokën. Para disa ditëve tre ekspertë të angazhuar nga Bashkimi Evropian që të bëjnë vlerësimin e kapaciteteve të Kosovës për të luftuar korrupsionin, kanë dorëzuar raportin e vlerësimit. Në këtë raport ata kanë konstatuar thjesht dhe qartë se Kosova nuk e ka luftuar korrupsionin dhe se as nuk e ka objektiv qendror që ta bëjë këtë. Dhe, kjo është arsyeja përse kjo Qeveri sot po e mban këtë raport larg vëmendjes së publikut. Kryeministri nuk është këtu, sepse dëshiroja t'i tregoja se kryeministri dhe Kabineti i tij reagon pas konferencës sonë se nuk ka raport të tillë.

Unë po e përsëris mesazhin tim që ta dëgjojë kryeministri, se po, kryeministër, ka raport të tillë dhe këtë raport e kanë Ministria e Integriteteve Evropiane dhe Ministria e Drejtësisë. Por, kryeministri mund të mos jetë i informuar, ngase këta dy ministra të PDK-së nuk i raportojnë kryeministrit, por Hashim Thaçit e Kadri Veselit. Kryeministri ka bërë shumë gabim nëse ende nuk e ka lexuar këtë raport dhe sot ishte këtu dhe na foli për mënyrën e përmbushjes së kushtit kryesor, pra luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, përderisa nuk e ka lexuar raportin, kryeministri nuk e ka as idenë se sa larg jemi në përmbushjen e kushtit kryesor. Atëherë, të nderuar deputetë, pse Kosova duhet të paguajë çmimin që nuk e paguan qytetarët e Serbisë, qytetarët e Shqipërisë, ata të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe qytetarët e Bosnjës, ata nuk dhanë tokë për viza, pse duhet të japim ne?

Të dashur qytetarë,

Kjo nuk përfundon këtu, pas demarkacionit do të dëgjoni po të njëjtat mashtrime dhe premtime për të bërë koncesionin e radhës, e mbase koncesioni i radhës do të jetë falja e pjesëve të tjera të territorit të Kosovës. Pra, do të ndodhë ashtu siç ndodhi me dialogun Kosovë-Serbi, përmes të cilit u bënë koncesione të dëmshme për Kosovën, ku përveç tjerash, Republika e Kosovës u reduktua në fusnotë, për të cilën na thanë se do të shkrihet si një flluskë bore, por ajo u fuqizua edhe më tepër. Na u tha se rruga jonë drejt integritetit evropian do të bëhet përmes dialogut Kosovë-Serbi, por nga ky dialog nuk përfituam asgjë, veçse ia hapëm rrugën Serbisë drejt integritetit dhe ia mbyllëm Kosovës. Kjo u pa nga strategjia e Bashkimit Evropian, sot pas shtatë vjetëve dialog, Kosova është pjesë e dokumentit që ka publikuar Komisioni Evropian, por nuk është pjesë e strategjisë së zgjerimit.

Kështu është edhe kjo puna e liberalizimit të vizave, po falim territorin dhe nuk do të fitojmë liberalizimin e vizave. Liberalizimi i vizave nuk është proces i thjeshtë, ky proces varet nga shtetet anëtare, të cilat me votat e tyre mund ta bllokojnë liberalizimin e vizave për Kosovën, edhe pas ratifikimit. Miratimi i liberalizimit të vizave varet kryesisht në përmbushjen e kushtit themelor, luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Por, jo vetëm vendimi i shteteve anëtare varet shumë edhe nga gjendja e rëndë ekonomike, nga papunësia dhe shkalla e lartë e migrimit. Sipas Gallup International, për vitin 2017, rreth 34% e popullsisë, po të kishin mundësi do të largoheshin menjëherë nga Kosova drejt Evropës. Pa dyshim, kjo do të përcaktojë edhe vendimin e shteteve anëtare. As ky kryeministër, as presidenti dhe as ju deputetë, që do ta votoni

këtë demarkacion, nuk mund t'u garantoni qytetarëve të Kosovës se vota e shteteve anëtare do të jetë për liberalizimin e vizave.

Nuk e kemi asnjë informatë të sigurt se cilat shtete anëtare do të na përkrahin. Një qeveri normale sot do t'i prezantonte statistikën se cilat vende e përkrahin liberalizimin dhe cilat jo.

Qytetarë të Republikës,

Janë bërë shumë pazare për interesat e qeveritarëve të korruptuar, e në kurriz të këtij vendi. Liberalizimin duhet ta kemi edhe në sikur të gjitha vendet e rajonit, por jo duke e shkëmbyer atë me territorin tonë dhe me burimet tona ujore e me pikat strategjike të vendit. Liberalizimin duhet ta marrim, por edhe mund të na e ndalojnë në momentin kur shteteve evropiane u paraqiten interesat tjera, pra siç u pa edhe dje kur ministri për Punë të Brendshme të Gjermanisë kërkoi suspendimin e Marrëveshjes së Shengenit.

Tokën që po e falim nuk do të mund ta kthejmë më.

Të nderuar deputetë,

Ju e dini shumë mirë se liberalizimi i vizave nuk do të ndodhë edhe pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje. Nuk do të ndodhë as nesër, e as pas një muaji dhe se nuk do të ketë liberalizim të vizave as gjatë këtij viti. Prandaj, pse po nguteni? Ne kemi kohë ta shqyrtojmë mirë dhe drejt Marrëveshjen me Malin e Zi nga fillimi. Kemi kohë që së pari t'i përmirësojmë gabimet e bëra, e pastaj ta ratifikojmë. I gjithë ky nxitim nuk po bëhet për qytetarët dhe për liberalizimin e vizave. Ky nxitim dhe ky presion po bëhet për interesat e presidentit, në vallen e të cilit është bashkuar edhe kryeministri.

E gjithë kjo po bëhet për ta shpëtuar nga dënimi për tradhti kombëtare, që mund të marrë presidenti për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, e cila e cenon integritetin territorial të vendit.

Të nderuar deputetë,

Të përkujtojmë se u betuam që në këtë Kuvend ta përfaqësojmë popullin me dinjitet, të punojmë në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, të angazhohemi për mbrojtjen dhe për respektin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, të angazhohemi për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të vendit.

Sot, ne deputetët e Kuvendit të Kosovës e kemi në duart tona të votojmë ashtu siç na obligon Kushtetuta, kundër kësaj marrëveshjeje, për mbrojtjen e territorit, për mbrojtjen e burimeve tona ujore dhe të pikave strategjike të vendit.

Pra, të votojmë në interesin më të mirë të Republikës e të qytetarëve. Të votojmë kundër kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Fidan Rekaliu e ka fjalën, pastaj Nait Hasani.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë,

Qeveria e drejtuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës ikishte përfunduar të gjitha kriteret për liberalizim të vizave në vitin 2016. Kishte nxitur përgatitjet edhe për kriterin e fundit, atë të shënimit të kufirit me Malin e Zi, ku në prag të përfundimit të procesit partitë opozitare, të udhëhequra nga inatet për dështimet në realizimin e egrove personale për pushtet e pozita të larta shtetërore, u bashkuan me grupime populliste, që e kontestuan çdo të arritur të Republikës së Kosovës.

Ata artificialisht dhe vetëm që ta pengonin punën dhe aktivitetin e Qeverisë e tensionuan ekstremisht situatën politike në vend, manipuluan me ndjenjat e qytetarëve duke i trembur e shqetësuar, ushtruan dhunë në institucione e jashtë tyre, duke e shkatërruar imazhin e vendit, shpërfillën argumentet e porositë dashamirëse të partnerit e mikut më të madh të shqiptarëve, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian. Gati se e shndërruan Kosovën, nga kontribuuese për paqe, stabilitet dhe siguri në Ballkan, në një vend që shihet si shkaktar artificial i problemeve.

Kështu, ata, pavëmendshëm i ndihmuan efektit të ndërhyrjes së faktorëve destruktivë në Ballkan, e rënduan shpresën, besimin dhe optimizmin e të rinjve të Kosovës.

Më e rënda dhe më e dhembshmja nuk janë pengesat jopolitike, joparimore dhe jokushtetuese që e nxorën qeverisjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse ne shpejt do të kthehemi në pushtet, por izolimi i padrejtë i qytetarëve, i të rinjve, studentëve, sportistëve, artistëve, biznesmenëve e të tjerëve. Ata e izoluan për interesa të ngushta, u sakrifikuan aq shumë të rinj e të reja, që dikush të realizonte hakmarrje primitive politike.

Qeveria Mustafa në shumë raste kishte ofruar bashkëpunim, kooperim dhe bashkëbisedim me këdo që kishte dilema. Ai madje kishte propozuar në Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes me Malin e Zi nenin 7, po e përsëris edhe një herë - nenin 7 të projektligjit, i cili e obligonte Republikën e Kosovës që të kërkonte rihapje të diskutimeve me Malin e Zi në rast të fakteve të reja lidhur me ndonjë lëshim eventual, e kjo është saktësisht ajo çfarë krerët e institucioneve po provojnë t'ua shesin qytetarëve të vendit.

Pra, këtyre ditëve, pa fije turpi, nga Qeveria e Kosovës u kumtua “Urime Kosovë!” për një marrëveshje në germë e në frymë të proceduar nga Isa Mustafa më 2016. Ky standard i sjelljes politike nuk do të mund të kalojë pa u ndëshkuar nga qytetarët. Ata s’duhet ta lejojnë asnjë politikan të guxojë të tallet në këtë mënyrë me fatin dhe perspektivën e tyre. Me këtë rast, u bëj

thirrje të gjithë atyre që të marrin guximin intelektual, që të kërkojnë falje për qasjen e tyre të gabuar, e cila u ka sjellë shumë dëme qytetarëve të vendit.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të jetë gjithmonë e qëndrueshme në interes të vendit, duke marrë vendimet e duhura për qytetarët dhe rininë evropiane të Kosovës, pa mashtrime, pa pazare e kalkulime të pushtetit si qëllim më vete.

Për fund, dua të konfirmoj edhe një herë votën time në përputhje të plotë me qëndrimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pro kësaj marrëveshjeje, e cila e mbyll një dramë të madhe, në të cilën viktimë ishin qytetarët e Kosovës.

Do të votoj pa dyshim për të rinjtë e Kosovës, të cilët kanë mbetur padrejtësisht të izoluar nga pjesa tjetër e Evropës. Qytetarët, sidomos të rinjtë, e meritojnë një politikë serioze e të përgjegjshme nga të gjithë ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani e ka fjalën, ndërkohë të bëhet gati Arbër Rexhaj.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kolegët!

Përshëndetje ministër!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Është një thënie e moçme e Martin Luther Kingut, që thotë, “unë e kam një ëndërr se një ditë ky komb do të ngrihet dhe do të jetojë në kuptimin e vërtetë të besimit të tij”. Me këtë, edhe ne mendojmë se këto të vërteta janë të vetëkuptueshme, se të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë.

Shekujt qenë plot histori e dhembshme për popullin tonë, për shqiptarët. Kanë qenë luftëra të përgjakshme, humbje në njerëz dhe territore. Asnjëherë deri më sot nuk janë marrë vendime institucionale. Janë marrë vendime nga bajraktarë fisesh, nga kryetarë partish, duke rrahur gjoksin për trimëri, e duke e humbur për çdo ditë hapin me kohë për ta krijuar shtetin shqiptar një herë, po nuk patëm krahë politikë dhe miq. Klasa jonë politike sot është klasë në politika ditore, pa strategji dhe e nënshtruar për shkak të hipotekave politike.

Ka gati tre vjet që po diskutohet për çështjen e demarkacionit. Kushti i Bashkimit Evropian për ta miratuar demarkacionin si kusht për liberalizim të vizave, pa të drejtë është një kusht politik që e ka dëmtuar Kosovën.

Demarkacioni duhet të jetë vullnet për marrëdhënie të mira fqinjësore ndërmjet shteteve, e jo në krijimin e situatave politike të pakëndshme. Të dhënat tregojnë se Kosova po humb territor. Këtë e dëshmojnë raporte të ndryshme shtetërore. Demarkacioni tashmë nuk po del si çështje

shtetërore, si çështje që do zgjidhje, por si përfitim partiak. Te qytetarët është krijuar presioni publik nëpërmjet deklaratave politike të ambasadorëve, analistëve politikë dhe portaleve gazetareske e OJQ-ve që janë një mori e plotë, që me veprimtarinë e tyre plot janë të dyshimta.

Marrëveshja politike për demarkacionin, që u arrit ndërmejt presidentëve, e tregon një mundësi korrektimi, por që në thelb tregon se ka shkelje dhe humbje të territorit. Kjo nuk e zgjidh çështjen. Kjo e tregon mundësinë e korrektimit. Unë deri më tash kam marrë mesazhe të ndryshme, nga njerëz të ndryshëm, për dhe kundër demarkacionit. Një pjesë e tyre kanë bërë presion për t'u hyrë në qejf kryetarëve, ndërsa pjesa tjetër tregon se humbim territore. Edhe njëra, edhe tjetra kanë të drejtë, sepse klasa politike ka luajtur me mendjemadhësi me pushtetin dhe ajo e ka krijuar këtë gjendje.

Çështjet shtetërore me interes për vendin duhet të kenë konsensus dhe unitet politik, e jo këso konfliktesh politike. Kuvendi ka mundësi të bëjë veprimin politik dhe të gjejë konsensus.

Logjika e sotme politike tregon se Kosova është në krizë të identitetit shtetëror dhe të partneritetit politik me miqtë ndërkombëtarë. Sot Kosova është e nënshtuar politikisht dhe nuk ka politikë të veten, por politikë gazetareske, të portaleve, dhe e bën duke u gjuajtur me kunja. Ne me këso politike e kemi edhe Asociacionin, me këso politike e kemi edhe Gjykatën Speciale, me këso politike nuk do të jemi asnjëherë partnerë me miqtë tanë, por shërbyes socialë kundër interesit të shtetit të Kosovës. Kosova ka nevojë për liberalizim të vizave, ka nevojë për sundim të ligjit, ka nevojë për shtet ligjor, e jo për shtet ku "shteti jam unë", siç ka thënë Luigji 15.

Kosova ka nevojë për zhvillim ekonomik. Me demarkacionin nuk ka zhvillim ekonomik. As me liberalizim. Me liberalizim ka vetëm edhe një varfëri ekonomike. Miqtë tanë nuk po e ndihmojnë Kosovën me këtë formë të presionit. Ata duhet ta ndihmojnë ekonomikisht, me zhvillim ekonomik, që rinia të jetë këtu, të punojë këtu. Mjerimi politik i klasës politike dhe intelektuale është mjerim politik, që do ta gjykojë koha.

Unë nuk pajtohem me demarkacionin, por do të jem në shërbim të qytetarëve dhe të votuesve të mi, që të kenë një jetë më të mirë në vendin e tyre për shtetin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, në natyrën time nuk është replika, por para se të filloj po dua pak t'i them disa gjëra që i përmendi deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj.

Unë e kam përcjellë disa herë Dritonin, kur është ballafaquar me PDK-në dhe përherë e kam parë se e ka humbur debatin dhe është paluar me plotkuptimin e fjalës para PDK-së. Mirëpo, që

Dritoni e sheh si frikë, ankth makabër Lëvizjen “Vetëvendosje” në rrugëtimin e saj dhe frikohet prej Lëvizjes “Vetëvendosje”, këtë sot e mësova, sepse atë po e sheh si plëngprishës në kuptimin politik për të ardhmen e tij, për të ardhmen e partisë së vet dhe për “të ardhmen” të shtetit, siç po e quan ai. E, në ndërkohë po harron që pikërisht Qeveria e kaluar, e përbërë prej LDK-së në krye, ishte pra ajo Qeveri, e cila e solli këtë lloj, këtë tip të demarkacionit, po ashtu edhe “Zajednicën”, të cilën e rrëzoi Gjykata Kushtetuese në shumësi të pikave të saj.

Prandaj, është mirë pra që Dritoni të merret më shumë e të fitojë guxim me PDK-në, sesa me “Vetëvendosjen”, sepse ashtu-kështu e ka edhe shumë problem me ne.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Si deputet i Republikës së Kosovës, në këtë moment para meje, njëkohësisht para nesh, ekziston një situatë kur një përfaqësues e pyet veten, cili është kuptimi i institucionit të Kuvendit, si i tillë? Çfarë do të thotë të jesh deputet i kësaj legjislature, kur para teje, në mënyrë flagrante po na e përplasim në fytyrë një tekst që buron nga një marrëveshje, për të cilën, për shembull, profesor Martin Berisha nga Komisioni Shtetëror thotë se nga kjo marrëveshje humbim 82 km²”, e të cilët janë njësoj si rruga prej Prishtinës në Pejë në 1 km gjerësi.

Njëjtë sa dy territore të shtetit të Vatikanit. Kjo situatë na bën përgjegjës individualisht secilin për votën tonë dhe kolektivisht, po ashtu.

Vota jonë sot ka peshën më të rëndë. Ajo peshon sa 8 200 hektarë të Kosovës, që po duan patjetër të na i heqin padrejtësisht. Vota e secilit sot, të atyre që po thonë se janë pro marrëveshjes së 16 gushtit 2015 do të thotë dhënie e territorit të Kosovës Malit të Zi në kohë paqeje dhe legjitimim i tradhtisë kombëtare të presidentit Hashim Thaçi, i cili dy herë e ka nënshkruar të njëjtën çështje dhe të njëjtën gjë. Kështu, secili mund ta njollojë veten në përhershmeri me historinë, e cila do të shkruajë për ditën e sotme.

Vota kundër e vendos para drejtësisë edhe më shpejt pikërisht Hashim Thaçin dhe, mbi të gjitha, e mbron territorin dhe sovranitetin e Kosovës, të cilat pikërisht Thaçi dhe të tijtë po i shkel sa herë po i lipset për ta shpëtuar veten. Zgjedhja është në duart tona, një buton, kaq afër, por me peshë dhe përgjegjësi të lartë. Ne e kuptojmë shqetësimin e qytetarëve për izolimin e tyre, varfërinë e cila e ka pllakosur shoqërinë tonë si pasojë e qeverive të kaluara dhe nga kjo ekzistuese, e cila nuk ka as alternativë dhe as zgjidhje për zhvillim ekonomik. Sot, po të kalojë ky demarkim i padrejtë, qytetarët do ta shohin shumë shpejt mashtrimin e kësaj Qeverie, e edhe të këtij presidenti, sepse ky ratifikim i padrejtë nuk e sjell liberalizimin e vizave. Thaçi po mashtron për të njëqindtën herë. Pse duhet t’i besojmë? Drejtësia do të duhej që në mënyrë efektive të tregojë gatishmëri që ta luftonte korrupsionin dhe kriminalitetin në vend me dënime efektive të rrjetit të krimit të organizuar, që lidhjet i ka drejt e te shumica e këtyre që i kemi përballë, e ne këtu anash.

Pa e bërë këtë, nuk ka liberalizim vizash. Prandaj, kjo vijë e re demarkimi me këtë aneks shfajësues përbën kufij të rinj. E si i tillë, ky veprim përbën cenim të integritetit territorial të vendit, duke e dëmtuar Kosovën për 8 200 hektarë. Marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi është e papranueshme, pasi ajo është e pasaktë dhe e padrejtë. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi po keqinterpretohet si çmim për liberalizimin e vizave, por e vërteta është se ka ende shumë procedura të brendshme në Bashkimin Evropian për liberalizimin e vizave: Komisioni Evropian, pastaj Këshilli i Bashkimit Evropian, pastaj Parlamenti Evropian, pastaj ministrat e Drejtësisë dhe të Brendshëm të vendeve anëtare.

Asnjë shpjegim zyrtar dhe të besueshëm nuk kemi nga Qeveria e Kosovës, nga ministrat përkatës, apo edhe nga presidenti, se ku dhe si qëndrojnë shtetet anëtare të BE-së në raport me votën që nevojitet në Parlamentin Evropian për rastin e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Këtu po na paraqesin veç qëndrime të mjegullta, të paqarta e, mbi të gjitha, të pabesueshme për një institucion më tepër me shumë struktura, si Komisioni Evropian, për shembull, pa na thënë se si dhe kur plotësohen, apo vërtetohen të arriturat për krim të organizuar e korrupsion. Pse po nxitoni? Pse?

Na thoni zyrtarisht dhe me argumente. Liberalizimi nuk do të vijë këtë të premte, as javën e ardhshme, as muajin e ardhshëm, e as në stinën e ardhshme. Pse pra ka kaq nxitim? Deklarata Thaçi-Vujanoviq nuk sjell gjë të re. Thaçi e ka nënshkruar dy herë të njëjtën çështje dhe të njëjtën gjë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta votojë ratifikimin e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Ky është një ratifikim i një kufiri të ri, të padrejtë, në vazhden e plot kufijve të padrejtë që na i kanë imponuar me pushtim e me luftë. Para nesh, si shqiptarë, si deputetë, si qytetarë të Kosovës, po vihet sërish marrëveshja që Kosovës i merr 8 200 hektarë tokë, pra Liqenatin, ose Bjelluhën, Kullën e Zhlebit dhe Çakorrin.

Sot Astrit Dehari nuk është në mes nesh si shprehje e dhunës më ekstreme që shteti përdori kundër “Vetëvendosjes” për ta zmbarsur nga kundërshtimi i marrëveshjes së dëmshme të demarkacionit. 21 vjet burg u dhanë arbitrarisht për 4 aktivistë tanë, vetëm pse ishin nga lëvizja që e kundërshtonte demarkacionin.

Letra e re me përmbajtje të vjetër, të nënshkruar nga Thaçi, përbën akt tradhtie në kuptimin ligjor e formal referuar Kodit Penal të Kosovës. Mbështetur në konkluzionet e Komisionit Shtetëror për kufirin, drejtuar nga profesor Bulliqi, Marrëveshja e 26 gushtit 2015 rrjedhimisht edhe deklarata e 16 shkurtit 2018 Thaçi-Vujanoviq, përbëjnë cenim të territorit të Republikës së Kosovës në të paktën 78 pika koordinatave. Ajo marrëveshje ka tentuar të vendosë kufij të rinj ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Cilido deputet apo deputete që e gjen si alibi këtë deklaratë të

Thaçit për ta ndërruar votën për demarkacionin, konsumon njëjtë si Hashim Thaçi për veprën e rëndë të cenimit të territorit.

AAK-ja dhe “Nisma”, deputetët e tjerë nuk mund të fshihen pas letrës së Thaçit. Kush ia dha Fatmir Limës autorizimet sipas Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare për të negociuar me Malin e Zi? Kush? Ministria e Punëve të Jashtme, kryeministri apo Hashim Thaçi? Ka shumë rëndësi përgjigjja në këtë pyetje. Ku janë shënimet për ato takime? A janë paraqitur koordinatat që e vendosin në vend kufirin e Kosovës? Pse nuk janë koordinatat te letra Thaçi-Vujanoviq, por vetëm në drejtim të kujt? Ç’janë këto dokumente që përcaktojnë vijë kufiri, e nuk paraqiten në koordinata? Ku është adresa në drejtim të Çakorrit, në lindje, në perëndim, në çfarë gjerësie?

Në mos tjetër, gjë më e rëndë, letra Thaçi-Vujanoviq, është një maskaradë e pakapërcyeshme. Nuk ka ratifikim pa korrigjim, pa ndryshim të marrëveshjes bazë, përndryshe ju secili, Limaj, Haradinaj, bashkëprotestues të tre vjetëve të shkuara, e keni marrë emrin e Thaçit në fytyrat tuaja. Ne, por edhe Kosova, nuk patëm nevojë ta klonojmë Hashim Thaçin, as të bëmat e tij për Kosovën. Je dorëzuar Ramush Haradinaj. Posti pa dinjitet nuk të duhet ty, as mbiemrit tënd. Je dorëzuar, pra kryeministër! Qeveritë vijnë e shkojnë dhe vetëm e përhershme mbetet Kosova.

KRYETARI: Driton Selmanaj ka replikë. I është përmendur emri.

DRITON SELMANAJ: Madje, disa herë...

Në fakt, zoti Rexhaj, kam përshtypjen që s’më ke dëgjuar. Unë nuk kam thënë që po keni frikë, kam thënë se mesazhi tek njerëzit mund të bartet kështu. Përkundrazi, unë kam thënë se ky është emancipim, ky është maturim, kjo është pjekuri çfarë po bëni ju sot. Por, kam thënë mesazhin që e bartni jashtë, sikur duket se keni frikë.

Tjetra? Në kontekst të raportit tim me PDK-në, më beso prej themelimit tuaj si “Vetëvendosje” dhe deri sot, gjithmonë kam pasur vështirësi të ju dalloj se çka jeni ju, e çka është PDK-ja. Gjithmonë më keni dalë si njësoj. E, në fakt, tash kur po e shoh edhe kontributin dhe rolin tuaj, po them kështu: Nëse PDK-ja është në kontekstin e shkatërruesit të këtij vendi, të së kaluarës dhe të tashmes, ju jeni shkatërrues e të tashmes dhe të së ardhmes. Prandaj besoni, pak keni dallim!

Nëse mendon që dikur më ka “paluar” mua. More, mund të “paloheni” ju krejt të tjerët, por e keni pak vështirë, besomëni!

KRYETARI: Kundër-replikë, Arbër Rexhaj! Mos reagoni kur përmendet partia, nuk ju jap për replikë.

ARBËR REXHAJ: Driton, unë të mirëkuptoj, sepse këtu janë 120 deputetë, domethënë të gjithë janë kanë qenë të pranishëm kur ti je “paluar” përherë para PDK-së, ndërsa “Vetëvendosja”

asnjëherë. Ndërsa, sa u përket relacioneve se si dukemi ne në publik, ato i ka përcaktuar vota e qytetarëve, e cila e ka nxjerrë subjektin e Lëvizjes “Vetëvendosjes” të parën në zgjedhje parlamentare dhe fituese në disa komuna.

Në aspektin e asaj se sa kemi ngjashmëri me subjektet tjera politike, po shihet këtu, sepse vetëm Lëvizja “Vetëvendosje” është kundër demarkacionit, sepse e shohim si të tillë të dëmshëm edhe si cenim të territorit e sovranitetit të Kosovës, madje unë dua ta bëj një pyetje: Unë nuk jam me LDK-në dhe me Rugovën, por nëse ti je me Rugovën, Rugova ka thënë që ky version i demarkacionit është gabim. Tash, a je ti me Rugovën a je me PDK-në?

KRYETARI. Në qoftë se është gati, Arban, e dëshiron fjalën? Ju kisha lutur, ka edhe reagime nga PDK-ja, Driton, a e përmende Albulenën? Albulenën s’e ke përmendur me emër. Arban Abrashi e ka fjalën.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës, të cilët për s’di të satën herë po e përcjellin të njëjtin debat, të njëjtën temë, pikërisht për të njëjtën marrëveshje të cilën LDK-ja e ka dërgua në Parlament para disa vjetësh. Prandaj, kërkoj ndjesë edhe për këtë zhurmë, të cilën e kemi shkaktuar për ju tani.

Dua të theksoj disa çështje, të cilat janë ngritur në seancë. Dua të përmend se në këtë seancë nuk po flasim vetëm për lirinë e lëvizjes së qytetarëve, realisht në këtë seancë po vendosim edhe për vendosjen e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës, prandaj kjo ka një vlerë të shtuar në këtë marrëveshje.

Të gjithë ata që thonë se LDK-ja nuk duhet të votojë për shkak se kjo Qeveri, ose ky koalicion e ka rrëzuar LDK-në nga Qeveria, ne mendojmë se veprimi dhe mendimi i tyre bazohet në inate dhe në kalkulime për pushtet, dhe kjo e bën dallimin me LDK-në.

Është e vërtetë që neve na kanë rrëzuar për një kauzë fiktive dhe ne mendojmë që kjo është gabim dhe nuk dëshirojmë ta bëjmë të njëjtin gabim. Pra, nuk do t’i lëmë qytetarët e Kosovës pa integrim evropian vetëm për t’iu hakmarrë atyre që sot janë në pushtet.

Qytetarët e Kosovës e vlerësojnë vetë punën e Qeverisë së Kosovës dhe besoj që ka material të mjaftueshëm për të vlerësuar punën e tyre.

Unë mendoj që kjo Qeveri nuk duhet të qëndrojë edhe as një minutë, por ne nuk do ta shfrytëzojmë këtë rast për ta rrëzuar Qeverinë, sepse më shumë se ardhja në pushtet, më shumë kanë rëndësi interesat e qytetarëve, sikurse lëvizja e lirë si dhe caktimi i kufijve të Republikës së Kosovës.

Pra, ne do ta lëmë anash inatin dhe kalkulimet, sepse LDK-ja është parti, e cila vepron për interesat e qytetarëve.

E dyta, LDK-ja gjithashtu ka qenë në favor të kësaj marrëveshjeje, edhe kur ka qenë në pushtet dhe nuk kemi pse ta ndërrojmë mendjen edhe tani.

Siç përmenda edhe më herët, ne jemi në shërbim të qytetarëve, sepse e kemi marrë votën nga ata, ne nuk do t'i lëmë peng qytetarët për interesat tona personale.

LDK-ja është konsistencë në vendimet e saj, nuk mban inat, nuk është hakmarrëse, nuk është kalkuluere.

Ne do të jemi deri në fund në mbrojtjen e interesave të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Debati që po e mbajmë sonte, sado në orët e vona, është edhe i vonuar, dy herë pra i vonuar, sepse kemi mundur ta thërrasim ditën dhe tërë ditën të diskutojmë më lirshëm dhe në fund të merremi vesh.

Ky debat jo vetëm pse është i vonuar tre vjet, por ai njëherësh po ndodh mbas shumë ndodhivë që infektuan politikën e vendit tonë, që i dhanë një pasqyrë jo të mirë shtetit tonë të ri para qytetarëve tanë, edhe ashtu të traumatizuar nga lufta, me pasoja të sindromit post-traumatik, por edhe të cilët pritnin shumë nga politikanët, sidomos politikanët e rinj. Gjithashtu na dëmtuan shumë në opinionin ndërkombëtar dhe në relacion me ata që na përkrahën në liri dhe në ndërtimin e shtetit tonë të ri.

Shkaku ishte marrëveshja për demarkacion e vitit 2015 me Malin e Zi dhe ratifikimi i kësaj marrëveshjeje në Kuvendin e Kosovës.

Në raportin e Komisionit shtetëror për demarkacionin kishim disa arsyetime, të cilat natyrisht që na sjellin edhe dilema, do t'i përmend disa.

Anëtarët e këtij komisioni arsyetoheshin se ishte shkaku gjeografik dhe i terrenit të vështirë që Kosova për një arsye ose tjetër mori territor nga Mali i Zi, por në anën tjetër, ajo i dha territor Malit të Zi, siç ishte rasti i Çakorrit dhe Kullës.

Pikat që janë shumë strategjike dhe të rëndësishme, e ato po na sjellin këtë dilemë.

Është punuar me kadastër, në rregull, por me cilën kadastër, kadastrën e cilës kohë, kur u dhanë këto dëshmi kadastrale personave në fjalë.

A kishin kadastër edhe për kodrat e Malit të Zi që iu ndanë Kosovës, a kishin kadastër personat në fjalë edhe për liqenet, edhe për lumenjtë, këto janë dilema që edhe unë personalisht i pata dhe kisha nevojë të zhvillonim biseda njëri me tjetrin, pa marrë parasysh dallimet partiake që të dëgjojmë argumentet dhe të kemi një arsyetim më adekuat.

Por situata në Kuvend nuk ishte e tillë, atmosfera me gaz e lotsjellës nuk e mundësonte debatin, bisedimet dhe ballafaqimin, ndodhi edhe ballafaqimi i dy komisioneve, por sikur dilemat prapë ishin në të njëjtën frymë.

Gjatë vitit 2015 me Komisionin për Shëndetësi, në cilësinë e kryetares së komisionit vizitua Malin e Zi dhe u takuam me deputetet e Malit të Zi, të komisionit adekuat, por edhe të komisioneve të tjera dhe me struktura të tjera të rëndësishme të Kuvendit të Malit të Zi.

Personalisht shtrova çështjen e demarkacionit dhe atmosferën e pakënaqshme në Kuvendin e Kosovës, kur ende s'kishim dhënë as mendimin tonë, që do të thotë kërkesa ime ishte që edhe Mali i Zi ta shtynte marrjen e vendimit derisa ne të qetësoheshim, po ne nuk qetësoheshim dot dhe kjo është e keqja.

Për këto çështje kisha të drejtë, pse kisha të drejtë të jem e zëshme në Parlamentin e Malit të Zi, sepse kam qenë njëra ndër lobueset për pavarësinë e Malit të Zi dhe për këtë arsye i dhashë vetit të drejtën të flas për këtë çështje.

Hasa në mirëkuptim dhe kjo nuk ishte befasi imja, por ishte një kënaqësi që Mali i Zi e kuptonte situatën në Kosovë dhe pas kësaj i njoftova strukturat politike të partisë time, por edhe ato në pushtet. Pasuan bisedimet mes strukturave të shtetit dhe përfunduan e ngecën në Shkodër.

Unë më tepër nuk dua të them, se edhe nuk di më tepër pse ngecëm në Shkodër, kush ishte shkaku, ndoshta dikush nga ju e di.

Por sot më vjen mirë që ekziston deklarata mes dy presidentëve, në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, ku jepet mundësia shtesë e nënvizuar në pikat 7, 8 dhe 11 që janë pika diskutabile në demarkacionin me Malin e Zi.

Besoj shumë në korrigjimin e këtyre pikave, të cilat na sollën kaq shumë telashe, besoj se gabimet do të përmirësohen dhe të korrigjohen në bazë të argumenteve tona, në grupet punuese të besueshme dhe profesionale që do t'i zgjedhim ne.

Kjo varet nga ne dhe në bazë të këtyre argumenteve, besoj që edhe do të arrijmë të japim një përgjigje shumë adekuate.

Por, në ndërkohë ne duhet të vazhdojmë ecjen më tutje, të mos stagnojmë, sepse nuk kemi mjaft kohë dhe nuk kemi as të drejtë para qytetarëve tanë që të ngecim edhe më tutje.

Duhet të kemi më shumë guxim në vendimmarrje dhe në marrjen e përgjegjësisë.

Kur është në pyetje Kosova dhe kur janë në pyetje qytetarët tanë, ne duhet të ecim më shpejt, sepse edhe ashtu jemi të vonuar në integrimet evropiane, jemi të vonuar në zhvillimin ekonomik dhe në shumë lëmenj të tjerë.

Kjo situatë, pra, na ka stagnuar më tepër, kjo situatë më kujton një moment shumë të rëndësishëm dhe të ngjashëm, në marrjen e vendimeve të rëndësishme për vendin tonë. Kohën e marrëveshjes së Rambujesë, dilema të shumta kur ushtarët e UÇK-së në zona të ndryshme kishin se është vendim i duhur apo jo, por në fund konsensusi dhe marrja e vendimit unanim doli se ishte zgjidhja.

Dilemat politike, qoftë edhe në këtë Kuvend, zvogëlojnë fuqinë vendimmarrëse të lidërshipt tonë, e zvogëlojnë fuqinë e bisedimeve dhe në takime ndërkombëtare, madje edhe japin një pasqyrë jo të mirë për shtetin tonë të ri. Por, kjo situatë njëherësh është një vërejtje shumë e fortë për lidërshiptin tonë që, për mungesën e transparencës dhe përgjegjësisë që duhet të ketë ai para nesh, si Kuvend i Kosovës, por edhe para qytetarëve.

Transparenca dhe bisedimet janë rruga dhe arma e demokracisë. Edhe kur nuk pajtohemi, sepse fyerja, dhuna dhe qëndrimi i palëkundur nuk është zgjidhja.

Ne duhet të merremi vesh dhe ta gjejmë konsensusin, kjo në rend të parë jo vetëm për shkaqe politike, por edhe për shkak të zhvillimit tonë ekonomik, kulturor, arsimor dhe në përgjithësi për integrimin tonë kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të jemi më seriozë, më aktivë dhe më të sigurt kur marrim vendime.

Ne na presin aq e aq detyra të tjera shumë të rëndësishme në të mirë të Kosovës dhe në të mirë që qytetarëve tanë.

Unë pres një unifikim politik në marrjen e vendimit shumë të rëndësishëm që po e diskutojmë.

Presim ngritjen e vetëdijes për domosdoshmërinë e një konsensusin nacional, për të cilën një shumicë e diskutuesve, për interesin e madh dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve tanë të Kosovës. Kjo strategji na është e domosdoshme, na duhet dhe ne duhet ta bëjmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj e ka fjalën, të bëhet gati Xhelal Sveçla.

RASIM SELMANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Po thuhet e u fol sot se Kosova i humbi tre vjet, ky vlerësim nuk qëndron, sepse kemi arritur një momentum të ri, pra një version të ri të ligjit me tri pika.

Pika 1.1. Marrëveshja e vitit 2015, tashmë e njohur si versioni Meha.

Pika 1.2. Të gjeturat e Komisionit shtetëror të zotit Bulliqi që konstaton gabimet e versionit Meha, dhe

Pika 1.3. Deklarata e dy presidentëve, atij të Malit të Zi dhe të Republikës së Kosovës.

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, tani presidenti Thaçi, thoshte se versioni Meha është në rregull.

Më vjen mirë që edhe zoti Thaçi është bindur dhe e ka kuptuar se versioni i zotit Meha ka gabime.

Ka nënshkruar deklaratën me presidentit e Malit të Zi, që trupi i përbashkët punues në mënyrë specifike do të rishikojë dhe do të korrektojë sektorët në drejtim të Çakorrit dhe Kullës së Zhlepit.

Marrëveshja e re e integruar në këtë projektligj dallon skajshmërisht me marrëveshjen e vitit 2015.

Ishte kundërshtimi opozitar që arriti të krijojë argumente të mjaftueshme që të kemi një deklaratë të përbashkët të dy presidentëve, ku shprehet gatishmëria dhe vullneti politik për të korrigjuar kufirin në drejtim të Çakorrit dhe Kullës së Zhlepit.

Pas nënshkrimit, të nesërmen presidentin Vuçanović në Mal të Zi do ta akuzonin për tradhti. Ne e mbajmë në mend po ashtu kur Mali i Zi thoshte se për ne demarkacioni me Kosovën është çështje e kryer. Pra, ja që edhe Mali i Zi ka ndryshuar qëndrim dhe shpreh gatishmërinë që të korrektojë gabimet që kanë ndodhur në versionin Meha.

Arsyeja pse unë besoj në korrektim dhe korrigjim është se brenda ligjit është raporti i Bulliqit dhe vullneti politik i konfirmuar nga Mali i Zi dhe Kosova.

Kosova tani ka një bazë juridike dhe politike për ta korigjuar kufirin në drejtim të Kullës dhe Çakorrit. U tha sot se një herë të korigjohen gabimet, e pastaj të votohet. Pra, ndërrim në hapa e në veprime.

Deshëm apo nuk deshëm të pranojmë, Kosova ka gabuar në hapa. Është ngutur me temën e demarkacionit dhe tani jemi këtu ku jemi.

Kosova sot ka dy mundësi: të fitojë të drejtën në territor dhe në liberalizim të vizave ose rrëzimin e këtij versioni të ri dhe kthimin në pikën zero. Pra, rrjedhimisht i humbim disa vjet dhe ndoshta kthehemi këtu ku jemi sot.

Ne sot po flasim për dalje prej kësaj bllokade dhe zgjidhje të kësaj teme, e cila po e rëndon Kosovën.

Të gjithë sot kemi të drejtë të kemi dilema e qëndrime të ndryshme për demarkacionin, siç kishim edhe dje, por sot me këtë projektligj të ri besoj se Kosova po e fiton të drejtën në territor dhe njëkohësisht zhbllokimin e kësaj situatë.

Ne nuk po duam të falim territor për liberalizim të vizave, përkundrazi. Aktualisht jeta e qytetarëve po rëndohet dhe duke mos i dhënë zgjidhje kësaj teme, sikur po e shuajnë shpresën e tyre, pra të qytetarëve për ditë më të mira, e përtej kësaj po dërgojmë Kosovën drejt izolimit dhe humbjes së besimit dhe përkrahjes së miqve tanë.

Të nderuar deputetë,

Nuk është se unë sot kam ndonjë vullnet dhe entuziazëm për ta votuar Projektligjin për demarkacionin, por qëndrimi dhe besimi im është se ne sot po e fitojmë të drejtën në territor dhe në liberalizim të vizave.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po të mos ishte brenda këtij ligji raporti i Komisionit shtetëror të zotit Bulliqi, unë kurrë nuk do ta votoja këtë version. Pra, as Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Krejt në fund, është obligim dhe përgjegjësi e Qeverisë që ta bëjë korigjimin në mënyrë obliguese në drejtim të Kullës dhe Çakorrit, kufiri duhet të kthehet në Kullë e Çakorr. Faleminderit!

KRYETARI: Xhelal Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Të nderuar deputetë,

Projektligji për marrëveshjen për demarkacionin me Malin e Zi që është sot këtu para nesh, është ai i vjetri që Hashim Thaçi u mundua të na e shesë përmes Isa Mustafës, e tani po mundohet të na e shesë përmes Ramush Haradinajt.

Deklarata e presidentëve nuk është asgjë tjetër, përveç një letër dekori, e mundësuar pas të ashtuquajturit negociim të Fatmir Limajt për të kamufluar tradhtinë, për t'i hedhur hi syve opinionit publik si dhe tendencë për të shpëtuar Ramushin disi me fytyrë.

Më 1 mars të vitit të kaluar, në një intervistë televizive Ramush Haradinaj thotë, citoj: “Kulla e Zhlebit është plot varre, edhe Serbia, kur është maru Jugosllavia nuk e ka lujt kufinin se e ka ditë sa gjaku, sa temeli është aty”.

Asnjë deklaratë e asnjë president nuk mund ta injorojë këtë fakt.

Projektligji është i njëjti që fuqimisht e ka kundërshtuar Ramushi, e shumë prej deputetëve këtu. Të mos harrojmë çka është edhe më e rëndësishme, mbi 205 000 qytetarë e kanë kundërshtuar përmes peticionit e qindra-mijëra përmes demonstratave. Asgjë nuk ka ndryshuar, përveç Ramushit dhe disa deputetëve.

“Nuk është një arë në pyetje, një mal, një bjeshkë, a një lis. Jo bre, është shumë më shumë... është testament i shqiptarëve”, thoshte Ramush Haradinaj i opozitës më 1 mars të vitit 2017. Çka po ndodh me “testamentin e shqiptarëve”, zoti Haradinaj?

Dikur, jo shumë moti, thoshe “...nuk ka mund sulltani me ndërru kufinin, e le ma ky djali i Brojës”

Çka u bë tash, Ramush, që po ta ndërron kufirin ky djali i Brojës?!

Se kjo marrëveshje është e dëmshme për Kosovën, besoj se nuk ka qytetar që e vë në dyshim këtë. Deklarata e presidentëve do të mund të shfrytëzohej për korrigjim nëse hyn në funksion para votimit për ratifikim që po kërkohet sot dhe sikur aty të ishin të shënuara koordinatat, të cilat përshkruajnë vijën kufitare të vërtetë dhe që korrektojnë atë që ka propozuar me pa të drejtë Komisioni i Murat Mehës.

Kështu si e keni paraqitur si dhe e keni menduar është vetëm një letër e pavlerë, njësoj siç ka qenë rezoluta e Kuvendit, ku jepeshin instruksione dhe kriteret se si të kryhej demarkacioni në një kohë kur qeveria e atëhershme e kishte kryer këtë proces dhe e mbante të fshehur nga deputetët dhe qytetarët. E ne na akuzoni se nuk kemi lejuar të mbahej debat në Kuvend. Rrena.

Kushti që kalimi i demarkacionit të lidhet me liberalizimin e vizave është shumë i padrejtë. Ne e

kuptojmë nevojën e qytetarëve për lëvizje të lirë, por a duhet të falim tokë për viza?! Jo. Për më shumë, votimi i demarkacionit nuk është kushti i vetëm dhe i fundit.

Po i mashtroni qytetarët. Prej fillimit keni qenë jotransparentë me qytetarët e me këtë Kuvend. Sot, të nderuar deputetë, duhet ta keni të qartë se pa luftimin e suksesshëm dhe të dëshmuar të krimit të organizuar dhe korrupsionit, nuk ka liberalizim të vizave për ne.

Më 26 gusht të vitit 2015, në Vjenë, Hashim Thaçi dhe Skender Hyseni e nënshkruan Marrëveshjen për demarkacion, në bazë të raportit të Komisionit të Murat Mehës.

Sot, gati tre vjet më vonë, Ramushi po bëhet bashkëpjesëmarrës i kësaj marrëveshjeje, të cilën tre vjet e kundërshtuam së bashku e me qindra-mijëra qytetarë. E si ta kuptojmë këtë?!

Papjekuria politike e kësaj qeverie po i kushton çdo ditë Kosovës. Me iniciativa në mes të natës, me shpresën që ambasadorët janë në pushime dhe me kontrata e tenderë që kalojnë ëndrrat e korporatave të mëdha, në kurriz të popullit, kuptohet, papërgjegjshmëria e kësaj qeverie po kalon edhe imagjinatën më të frikshme që ka mundur të ketë dikush.

Në politikë, nëse nuk e ke bindjen e fortë e dijen e thellë, një ditë shitesh. Në Kosovë, kur bindjen e shet e dijen s'e ke pasur kurrë, përfundon shërbëtor i Hashimit. Me marrëveshjen e vitit 2015, "Gjarpri" ia bëri gropën Isa Mustafës, me tepihun e kuq, e tash deklaratën e presidentëve po i bën gropën Ramushit, e pandërprerë edhe Kosovës. Këmbëngulja që ky variant i marrëveshjes të vijë për votim në Kuvend, tregon qartë se Hashim Thaçi po kërkon bashkëpunëtorë për ta ndarë barrën e rëndë të cenimit të territorit të Kosovës në kohë paqe.

E për këtë "Gjarprin", ose "pashën e Brojës", siç e quante Ramushi dikur, të cilit po i kthehen mbrapsht edhe dekoratat, nuk ia vlen as ta zgjasim më shumë në këtë ditë të rëndë për kombin e Republikën, në të cilën ai dhe klani e tij na solli.

Qytetarë të Republikës,

Tradhtia ndaj vendit nuk është tregim historie. Ajo po ndodh para syve tanë prej 2015 e sot po tentojnë ta materializojnë këtu në Kuvend. Një ditë, jo shumë larg, dikush do të japë përgjegjësi për këtë.

E tash edhe një herë i bëj apel, të fundit, "Smajlit", aq sa ka mbetur prej tij, gjeneral, mos jep tokë për asnjë çmim!

KRYETARI: Fjalën e ka Lumir Abdixhiku

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po besoj që dita e sotme e përbën simbolikën më të mirë të mundshme të një procesi të zgjatur tash e tre vjet. Po besoj se dita e sotme i jep fund një kauze të mundimshme, të lodhshme për qytetarët tanë, një kauzë që e mbajti vendin tonë peng për tre vjet rresht. Dhe, bën mirë që përfundimisht kjo kauzë merr fund, bën mirë që shuhet përfundimisht, ani pse e njëjta lë pas vetes tre vjet izolim, tre vjet të plota mosliberalizim për qytetarët tanë. Dhe më, vjen mirë që refuzuesit e djeshëm sot janë zbutur politikisht. Të parët, që tash janë në Qeveri, flasin se si liberalizimi i vizave është jetik për Republikën, e ka tre vjet që e gjithë Kosova, e besa gjithë bota e thotë të njëjtën gjë.

Dhe, dytët, që në zbutje e sipër e ka shndërruar kundërshtimin me gaz molotov e dhunë në kundërshtim simbolik prej follderash. Është bukur avancim ky të të dyja palët, prandaj e vlerësojmë si të tillë.

Zonja dhe zotërinj,

Në seancën e sotme ky Parlament ua kishte borxh qytetarëve tanë tre vjet më parë, por për tre vjet ne prodhuam papërgjegjshmërinë më të madhe politike në vend që nga shpallja e pavarësisë e këndej. Për tre vjet ne e rrezikuam udhëtimin tonë shtetndërtues, ndërtoam narracione fiktive të faljes së tokës, të shitjes së vendit, të copëtimit të Kosovës, s'i pamë faktet para vetit, s'e dëgjuam njëri-tjetrin, s'e lejuam të dëgjohet njëri-tjetri, e s'i dëgjuam as aleatët tanë ndërkombëtarë. S'i thamë fjalët me guxim dhe në vend të arsyes ne e zgjodhëm dhunën.

Kjo politikë që ndoqi Kosova për tre vjet pas vetes lë trazirat, lë dhunën nëpër rrugët e Prishtinës, lë djegiet, gazin, atentatet e sulmet ndaj Policisë së vendit, lë pas vetes edhe sulmet ndaj kundërshtarëve politikë për herë të parë në Kosovë në historinë e saj.

Kjo politikë dëshmoi se para interesave të pushtetit s'le gurë pa lëvizur, dhe kjo politikë e lëvizi secilin gur për të ardhur në pushtet dhe kaq ishte qëllimi. Sot të njëjtat thirrje i dëgjojmë edhe në këtë Parlament. Sot është bërë fare e lehtë shpallja e tradhtarëve, e ngritja e patriotëve me në fjalë të dhënë në këtë foltore. Mjafton të mendosh se për t'u bërë patriot po kundërshtove je tradhtar, dhe shihini kolegët tanë për pak se sa me lehtësi e ngrenë veten mbi të tjerët, ani pse s'kanë asnjë argument, ani pse s'kanë asnjë fakt, ani pse s'kanë asnjë arsye për kauzën fiktive që e ushqejnë me zell. Bëjnë kështu, sepse u është dhënë shembulli se me kauzë fiktive mund të vihet në pushtet, dhe këtë shkollë Kosova e ka përjetuar një herë, por s'ka akt patriotik më të madh sot sesa guximi për të shuar një kauzë të rrejshme: Kosova nuk po fal tokë, Kosova mund t'i korrigjojë lëshimet eventuale, Kosova po i hap dyert për në Evropë. Kaq i thjeshtë është narracioni politik, kaq e thjeshtë duhet të jetë vota sot, as për hatër të Qeverisë, as për inat të serbëve ose Beogradit, por veç pse s'ka rrugë tjetër, sepse këtu jemi për bindje, e jo për hatër.

Tash do të doja që në këtë fjalimin tim të mos merrem shumë me të kaluarën, por më shumë se kaq do të doja t'i shihja përfaqësuesit e kauzës së djeshme, Qeverinë e sotme të ngrihet mbi veten dhe kauzën që po merr fund dhe kjo ngritje mbi vete të niste me kërkim-falje. Për secilin udhëtar në një rrugëtim që s'prodhoi asgjë, veçse tre vjet të humbura keq.

Pra, nuk ka asgjë të keqe në ndryshimin e mendimit. S'do të kishte asgjë të keqe në nisjen e kërkim-faljes për të gjithë, do t'u kërkoni falje fillimisht deputetëve këtu, në këtë Parlament që i mbajtet me gaz, që nuk ua dhatë të drejtën e shprehjes së mendimit siç po jepet sot kjo e drejtë. Do t'u kërkoni falje edhe kundërshtarëve politik në vend që i shatë e i quajtet "tradhtarë", që i bëtë shënjestra të rrezikimit e të eliminimit fizik për secilin që mendonte ndryshe nga ta. Do t'u kërkoni falje edhe qytetarëve të vendit që i nxorët në rrugë, e që i përdorët si shkallë për pushtet dhe do t'i kërkoni falje gjithë vendit që ia humbët tre vjet kohë. Po, do t'i kërkoni falje në veçanti një njeriu që e patët në shenjë për tre vjet rresht, që i bëtë atentate sa ishit në opozitë bashkë, që ia sulmuat familjen në shtëpi, e që e shpallët tradhtar, që u bëri ballë të gjithëve bashkë, sepse dinte se kishte të drejtë dhe po e mbronte Republikën dhe sot, zonja dhe zotërinj, ju që jeni sot në Qeveri i keni borxh një kërkim-falje ish-kryeministrit Mustafa, sepse koha e vërtetoi se ai kishte të drejtë, e ju jo.

Zonja dhe zotërinj,

Sot ne e kemi arritur një konsensus. Është i vonuar megjithatë është konsensusi i shumicës shqiptare në këtë Parlament. Konsensusi në thelb e ka ratifikimin e marrëveshjes së gushtit të vitit 2015. Javë më parë ne e kundërshtuam draft-ligjin e propozuar nga Qeveria dhe bëmë kështu, sepse, ndonëse kishim konsideratë për derën dalëse që Qeveria e kërkonte për vete, ne s'mund të kishim konsideratë për paradokset që ligji i prodhonte njëkohësisht. Paradokse, sepse, në njërin anë, i njëjti ligj provonte ta ratifikonte një marrëveshje të dhënë, në anën tjetër provonte ta hidhte atë poshtë. Dhe, të dyja këto i bënte në një dokument të vetëm prej katër neneve. Dhe, ligji nuk është veçse procedurë, nuk është veçse letër, ligji është substancë, është përmbajtje.

Prandaj, edhe kundërshtimi ynë, ne s'mund të krijojmë kundërthënie ligjore qofshin ato edhe në një letër prej katër nenesh sa për ta arsyetuar një palë të dhënë që ishte në hall e në zor. Ne sillemi siç jemi sjellë gjithherë me guxim, përgjegjësi e me dinjitet, edhe kur përballë kemi kauza e tema popullsite. Ne gjithherë do të kërkojmë votim të qartë, jo ambiguoze, e do të theksojmë një fakt të dhënë kur bindemi për të. Ne e mbështetim sot draftin e ri, sepse në njërin anë ka qartësi votuese, e në anën tjetër lë hapësirë për korrigjim, e hapësira për korrigjim ishte gjithherë edhe në marrëveshjen e parë.

Më lejoni për pak të citoj dy rreshta të rëndësishëm të veçantë, "trupi i përbashkët i punës për shënjimin e kufirit shtetëror do të ketë mundësi që me pëlqimin e dyanshëm të bëjë korrigjime të nevojshme". Pra, trupi i përbashkët punues ka mundësi të bëjë korrigjime të nevojshme dhe këta

dy rreshta nuk janë të ndonjë dokumenti të ri, nuk janë pjesë e ndonjë deklaratë të re, është neni 7 i marrëveshjes së parë. Nenin të cilën nuk e dëgjuat asnjëherë. Në substancë, ky nen është thelbi i zgjerimit unilateral të Kosovës dhe LDK-ja do ta mbështesë, siç ka siguruar me marrëveshjen e parë secilin korigjim eventual në të ardhmen.

Në fund fare, s'kam sesi të mos u përgjigjem të gjitha frymave populiste që vazhdojnë ta godasin LDK-në edhe sot, sidomos kur tash s'guxojnë të merren shumë me pushtetin. Por për çfarë po akuzohet LDK saktësisht sot? LDK-ja po akuzohet se s'po mban inat. "Ju kanë refuzuar", na thonë, "tash mbani inat për ta". Dhe, në këtë inat na thonë "dënoni 1,8 milionë kosovarë me izolim". Me rëndësi qenka hakmarrja. Por, kjo s'është logjika me të cilën veprimet dhe s'ka qenë asnjëherë. Natyrisht që LDK-ja ka pasur dhe ka guxim të merret me secilin prej jush dhe nuk ua ka frikën, por gjithsesi ua ka njohur gjithmonë mbrapshtitë dhe duke njohur mbrapshtitë tuaja, LDK-ja e ka zgjedhur Eepublikën para konflikteve qytetare, të nxitura nga ju. Të njëjtën Republikë që ju e përdorni për një karrige, LDK-ja ka vendosur ta ruajë me dinjitet, edhe kur ky vendim i ka kushtuar me rrëzim.

LDK-ja e ka zgjedhur shtetin para pushtetit dhe gjithmonë do të zgjidhte kështu. LDK-ja, asnjëherë për asnjë çmim e për asnjë karrige, nuk do t'i vendoste interesat e shtetit në tavolinën e zareve të pushtetit dhe këtë mbajeni mend mirë. Kjo na dallon neve prej juve sot, na ka dalluar gjithherë dhe do të na dallojë përherë, edhe me juve që jeni në pushtet, edhe me juve që jeni në opozitë. Prandaj, ne sot jemi në gjendje të kapërcejmë mbi inatet politike nga opozita për një interes nacional, prandaj ne sot s'mendojmë me hatër se u rrëzuam, por me mendje dhe bindje se po veprimet drejt për Republikën, për të ardhmen e saj.

Të nderuar qytetarë,

Vendimi i sotëm do të duhej të ndodhte tre vjet më parë dhe tre vjet më parë Kosova do t'i hapte dyert e veta për në Evropë. Sot po shënojmë tre vjet të humbura për hiçgjë dhe humbjet e tilla, përveçse janë të shkuara, janë edhe argumente të sotme se ky rrugëtim duhet të mare fund njëherë e përgjithmonë.

Dhe, të nderuar kolegë deputetë, sot as s'është ditë feste, as s'është ditë mërzie. Sot është veç një ditë e zakonshme, e cila do të duhej të ndodhte tre vjet më parë, prandaj ju ftoj ta trajtoni si të tillë, si ditë të zakonshme dhe ta kapërcejmë këtë sfidë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fatmire Kollçaku, fjala për ju!

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Nëse dikush sot mund të jetë kokëllartë këtu në seancë plenare, besoj që janë deputetët e Lëvizjes "Vetëvendosje". Sa i përket izolimit, është e vërtetë që jemi populli më i izoluar dhe nuk e kemi

të mundur lëvizjen e lirë, por a thua a krejt faji qenka te mosratifikimi i Marrëveshjes për demarkacion me Malin e Zi, apo a është faji edhe diku tjetër?

Të gjitha këto subjekte tjera politike që qeverisën me vendin në periudhën e pasluftës, është shumë normale që duan të fokusohen vetëm te demarkacioni nëse bëhet fjalë për mosliberalizim të vizave. A thua pse jemi populli më i izoluar? Mungesa e zhvillimit ekonomik në vend, që është reflektuar pastaj në të gjithë sektorët tjerë, e ka krijuar një klimë të paperspektivës në vend, ku kemi qenë dëshmitarë të ikjes të qindra-mijëra qytetarëve jashtë vendit, pa dokumente, pa viza dhe kanë shikuar vetëm si ta lëshojnë këtë vend pa perspektivë, ku kanë qeverisur me ndërrime apo bashkë edhe LDK-ja, edhe PDK-ja, edhe kohë pas kohe AAK-ja. Kështu që besoj që kjo klimë e paperspektivës dhe e izolimit pikërisht është për faj të këtyre subjekte që na kanë sjellë në këtë gjendje, në të cilën jemi sot.

Nuk po japim provim që jemi popull shtet formues, përkundrazi - ky shtet funksionon me improvizime, zgjidhje ad hoc, sikur që është edhe kjo seancë e thirrur në orët e vona të pasdites, kur pa asnjë arsye nuk jemi takuar sot si zakonisht në orën 10:00, por thirret një seancë pasdite, e nuk e di cili është shkak. E dimë që votat nuk i kemi pasur, dhe si duket nuk i kemi, prandaj ju nevojitet që të konsumohet një debat dhe pastaj ta sillni për votim në një ditë tjetër, kur qytetarët do të harrojnë se çfarë është folur për këtë temë, apo ndoshta edhe do të na befasoni sonte.

Po, jemi popull pa perspektivë evropiane, jemi të vetmit që asnjë rreze drite nuk e kemi në fund të tunelit. Kur ne do të kemi mundësi të jemi pjesë e bashkësisë evropiane?

Çka na ka sjellë kjo qeveri sot përpara? Edhe pse e ka angazhuar një komision tjetër, i cili ka gjetur shkelje të mëdha të komisionit paraprak, Qeveria pa asnjë qëndrim të vetin e sjell atë raport, e inkorporon në këtë projektligj, dhe me këtë na bën plotësisht të pamundur, edhe sikur të mos kishte humbje të territorit, që ne sot ta votojmë një projektligj të tillë, ku e kemi një marrëveshje, e cila është bazuar në një raport të komisionit, po i referohem si komisioni i parë shtetëror, apo Komisioni “Meha”, dhe një raport tjetër plotësisht në kundërshtim me raportin e parë, të cilit duhet kinse t’i referohet eventualisht një komision pas ratifikimit, duke e ditur që edhe pse pala malazeze e ka kryer ratifikimin dhe shumë ballëhapur u del qytetarëve të vetë përpara, ndërsa tek pas ratifikimit nga ky Kuvend ajo marrëveshje është e plotfuqishme, dhe pse ne sot duhet ta bëjmë një ratifikim të marrëveshjes pa e bërë korrigjimin? Nëse kjo Qeveri qëndron prapa raportit të ri, apo të ashtuquajturit Raport “Bulliçi”, apo komisionit të ri që vetë Qeveria e ka angazhuar, e jo opozita.

Prandaj, krejt përgjegjësia bie mbi këtë Qeveri, që nëse është një Qeveri joimprovizuese, por një Qeveri që është e interesuar që këtë shtet ta çojë përpara, në qoftë se disponon me argumente dhe qëndron prapa komisionit dhe raportit të komisionit të ri, që vetë e ka formuar, jo vetëm që është dashur ta ketë një qëndrim dhe ta sjellë atë raport këtu për debat në Kuvend, dhe pastaj së bashku

nëse do të kishte pëlqim nga pala malazeze me faktet, e jo me një theks nëse eventualisht ka diçka që duhet të korrigohet, atëherë komisionet që do të bëhen nga të dyja palët mund të merren me korrigjime eventuale, e jo me të gjeturat faktike që edhe vetë Qeveria po e pranon që janë në raportin e ri të Komisionit “Bulliçi”.

Prandaj, të shkojmë ashtu siç duhet, për së mbari, të bëhet rishikimi i marrëveshjes, korrigjimi dhe tek pastaj ratifikimi, se edhe ne jemi shumë të interesuar që të kryhet procesi i demarkacionit me një shtet fqinj miqësor që na ka njohur, jemi shumë të interesuar që të bëhet liberalizimi dhe qytetarëve t’u mundësohet lëvizja e lirë, ku edhe ne bëjmë pjesë, sepse mos harroni një mandat i deputetit është shumë i shkurtër dhe ne kemi nevojë që të lëvizim të lirë.

Prandaj, të shkojmë ashtu siç duhet dhe të mos bëjmë improvizime siç jemi mësuar deri tani, sepse kjo do të na kushtojë edhe si shtet, edhe gjithnjë do të jemi shumë jokredibilë edhe karshi miqve tanë ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Vjosa Osmani Sadriu e ka fjalën.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Siç e dini, sidomos ju që keni qenë deputetë edhe më herët, kjo është një ndër çështjet më kontraverse, e cila e ka mbajtur këtë vend peng për disa vite, duke rezultuar, për fat të keq, edhe me dhunë brenda institucionit më të lartë përfaqësues në vend, por duke rezultuar me dhunë edhe ndaj pronës private. Ajo çka unë shpresoj që kemi bërë pas tre vjetësh është që secili prej nesh kemi mësuar nga gabimet e viteve të kaluara, secili prej nesh kemi mësuar që për çështjet e interesit nacional, për çështje që kërkojnë vëmendjen e secilit prej nesh është e pamundur të ecim përpara si shtet në qoftë se nuk ka konsensus.

Lidhur me këtë temë, përkundër faktit që shumë rrallë kam folur publikisht, mund të them që së bashku me kolegët e mi kemi bërë një sërë përpjekjesh që të gjejmë një zgjidhje të përbashkët, pa marrë parasysh nëse kemi qenë deputetë të partive në pushtet në mandatin e kaluar, apo deputetë të opozitës. Qysh në fillim kur përdornin dhunë në këtë Parlament, së bashku me deputetin Ilir Deda e propozuam planin pesëpikësh që, ndër të tjera, propozonte një komision parlamentar që do ta shqyrtonte materialin, i cili ishte përgatitur nga Komisioni “Meha”, por mbi të gjitha do të krijonte një konsensus ndërmjet të gjitha partive politike për një temë kaq të ndjeshme.

Pastaj, së bashku me deputetin Arben Gashi, një herë në Bruksel dhe pastaj edhe në Prishtinë, propozuam që të ketë deklaratë të përbashkët të dy kryeministrave që, ndër të tjera, do ta adresonte edhe çështjen e korrigjimeve të nevojshme.

Propozuam pastaj, për herë të tretë, edhe rezolutë të këtij Kuvendi, i cili do të mund t'i trajtonte me seriozitet shqetësimet që i ngrinin deputetët lidhur me këtë temë, edhe pse në rrethana gati të një lufte, ishte e pamundur të flitej me racionalitet.

Dhe, së fundi, së bashku me 16 deputetë të tjerë të LDK-së propozuam që Marrëveshjes për ratifikimin e kufirit t'i shtohet një aneks-marrëveshje, e cila në fakt do ta kishte efektin e njëjtë, edhe pse ka ofruar edhe më shumë me atë që sot i është bashkangjitur dokumentit që po shqyrtohet në Kuvend. Fatkeqësisht, Ramush Haradinaj i pati refuzuar të gjitha këto opsione. Propozimin e parë e quajti “të pamjaftueshëm”, propozimin e dytë e të tretë i quante “të pamundur”, propozimin e katërt e quante “pa asnjë efekt juridik”, ndërkaq sot e sjell po të njëjtin.

Pra, i ka refuzuar të gjitha dhe sot para deputetëve të Kuvendit të Kosovës vjen me të njëjtat opsione, të cilat qysh në vitin 2016 e kanë pasur mundësinë ta arrijnë një konsensus së paku tek shumica dërrmuese e partive shqiptare, në mënyrë që as skena politike, as raportet tona me bashkësinë ndërkombëtare, por mbi të gjitha qytetarët e vendit të mos mbeteshin peng.

Por, përtej refuzimit të dokumenteve, këto tre vjet më së shumti është refuzuar racionaliteti. Më së shumti është vlerësuar gjuha akuzuese, e fatkeqësisht më pak është vlerësuar puna dhe fuqia e argumenteve. Është refuzuar mundësia për të biseduar, mundësia për t'i zgjidhur problemet, mundësia për të pasur konsensus për çështjet e interesit nacional e qytetar. Dhe, tani shumica dërrmuese, më në fund, për fat të mirë po pajtohem që vetëm ky konsensus mund ta çojë vendin përpara. Siç e dini, së bashku me disa deputetë të tjerë kemi pasur një sërë pyetjesh dhe kemi shtruar një sërë çështje legjitime lidhur me dokumentet që i ka sjellë Komisioni “Meha”.

Në radhë të parë, kemi pyetur për përcaktimin e kriterit kadastral. Deri në korrik të vitit 2017 nuk ka pasur një përgjigje të saktë lidhur me atë, se pse të dyja komisionet janë pajtuar për përdorimin e këtij kriteri. Kurse sot e kemi një vendim të Tribunalit të Arbitrazhit ndërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë, e cila jo vetëm për ato dy shtete, por për tërë ish-Jugosllavinë e ka sqaruar përfundimisht këtë punë, duke konsideruar kriterin kadastral si kriterin më të saktë, i cili do të duhej të përdorej sidomos kur ka marrëveshje ndërmjet dy shteteve, në fakt ndërmjet dy komisioneve për ta përdorur atë.

Unë kam dëgjuar interpretime të ndryshme të tjera të këtij vendimi, natyrisht nga njerëz që kurrë nuk janë marrë me të drejtën ndërkombëtare, ose nga njerëz që citojnë vetëm deri te presja, e pjesën pas presjes, ku thuhet “megjithatë”, nuk e lexojnë fare.

Mirëpo, në qoftë se i mbyllim sytë para këtyre argumenteve të reja, në qoftë se i mbyllim sytë para këtyre ndryshimeve të rrethanave, ne do të vazhdojmë thjesht të tregohemi irracionalë. Kjo është e para. E dyta, para disa vitesh, mosmarrëveshjet lidhur me këtë temë ishin

mosmarrëveshje bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Sot, edhe në këtë kontekst kemi ndryshim rrethanash. Mali i Zi është anëtar i NATO-s dhe çdo kontest tash e tutje është kontest ndërmjet Kosovës dhe Shteteve anëtare të NATO-s. Nuk është kontest veç me Malin e Zi, është kontest edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me çdo shtet tjetër anëtar.

Në qoftë se nëpërmjet marrëveshjes së dy presidentëve arrihet që të gjendet dokumentacion shtesë, fakte shtesë dhe mund të kontestohen disa nga pikat që janë arritur si marrëveshje ndërmjet dy komisioneve shtetërore, atëherë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës e ka një mundësi, atë që quhet suspendim i performansës. Pra, po në atë moment, juridikisht, Qeveria e Kosovës mund ta ndalë ekzekutimin e marrëveshjes nga ana e saj, deri në momentin kur bëhen përmirësimet e nevojshme.

Unë jam plotësisht e vetëdijshme që përmirësimet nuk mund të shkojnë ndoshta deri në atë masë, ku secili prej nesh do të kishim dëshiruar. Mirëpo, sot flas për këtë marrëveshje, e bindur për dy gjëra themelore: e para, se pas tre vjetësh, kur dikush ka bërë përpjekje në mirëbesim, e dikush me dhunë, nuk mund të nxjerrim asgjë më shumë. Jam qind për qind e bindur, sepse sikur të isha vetëm 1% e bindur që do të mund të nxirrnim diçka më shumë nga ky kontest, sot nuk do të flisja para jush. Dhe, e dyta, jam e bindur plotësisht se këtë e kërkojnë shumica dërrmuese e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Çka ka ndodhur fatkeqësisht gjatë këtyre tre vjetësh është që izolimi mendor i politikës kosovare i ka mbajtur të izoluar edhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Për fund, ne dëgjuam sot shumë fjalime që na thanë ta mbrojmë Republikën.

Të nderuar deputetë,

Republika përbëhet nga qytetarët e saj, burra, gra, rini, shumica dërrmuese prej të cilëve presin që përfundimisht ne t'i largojmë nga ky burg i quajtur Kosovë, sepse në qoftë se Bashkimi Evropian vazhdon t'ua mbajë atyre derën e mbyllur, e dini që dikush tjetër do t'ua hapë atë derë, do t'ua hapë ashtu siç ua hapën korridoret për të shkuar e për të luftuar me ISIS, fatkeqësisht 268 qytetarëve të Republikës së Kosovës, do t'ua hapin ata që duan t'ua shpërlajnë trurin dhe në qoftë se sot diçka është detyrë patriotike e secilit prej nesh, është t'ua shpëtojmë jetën atyre njerëzve nga një izolim i tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Labinot Tahiri e ka fjalën.

LABINOT TAHIRI: Kryetar i nderuar,
Kolegë deputetë,
Qytetarë të nderuar,

Qytetarët tanë presin sot ndonjë gëzim më të madh, se sa ne këtu në Kuvend nëse e ratifikojmë demarkacionin.

Nuk kisha pasur qejf që të varemi prej Listës Serbe, se mësohen të na qesin kushte gjithmonë neve shqiptarëve këtu shumicë në Kosovë. Megjithatë, atë që e ka thënë zonja Emilija më ka pëlqyer shumë, ne jetojmë së bashku në Kosovë, por jo për t'u vënë kushte sa herë që duan ata shqiptarëve për ndonjë gjë që është në interes nacional.

Unë jam si deputet i ri në Kuvendin e Kosovës, po i them kryeministrit Haradinaj, nëse rastësisht varemi vetëm prej Listës serbe dhe ofrohet numri 80 e më tutje, unë nuk e votoj demarkacionin, por nëse varet që shembull ta bëjmë shumicën e shqiptarëve, atëherë nuk jam për ta mbajtur peng ratifikimin e demarkacionit.

Të ju them të drejtën, po t'i dëgjosh qytetarët se çfarë po flasin jashtë, shikoni komentet nëpër portale e gjithandej, nuk u interesojnë debatet prej 2015-ës, ose edhe më herët, e deri më tash. Ata presin një gjë konkrete që është sot për t'u votuar ajo marrëveshje dhe ne duhet ta bëjmë. E keni lutur edhe "Vetëvendosjen", edhe këtë Grupin e ri Parlamentar, por mendoj se duhet të reflektojë "Vetëvendosja" e të mos lejojë të varemi ne prej Listës serbe. E di që Ramush Haradinaj e ka punën pisk, por pasi që gjithherë kemi dalë mbi 1 milion popull në protesta për të, e lus "Vetëvendosjen" dhe Grupin Parlamentar që t'i ndihmojmë sot, të mos e lëmë me faj vetëm Ramushin, se s'ka faj vetëm Ramushi, sa i përket kësaj marrëveshjeje, po faj kemi të gjithë këtu që jemi në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Shemsi Syla e ka fjalën.

SHEMSI SYLA: I nderuar kryesues,
Zoti kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Të gjithë e dimë se iniciues dhe kundërshtuesi më i madh i demarkacionit me Malin e Zi ka qenë vet Ramush Haradinaj, kurse sot me kërkesën e tij por tani në cilësinë e kryeministrit ka kërkuar mbajtjen e kësaj seance për të ratifikuar demarkacionin, për të cilin me dorën e tij ia dorëzoi këtij Kuvendi edhe këto nënshkrime të mbi 200 mijë qytetarëve. Kurse, në cilësinë e kryeministrit veprimin e parë që bëri ishte shkarkimi i komisionit në krye me Murat Mehën dhe emërimin e një komisioni të ri, i cili hartoi një raport duke ngritur edhe akuza, se komisioni i mëparshëm në krye me Murat Mehën ka fshehur materiale dhe harta, që e përcaktojnë vijën kufitare me Malin e Zi.

Duke pasur parasysh acarimin e raporteve ndërmjet kryeministrit Haradinaj dhe Murat Mehës, është pritur që të ngritet akuzë për këto falsifikime të supozuara ndaj Mehës. Por, kjo nuk

ndodhi. Madje, u harruan edhe argumentet se me ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit Mali i Zi do të përfitojë rreth 80 km² territor, që historikisht i ka takuar Kosovës. Historikisht, edhe atëherë kur territoret shqiptare ishin ende nën sundimin e Perandorisë Osmane, si dhe në vendimet e Kongresit të Berlinit, Qafa e Çakorrit është njohur si pikë kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe territoreve shqiptare. Edhe në kohën e sundimit të Austro-Hungarisë në këto anë gjatë Luftës së Parë Botërore Qafa e Çakorrit është njohur si pikë kufitare, siç është njohur edhe në periudha të mëvonshme të sundimit Jugosllav 1945-1989, kur ky territor kontrollohej plotësisht nga Kosova.

Duke anashkaluar të gjitha këto argumente u përdor një manipulim politik, kur gjoja presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanoviq, qenkan dakorduar për një marrëveshje të re, përmes së cilës është arritur pajtueshmëri e dyanshme për rishikim të demarkacionit dhe korrigjim të gabimeve të mundshme. Kjo e ashtuquajtur marrëveshje e re, në fakt është një deklaratë politike, që nuk prodhon asnjë efekt juridik ndërkombëtar dhe nuk i heq asnjë presje të vetme marrëveshjes së 26 gushtit të vitit 2015 dhe as që bëhet fjalë për ndryshimin e saj.

Deklarata Thaçi – Vujanoviq, edhe nëse futet në proces të ratifikimit në Kuvendin e Kosovës në cilësinë e shtojcës së marrëveshjes së demarkacionit, përsëri nuk mund të klasifikohet si dokument juridik ndërkombëtar, derisa ajo të mos i nënshtrohet procedurës së ratifikimit edhe në Kuvendin e Malit të Zi, ku për deklaratën politike Thaçi - Vujanoviq pala malazeze po deklaronte se nuk bëhet fjalë për rishikim të demarkacionit, por për eliminimin të ndonjë gabimi teknik e gabim teknik nuk mund të quhet 80 km² të territorit.

Në fakt, teksti i deklaratës nuk prodhon gjë tjetër, veç përsërit dispozita të marrëveshjes së mëparshme. Konkretisht, neni 9, sipas të cilit mosmarrëveshjet eventuale ndërmjet dy vendeve zgjidhen në kanale diplomatike. Gjithashtu, edhe pika për krijimin e grupit të përbashkët të punës për shënimin e vijës së kufirit është një përsëritje e dispozitave që përmban çdo marrëveshje kuadër e demarkacionit. Ky është një proces i thjeshtë teknik, i cili si rregull ndërmerret në zbatim të marrëveshjeve politiko-juridike, sepse shënimi i kufirit, vendosja e gurëve, shtyllave, piramidave dhe tabelave kufitare nuk mund të bëhet pa grupe të përbashkëta pune.

Duke qenë një proces teknik janë të paqëndrueshme argumentimet dhe pretendimet se ky grup do të merret me rishikim dhe korrigjim të demarkacionit me Malin e Zi. Korrigjimet që ai mund të bëjë do të jenë krejtësisht të papërfillshme, që lidhen vetëm me natyrën e terrenit, ku do të bëhet shënimi i kufirit. Por, pse me kaq pompozitet po fryhet e po ngritet në qiell kjo deklaratë, madje duke i dhënë edhe fuqinë e një marrëveshjeje të re, se kinse me automatizëm pas ratifikimit po i hapka rrugë liberalizimit të vizave dhe afrimit të shpejtë me BE-në. Ky manipulim me opinionin publik po bëhet për interesa personale për të qëndruar thjesht në pushtet.

Kryeministrit Haradinaj po i duhet një ambalazhim i ri i demarkacionit, sa për të justifikuar kauzën e tij të mëparshme duke i ikur ndëshkimit politik, kurse presidenti Thaçi, i cili ka nënshkruar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi më 26 gusht 2015 në cilësinë e ministrit të Punëve të Jashtme, mosratifikimi do ta komprometonte politikisht, ndërsa ratifikimi do të perceptohej si sukses personal i tij dhe të njëjtën kohë, duke identifikuar kryeministrin Haradinaj si lider, që për të arritur pushtetin sajón kauza të rrejshme politike e kombëtare. Por në fakt, edhe kryeministri edhe presidenti kanë një shqetësim dhe përpjekje të përbashkët, ku përmes ratifikimit të demarkacionit po kërkojnë njëfarë rehabilitimi në sytë e ndërkombëtarëve, por ata po harrojnë se po hapin një problem edhe më të madh, siç është themelimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe, i cili do të jetë kushti i radhës për liderët institucionalë të Kosovës.

Serbia veç e ka filluar ofensivën diplomatike, duke deklaruar se është e papranueshme të ndryshojë, qoftë edhe një presje të marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me shumicë serbe, e lëre më të bëhet një projekt i ri i këtij dokumenti. E të mos harrojmë, se edhe asociacioni i komunave me shumicë serbe është një marrëveshje e karakterit ndërkombëtar, garantues i së cilës është vetë Brukseli.

Prandaj, i nderuar kryeministër Haradinaj dhe i nderuar president Thaçi, me ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi mos mendoni se kaluat lumin dhe fituat simpatinë e faktorit ndërkombëtar. Ju vetëm sa po hapni rrugë për presionin e radhës, i cili përfundimisht do të vulosë edhe fatin tuaj në politikë.

Të nderuar deputetë,

Çështje të pazgjidhura kufitare Mali i Zi ka edhe me Kroacinë. Mosmarrëveshje kufitare ende kanë Sllovenia e Kroacia, Shqipëria e Greqia, madje edhe Serbia e Maqedonia, por askush nuk u ka vënë kushte, se nuk mund të ecin në proceset integruese euro-atlantike pa i zgjidhur këto mosmarrëveshje. Kushte i janë vënë vetëm Kosovës, prandaj ju bëj thirrje që të votoni kundër demarkacionit të tillë me Malin e Zi, duke qenë të sigurt se nuk po shkelim asnjë kriter dhe asnjë standard të BE-së, por po mbrojmë sovranitetin e vendit tonë dhe duke kundërshtuar këtë marrëveshje i hapim rrugë mundësisë për të rifilluar nga e para përcaktimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Faleminderit!

KRYETARI: Drita Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë dhe të nderuar deputetë,

Çdo marrëveshje e dëmshme e kësaj qeverisjeje, por edhe e qeverisjes së kaluar, vazhdon të kontrabandohet natën, siç po ndodh edhe sonte. Para se të filloj desha t'i përgjigjem zonjës Vjosa Osmani për një të pavërtetë në lidhje me rastin e konfliktit midis Sllovenisë dhe Kroacisë, rasti i Gjykatës së Arbitrazhit PCA, nr. 2012/04 për ndërmjetësimin midis Kroacisë dhe Sllovenisë,

paragrafi 346, 353 thonë në kontradiktë të asaj që e tha, e deklaroi zonja Osmani në lidhje me karakterin kadastral.

Ndër qëndrimi përfundimtar i vendimit të gjykatës i datës 29 qershor 2017 thotë shprehimisht në paragrafin 353, arsyet për mospajtime me çështje të kufirit në pjesët diskutabile nuk janë të njëjta në çdo rast. Në temat e përgjithshme arsyet mund të mos jenë në pajtim si në vijim:

a) sepse kufijtë kadastralë të parashkruar në hartat kadastrale mbivendosen, ose lënë hapësira të zbrazëta;

b) kur nuk ka kufij kadastralë;

c) kufiri duhet të përcaktohet duke aplikuar instrumentet apo kriteret tjera.

Gjykata e Arbitrazhit përfundimisht kështu vlerëson kriterin kadastral. Nëse, kufijtë kadastralë nuk kanë ndonjë status të veçantë thelbësor, që i bën ato automatikisht të mbivlerësohen mbi ndonjë evidencë tjetër vlen si indikacion i kufirit administrativ apo politik, është i ndryshëm nga ato të dikasterit kadastral.

Dhe, tani dua të kaloj te zoti kryeministër. Në disa deklarime të tij ai ka thënë se s'ka as sulltan, as krajl që mund ta luajnë kufirin. Tani, dua ta pyes kryeministrin, se cilin pozicion e ka, të Sulltanit apo të krajlit, i cili po dëshiron ta lëvizë kufirin?

Para nesh prej më shumë se tri vjetësh është shtruar çështja, a t'i besojmë Hashim Thaçit që këmbëngul se nuk ka humbur Kosova asnjë centimetër tokë në marrëveshjen e Malit të Zi apo profesorëve e banorëve të zonave, që shpjegojnë shumë qartë se Kosova ka rrezik t'i humbë 8 200 hektarë tokë. Kush në këtë vend ende i beson Hashim Thaçit dhe atyre që e mbështetin atë? A mund t'i besohet përgjegjësit kryesor që prej dhjetë vjetësh premtonte gati çdo vit, nga pozicione të ndryshme në politikë, se po liberalizohen vizat në Kosovë? A mund t'i besojë kush më Hashim Thaçit në këtë vend të rrënuar nga korrupsioni dhe krimi i organizuar nga vetë ai dhe nga klani i tij?

Ne praktikisht, nga ne po kërkohet që të bëhemi të verbër e të mos e lexojmë, as raportin e Komisionit Shtetëror drejtuar nga profesor Bulliqi, që thotë zyrtarisht se Republika e Kosovës nga marrëveshja e 26 gushtit 2015 humb territor, ndërsa Komisioni i Murat Mehës ka kaluar kompetencat e tij dhe e ka bërë kufirin e ri, duke përdorur harta të dyshimta.

Po, pse duhet të na shpërfillin këtë fakt të jashtëzakonshëm e të dëmshëm, për premtime që prapë vijnë nga zoti Thaçi, njeriu më i pabesueshëm në këtë Republikë. Profesori Përparim Ahmeti pati sjellë në vëmendje gjatë vitit 2016 çështjet lidhur me kriterin e kadastrës, mbi të cilin është bërë

kjo marrëveshje që sot e kemi para vetes. Ai shpjegon qartë se 82 km² të cilat pretendon Mali i Zi, as ky i fundit nuk ka mbulesë kadastrale.

Dhe së dyti, gjatë konferencës për demarkacion që u mbajt në Kuvend më 3 gusht, ai paraqiti një dokument kadastral malazez, të cilin marrëveshja e 26 gushtit 2015 e merr për të mirëqenë mbi të cilin jep tokë. Dokumenti në fjalë është shkruar me laps, nuk ka vit, nuk ka kurrfarë vulash, asnjë shenjë që është dokument shtetëror i shtetit përkatës. Asnjëri prej anëtarëve të pranishëm të ish-komisionit në atë konferencë nuk i hodhën poshtë faktet relevante të paraqitura nga zoti Ahmeti. Po ashtu, eksperti i fushës Sali Ahmetaj ka shpjeguar se argumenti i qëndrueshëm me Malin e Zi dhe Kosovën nuk e kanë as kadastrat kontabël. Për tërë këtë zonë të Kosovës e të cilën Mali i Zi pretendon, mundohet t'i mbulojë përmes kadastrës përshkruese. Kjo me fjalë tjera është sikur tokën, pronë tënden që e kontrollon dhe e mirëmban, ti ta kalosh në emër të fqinjit, sepse ai po pretendon që e ka një vizatim apo një pikturë ku është e vizatuar edhe toka jote.

Florim Isufi, profesor në universitetin e Prishtinës, tash anëtar i komisionit të ri shtetëror, ka paraqitur hartën kadastrale të Kosovës Autonome të vitit 1974. Aty shihet se territori i vendit tonë është saktësisht në Kullë dhe Çakorr. Marrëveshja e vitit 2015, kjo që e kemi sot para nesh, nuk ka marrë për bazë këtë hartë kadastrale e cila plotësisht përputhet me kufijtë e atëhershëm administrativë të Kosovës. Pra, zoti Isufi ka sjellë argumente të qëndrueshme se edhe po të merret si kusht kadastra, ani pse kriter i paqëndrueshëm dhe i pavërtetë, por si kusht i veçantë i demarkimit të kufirit ndërkombëtar. marrëveshja rezulton me gabime të pafalshme.

Ai po ashtu, ka sjellë në vëmendjen e publikut hartën e Malit të Zi në vitin 2014 të cilën vet mali i Zi e kishte paraqitur në Atllasin e Adriatikut. Në atë hartë të Malit të Zi, të cilën nuk e kemi përpiluar, as ekspertët tanë të Kosovës, mirëpo as ne deputetët të cilët po e kundërshtojmë këtë marrëveshje. Kufijtë e tij janë në përputhje me versionin e kufirit, që ishte gjithmonë në Kullë dhe Çakorr. Të mos i mbrosh këto pozicione të cilat qëndrojnë të vërteta dhe interesi ynë shtetëror, por të dalësh në anën e kundërt dhe të mbrosh harta të dyshimta, të atyre malaziasve që e duan përvetësimin e tokës së Kosovës, kjo meriton një gjykim të ashpër e mbi të gjitha, meriton daljen përpara gjyqit të të gjithë atyre që për kaq vite na gënjyen dhe cenojnë interesin e vendit tonë.

Qeveria e Kosovës, e kaluara dhe kjo e tanishmja, ndaj gjithë këtyre vërejtjeve dhe kritikave për lëshimet e bëra ka përdorur vetëm një arsytim, liberalizimin e vizave. Udhërrëfyesi fillestar i liberalizimit të vizave të Kosovës u dorëzua në vitin 2012. Aty ndodhen një varg kriteresh, të cilat janë të domosdoshme, pra reforma të domosdoshme, që Kosova duhet t'i bëjë ashtu që t'i ofrohet liberalizimi i vizave. Ndër kushtet apo reformat kryesore është edhe sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Këto reforma përfshijnë 101 mijë veprime të cilat Qeveria duhet t'i ndërmarrë në fushat përkatëse, në kuadër të bllokut të tretë ndodhet edhe demarkacioni me Malin e Zi.

Së pari, një pjesë e konsiderueshme kushteve nuk janë përmbushur ende, ngecje të mëdha kemi sidomos në fushën e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këto ngecje nuk kanë asnjë shenjë që do të kapërcehen nga qeverisja aktuale, madje do të ishte kulmi i naivitetit më të madh nëse besojmë, për shembull, se departamenti i krimeve ekonomike do ta fillonte hetimin, për shembull për pasurinë e Hashim Thaçit dhe familjes së tij, si dhe krimit të organizuar të zyrtarëve të lartë në institucionet e Kosovës.

Kush beson më në Kosovë, se këta autorë të “klanit Pronto” lejojnë sistemin e drejtësisë t’i hetojë dhe ta dënojnë veten e tyre dhe njerëzit e tyre?

Dhe së dyti, fakti që demarkacioni ndodhet në udhërrëfyesin e liberalizimit të vizave nuk do të thotë që detyrimisht duhet ta bëjmë një demarkacion të gabueshëm, i cili na kushton me territor. Asnjë shtet në Botë nuk jep territor për viza. Nëse edhe kjo qeveri mendon të kundërtën, ne duhet ta kundërshtojmë. Duke vendosur demarkacionin mbi kriteret tjera, që janë sh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ka kërkuar fjalën kryeministri i Republikës së Kosovës. Po, më fal. Kërkoj falje! Vjosa Osmani-Sadriu e ka kërkuar fjalën për replikë. I është përmendur emri dy herë.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Unë dua ta falënderoj zonjën që e konfirmoi pikërisht atë që e thash në fjalimin tim.

E para, që dokumentet gjithmonë zgjedhin t’i lexojnë në mënyrë të përgjysmuar, vetëm çka u përshtatet atyre dhe e dyta, edhe kur i lexojnë i keqinterpretajnë. Asnjëra nga ato tri rrethana të paragrafit 353, që ju e përmendët, nuk vlejnë në rastin e Kosovës, nën një.

Nën dy, në qoftë se doni vërtet ta kuptoni lexoni edhe fusnotat, sidomos fusnotën 623 të po të njëjtit vendim. Lexoni në tërësi dokumentet, analizoni, po edhe 342-shin, edhe 343-shin, edhe 347-shin edhe për dallim prej jush, të gjitha këto unë i kam diskutuar në Komision për Punë të Jashtme me Komisionin Shtetëror edhe në fund ata janë pajtuar me atë interpretim.

Në qoftë se ka pasur dallime lidhur me atë se çka është mandati i Komisionit Shtetëror, ne e kemi humbur shansin për ta refuzuar atë, në momentin kur ajo marrëveshje është nënshkruar nga personi që e ka emëruar dhe autorizuar komisionin, pra nga Hashim Thaçi. Në atë moment, sipas Konventës së Vjenës për traktate, ai e ka autorizuar edhe tejkalimin e mandatit. Ligjërisht po flas. Kështu që, lexoni dokumentet në tërësi dhe mua më vjen mirë që me reagimin tuaj, vetëm sa e konfirmuat atë që e thash unë sot në fjalim.

KRYETARI: Më fal, zoti Kurteshi, zonja Millaku mund veç kundër-replikë. Më vjen keq! Kërkoj falje, më vjen shumë keq. Më vjen shumë keq, nuk po hyj në interpretim. Zonja Millaku, në qoftë se dëshiron kundër-replikë, ka mundësi.

DRITA MILLAKU: Faleminderit! Meqenëse pyetja është profesionale, atëherë fjalën ia kaloj zotit Kurteshi.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Atëherë, vazhdojmë seancën. Nezir Çoçaj fjala për ju, bëhet gati Valentina Bunjaku. Arben, prej LDK-së mbetesh i fundit.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qytetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Tashmë një kohë të gjatë jemi duke u përballë me një situatë politike aspak të lehtë për vendin dhe institucionet tona, demarkacionin.

Marrëveshja e demarkacionit e arritur në gushtin e vitit 2015 ka qenë një marrëveshje që na ka mbajtur të izoluar dhe në të njëjtën kohë ka qenë tema kryesore e politikës sonë shtetërore.

Tash tre vjet, institucionet e Kosovës nuk kanë mundur të fokusohen në politika ditore në të mirë të qytetarit, ku do të punonin më shumë në zhvillimin ekonomik të vendit, për një sistem më të mirë arsimor, për një sistem më të mirë shëndetësor, etj., por janë marrë kryesisht me një temë puro politike që ka ngecur çdo proces euro-atlantik të Kosovës.

Procesi deri në mbylljen e marrëveshjes së demarkacionit gjithashtu ka nxjerrë në pah politikanë burokratë në institucionet e Kosovës, të cilët neglizhencën e kanë pjesë ditore të punës. Demarkacioni u tregoi të gjithë qytetarëve të Kosovës se ne jemi të prirë të punojmë me improvizime deri në ekstrem.

Qytetarët e Kosovës po ashtu e dinë se procese të tilla janë duke u zhvilluar çdo ditë dhe duhet të ketë fokus më të madh në këtë lloj politikëbërje, të ketë një proces vlerësimi i kontrollit të punës që politikanët e bëjnë, sepse paguhen me taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Demarkacioni ka qenë edhe argumenti kryesor i izolimit. Qytetarët e Kosovës nuk mund të udhëtojnë lirshëm vetëm e vetëm se ka politikanë të pandërgjegjshëm dhe neglizhentë.

Ky lloj i politikanëve në vazhdimësi janë munduar të përfitojnë gjithçka në këtë kauzë, jo vetëm vota.

Patriotizmi i tyre i rrejshëm që po vazhdon të kundërshtojë këtë temë të rëndësishme për qytetarin e Kosovës, studentin, punëtorin, të sëmurin, duke i mbajtur të izoluar, po krijon tensione të panevojshme publike te qytetarët.

Liderët kryesorë që po i udhëheqin institucionet duhet të jenë të kujdesshëm, sepse shumë tema profesionale po bëhen tema politike, e kjo praktikë çdo ditë e më shumë po zë vend në politikën e përditshme të institucioneve dhe të vetë shoqërisë sonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot do të mbështes këtë ligj, duke forcuar sovranitetin e shtetit tim si dhe me të vetmen arsye se mund të rishikohet çdo lëshim i mundshëm. Do të votoj, sepse mendoj se qytetarët e vendit tim duhet të lëvizin lirshëm, sikurse të gjithë njerëzit e shumë shteteve të tjera, edhe këta kanë të drejtë të kërkojnë një zhvillim më të mirë arsimor, profesional, ekonomik, njerëzor, e të tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën, zonja Bunjaku pastaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Prita të jap përgjigje në plot aspekte që janë trajtuar prej diskutuesve, për shkak se mendoj se në atë fjalën time hyrëse elaborova çka përmban ligji, edhe pse në ligj, edhe partitë që e kanë përkrahur dikur, mendova në LDK-në edhe në PDK-në, e kanë bazën e vet dhe mund të vazhdojnë atë përkrahje dhe ka bazë të shkojmë tutje.

Njëkohësisht shpjegova që diçka ka ndodhur në periudhën gjashtëmujore, mund të mos jetë ajo që të gjithë kishim pasur dëshirë, por është një zhvillim bukur substancial, është një komision i ri shtetëror, është një raport me të gjetura që dikujt po i pëlqejnë, dikujt më pak, edhe është pjesë e ligjit.

Tani mendoj se raporti i Komisionit shtetëror nuk ka për qëllim të vështirësojë rrugëtimin përpara, nuk besoj që është aty qëllimi i këtij raporti, janë njerëz të shkencës që kanë sjellë aq materie, e cila nëse shfrytëzohet mirë nga vendimmarrësit politikë, nga Qeveria, nga grupi punues, mund ta ndihmojë korrigjimin, mund ta krijojë bazën për korrigjim.

Nuk mendoj që kjo lan turpin e dikujt, as s'krijon favore politike e pushtetmbajtëse, por e mundëson kthimin e territorit ose të drejtën në territor të vendit tonë.

Për mua është kaq, edhe si të tillë e vlerësoj, si të tillë kisha pritur që plot prej juve mos e minimizoni, mos e ulni, mos e harroni që ekziston ky raport.

Unë po dëgjoj mendime se e kryejmë demarkacionin, e pastaj është luftimi i korrupsionit. Mirë qenka, si për opozitën, si për pozitën, nuk besoj që duhet të shqetësohemi për atë, shyqyr po

hiqet një temë prej rrugës, e atëherë po u dashka të merremi me korrupsionin. Nuk e di ku është problemi në këtë rast, sikur disa etapa të tjera, kur kemi biseduar këtu së bashku, jam detyruar t'ju pyes a është, a qëndron kjo, për shembull, a është në rregull, po ju pyes disave këtu, a është në rregull që raporti i Komisionit shtetëror që ka të gjetura, që dikush po i quan edhe konfliktuoze, kontradiktore, nuk përputhen me atë të parin. A është në rregull, pra që e kemi në ligj. A është ndonjë ndryshim, a nuk është fare, a na mundëson diçka më tutje, a është krejt fals, a është edhe ky raport si deklarata e dy presidentëve, apo është diçka tjetër.

Nëse janë njësoj, thoni se janë njësoj, nëse nuk janë, ju lutem, nuk po e them këtë për hatër timin, as për fytyrën time, as me la veten, po nesër si Kosovë duhet kërkuar ndoshta përmirësime, korrigjime, dhe s'e kuptoj pse para se të mbërrimë atje duhet ta dobësuar vetveten.

Jo veç njëri krah, po të gjithë ne po thamë se këto nuk janë asgjë, janë rrena, sa ta lajë fytyrën dikush ose disa. Ndoshta janë ashtu, po mos i gjuani krejt poshtë, shfrytëzoni të nxjerrim korrigjimin, se e keni në ligj, kushdo qofshim ne, a jemi LDK, PDK, VV, AAK, "Nisma", serbët, joserbët, të gjithë, kush e ka qëllimin të korrigjimi, shfrytëzoni raportin. Unë jam sot, nesër nuk jam, dikush tjetër, s'është, vjen tjetri, po shfrytëzoni këtë që i mbetet Kosovës për të kryer punë për vete, për këtë vend, për ato metra, për ato lisa, për atë Bjelluhën, e për atë tjetrën, e atë tjetrën, krejt, shfrytëzoni se i keni në ligj, mos i gjuani apriori, leni aty, nëse nuk besoni mjaftueshëm, të paktën mos i gjuani më shumë, leni aty se i keni.

Po thuhet si të kryhet kjo, vjen asociacioni. Prej frikës që do të vijë, a të rrimë pra kështu, të mos luajmë vendit hiç, po bllokohemi: s'po lëviz Kosova, s'po lëvizin temat, po e bllokojmë veten.

Nuk mendoj që edhe kështu jem duke e ndihmuar as kombëtaren, as progresin, as fuqizimin tonë. Ne duhet të përballemi me çka na pret këtu, dallojnë temat, i kanë dalluar edhe dikur, edhe institucionet e ligjit, Gjykata Kushtetuese ka dhënë një vlerësim për atë temë, e dimë që e ka dhënë.

Po dua t'ju lutem edhe një herë, deputetë, unë i dëgjova fjalimet e më vjen mirë që ka pasion për t'i shpjeguar gjërat, të elaborohen, mendoj se është në rregull çdo gjë.

E vetmja lutje që e kam për ju, pa marrë parasysh në cilën ulëse jemi sot, mos e minimizoni, mos e dobësoni, mos e nënvlerësoni, se në këtë ligj e keni raportin e Komisionit shtetëror, pse, nuk e dimë kush çfarë pune do të kryejë nesër, e ndoshta bash si mua sot që po më bie, mund t'i vijë dikujt të shkojë në korrigjim, e atëherë mos deklaroni kështu përpara se s'ka gjë prej korrigjimit, se është veç pika 7. Ndoshta është 12-shi, nuk është veç 7-shi aty që po i përmendi, ndoshta po harroni që është edhe një pikë diku, një 12.

Po harroni që ka vullnet politik deklarata e dy presidentëve të zgjedhur, presidenti është komandanti suprem, shefi i shtetit është numër një në përgjegjësi të shtetit.

Mos i gjuani këto kështu, ruani aty, mund të thoni çka të doni, ka bazë të mjaftueshme të kritikoni ndryshimin e qëndrimeve, shfrytëzoni çka do qoftë, por mos e minimizoni, mos e dobësoni raportin e Komisionit shtetëror, jo për shkak kush është kush sot, por për temat që na presin në të ardhmen për vendin, pikërisht për ato që realisht u shpreh shqetësim në vazhdimësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albin, a të ka përmendur? Liburn Aliu e ka fjalën. Kështu-ashtu, i “Vetëvendosjes” është. Po kur nuk përmendet askund, në Rregullore nuk është. Krejt çka flasim këtu i referohet çështjes. Krejt vetëm një çështje e kemi.

Liburn Aliu, të lutem, edhe mund ta shfrytëzosh pastaj edhe si qëndrim të partisë. Liburn, Ademi nuk është në bazë të listës që e ka dorëzuar Lëvizja “Vetëvendosje”, jeni ju. Po e bëj të qartë edhe publikisht. Ademi nuk qenka numër 11, ju jeni 15, se i kanë përfunduar të gjithë të tjerët, Sali Zyba 16 e Valon Ramadani 17, s’ka tjetër, këta janë, janë edhe 8 deputetë për diskutim. Faleminderit!

LIBURN ALIU: Unë po e marr fjalën, po flas për diçka tjetër, po besoj që meqenëse tash po i përmend emrin Albin Kurtit, do t’i jepni një replikë pas kësaj.

Fjalimi im nuk do të jetë i gjatë, po për sa i përket çështjes së humbjes së territorit, nuk jam këtu i bindur që asnjë nuk ka dilemë që kjo është duke ndodhur.

Të gjithë i dinë, edhe argumentet. Dikush përpiqet ta kalojë këtë demarkacion për ta shpëtuar Hashimin, dikush përpiqet ta kalojë këtë demarkacion për ta shpëtuar fytyrën e Isës, të kaluarën, dikush e ka tash për pushtet, por kryesorja të gjithë e dinë saktë që këta do të votojnë sot, që do të votojnë për, sot apo kurdo që të vijë puna, do të votojnë për humbje të territorit.

Thuhet kështu, edhe kryeministri e tha, e kuptoj që duhet të keni hezitime për sa i përket votimit, mirëpo do të kemi mundësi edhe të përmirësojmë. Nga njëra ana thuhet kjo, nga ana tjetër thuhet tjetra, që e kemi fqinj Malin e Zi, i cili është anëtar i NATO-s, pra çështjen e prishjes së marrëdhënieve me të.

Unë vetëm dua ta ngre një çështje, çështja e prishjes së marrëdhënieve do të jetë temë kur ne të provojmë ta rishikojmë këtë kufi, jo tash kur ta ratifikojmë. Nëse e ratifikojmë tash, tash nuk i prishim marrëdhëniet me Malin e Zi, po kur ta ratifikosh dhe pastaj fillon të bësh tentativë në bazë të raportit të Komisionit Bulliqi, e atëherë ke punë me shtetin, i cili është anëtar i NATO-s.

Për sa u përket argumenteve të raportit Bulliqi, u tha këtu më herët që ata nuk kanë dalë në terren të bëjnë matje, nuk kanë pse të bëjnë matje, nuk është çështje gjeodetësh kjo që të dilet e të matet. Ata kanë afruar argumente dhe kanë qenë mjaft argumente të fuqishme dhe, në fakt, raporti i Bulliqit për neve duhet të jetë ai i cili e përcakton çdo gjë dhe jo që duhet të vijë kjo çështje tash në votim, po duhet automatikisht të tërhiqet krejt.

Përpos që ka rrezik që ne të hupim territor me kalimin e këtij demarkacioni, unë tanimë e shoh një humbje qysh tash.

Unë personalisht e ndjej humbje të madhe që kryeministri Ramush Haradinaj na e ka sjellë këtu demarkacionin ta votojmë. E konsideroj humbje, për shkak se konsideroj që Ramush Haradinaj me të kaluarën e tij përbën një vlerë të madhe për Kosovën dhe për të ardhmen e Kosovës.

Ne duhet ta kemi të qartë që lufta çlirimtare në Kosovë është themeli i shtetit tonë, qysh do qoftë dhe çfarëdo lloj devijimi i njerëzve të rëndësishëm dhe të fuqishëm të kësaj lufte, e godasin edhe shtetin.

Nuk po më pëlqen që po e shoh Ramush Haradinajn në pozitat e tanishme, se kjo në fakt, tanimë është humbje për ne të gjithë.

U tha këtu më herët që Republika e Kosovës janë qytetarët e saj, janë gratë e burrat, këta janë Republika e Kosovës. Nuk janë vetëm këta Republika e Kosovës. Republika e Kosovës është qytetarët e saj bashkë me territorin, integriteti territorial është një ndër elementet kryesor të shtetësisë dhe pikërisht në integritetin territorial matesh si shtet.

Madje, nuk janë qytetarët apo gjenerata që popullata sot jeton, shteti apo kombi i një vendi apo Republika e atij vendi, është edhe e kaluara e tij, është edhe e ardhmja, edhe gjeneratat që vijnë. Pra, sikurse që është territori, sikurse që janë qytetarët, është edhe historia dhe e ardhmja. Prandaj, nuk mund të kufizojmë te qytetarët e sotëm, që sot janë duke jetuar këtu, kur bëhet fjalë për territorin e Kosovës.

Prandaj, po shpresoj, vazhdoj të shpresoj që shumë prej fjalimeve këtu që u thanë, pati fjalime prej të gjitha grupeve, me të cilat unë u pajtova dhe po besoj që ata deputetë që patën fjalime mjaft të qarta, edhe nga grupet parlamentare të LDK-së e të PDK-së, nuk do ta votojnë dhe ky demarkacion do të bjerë, dhe atëherë do të kemi mundësi ta përmirësojmë dhe të ndërtojmë marrëdhëniet me Malin e Zi tamam ashtu si duhet.

Prandaj, unë ju ftoj që të mos e votojmë këtë marrëveshje.

KRYETARI: Do ta bëjmë përjashtim, por Albin, jo më. Merre fjalën, replikë, por do ta bëjmë vetëm këtë përjashtim, edhe për hir të korrektësisë pasi po shkon seanca mirë.

ALBIN KURTI: Kur më përmendet emri, zakonisht nuk reagoj, është shumë e rëndësishme të reagoj kur përmendet çështja se emri.

Zoti Haradinaj, raporti i Komisionit Bulliqi është aktakuzë, ky raport është aktakuzë. Nuk mund t'i barazojmë tash, si tavolinë suedeze, projektligji, e keni edhe Mehën, e keni edhe Vujanoviçin brenda, e keni edhe Bulliqin, çka të keni qejf, merrni aty. Nuk shkon ashtu. Nuk mund të bëjmë kesi joserioziteti me integritetin e institucionit të Kuvendit edhe me integritetin territorial të shtetit.

Raporti i Komisionit Bulliqi është aktakuzë për zotin Meha e zotin Thaçi, aktakuzë është.

Ky raport thotë ata janë të pandehur tashmë, po ne s'kemi prokurori në këtë vend, s'kemi gjyqësi në këtë vend, s'kemi drejtësi. Këta e kanë shkruar aktakuzën. E tash ju po na thoni neve votoje edhe aktakuzën, edhe të pandehurin, edhe Vujanoviçin e shtetit tjetër, po edhe Thaçin se ai është gjithmonë rrotull aty. Ama nuk shkon kjo punë kështu.

Edhe historia neve na mëson, konfliktet, kontestet, tensionet mes shteteve nuk vijnë prej mosmarrëveshjeve, sa prej marrëveshjeve të këqija.

Luftërat, konfliktet, kontestet, tensionet shumë më tepër i shkaktojnë marrëveshjet e këqija, se sa mosmarrëveshjet. Nëse ne nuk ratifikojmë, asgjë s'bëjmë. Ne jemi Republikë parlamentare, Kuvendi është organi më i lartë, hyjmë në bisedime prapë, ana nëse ne ratifikojmë dhe bëjmë marrëveshje të keqe, e atëherë tensionet janë në prag. Ne jemi për paqe edhe për marrëdhënie të mira me Malin e Zi, ama ky ratifikim e bën të kundërtën e kësaj.

KRYETARI: Fjalën e ka zonja Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Mua më vjen keq për këtë situatë të krijuar në Kosovë.

Një shtet i ri me kapacitete të mjaftueshme në vend se t'i shtyjë proceset përpara, zvarritet që tre vjet për demarkimin me Malin e Zi për teket e atyre që dëshirovan pushtetin me çdo kusht.

Qe tre vjet presion, shantazh, kërcënime, komisione e komisione me para të taksapaguesve tanë.

Kush do të japë llogari për këto tre vjet? Kush do të marrë sipër dëmet që ua keni shkaktuar qytetarëve të Kosovës?

Në kohën kur në Kuvend opozita e bashkuar, e sot pozita, dhanë pasqyrë tmerruese qytetarëve me një pamje të tmerrshme në Kuvendin e Kosovës, ku brenda Kuvendit kishte gaz, ujë e çka tjetër dhe jashtë protesta, unë kam vëzhguar nga larg dhe jam tmerruar, më ka ardhur turp me këto skena.

Po sot po më parafytyrohet kryeministri, disa ministra dhe disa deputetë, të cilët a janë të njëjtë, sa janë të qetë, sa janë të kujdesshëm vetëm e vetëm për të mbetur në pushtet.

Të njëjtit kanë vetëm një dëshirë, të kalojë demarkacioni dhe të vazhdojnë pushtetin.

Pse, burra e gra, jenë aq të qetë, jeni aq të urtë, apo ju ka mbuluar edhe petku dhe po ndiheni komodë në pushtet.

Populli ynë duhet t'i besojë dikujt. Ne i besojmë Departamentit Amerikan të Shtetit, ashtu siç i besuam kur ishim në ditët më të vështira. Ne u besojmë shteteve mike të Kosovës.

Ne nuk duhet të jemi bllokues të qytetarëve, unë si deputete dua që qytetarët tanë të mos presin nëpër ambasada. Tek e fundit, kjo çështje ka marrë tashmë ngjyrime partiake dhe luftë për pushtet, sa që nuk i besohet më askujt.

Aq drejtim të gabuar ka marrë demarkacioni, sa që ka kaluar në absurditet.

Dua të besoj që për një çështje të madhe, duhet të jemi të gjithë bashkë.

Të nderuar deputetë,

Dhe ju deputete,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jam kundër bllokimit dhe kundër temave të njëjta në diskutim për aq shumë vjet, janë lodhur edhe qytetarët me fjalën demarkacion.

Prandaj, sot këtu duhet ta mbyllim këtë çështje. Jam për lirinë e qytetarëve, jam kundër dëmtimit territorial, por jam shumë kundër këtij koalicioni, i cili e shfrytëzoi këtë kauzë vetëm për të ardhur në pushtet. Në vend të shtetit, ju e zgjodhët pushtetin.

Dhe krejt në fund, dua të besoj dhe kam dëshirë që të gjithë të bëhemi bashkë, sepse tërë ditën sot kam marrë mesazhe nga qindra qytetarë të moshave të ndryshme, të cilët kërkojnë lëvizjen e lirë njëjtë si qytetarët e vendeve të zhvilluara. Andaj, nuk dua të besoj që mund të ketë deputetë,

të cilët dëshirojnë ta mbajnë Kosovën të izoluar dhe të bëhen pjesë e kundërshtimit, sidomos me ata që konsiderohen instrument i Beogradit në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Sali Zyba e ka fjalën.

SALI ZYBA: Përshëndetje, të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar të pranishëm,
Kolegë deputetë,
Unë me vete nuk mora letra, as harta, sepse do të duhej në këtë rast të bëja veprimin që është bërë ndaj Komisionit Meha.

Zoti kryeministër,
Kohë më parë në shesh, para disa qytetarëve pati deklaruar se është për sporte të rënda.

Zoti kryeministër,
Sport më të rëndë se të luash me guri të kufirit nuk ka.
Vëllai i tij, Haradinaj, ia bëri me dije Rexhep Selimit që nuk ka ushtarë të mbrohet kufiri, edhe ne e dimë, po jemi të vetëdijshëm secili, sepse këta ushtarë i ka demobilizua nënshkruesi i njëjtë i kësaj marrëveshjeje të dëmshme të demarkacionit.

Andaj, të kemi kujdes, të jemi të vetëdijshëm dhe të vendosim si Kuvend, a do të vendosim sot të mbrojmë kufirin nga nënshkruesi i njëjtë apo do të vendosim ta mbrojmë nënshkruesin nga kufiri.

Në mungesë të ushtarëve, këtu e kemi vullnetin e qytetarëve, vullnet, i cili do të dëshmojë herët apo vonë.

Për subjektin e LDK-së po përmend me emra, qoftë Dritoni, qoftë Lumiri, po i jap mundësi edhe të flasin, si pasardhës politikë të Ibrahim Rugovës, me akuza ndaj “Vetëvendosjes” se e keni vonuar të paktën për tre vjetët e fundit liberalizimin e vizave, jua rikujtoj se pasardhësi biologjik, njëherësh edhe politik i Ibrahim Rugovës, me afërat e në fakt, me mundësinë që ua ka dhënë juve si subjekt të udhëtoni pa viza, e ka vonuar jo pak liberalizimin e vizave, po jo demarkacioni.

Përfaqësuesi, thanë më mirë, zoti Reçica këtu e përmendi suksesi apo të arriturën, referendumin e popullit malazez qoftë për pavarësi, qoftë për procese.

Në mungesë të referendunit jemi detyruar jo vetëm si Lëvizje “Vetëvendosje”, por edhe si qytetarë, e jo pak, së paku 205 mijë nënshkrues që ne e kemi quajtur me të drejtë referendum, po jo vetëm ne, edhe kryeministri i tashëm, atëherë opozitë e bashkuar.

Vota e “Vetëvendosjes” dihet, angazhimi, kauza dhe përpjekja jonë nuk janë vetëm në këtë petition, që nuk është yni, po i qytetarëve, ndërsa ata që u referohen sukseseve apo pozitës në këtë Kuvend, qoftë kur i referohen të kaluarës së vet, qoftë si pasardhës të ideve politike, ju rikujtoj se “Vetëvendosja” e ka angazhimin dhe e ka besimin te qytetarët.

Andaj, kërkojmë që të mos votohet, kërkojmë që të mos jepet mundësia të përsërisim secili individualisht, ata që jemi prezentë, që të bëjmë shkeljen e njëjtë që e ka bërë presidenti i tashëm, e në fjalën e kaluar Haradinaj tha se ka qenë i zgjedhur.

Ne si “Vetëvendosje” dhe si qytetarë të Republikës së Kosovës e kujtojmë edhe zgjedhjen e këtij presidenti me polici, me gjendje të jashtëzakonshme në këtë Kuvend, andaj, të lutem, kryeministër, mos iu refero zgjedhjes ose përfaqësimit si president Hashim Thaçit, sepse shumë pasoja, përfshirë edhe Gjykatën Speciale, do t’i vuajmë ne edhe si qytetarë, por në veçanti si shqiptarë. Faleminderit!

KRYETARI: Elmi Reçica ka replikë.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për të gjithë!

Përsëritje deputetë!

Zoti Zyba, veç një gjë po ta them, që je i njoftuar, dhe të gjithë ju të tjerët.

Çka do të ndodhte po të mos kishte kaluar referendumi më 21 maj 2006 në Mal të Zi? Do të ishim pjesë e një federate Serbi dhe Mali i Zi. Dhe, do ta shihje ti a do të të mbështeste dikush për pavarësinë, si na kanë mbështetur më 2008-ën. Këtë ta keni parasysh. Për këtë arsye po të them se referendumi në Mal të Zi ka qenë një mundësi për ne për ta realizuar pavarësinë.

KRYETARI: Urdhëro, kundër-replikë Sali Zyba.

SALI ZYBA: Shumë mirë që e mban mend, zoti Reçica, datën e pavarësisë së Malit të Zi, po ka shumë vjet që këta të njëjtit njerëz, ky Kuvend me këta përfaqësues të këtij subjekti e kanë penguar, ose s’e kanë lejuar, prej Kushtetutës e deri sot, që të ketë referendum. Andaj, kërkesa jonë ka qenë gjithmonë për referendum dhe në mungesë të referendumit është bërë peticioni.

Në këtë rast, zoti Reçica, nuk pate argument, por pate veç një mundësi të flasësh. Të përgëzoj!

KRYETARI: Rregulloren e respektoj. Hajdar, i gatshëm je, mund të vazhdosh.

Jo, jo, s’ka kundër-replikë, se pastaj mendon opozita që... Le ta përmendë Hajdari emrin, pastaj ta jap fjalën. Hajdar Beqa, fjala për ty.

HAJDAR BEQA: Kryetar, faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Ministra,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht, për temën e demarkacionit kemi biseduar qe tre vjet, por jashtë këtij vendi, jashtë kësaj salle dhe ne i dimë të gjithë arsyet pse nuk kemi diskutuar këtu.

Ne i kemi edhe qëndrimet tona, janë edhe publike, realisht edhe si Parti Demokratike, por edhe si deputetë, në mënyrë konsistente e kemi përkrahur demarkacionin dhe shënimin e vijës kufitare në mes të Republikës së Malit të zi dhe Republikës së Kosovës. Sot nuk kam asnjë dilemë se demarkacioni duhet të kalojë. Këtë janë duke e pritur qytetarët e Republikës së Kosovës, sot vendoset për fatin e dy milionë qytetarëve të vendit tonë. Demarkacioni nuk ka të bëjë me pozitë apo opozitë, por me secilin deputet dhe secili nga ne duhet të mbajë përgjegjësi për izolimin e vendit dhe për votën e vet këtu.

Për vendime të mëdha, siç është edhe marrëveshja e demarkacionit në mes të dy shteteve, duhet të ketë konsensus politik, sepse nevojiten 80 vota dhe për këtë marrëveshje në mes të dy shteteve duhet të kemi konsensus politik. Sot dua ta përgëzoj spektrin politik, institucionet e Republikës së Kosovës për vendosmërinë e tyre, që çështja e ratifikimit të marrëveshjes për shënimin kufitar shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi të marrë fund si epilog, pas debatit disavjeçar dhe këtij debati që tash po bëhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, debat që mendoj se është dashur të bëhet para dy vjetësh.

Qytetarët e Kosovës i kemi lodhur me këtë temë, i kemi bllokuar studentët, i kemi bllokuar artistët, i kemi bllokuar biznesmenët, i kemi bllokuar të gjithë qytetarët, mundësinë e lëvizjes së lirë, mundësinë elementare, i kemi bllokuar për mundësinë e kontakteve me botën, me Evropën. Është faji ynë, sepse është detyrë jona t'i kryejmë detyrat tona. Të nderuar kolegë, secili nga ne këtu përfaqëson qytetarët e vendit tonë. Prandaj, kemi obligim që të jemi në nivel më të lartë të detyrës, duke vepruar dhe menduar në bazë të parimeve të shtetndërtimit, me qëllim të arritjes së synimeve madhore kombëtare, duke marrë përgjegjësi për pasoja dhe duke lënë anash interesat personale, partiake, grupore apo çfarëdo interesash të tjera që mund t'i përfaqësojmë. Ne kemi para vetes marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2015 në Vjenë në mes të palës së Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të bazuar në komisionet shtetërore. Kemi raportin e komisioneve që e kanë shqyrtuar këtë çështje, siç është Komisioni për matjen e territorit të Republikës së Kosovës, Komisioni Ad-hoc për rishikimin e procesit të shënimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi dhe raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit. Përfundimi i përbashkët i të gjitha atyre raporteve ishte se Kosova nuk humb territor. E kemi edhe raportin e Komisionit të Bulliqit, të gjitha këto raporte si orientim për votim. Motivues, besoj, për të gjithë ata skeptikët që kanë

qenë, apo ata që kanë pasur dilema, është edhe marrëveshja e fundit e 16 shkurtit 2018 në mes të dy presidentëve, të Republikës së Kosovës dhe të Malit të Zi, e cila u mundëson të dy shteteve korrigjimin, nëse ka humbje territori nga njëra anë, për të bërë korrektimin, pastaj t'i bëjmë komisionet dhe të dalin në vend të ngjarjes.

Asnjë deputet i këtij Kuvendi nuk është për të humbur territor. Të mos manipulojmë me opinionin publik, të mos shesim patriotizëm folklorik, por t'i kryejmë detyrat tona. Ratifikimi i marrëveshjes është kusht, konsideroj, i padrejtë që duhet ta kryejmë për të marrë liberalizimin e vizave nga Bashkimi Evropian. Ky është një kusht, të cilit nuk mund t'i ikim dhe ne duhet ta realizojmë së bashku edhe me kushte të tjera, siç është luftimi i krimit të organizuar, luftimi i korrupsionit. Ditët e fundit ka pasur deklarata nga zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian se procesi i zgjerimit do të bazohet në merita, prandaj ne duhet t'i kryejmë obligimet tona, qoftë ato që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare, qoftë obligimet tona të brendshme, në fund të fundit, kjo është në të mirën e interesit të vendit tonë dhe obligim e detyrë jona edhe në bazë të Kushtetutës.

Me ratifikimin e marrëveshjes ne tregojmë maturi politike dhe fillojmë të rivendosim besimin te partnerët tanë strategjikë. Kosova është me fat se gjatë gjithë historisë, flasim me fakte, në dy dekada të fundit kemi pasur miq që na kanë mbështetur në vazhdimësi, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Ne nuk duhet ta humbim besimin. Ne e dimë se kemi kaluar një proces të gjatë dhe kemi pasur sukses fal angazhimit dhe luftës së fundit çlirimtare dhe përpjekjeve të brezave. Për më tepër, shënimi i kufirit përforcon subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe sovranitetin e saj, duke shënuar kufirin me një shtet anëtar të NATO-s. Ne duhet ta kemi parasysh atje, se pajtohem me atë se tha edhe zoti Reçica, deputeti i Partisë Demokratike, që duhet ta kuptojmë edhe situatën në Republikën e Malit të Zi, duhet ta shikojmë se çdoherë ka qenë e gatshme të bisedojmë për këtë çështje. I përgëzoj, do të thotë edhe marrëveshjen e fundit, edhe nuk ka pasur dhe nuk ka pretendim territorial as Republika e Kosovës ndaj Malit të Zi, po nuk ka as Mali i Zi ndaj Republikës së Kosovës, kjo çështje besoj që është e qartë.

Të nderuar deputetë,

Sot gjendemi në një udhëkryq dhe duhet të marrim kahun e duhur. Popullit të Kosovës i nevojitet të dëgjojë dhe të shohë se ne jemi të bashkuar për një çështje që ka sjellë shumë përçarje qe tre vjet në këtë vend, ka sjellë pengim të proceseve, pengim të zhvillimit, pengim të integritetit, pengim të ecjes përpara. Mua më befasoi, ndoshta edhe nuk e pata në plan të flas hiç, por më befasuan shumë disa fjalime inspiruese të disa deputetëve të "Vetëvendosjes", ishin tamam fjalime Mic Sokolash, ndoshta edhe të vonuar, shpallin tradhtarë në këtë vend, flasin për klane. Nuk e di, të paktën, deputetëve të "Vetëvendosjes" duhet t'u vijë turp të flasin për klane, e sidomos në këtë situatë, në të cilën ende nuk keni qartësuar cilit klan i takoni ju, e cilit klan i takojnë ata të tjerët, e keni shqetësuar edhe opinionin publik. Ne pamë që fjalimet i keni pasur bukur të mira, po ju kishte ndërruar shkrimtari, se shumica nuk ditët as t'i lexoni ato fjalime që

jua kanë shkruar. Ai shkrimtari, po më duket, ka shkruar në atë grupin tjetër. I shpallët tradhtarë këtu njerëzit, folët për njerëz që nuk mund të shkruhet historia pa ta, nuk mund të shkruhet historia pa presidentin e vendit, pa zotin Hashim Thaçi, i cili është pjesë e të gjitha proceseve që kanë ndodhur në të mirën e këtij vendi. Besoj se të gjithë ju pajtoheni për këtë, pavarësisht qeshni apo jo. Por, ne nuk po jua përmendim një tjetër, se fatkeqësisht, çdoherë kur duhet të marrim vendime të mëdha në këtë Kuvend, fatkeqësisht e them këtë, kur ju bëni kauza ndoshta edhe të rrejshme, kisha pasur dëshirë të na tregoni neve deputetëve, por edhe qytetarëve, se si është e mundur që sa herë fati i Kosovës dhe i qytetarëve është në udhëkryq, Lëvizja “Vetëvendosje” është në qëndrim të njëjtë me atë të Beogradit. O e kemi mirë ne, o Beogradi. Po, edhe sot e shohim kush ka qëndrim, cili është qëndrimi i Beogradit, cili është qëndrimi juaj, ju sqaroheni këtë çështje. Foli për Partinë Demokratike edhe deputeti Selmani, Dritoni, po s’qenka këtu, edhe nuk ia zura shumë për të madhe, se ai ende nuk e njeh mirë Lidhjen Demokratike e të flasë për Partinë Demokratike, po ka kohë, e mëson edhe këtë.

Unë e mbështes këtë marrëveshje, e mbështes fuqishëm, e cila edhe një herë po e përsëris, e përgëzoj edhe marrëveshjen e fundit në mes të dy presidentëve, e cila ka sqaruar dhe jep mundësinë nëse ka gabime eventuale, të korrigjohen. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Glauku ka replikë.

GLAUK KONJUFGA: Njëherë thashë të mos i përgjigjem zotit Beqa, pa e mësuar fjalën “turp” se si t’i thotë, mirëpo, hajt, pasi foli për “Vetëvendosjen”, po ia them nja dy-tri fjalë.

Zoti Beqa, një vendim e keni marrë shumë të dëmshëm në vitin 2013 dhe e keni marrë bashkë me Serbinë dhe me Beogradin. E keni marrë marrëveshjen e 19 prillit të vitit 2013. Unë nuk di marrëveshje më të dëmshme që ka pasur për Kosovën. “Vetëvendosja” e ka kundërshtuar, ju bashkë me Listën serbe e keni marrë atë marrëveshje, bashkë me Beogradin, bashkë me Vuçiqin.

E dyta, zoti Beqa, Listën serbe e keni krijuar ju, është krijuar në negociatat e Brukselit në vitin 2013. Ai idoli yt, Hashim Thaçi, që ti po e përmend, është njeri vendimtar i krijimit të Listës serbe. Tash çka po bën Lista serbe? Ju e keni në Qeveri, e po e akuzoni “Vetëvendosjen”? A e ke në Qeveri Listën serbe, zoti Beqaj? A e keni në Qeveri Listën serbe, ju lutem? E dua një përgjigje të qartë! A e keni Beogradin edhe Listën serbe në Qeveri të Kosovës?

Pyetja e dytë për PDK-në, a e ka krijuar Listën serbe Hashim Thaçi në Bruksel? Shumë e vërtetë është, ai e ka krijuar. Tjetra, a është e vërtetë që Lista serbe po e pengon ushtrinë e Kosovës? A e keni ju në Qeveri? A po e pengon ushtrinë e Kosovës? A e ke në Qeveri, Ganimete, Listën serbe? Ti. Ti, Beqa, Elmiu, Hashimi... krejt ju e keni Listën serbe, ju e keni krijuar.

(Ndërhyrje)

Kush paska lidhje me Beogradin, pra Elmi? Kush paska lidhje me Beogradin këtu? Kënd po e akuzon ti për lidhje me Beogradin? E ke krijuar Listën serbe, e ke në Qeveri Listën serbe, nuk të lë ta krijosh ushtrinë e Kosovës dhe del e akuzon opozitën! Marre duhet t'ju vijë!

KRYESUESI: Kundër-replikë, Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Glauku, prej se u ul në vend të profesorit Sabri Hamiti, po i duket vetja që u bë më i mençur, por, për t'u bërë i mençur duhet të lexojë libra, e jo të dalë para pasqyrës para çdo fjalimi e të përgatitet nga dy-tri orë. Realisht, Lista serbe, edhe të gjitha komunitetet, është kategori kushtetuese, i kanë të drejtat me Kushtetutë, jo Lista, po komunitetet janë kategori kushtetuese. Edhe ju, zoti Glauk, bashkë me Albinin në 2014-ën keni bërë marrëveshje edhe me Listën serbe, në këtë rast me komunitetin serb, vetëm keni pasur një kërkesë: që bisedimet me Serbinë t'i udhëheqë Albin Kurti. Ky ka qenë i vetmi kusht juaji, të cilin e keni thënë çdoherë publikisht. Atëherë, mos shisni patriotizëm, se na keni lodhur. Boll më. Boll më, Glauk!

KRYESUESI: Atëherë, Memli, se ia ka përmendur emrin, edhe Elmiut ia ka përmendur emrin.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përnjëmend e përziu pak Hajdar Beqa fjalën, në vend se të thotë “turp” tha “trup”, po tha me siguri se i ra trup, e po më duket se këtyre u dhembti, se i ra goxha trup, po u kallëzoi drejt.

E vërteta është kjo. I njëjti grup i “Vetëvendosjes” kur kanë qenë atëherë në VLAN me Listën serbe bënin takime të fshehta për t'i përfshirë në Qeveri, se e dinë se s'munden ndryshe, se duhen t'i kenë përfaqësuesit e minoritetit serb, se këtë Kushtetutë e kemi bërë ne të gjithë këtu bashkë, e para. E dyta, marrëveshjen e dialogut në Bruksel e ka ratifikuar me 2/3 Kuvendi i Kosovës. Këta kanë mundur ta votojnë kundër, po 2/3 e Kuvendit të Kosovës e kanë votuar.

E treta, kush e ka themeluar Listën serbe? Po të pyetën gjysmën e LDK-së, edhe disa të tjerë, thonë se ne e kemi themeluar edhe “Vetëvendosjen”. A i keni dëgjuar se 100 deklarata herë thonë SHIK-u e ka bërë “Vetëvendosjen”, herë PDK-ja. Tash, le të na tregojnë këta a i kemi themeluar ne apo jo. Tash reagojnë, thonë, jo s'na keni themeluar ju. Po, s'i kemi themeluar ne, as Listën serbe. Po tashti, të dy palët po e kundërshtojnë demarkacionin. Na lini të lirë, pashë Zotin, t'ia nisim të udhëtojmë edhe ne si krejt Evropa. Leni qytetarët. Sot, nuk po themi ne, në Qeveri e kemi Listën serbe, se pyete, e kemi Listën serbe në Qeveri, edhe nuk kemi qare pa e pasur. Për këtë arsye e kemi. E kemi pasur përpara SLS-në, tash e kemi Listën serbe, nesër kurdo që të vijë dikush tjetër që përfaqëson serbët e Kosovës, do të jenë me ne në Qeveri, por sot jemi duke folur për demarkacionin.

Kush është kundër demarkacionit në këtë Kuvend? Është “Vetëvendosja”, me këta deputetët e pavarur të “Vetëvendosjes” që kanë qenë, e tash s’janë, dy krahët, dhe është Lista serbe. Kjo është e vërteta. Ne s’jemi duke thënë a e jeni ju në Qeveri, a jeni me ta a s’jeni me ta. Për demarkacion është seanca, për demarkacion po flasim. Votat e vetme kundër demarkacionit, që po e pengojnë lëvizjen e lirë, janë tuajat dhe të tyre.

KRYESUESI: Kundër-replikë, Glauku.

GLAUKU: Ti, Memli Krasniqi, i ke dy ditë shkollë sa të kuptosh dallimin përse s’po e voton “Vetëvendosja” demarkacionin e Lista serbe, po me qëllim po i përziën. Lista serbe nuk po e voton se po do prej juve më shumë. “Vetëvendosja” nuk po e voton se po do ta mbrojë territorin e Kosovës. Mbase i ke dy ditë shkollë ta kuptosh këtë farë dallimi! Po, pse i përziën? Për të krijuar opinion publik e ke, që ta vendosësh “Vetëvendosjen” me... e çka nëse Lista serbe e voton? A të të them unë tash ty me Listën serbe qenke?

(Ndërrhyrje)

Po, a po e sheh, domethënë është në nivel të analfabetizmit, për besë dhe ta fyen inteligjencën kjo. Me të thënë “ti me Listën serbe”, e tash po e lut Listën serbe të bëhet me ty. Qysh po i bie kjo punë? Kjo matematikë qysh po i bie, shpjegoma.

KRYESUESI: Elmi Reçica e ka fjalën për replikë.

(Ndërrhyrje)

ELMI REÇICA: Ia kaloj Memlit.

MEMLI KRASNIQI: Elmi Reçica, unë po e marr fjalën. Faleminderit!

Glauk, më duket që e kalove minimumin e etikës parlamentare, që nganjëherë ti, bile, e ruan, se u lëshove në nivele të ulëta. Nuk i kam dy ditë shkollë. Kam goxha shumë ditë shkollë, besoj aty diku me ty, në mos më shumë. Njëmend, ti e ke shkruar një libër, kam dëgjuar, unë s’ kam shkruar, po kam lexuar, besoj pak më shumë se ti.

Po, këtu jemi duke folur për politikë. Jemi duke folur për diçka tjetër. Unë nuk ju thashë, edhe po e përsëris A jeni ju me Listën serbe, a s’jeni? Unë thashë që sot demarkacionin janë këto dy grupe që nuk e votojnë. Edhe ju jeni njëra palë, pala tjetër janë ata. Thatë: “Me ba me votue...”

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Valon Ramadani.

VALON RAMADANI: Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Dua që, së pari, në emrin tim personal të përgënjeshtroj lajmin e dhënë mbrëmë në lajmet qendrore të RTK-së se qytetarët po kërkojnë ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Unë si qytetar i këtij vendi nuk jam nga ta, ani pse RTK-ja linte përshtypjen se të gjithë qytetarët, pra përfshirë edhe mua, po kërkojnë ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi.

Qytetarët vërtet duan të dalin e të punojnë për veten dhe familjet e tyre, sepse janë të dinjitetshëm, sepse këtu nuk u keni ndërtuar perspektivë atyre dhe me ju ata as nuk shohin perspektivë. U keni bërë padrejtësi e i keni plaçkitur, madje çka është lajmi më i keq për vendin, ju po përpiqeni që korrupsionin dhe dukuritë negative t'ua përbrendësoni atyre, t'ua shndërroni në ndërgjegje si diçka normale. Ju, kush me vetëdije e kush pa vetëdije, jeni duke kontribuar ta denatyrizoni popullin shqiptar, ta leni edhe pa vetëdije kombëtare e pa moral. Shqiptari nuk e jep tokën e shenjtë të shtetit për të shkuar diku për qejf, aq më tepër që edhe ky favor i premtuar është i rremë, sepse qytetarët janë të privuar nga lëvizja e lirë për shkakun se Bashkimi Evropian ju di juve për të korrupuar dhe nuk ju beson dhe kurrsesi se ju mund ta luftoni korrupsionin. Kur ju thoni, ta votojmë demarkacionin që të lëvizim të lirë, ju a e dini që ashtu fyeni ndjenjën dhe lojalitetin e qytetarëve të Republikës ndaj atdheut e shtetit, fyeni gjithashtu edhe inteligjencën e tyre. Fëmijëve të dëshmorëve, të veteranëve, të veprimtarëve të paraluftës po u thoni: “Të japim tokë të mbrojtur me gjak që të dalim për qejf”.

Të nderuar deputetë,

Unë besoj në shqiptari, unë besoj në drejtëkuptimin e shqiptarëve, sado që ju e qitni në mjegull. Unë besoj në gjallërinë e ndjenjave shqiptare, sado që ju i qëlloni për t'i mbytur. Unë besoj se ka orë të reagimit të tyre ndaj sojit tuaj, ndryshe historikisht nuk do të ishim ruajtur ne dhe toka jonë.

Gënjeheni keq nëse mendoni se nuk do të bëhet asgjë me ju nëse votoni këtë demarkacion. Do të bëheni turpi i vendit dhe ngarkesë psikologjike për fëmijët tuaj. E përmenda më herët rastin e lajmeve të mbrëmshme të RTK-së vetëm si shembull të freskët për karakterin e propagandës së oligarkëve tanë, të cilët për ushtrinë kanë interes vetëm ta adresojnë se për faj të kujt nuk u formua dhe kaq. Kurse, për ratifikimin janë të interesuar ta kryejnë sa më parë, madje edhe ta bindin opinionin publik, që opinionit t'i qesin opium, që ai të mos këndellet e të mos i quajë tradhtarë e t'u lërë vend ende në shoqëri.

Thjesht, me ratifikim Kosova humb tokë, tash e vërtetuar kjo dhe nuk ia vlen të jepet toka që është trashëgimi e dëshmorëve dhe për ata që ende nuk kanë lindur që ne të sotshmit të gjezdisim, e aq më tepër, që burime nga Bashkimi Evropian na konfirmojnë se jo ratifikimi, po korrupsioni është pengesa për liberalizim.

Në fund të fjalimit tim, duke pasur edhe një shpresë, dua t'u adresohem deputetëve të AAK-së dhe të "Nismës". A nuk e kuptoni ju, deputetë të Aleancës dhe "Nismës", se ju po votoni kundër bindjes suaj që keni shpërfaqur për demarkacion? Mos e votoni, të paktën edhe ju, dhe ai nuk kalon pa ju. Toka mbetet pa u humbur dhe ju mbeteni pa u shkrirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Ju përsëndes, udhëheqës!

Mua më duket se mbarëvajtja e seancës ka qenë sot për lakmi, për të gjitha, edhe diskutimet, edhe këto vite që po thonë kanë humbur, unë s'po i shoh si të humbura, por po i shoh disa si mësim për demokracinë.

Unë mendoj se fjala e zotit Kurti ka qenë e drejtë, ka qenë e vërtetë dhe unë e kam bindjen që po, Kosova po i humb ata 8 200 hektarë. A e dini pse e kam atë bindje, se s'më duhet as Meha, as Bulliqi, po e di vetë gur për gur ku është kufiri. Po tash, i nderuar Albin, jemi ku jemi. Të gjithë e dimë ku ka rënë guri, shpëtojmë çka mund të shpëtojmë. Unë mendoj se një mundësi e madhe, pa nguti, më mirë është të varemi e të na ndihmojë "Vetëvendosja" sesa të varemi prej dikujt tjetër. Kështu që, nëse diçka nxjerrim çka kemi humbur, se është shumë vonë me kohë, edhe pse nganjëherë po dalim te liberalizimi e te tjerat gjëra, por ky moment, nëse votojmë të gjithë, atëherë i kemi shanset më të mira për të kërkuar diçka që është e jona. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Albulena Balaj-Halimi flet, Arben Gashi bëhet gati.

ALBULENA BALAJ-HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Unë kisha sot një propozim.

Nëse edhe sot nuk kalon demarkacioni, pra plus me aneks-marrëveshjen e arritur, do të duhej që Qeveria ta shtypte nga një mirënjohje për secilin qytetar të Republikës së Kosovës, i cili vendos të qëndrojë në Kosovë dhe të sigurohet që atyre deputetë që kanë mbetur në "Vetëvendosje" t'ua shpërndajë ato, sepse mendoj se ua kemi nxirë jetën qytetarëve me këtë demarkacion.

Për vendime të lehta mendoj se jemi në shtëpi, e këtu mendoj se do të duhej të merrnim vendime pak më të rënda. Faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi, fjala për ju!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sonte jemi këtu për ta marrë vendimin më të rëndësishëm të kësaj legjislature. Natyra e punës sonë është e tillë. Na bie përgjegjësia që të marrim vendime, të cilat nuk janë vetëm për ne. Nuk janë të thjeshta dhe nuk janë të lehta.

Sonte ne po e marrim vendimin për ta përcaktuar vijën kufitare me fqinjin tonë, Malin e Zi, vend ky që në njëzetvjeçarën e fundit është karakterizuar me qëndrime kryesisht miqësore dhe përkrahëse për shtetin tonë. Vendimi nuk është i lehtë, sepse gjithmonë ka qenë sfida e vështirë për të përcaktuar kufij, sidomos në situatën tonë kur kombi ynë ka pasur dhe vazhdon të ketë jashtë vijave kufitare shumë bashkëkombës të vet.

Sot ne e kemi para vetes një çështje konkrete si kurrë më parë, e cila ka shkaktuar shumë përçarje dhe armiqësi ndërmjet nesh. Tre vjetët e fundit ne e pamë gjithsecilin si armik, si të shitur, si tradhtar. Për më tepër, gjendja kishte eskaluar deri aty sa kishte të rinj dhe të reja që e duan këtë vend, e që në emër të dashurisë për vendin ishin të gatshëm që Kuvendin e vendin e tyre edhe ta bombardojnë, ngase urrejtja në ndërmjet nesh për një çështje, e cila do të duhej të na bashkonte, na ka përçarë. E kjo sepse sot shumë këtu, e sidomos ata që janë ulur në karrigen e pushtetit, e kanë trajtuar këtë çështje si një mjet për të arritur qëllim politik, qëllim i cili nuk duhet të arrihet me këtë kauzë.

Sot si kurrë më parë ne jemi të ndarë në “ne” dhe “ju”. Sot si kurrë më parë ne jemi të ndarë në përhapës të urrejtjes dhe ata që e përdorin urrejtjen për ta motivuar forcën e dhunës për qëllimin e tyre politik. Por, a jemi sot ne këtu të fokusuar vërtet aty ku është problemi? A jemi duke punuar që vërtet ta dimë ku është kufiri? A jemi duke kontribuar që ta gjejmë zgjidhjen dhe ta drejtojmë vendin në rrugën e duhur, apo ne sot të gjithë kemi rënë në grackën e mediokritetit të ambicies personale, apo të kauzës grupore për pushtet?

E vërteta është se situata ka ndryshuar pak, sepse disa nga protestuesit e dhunshëm të deridjeshëm sot janë ulur në karrigen e pushtetit dhe e kanë harruar gjuhën e urrejtjes, të denigrimit dhe të linçimit. Sot janë bërë paqësorë, siç dinë të bëhen vetëm qyqarët, sepse sot në lakminë e pushtetit dhe në rehatinë e përfitimit kanë tjetër pozicion.

Unë, sikur në të shkuarën, edhe sot refuzoj sjelljen obstruktive. Unë, sikur në të shkuarën, edhe sot e refuzoj gjuhën e komunikimit që e dëgjoj këtu. Unë sot, sikur edhe në të shkuarën, e refuzoj gjuhën e sjelljes në këtë sallë. Unë sot, sikur edhe në të shkuarën, refuzoj që njëri-tjetrin ta quajmë tradhtar, vetëm pse nuk mendon si unë.

Por, ne sot do të jemi në nivelin e përgjegjësisë të të zgjedhurit të popullit, në emër të të cilit ne sot duhet të vendosim për të marrë përgjegjësi.

Jam para jush, jo për të ju thënë se sa të këqij jeni ju që na penguat për vite të tëra që ne t'i përfaqësojmë qytetarët tanë, apo se sa gabim ishit ju të tjerët kur na mohuat me dhunë të drejtën e përfaqësimit, ngase pretendonit se ju jeni pronarë të së vërtetës, se ju jeni e vërteta vetë, se sot ju vërtetoni se jeni e pavërteta dhe se jeni mashtrimi.

Sot më duhet t'jua kujtoj se si ju refuzuat që të merremi vesh për një material, i cili do të kalonte këtë çështje para një viti, material i cili ofronte zgjidhje, material që është baza e zgjidhjes së sotme. Ju refuzuat nga lakmia për pushtet, nga lakmia për lavdi, por harruat se pushteti është përgjegjësi dhe sot ju që jeni ulur në karrigen e pushtetit me kokën poshtë, sepse jeni në gjendje të bëni zgjidhje për pushtetin, e jo zgjidhje nga dashuria për shtetin.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Më lejoni që unë sot si njëri nga ju, apo si përfaqësues juaji, të marr vendimin tim për vendin tonë. Ne sot i japim një mundësi për të ecur përpara vendit tonë, prandaj duhet të jemi të bashkuar dhe të ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar, kolegë,

Kor diplomatik,

Medie,

Me të vërtetë sot e kemi bërë një debat të gjatë. Tani po bëhen tetë orë që jemi këtu, e po diskutojmë. Është një debat i rëndësishëm.

A mendoni ju se që nga shtatori e deri më sot nuk e kemi bërë një debat për zhvillimin ekonomik, për të mirën e qytetarit, por na ka shkuar krejt koha duke biseduar, duke u përplasur njëri me tjetrin, e çështjet nacionale nuk jemi në gjendje që ne të ulemi bashkë e t'i trajtojmë së bashku, ta marrim një vendim të përbashkët dhe t'i kalojmë.

Ne po e hapim rrugën për Listën e serbëve. Që ata të na kushtëzojnë, ne jemi fajtorë. Jo dikush tjetër! Ne mund të vendosim. Do të thotë, kur të jenë çështjet nacionale, ne nuk duhet të presim që ku me ditë kush të vijën e të na i zgjidhë problemet. Kemi harruar që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Britania e Madhe na kanë ndihmuar të vijmë deri këtu, dhe pikërisht ata janë garantues të këtyre çështjeve madhore, e ne nuk jemi në gjendje t'i zgjidhim.

Çka po presim? Mali i Zi është NATO. Ne deri kur? Është dashur ta trajtojmë me kohë, e tani është e vonshme për të qarë me lot krokodili. Mendoj që është koha kur ne duhet t'ia hapim rrugën qytetarit tonë, që e kemi bllokuar në të gjitha anët. Qe sa vjet po e bllokojmë?

Mendoj që edhe deri më sot që u bllokua, nuk ka qenë e drejtë. Prandaj, ne duhet të mos harrojmë, pse jemi bërë deputetë nuk do të thotë që duhet mbajtur fatin e qytetarit në duart tona, thua se ne ku me ditë çka kemi shpikur. Mendoj që është koha më shumë se kurrë që ne të jemi unikë dhe të vendosim ta çojmë këtë çështje përpara, por unikë e të përbashkët.

Nuk na bën nder nëse ne shpërmdahemi, e fyejmë njëri-tjetrin dhe nuk i zgjidhim çështjet tona nacionale. Për çështje nacionale, ne duhet t'i lëmë debatet folklorike për përfitime politike, duke mos i çuar çështjet përpara. Neve sot tërë ditën qytetarët na kanë pritur dhe na kanë përcjellë se çfarë po bisedojmë, prandaj për këtë nuk kisha dëshirë që ta marr fjalën tërë ditën, vetëm që të mos bëjmë shumë popullizëm dhe të përfitojmë ne nga qytetarët. Ne e kemi fatin që ne ta zgjidhim këtë çështje.

Ju lus që të reflektojmë mirë dhe t'i çojmë përpara dhe ta dimë kë e kemi garantues prapa nesh, e të mos i harrojmë ato të mira që na janë bërë deri më sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Anton Quni fjalën e ka. Edhe një deputet është i lajmëruar dhe përfundon debati pastaj, ta kini parasysh.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër,

Ministra,

Të gjithë ju që po na përcillni nëpërmjet medieeve,

Mendoj se u thanë të gjitha, por fjala ime do t'i adresohet kryesisht kryeministrit, zotit Ramush Haradinaj, më shumë si këshillë.

E di që është lodhur, por i kisha bërë thirrje që të ketë vëmendje, sepse është në interes të të gjithë qytetarëve.

Para tre vjetësh, pasi u shkëputën urat e komunikimit me dhunën që u shpreh këtu në Parlament, por edhe jashtë Parlamentit, kryeministrit Ramush Haradinaj iu pata drejtuar me një letër publike. E vetmja gjë që kërkoja në atë kohë ishte që të bisedojmë, të bisedojmë këtu brenda Parlamentit, me bindjen se kur të bisedojmë do ta gjejmë zgjidhjen.

Kërkoja atë që po e bëjmë sot. Dhe, krijohet përshtypja se shumica e deputetëve e tregojnë një vullnet të mirë, se jemi shumë afër zgjidhjes. Sot, kur ne flasim për kufijtë shtetërorë do të duhej

të ishte një akt ceremonial, sepse është një moment historik, se me këtë akt ne po e fuqizojmë, po e zhvillojmë e po e ngremë shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Por, para tre vjetësh, kur u hap kjo temë, të gjithë ishim në kërkim të së vërtetës dhe i vizitonim ato fshatrat pranë kufirit Kosovë dhe Mal i Zi, takonim familjarë e kryefamiljarë, takonim klerikë, takonim zyrtarë të ndryshëm, takonim njohës të kësaj problematike, në kërkim të së vërtetës. E të gjithë ne u premtonim se do t'i mbrojmë interesat e tyre pasi i dëgjonim të gjitha ato fakte, argumente, histori për ngjarjet e atyre banorëve të Grykës së Rugovës, të fshatrave të Podgurit në periudha të ndryshme. Ato fakte dhe argumente ne jemi munduar t'i prezantojmë dhe t'i shfrytëzojmë që ta arrijmë një marrëveshje të përbashkët.

Zoti Fatmir, nëse ka mundësi vetëm pak, se është shumë me rëndësi kjo që do ta them. Faleminderit!

Zoti kryeministër,

Ju në atë kohë më së shumti e vizitonit këtë zonë. Keni bërë marshime atje, keni bërë eksplorime të asaj zone. Besoj se edhe ju i keni parë edhe pozicionet e luftërave të ndryshme, keni dëgjuar histori të ndryshme, përjetime të ndryshme, se Çakorri e Kulla duhet të jenë pjesë e territorit të Kosovës. Po ashtu, i kam vizituar edhe unë, por jo në atë masë siç e keni bërë ju.

Ju keni premtuar se do t'i mbronit të drejtat e tyre, po ashtu ju kam premtuar edhe unë. Por ju në atë kohë fuqishëm i kundërshtoni të gjitha përpjekjet që të arrijmë një marrëveshje.

Tani jemi në pozitë, ku ju e kërkonit besimin e deputetëve që të përkrahim një marrëveshje, mund të them, me ndryshime kozmetike, por në esencë është e njëjta marrëveshje, të cilën e ka prezantuar ish-kryeministri, akademiku Isa Mustafa, para tre vjetëve.

Derisa bëhej këtu një performansë e dhunshme, ato banorë ju përkrahnin jashtë Parlamentin. Në mesin e tyre kishte intelektualë, profesorë, kryefamiljarë, me kostume tradicionale, me flamuj kombëtarë të Kosovës, me flamuj dardanë dhe e përkrahnin kauzën për të cilën ju luftonit. Ato ishin të bindur se ju kufirin do ta vendosni në Çakorr, do ta vendosni në Kullë, kurse sot kërkonit që ne t'ju besojmë. Ju kërkonit që ne t'i besojmë marrëveshjes të arritur mes presidentit të Republikës së Kosovës dhe presidentit të Malit të Zi.

Por, mendoj që është rendi, pasi e keni kërkuar ndihmën e banorëve të atyre fshatrave që edhe sot ta kërkonit bekimin e atyre njerëzve, të cilët ju dhanë përkrahje në ato kohë.

Nëse ky është akt ceremonial, atëherë aty ku janë të vendosur gazetarët, me kamera, në këtë lozhë, sot do të duhej të ishin edhe ata banorë, përfaqësuesit e tyre dhe të pajtohen e të japin bekimin se ne po e bëjmë një punë të mirë.

Zoti kryeministër,

Të lutem, krijoni një hapësirë kohore, ashtu siç keni biseduar në të kaluarën me këta banorë, tani t'i bindni se kërkesa juaj, kjo mënyrë e zgjidhjes së problemit është e vetmja. Është mirë që në seancën e ardhshme, kur të votohet, të jenë edhe ata prezentë këtu, sepse ky është një akt ceremonial dhe ta kemi bekimin e tyre, sepse pa bekimin e tyre është me pikëpyetje a po e bëjmë këtë punë si duhet dhe a është në ndërgjegjen e deputetëve që ne të flasim për një çështje që banorët e asaj zone e dinë shumë më mirë se ne dhe shumë më mirë se Komisioni i Mehës apo i Bulliqit.

Nëse në atë kohë, kur ju e kundërshtoni, forcën e gjenit të banorët e kësaj zone, atëherë është e rendit, është në traditën tonë, është në kulturën tonë që po me të njëjtit të uleni të bisedoni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Pasi e pati në fund si mesazh, pasi ishte me banorë, vazhdojani.

ANTON QUNI: Faleminderit, për mirëkuptim!

Dhe, me këtë akt ne si deputetë do të jemi shumë më të bindur, shumë më të relaksuar se po e bëjmë një punë të mirë.

Nëse ne nuk e kemi përkrahjen e atyre banorëve, atëherë gjithnjë gjatë jetës sonë do të na vrasë ndërgjegjja. Faleminderit!

KRYETARI: Kujtim Shala, nënkryetari. Milaim, ke folur më herët. Jo, ka folur, po do replikë se e kanë përmendur Suedinë, për këtë!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Jemi në fund të një dite të gjatë dhe një debati, besoj, të rëndësishëm që lidhet me një nga problemet e mëdha, çështje të mëdha të shtetit tonë që ka bartur pas vetes këto tre vjet dhe një prej, besoj, intrigave më të mëdha të historisë së re të shqiptarëve.

Kjo do të duhej të na bënte që ne sot të ishim pak më konkretë, të flisnim përtej pozicioneve politike dhe të arrinim sado pak kush sa ka fuqi të shpërfaqë argumentet lidhur me këtë çështje.

Unë do të përpiqem të flas shkurt, të jem sa më specifik për dy-tri çështje, e që janë krejt konkrete, të cilat janë thënë dhe janë përsëritur edhe sot, një pjesë e tyre, për fat të keq, të pavërteta, po që kur të përsëriten shpesh, pastaj po duken të vërteta.

E para, ne kemi para nesh një dokument, një projektligj, i cili është tepër i shkurtër, po e përsëris tepër i shkurtër që të jetë aq i çuditshëm sa që është ky dokument. Është një nga dokumentet më të çuditshme që kam parë ndonjëherë, të them, dokument me copa, të cilat vetë ndërtojnë diçka, pastaj e rrënojnë dhe e them këtë sepse e gjithë përpjekja e Lidhjes Demokratike e Kosovës ditëve dhe javëve të fundit ka qenë në drejtim të asaj me qëllimin që ne t'i japim një shkallë sado të vogël legaliteti dhe legjitimiteti këtij dokumenti.

Ne kemi diskutuar edhe sot, pa pranuar që, ta themi drejtpërdrejt, vetëm një marrëveshje, sepse s'kemi marrëveshje të tjera dhe mua më duhet ta përsëris.

Dokumentet që i janë bashkuar këtij projektligji kanë një efekt politik, unë e çmoj shumë, por ato janë një rrugë politike, një dalje për ata që vetes s'i kanë lënë asnjë rrugë, asnjë dalje në këtë proces kaq të rëndësishëm dhe të ndërlikuar.

Çështja e demarkacionit të kufirit të Kosovës me Malin e Zi nuk është aspak më specifike se çështja e demarkacionit të kufirit të vendeve të ish-Jugosllavisë.

Origjina e rregullimit të tij paradoksalisht janë vitet '30, sepse thuhet, edhe në tekstin, edhe në raportin që e keni ju, në raportin e komisionit që po e quani raporti i Komisionit Bulliqi. Unë, për fat të keq, vërej se janë shumë pak kolegë që e kanë lexuar, përfshirë edhe kryeministrin.

Dhe unë i kërkoj kryeministrin, meqë është dokument i porositur, që atë dokument ta mbajë në tavolinë, po së pari kërkesa themelore është ta lexojë së bashku me ekspertë dhe ta kuptojë. Nëse e kupton, do të shohë që ai raport dhe raporti i Komisionit Meha janë totalisht të ndryshëm, totalisht të ndryshëm për nga natyra dhe për nga pretendimet.

I pari që merret me problemin dhe i dyti që vlerëson dhe që tenton të sjellë argumente që të kundërshtojë të parin, pa argumente të një natyre tjetër, që të jetë e qartë.

Raporti i parë ka bazë themelore kadastrin, për atë i përmenda vitet '30, sepse kadastri që na intereson ne, kadastri i Komunës së Pejës është i vitit '30, çka do të thotë kjo, s'është e vërtetë që më 1930 Kosova dhe Mali i Zi kanë pasur kufi, sepse s'kanë ekzistuar si entitete. Por më 1930 janë përcaktuar kufijtë e Pejës, ata kufij dhe ai territor që e ka edhe sot, me një ndryshim tepër të vogël në zonën në drejtim të komunës së Istogut, te Banja e Pejës, zonë të cilën besoj e njihni të gjithë.

Tani, s'është e vërtetë që ish-Federata Jugosllave ka pasur një vazhdimësi administrimi dhe rregullimi kushtetues dhe s'është e vërtetë që Kosova e ka pasur të njëjtin territor gjithmonë, as në vitin 1945, as në vitin 1974, e të mos flasim për vitin '30, sepse s'ekzistonte.

Tani, pse na duhen dokumentet e vitit 1930 dhe këndej, sepse rregullimi, të cilin e njeh, të Federatës ish-Jugosllave, të cilin e njeh ligji ndërkombëtar është ai vendosur me Kushtetutën e vitit 1974 dhe ajo kushtetutë e ka pjesëtuar ose i ka lidhur ato vende mbi bazën e territorit të administruar të komunave dhe këtu ka edhe ish-kryetarë të komunave dhe ish-nënkryetarë të komunave, të cilët e dinë që kufijtë e komunave, kufijtë administrativë të komunave janë kadastralë. Nëse ka një kontest, për shembull, për zonën industriale në mes të Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Fushë-Kosovës dhe sillen dokumente që pretendojnë administrim, si zgjidhen në fund ashtu, cili është i zoti, ai që ka letrën poseduese, këtë duhet të keni parasysh.

Tani, pse kjo është e rëndësishme? Sepse Komisioni Badinteri, i cili, ç'është e vërteta, s'i referohet drejtpërdrejt rastit të Kosovës, por Ahtisari e përsërit, pa ia thënë emrin, sepse i merr kriteret e tij dhe ai thotë që duhet të kihet parasysh rregullimi kushtetues, territori dhe të gjitha çështjet e tjera 74, 31 dhjetor 1988. E çka kuptojmë këtu, që ai vërtet kodifikon territore kadastrale. Tani cili është pretendimi? Që territoret e Kosovës kanë mbetur jashtë Kosovës dhe kjo do të thotë që ka territore të Kosovës, të cilat nuk i takojnë asnjë komune të Kosovës, s'mund të jetë kështu.

Kadastru i Kosovës është i plotë, kadastru i Malit të Zi është i plotë, më jep atë dokument.

Këto janë dokumente të skanuara, dokumente origjinale, të cilat e provojnë vazhdimësinë e administrimit të territoreve mbi bazën e kadastrit, janë të të gjitha periudhave.

Tani, unë do t'ju jap edhe një argument tjetër dhe ta mbyll, sepse kjo çështje shpjegohet përbrenda saj që rregullon ligji ndërkombëtar, ose e drejta ndërkombëtare.

Janë 37 banorë, qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët kanë prona në zona të cilat ne po i kontestojmë, 37, 29 janë banorë të Deçanit, 7 janë të Pejës.

Prona e parë e regjistruar, për të cilën paguhet tatim, është e vitit 1955, prona e fundit është e vitit 2015. Tani, pse po i them këto? Sepse kryeministri ka një detyrë jashtëzakonisht të vështirë, edhe unë e kuptoj pozicionin e tij, edhe personal, edhe politik dhe detyra e tij e vështirë tashmë nuk është a miratohet, a ratifikohet kjo marrëveshje a jo, pa a do të arrijë të korrektojë ashtu si pretendon ai dhe duhet të ketë kujdes, sepse këto që po ju them unë, ne të gjitha ato që ekzistojnë si fakte duhet t'i marrim si fakte, se edhe rastin të cilin e kemi në dorë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem!

KUJTIM SHALA: Rastin që e kemi në dorë, nëse s'i shohim faktet, e rrezikojmë edhe atë.

Tani unë edhe një herë, si përfaqësues politik i jap mbështetje të plotë kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës që këtë çështje ta trajtojë deri në fund. E kam thënë edhe në fillim të seancës, e përsëris asnjë milimetër e territorit të Kosovës nuk duhet të mbetet jashtë kufijve të saj, asnjë milimetër dhe në këtë do t'ia kërkojmë kryeministrit për çdo ditë, por as unë, as ju nuk besoj që do të pretendojmë për territore që s'janë tonat. Besoj që pajtohemi, as Mali i Zi, por unë nuk mund t'i kërkoj Malit të Zi të mos ketë pretendim, duhet t'i kërkoj kryeministrit të Kosovës që të mbrojë interesin e Kosovës.

Gjithë dokumentacionin që e ka ai dhe të gjitha të dhënat e tjera të reja, të mundshme, duhet përfshihen në punën e komisioneve të përbashkëta dhe mua më intereson që ato të dhëna t'i ketë komisioni ynë, sepse ai ne na përfaqëson. Edhe një herë, as që bëhet fjalë që kryeministri të heqë dorë nga pretendimi i tij, vota jonë, vota e Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk është votë që të çlirojë kryeministrin, po që të kodifikojë pozicionin e tij, sepse kryeministri, edhe politikisht, edhe si njeri që e udhëheq këtë vend, edhe si burrështetas e ka barrën dhe karriera e tij politike lidhet me këtë rast.

Unë s'i them kryeministrit: "Çoje kufirin në Qafë të Çakorrit", sepse ka thënë ai, unë i them kryeministrit edhe një herë që territori i Kosovës të mbetet brenda kufijve të Kosovës. Asnjë fakt të provueshëm ne s'do ta kontestojmë. Pse do ta kontestoni? Kush është ai që e konteston, asnjë fakt, të gjitha faktet, të gjitha pretendimet të sqarohen dhe pastaj kryeministri të vijë e të raportojë pas ratifikimit të marrëveshjes, pas procesit të korrigjimit dhe të rishikimit, sidomos në ata sektorë dhe nëse ka nevojë edhe në sektorë të tjerë.

Por, të keni kujdes, nëse bëhen korrigjime, si thotë marrëveshja, të balancuara, ajo i bie që ne i marrim Malit të Zi 500 metra diku, e ai na i merr ne diku tjetër. Ky s'është procesi që po kërkoj unë. Procesi që kërkoj unë me fakte është tjetër.

E dyta, nuk kërkojmë që nëse i marrim 700 hektarë, Mali i Zi t'i marrë 700 hektarë të tjerë, sepse është marrëveshje e një natyre tjetër. Ajo i bie që ne do të negocionim ndërrim territorësh, as ajo s'mund të kërkohej.

Tani, kryeministri duhet të ketë kujdes me raportin që e ka, sepse po kryeministri po thotë që s'ka qare, pa tjetër që s'ka qare. Është një dokument, siç po e thotë kryeministri, i një Komisioni shtetëror, i cili duhet ta ketë parasysh, duhet të përpiket të korrektojë dhe në bazë të tij. Përballë fakteve që njoh unë, besoj që ajo është një punë tepër e vështirë dhe pretendimi i kryeministrit është tepër i vështirë.

Ne do të kemi mirëkuptim, zoti kryeministër, ju do të keni kohë, por ju do të arsyetoni gjithçka që do të ndërmerri në këtë proces.

Meqë s'ishit këtu, po e përsëris, vota për e LDK-së nuk është që t'ju çliroj ju, vota për e LDK-së është që t'ju mbajë në këtë proces deri në fund, deri sa të korrektohen gabimet e pretenduara, të cilat ju thonë që janë të konstatuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ali Lajçi i ka dy minuta, po jo të tjerët, Liburn, jo, kërkoj falje.

ALI LAJÇI: Po më vjen keq prej një intelektual, ku na kthen në vitin 1930, në një kohë të një Jugosllavie totalitare, domethënë modelin e një totalitarizmi, i cili ka qenë si strukturë administrative në Banovina. Ne duket se sot flasim për Republikën e Kosovës shtet sovran e të pavarur, që nuk ka qenë as në modelin e ish-Jugosllavisë mbretërore, por as në modelin e Jugosllavisë diktatoriale, por është në një realitet i ri krejt dhe bëjmë fjalë për kufij shtetërorë dhe të Republikës, por jo për vitet 1930 të kohës së Serbisë serbomadhe.

Prandaj, përkrahja e 1930-ës është përkrahja dhe kthimi i saj me kohën tonë që nuk është e pranueshme Serbia shtetmadhe.

Ju lutem, intelektual, shikoni kontekstin kohor, bisedat dhe argumentet dhe më s'kam qejf të të shoh në këtë pozitë.

Prandaj, jemi një realitet tjetër, ky i yti ka perënduar sipas kësaj që ju thatë, u krye dy Jugosllavi përpara. Prandaj, të lutem mbërrimë në këtë kohën tonë të Jugosllavisë tjetër, e kalimin e saj në një shtet sovran të Republikës së Kosovës, i cili tashmë nuk i definon kufijtë në baza kadastrale, por në baza shtetërore. Edhe pronën publike, dhe ju doni t'ia jepni Serbisë, Malit të Zi edhe pronën publike me pasuritë e saj, e cila është e pamundur zotërinj, sepse nuk shkon vetëm faktori apo bazikja, siç ju e mendoni - kadastra në kufij shtetërorë.

KRYETARI: Liburn, të lutem, Kujtim nënkryetar, pastaj i merr dy minuta i ke kundër-replikë. Liburni po insiston po e shoh, si argument po thotë, çështje e argumentit.

LIBURN ALIU: Çështja e kufirit republikan dhe e zonës kadastrale në përgjithësi është çështje konceptesh kadastrale. Këtu nuk dalim prej koncepteve kadastrale, por kur niveli më i lartë i kufirit ndryshon dhe nuk përputhet me atë më të voglin, merret gjithmonë ai më i larti dhe ai negociohet. Kjo shkon deri edhe në nivel fshati, deri edhe në nivel parcele. Kur brenda një parcele nënparcelet nuk përputhen me atë të madhen, vlen e madhja. Pra, e madhja diskutohet dhe në këtë rast nuk mund parcelat e vogla apo zonat kadastrale të jenë si argumenti kryesor i përcaktimit të vijës së kufirit, sepse vija republikane e kufirit është nivel shumë më i lartë ndërmjet dy shteteve sesa niveli kadastral. Kjo është brenda konceptit kadastral, brenda konceptit të kadastrës. Cilido inxhinier, edhe i kadastrës, edhe i hapësirës, e kupton kështu.

Pra, kur flasim për vazhdimësinë në këtë rast duhet lidhur me vazhdimësinë nga ana e Malit të Zi. Pse asnjëherë nuk është vënë si argument çështja e zonave kadastrale nga ana e Malit të Zi? Pra, duhet të jetë e dyanshme dhe pastaj të negociohet kjo punë. Por, kur e kanë diskutuar këta në komision, i kanë marrë vetëm zonat kadastrale të Kosovës, kurrë s'është vënë si argument. Le t'i hedhin ata të anës tjetër, le t'i hedhin komisionet, e jo tash në këtu. Nëse i keni ato libra, jepuni atyre të komisionit dhe atëherë qenka shumë mirë, ndoshta po u dashka të e ndërpritet. Ti paske argumente shtesë. Nëse paska argumente Mali i Zi që paska të dhëna kadastrale që kufiri është këndej Çakorrit, atëherë hidhja këtë komisionit. Pse s'është thënë kjo asnjëherë deri tash?

Prandaj, kufiri republikan është nivel shumë më i lartë sesa kufiri kadastral i zonave kadastrale i fshatrave, i territoreve.

KRYETARI: Faleminderit! Nënkryetari Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zotin Lajçi unë s'e kuptova, domethënë s'e kuptova, por unë e di që ai ka qenë si vëzhgues, pjesë e atij komisioni, e duket që ka qenë totalisht i padobishëm. Për këtë që po thotë kolegu tjetër, kjo ka shumë logjikë dhe unë pajtohem qind për qind. Por, ajo që po them unë është që ka përputhje. Komisioni Shtetëror i Kosovës e ka pasur gjithë materialin edhe të Malit të Zi, por s'është lexuar. Unë kryeministrit të Kosovës tani ia dhashë gjithë materialin e një zone kadastrale të Malit të Zi, që quhet Velika, dhe që është zona që lidhet me Çakorrin. Merreni dhe vlerësojeni.

Gjithë këtë dokumentacion e ka pasur Komisioni Shtetëror i Kosovës, që e ka udhëhequr Meha. Pse s'e vlerëson ky tjetri, është çështje tjetër, e para. E dyta, tani merreni edhe një herë lexojeni me kujdes raportin, se edhe shifrën që po e pretendoni ju, Bulliqi nuk e thotë te raporti. Lexojeni në faqen 57 çfarë thotë për territorin që kontestohet, sepse s'po e lexoni. Tjetra? Prapë harrojeni këto, sepse i marrin dhe i shohin ekspertët. Shiheni problemin në bazë të Ligjit ndërkombëtar, të natyrës së Ligjit ndërkombëtar. Komisioni Badinteri dhe më vonë Ahtisari, kadastrën e njeh si "uti posidetis", për ata tjerët s'vlen, për ata ajo zonja argumentoi çka thoshte Vjosa, edhe pse s'e kuptonte që po e argumenton.

Arbitrazhi edhe Gjillasin e famshëm, që po e përmend unë, në rastin Kroaci-Slloveni nuk e njohu.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A ka mundësi të rikthehemi në seancë, i kemi vetëm dy deputetë, të cilët janë në kërkimin e fjalës. Kush e dëshiron fjalën ta di për arsye se për këta që kanë folur kërkoj falje. Sala Berisha-Shala dhe Ganimetja, edhe Shkumbini u lajmërua tash.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E di që është tepër vonë, e di që mund të përsëris nga kolegët e mi, por megjithatë do ta shfrytëzoj rastin t'i them edhe unë dy-tri fjalë.

Caktimi i vijave kufitare askujt të mos i shkojë mendja se është një çështje shkencore, është një çështje krejtësisht teknike, e mbi të gjitha është çështje edhe politike dhe nuk do të dëshiroj të hyj në polemikë me askënd dhe ta kundërshtoj asnjë diskutim të asnjë kolegu tim. Vetëm po dua të përkujtoj, të nderuar kolegë deputetë, a ka mundësi Kosova ta bartë një barrë të rëndë të refuzimit aq të rëndë? A është e mundshme? Këtë pyetje secili deputet duhet t'ia shtrojë vetes.

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Pra, dita e sotme është njëra nga ditët më të rëndësishme në historinë e vendimmartjes politike të këtij Kuvendi. Sot mendoj që nuk është dita kur ne duhet ta sulmojmë njëri-tjetrin me betejat tona politike. Gjatë tre vjetëve ne jemi marrë me këtë temë, por fokusi ynë është larguar nga problemet e zhvillimit ekonomik, nga problemet e arsimit, të shëndetësisë e të fushave tjera, të cilat e rëndojnë jetën e njerëzve të këtij vendi. Duhet ta pranojmë se problemi i demarkacionit e ka dobësuar pozicionin tonë ndërkombëtar. Kemi ngrehur dyshime të rrezikshme për partneritetin tonë me Perëndimin dhe me miqtë tanë, duke kundërshtuar shpeshherë në raste të caktuara.

Të nderuar deputetë,

Është e rëndësishme që nga ky rast të nxjerrim mësim të duhura. Mendoj se ky Kuvend, pas kësaj seance dhe pas këtij vendimi, duhet që ta caktojë një ditë të diskutojë në një seancë të posaçme për rrugët që do t'i ndjekim kur t'i caktojmë kufijtë edhe me shtetet tjera fqinja.

Kuvendi duhet ta marrë një vendim për t'i caktuar kriteret që do të përdoren, për ta garantuar ashtu që një transparencë të plotë të procesit, në mënyrë që të hiqen të gjitha dyshimet dhe të mos humbim kaq shumë kohë edhe një herë. Ky rast duhet të na mësojë se loja me kauza të mëdha kombëtare mund të sjellë përfitime momentale politike, por mund të sjellë dëme shumë të mëdha për shtetin, për vendin, për qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkumbin Demaliaj e ka kërkuar fjalën, është edhe Ganimetja.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Kemi hyrë edhe në ditën e dytë që po diskutojmë. E kemi një ditë tjetër, sot është e mërkurë. Unë konsideroj se lidhur me gjithë këtë më pati lodhur zoti Milaim Zeka, duke m'u tekur "pse s'folë sot për demarkacionin". Desha të them se nuk jam ekspert i kësaj fushe, i njoh matjet si bëhen matjet me ato lartësitë mbidetare dhe me të gjitha ato, mirëpo kisha pas dëshirë t'ia bëj një pyetje

zotit Shala se kur po mundohen t'i arsyetojnë të gjitha komisionet brenda këtyre koordinatave dhe hartave dhe gjithë asaj eksperience që e kanë pasur komisionet në varësi, e deri te Komisioni "Bulliqi", vetëm një pyetje kisha pas dëshirë zotit Shala: A ka lëvizur kufiri në brendi të territorit të Malit të Zi, përderisa e konsideroni se në bazë të matjeve të Komisionit "Meha" është në rregull? Pse ka lëvizur kufirin mbas Qafës së Hajlës në territorin e Malit të Zi? Është një pjesë e Komisionit "Meha", kur territori i Kosovës lëviz brenda Malit të Zi. Domethënë ka hyrë brenda. A ka lëvizje të kufirit? Ka! Kjo është kah më intereson, atëherë pse s' duhet të kemi ne dyshime se nuk është luajtur me kufirin dhe s'ka pasur nevojë për Komisionin "Bulliqi"? Kjo ishte arsyeja dhe s'flas më për këtë punë.

KRYETARI: Nënkryetari e ka fjalën, replikë. Milaim, ta ka përmend emrin, do edhe ti? Ok! Replikë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit Shkumbin për pyetjen!

Besoj që kjo na ndihmon që ta sqarojmë edhe një çështje, të cilën s'e reflekton raporti i dytë i komisionit. Është një zonë që quhet Qafë e Hajlës e Pashajlë e tjerë, disa e dinë më mirë e disa jo, por të gjithë e kanë dëgjuar. Rreth 700 hektarë të cilët i ka administruar Mali i Zi gjithmonë, dhe provohet me dokumente, siç e provon Komisioni ynë që ne e kemi administruar Çakorrin, me dokumente të të njëjtës natyrë. Por, që është pjesë e zonës kadastrale të Koshutanit, që do të thotë që është territor i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim Zeka, replikë! Fjala për ju!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

E para, unë shpresoj që demarkacioni do të kalojë, pasi dikush edhe nga "Vetëvendosja" e quajti si tryezë suedeze, dhe tryeza suedeze është e njohur në krejt botën, por vetëm një diçka po më intereson. Me këta "6+" më herët në pauzë planifikonim kur t'i sulmojmë Malin e Zi dhe NATO-n. Tani, ja që dua ta di se cila është alternativa, cila është zgjidhja e krejt këtij problemi? Ne, e tha kryeministri, kemi mbetur në situatën, domethënë as andej, as kënde.

Unë mendoj që votimi pro demarkacionit i hap 1 milion rrugë të reja, 1 milion perspektiva shtetit të Kosovës, qytetarëve të Kosovës dhe, mbi të gjitha, ata që kanë dilema se ne do të humbim territor, të na jepet mundësia të ulemi dhe të bisedojmë vëllazërisht e miqësisht me Malin e Zi. Unë nuk po shoh alternativë të luftës, përtej luftës gjithmonë janë dialogu dhe bisedimet, prandaj mbi bazën e kësaj edhe një herë po u bëj thirrje deputetëve të Lëvizjes "Vetëvendosje" që të reflektojnë deri nesër, se sonte s'ma merr mendja që do të votojmë, dhe ta votojmë demarkacionin dhe t'ia japim një shpresë çdo qytetari të Kosovës dhe të kërkojmë falje, që i kemi maltretuar qytetarët e Kosovës prej 2015-ës e deri sot.

Prandaj, kjo është lutja ime vëllazërore edhe për Dukagjin Goranin, edhe për grupin e tyre, edhe për gjithë Lëvizjen “Vetëvendosje”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më erdhi rendi të flas, tash pas 12-ve. Ndoshta është më mirë, se edhe po ta bëj ndonjë gabim më falet.

Më vjen mirë që përfundimisht pas tre vjetësh për herë të parë po na lejohej që të paktën të debatojmë në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës në lidhje me çështjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, sepse jemi rropatur e jemi sjellë nëpër studio televizive, nëpër rrugë e korridore, por asnjëherë s’na është dhënë e drejta që të debatojmë këtu ku është vendi ne deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, për këtë dua ta përgëzoj kryeministrin Haradinaj, që përfundimisht me guxim e mori vendimin që ta sjellë në sallën e Kuvendit, pavarësisht sjelljeve të deputetëve atëherë dhe tani, që janë shumë të ndryshme.

Të nderuar deputetë,

Tema e demarkimit të kufirit me Malin e Zi është bërë një temë, e cila po e mban peng Kosovën tash e tre vjet. Është një temë që është konsumuar, është keqinterpretuar, është keqpërdorur e po keqpërdoret edhe sot dhe vërtet kjo është për keqardhje.

Demarkimi i kufirit si kusht për liberalizim të vizave për qytetarët tanë është fakt. Çfarëdo që flasim në këtë drejtim është thjesht për konsum politik dhe është vetëm humbje kohe. A është e drejtë apo jo që kjo çështje është e radhitur në listën e kushteve, unë mendoj se nuk është e drejtë, po realiteti është ky që është.

Tani, pas shumë debatesh, fatkeqësisht jo edhe aq përmbajtjesore, nuk e di çka duhet të presim ende? Është momenti i fundit që nga ky Kuvend të përçojmë sadopak seriozitet karshi votuesve, karshi qytetarëve të këtij vendi, të cilët padrejtësisht po mbahen të izoluar. Qytetarët tanë nuk e kanë merituar këtë izolim, prandaj mendoj se edhe Bashkimi Evropian duhet të turpërohet për këtë, sepse ne jemi Evropë, jemi më të vjetër këtu se vetë ky kontinent. Dhe, nëse tani fati është në duart tona, unë ju ftoj që ta bëjmë punën tonë dhe të kontribuojmë që kjo perde izoluese të bjerë përfundimisht.

Ta votojmë këtë marrëveshje duke i lënë anash inatet tona personale, sepse në këtë Kuvend kemi më shumë përgjegjësi dhe obligime sesa ta bllokojmë njëri-tjetrin. Sikur të ishin kufijtë çështje dëshirash, ne të gjithë jemi në dijeni se ku janë kufijtë tanë historikë. Por, sot është sot dhe sot kufiri me Malin e Zi është këtu ku është, e pranojmë apo e lëmë pezull këtë çështje, kjo varet nga ne dhe na dëmton më së shumti neve. Të bashkohemi që temat me interes nacional të përcillen me debate gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore, e jo të zëvendësohen me tema elektorale e të vishen me demagogji, shpeshherë edhe të rrezikshme.

Të bashkohemi për ta përmbushur këtë kusht, të cilin sot jo vetëm BE-ja po e kërkon, por po e kërkojnë edhe vetë qytetarët e vendit. Të bashkohemi për t'i dhënë një shans këtij vendi që të ecën përpara drejt zhvillimit. Të bashkohemi për t'u dhënë një shans qytetarëve tanë të lëvizin të lirë, në mënyrë që ta kenë mundësinë e zhvillimit konform kohës në të cilën po jetojmë. Izolimi vetëm përparim nuk mund të na sjellë.

Shumë nga kolegët e mi sot këtu kanë shtetësi të dyfishta, e kanë mundësinë e udhëtimeve në gjithë botën, prandaj është hipokrizi e kulluar që për inate politike kjo mundësi t'u mohohet qytetarëve, të cilët e kërkuan votën. Është hipokrizi e kulluar karshi turmave para ambasadave në pritje të vizave. Është hipokrizi e kulluar karshi maltretimeve që qytetarët tanë përjetojnë gjatë aplikimit për vizë dhe është më shumë se jonjerëzore t'u mohohet nënave e baballarëve që t'i vizitojnë fëmijët e tyre në Perëndim.

Pra, të nderuar kolegë,

Mendoni mirë dhe vendoseni, por kini gjithmonë parasysh se përderisa nuk jemi të aftë t'i ndryshojmë kufijtë, na lini të paktën t'i ruajmë këta që i kemi.

Të dashur qytetarë të vendit tim,

Ju duhet ta dini, duhet ta keni parasysh se liberalizimi i vizave nuk është ai shkopi magjik që do t'ua zgjidhë të gjitha problemet, por është një mundësi e mirë për ta parë se si jetohet përtej këtyre kufijve. Duhet të keni parasysh që heqja e vizave nuk është dritë e gjelbër për ta braktisur Kosovën, duke kërkuar azil nëpër Evropë. Është thjesht një mundësi e mirë për t'u ndjerë të barabartë me popujt që na rrethojnë.

Uroj që sa më shpejt ta keni këtë mundësi!

Unë shpresoj që kjo çështje sot do të vijë në votim dhe secili prej nesh të votojë me vetëdije të plotë dhe me përgjegjësinë më të lartë. Dhe, ju qytetarë, ta keni të qartë se kush është kundër dhe kush është për, sepse adresimi kolektiv nuk është diçka pozitive, qoftë karshi nesh këtu, qoftë në raport me ju dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Personalisht, nuk jam eksperte për këtë temë, por e kam lexuar dhe e kam përcjellë punën e të gjitha komisioneve që e kanë trajtuar këtë çështje. Kam biseduar me personalitete kombëtare e ndërkombëtare të kësaj fushe e, mbi të gjitha, tani e tre vjet po bisedojmë me qytetarët në mbarë Kosovën. Kjo temë duhet të mbyllet. Sa më gjatë që e mbajmë të hapur, aq më dëm i bëjmë vendit tonë. Qytetarët e vendit e duan lëvizjen e lirë. E them me bindje të plotë se shumica dërmuese e popullit të Kosovës sot e presin kalimin e kësaj pike.

Tani, e pyes edhe “Vetëvendosjen” nëse do të pozicionohet krahas kësaj shumice, apo do ta mbajë ritmin e Listës serbe, e cila është duke e keqpërdorur këtë vend për t’u bërë dëm proceseve nëpër të cilat po kalojmë.

Pyes secilin nga ne këtu, duam të tregojmë seriozitet në këtë Kuvend, apo të vazhdojmë të bëhemi adresë e talljeve të qytetarëve, apo edhe më keq, adresë e urrejtjes së qytetarëve? Mendoni mirë, sepse nuk jemi këtu për qejfe e inate personale, po për të shtyrë procese përpara, edhe atëherë kur nuk na pëlqen, por edhe atëherë kur nuk është e lehtë, sepse për atë na kanë zgjedhur qytetarët e Republikës së Kosovës. Përndryshe, vendimet e mëdha do të merreshin nga individë dhe jo nga institucionet e vendit.

Sot, në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës pati shumë akuza retorike dhe elektorale ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe këto akuza e kjo retorikë janë treguesi më i mirë që presidenti Hashim Thaçi është shndërruar në një kompleks të tmerrshëm për dikë këtu. I pëlqeu apo jo dikujt, presidenti Thaçi tashmë është president i Republikës së Kosovës dhe është dëshmuar si lideri më i merituar dhe më i suksesshëm në të gjitha proceset. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më, kolegë deputetë, të paraqitur për diskutim.

Jemi te pjesa e përfaqësuesit i Qeverisë, nëse e kërkon fjalën. Kryeministër, fjala për ju! Me këtë mbyllet pjesa e debatit për këtë çështje.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Nënkryetarë të Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Medie,

Qytetarë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritarë,

Dëshiroj të falënderoj deputetët për të gjitha ato mendime që janë shprehur sot. Besoj se shumica prej tyre janë edhe me vlerë dhe janë porosi për çka na pret.

Ka pasur sot plot diskutime që kanë përmbajtje, që kanë dëshmuar se ndoshta gjithë kjo kohë që ka kaluar në këtë temë na ka ndihmuar të gjithëve për t’i parë, do të thosha, vështirësitë që na

presin, mundësitë që kemi para nesh, e pse jo, në disa raste e hetojmë një dozë më të madhe të pesimizmit, e te disa të tjerë optimizëm, ndoshta edhe më shumë sesa duhet.

Kërkesa ime për grupet parlamentare veç e veç është, si vijon:

Për LDK-në, për hatër të përcaktimit të saj, që është edhe misionare, por edhe për hatër të banorëve që m'i përmendi disa herë Antoni, me të cilët unë komunikoj shumë, ju lutem ta ruajmë edhe raportin që është pjesë e ligjit. Nuk mendoj se është një dëmtim i marrëveshjes, e që është pika e parë.

Pra, edhe raportin ta ruajmë në këtë ligj. Nuk mendoj se ai raport ka për qëllim krijimin e kontradiktave, qofshin të aspektit ligjor apo të marrëdhënieve ndërkombëtare, por e ka vetëm një qëllim - për të dhënë mundësi, për atë sa janë ato mundësi - të korrigjimit. Nëse na intereson korrigjimi dhe mendojmë se është në të mirën e banorëve, të malësorëve atje, e na vret ndërjegjija për ta, atëherë është mirë pra të mos e zbehim raportin e Komisionit Shtetëror. Besoni nuk do ta thosha sikur të mos e ndieja që ekziston një mundësi për korrigjim, të mos e zbehim ne vetë.

Sa i përket Grupit Parlamentar të PDK-së, jemi të gjithë këtu, marrëveshja është në pikën e parë, nuk ka pësuar ndryshime, është po ajo. Edhe raporti i Komisionit Shtetëror është një material yni, i Kosovës, nuk bie në konflikt me parimet që të mbrohet territori, integriteti, e na jep një mundësi për ta korrigjuar. Nuk besoj se do të dëmtohej asnjë lider politik, asnjë kauzë politike, asnjë grup politik nëse korrigjimi ndodh.

Dëshira edhe e juaja, edhe e secilit prej nesh, jam i bindur edhe e grupeve tjera, është që kufiri të kthehet në Çakorr e në Kullë, në majat e larta, Bjelluha të mbetet brenda nëse është e mundur, përkundër faktit se dikush prej nesh mendon se s'është e mundur, nuk ndodh, është mashtrim... Por, t'ia lëmë një mundësi vetes, të mos ia humbim këtë mundësi që sonte. Ta kemi njëfarë besimi deri diku, ose njëfarë shprese se kjo mund të ndodhë.

Kolegë të "Nismës", njësoj jua kërkoj përkrahjen, ashtu siç ia kam kërkuar edhe Aleancës. Kolegëve të "Vetëvendosjes" dhe të Grupit të Deputetëve të Pavarur, dëgjoni, ju thashë edhe më herët, nga perspektiva e një opozitari të pastër, kundërshtimi i një veprimi që mund të jetë i rrezikshëm e i dëmshëm për një çështje të ndjeshme të atdheut, siç është territori, janë instrumente, disa të njohura, disa të krijujmë. Kemi rrugëtuar një rrugë të gjatë dhe mendoj se fakti që sot në ligj e kemi edhe raportin e Komisionit Shtetëror është meritë edhe e juaja, e opozitës, e rezistencës dhe punës që është bërë.

Njëkohësisht, pranimi për t'u votuar edhe raporti në ligj është një respekt edhe i partive tjera politike, edhe për sakrificën e përbashkët për punën që e kemi bërë, që në këtë mënyrë pra të

lihet mundësia e korrigjimit, ngase korrigjimi është real. Unë po e kuptoj edhe dozën e pesimizmit dhe të shqetësimeve, por është e pakuptimtë që ne krejt të heqim dorë nga mundësia, qoftë edhe kur votojmë kundër. Edhe nëse votoj kundër, prapë do ta ruaja të drejtën për t'u thënë institucioneve të vendit "jeni të obliguar për korrigjim", sikur u tha realisht këtu nga disa kolegë, që është tepër e mençur që të kërkohet korrigjimi.

Unë e kërkoj votën edhe të "Vetëvendosjes", edhe të Grupit të Deputetëve të Pavarur pikërisht për faktin se raporti i Komisionit Shtetëror megjithatë është materie e këtij vendi dhe ajo mund të jetë baza për korrigjim. Nëse ia shtojmë faktin që u tha disa herë se nuk është Mali i Zi një vend që e ka një agjendë konfliktuoze, armiqësore, ndoshta as të pretendimeve në territor ndaj Kosovës, por janë rrethanat që janë krijuar, gabime të së kaluarës, ose rrethanat çfarë kanë ndodhur. E shohim një vullnet të tyre politik, pse s'e lëmë edhe ne një mundësi? Pse na... ata ndoshta e kanë atë... dikush tha, "janë ndryshime teknike". Mirë, ai s'po do të thotë që do ta ndryshojmë krejt hartën. Mos pritni prej një ministri të shtetit tjetër të thotë "krejt hartën kemi për ta ndryshuar për hatër të Kosovës". Nuk bëhet ajo, e dini që s'e thotë kurrkush ashtu. Ata e kanë kaluar, e kanë një situatë çfarë e kanë në Parlamentin e vet, mirëpo kanë shprehur gatishmëri t'i përfillin të gjeturat, kanë shprehur gatishmëri të ketë komision të përbashkët.

Urdhëroni, hyjmë në atë komision të gjithë, nga një ekspert i secilit, plus Komisioni ynë Shtetëror. Edhe nga partitë opozitare, edhe nga "Vetëvendosje", nga Grupi i Deputetëve të Pavarur, nga LDK, nga PDK, nga "Nisma", nga të gjithë, edhe të komuniteteve, ta ndihmojmë korrigjimin. Nuk është krejt... më kujtohet një kohë njëherë një koleg imi, se m'u përmend periudha e lavdishme, tradhtia e sotme edhe shumë po ma bëjnë dertin realisht, faleminderit që ma bëjnë këtë dert, kam pasur plot etapa që ma kanë mbajtur dertin në mënyra të ndryshme. Më kujtohet njëherë një koleg, nuk është në këtë sallë, por dikush e di për kënd është fjala, më pati thënë: "hajde këndeje se s'ka gjë më". Kanë qenë kohëra të vështira. Thashë, "po pse mos ta ruaj unë të drejtën të këqyri a ka diçka". Unë dua ta ruaj të drejtën e korrigjimit, por ju lutem më ndihmoni, pra në emrin tuaj, në emrin e çdo grupi parlamentar, në emrin e çdo deputeti, në emrin e banorëve, që po u flasim e po u përmendim shpesh, të cilët unë bukur shpesh i shoh, komunikoj me ta rregullisht dhe i nderoj.

Ju lutem, lërmani mundësinë të kërkojmë korrigjim. Nuk besoj se është në dëm të kurrkujt kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ta bëj vetëm një sqarim procedural.

Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare e përcakton se Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3-ve të të gjithë deputetëve i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare.

Pra, ratifikimi i marrëveshjes i kërkon së paku 80 vota për, si dhe në bazë të nenit 60, paragrafi 3 i Rregullores përcakton që procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të dëshiroja ta kem fjalën e kolegëve kryetarë të grupeve parlamentare, për arsye se një pjesë e kolegëve deputetë tanimë nuk i kemi në sallë. Po e shoh edhe në bazë të Administratës gjendjen e kuorumit. A ka mundësi? Është ideja që votimi të mbahet ditën e nesërme, në orën 10:00.

Kërkoj nga kryetarët e grupeve. 73 deputetë jemi. A ka mundësi, në radhë të parë kryetarët e grupeve parlamentare? Unë e caktova për arsye më shumë publike, jo vetëm për këtë sallë, por edhe për jashtë kësaj sale, e bëra edhe sqarimin procedural.

Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nesër seanca të vazhdojë në orën 10:00?

AVDULLAH HOTI: Grupi ynë parlamentar pajtohet që votimi të ndodhë nesër në orën 10:00, duke qenë se nuk ka kuorum. Faleminderit!

KRYETARI: Në fakt, sot! Kërkoj falje! Zoti Hoti, mos ta kemi në protokoll gabimisht. Po flasim për sot, në orën 10:00 të mëngjesit.

Atëherë, Grupi Parlamentar i LDK-së pajtohet. Urdhëro, Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne edhe ashtu, meqenëse janë vetëm 73 deputetë, nuk kemi kushte për t'u realizuar votimi, meqenëse ju e cituat Kushtetutën që i kërkon 2/3-at, domethënë duhet të jenë së paku 80 deputetë në sallë për të pasur votim të suksesshëm. Kjo e pamundëson votimin sot, andaj ne e mbështetim propozimin që të mërkurën, në orën 10:00, pra sot, për afërsisht pas 9 orësh, të bëhet votimi, ndoshta para se të vazhdojmë seancën që e kemi të planifikuar me planin e punës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, nga Lëvizja "Vetëvendosje", fjala për ju!

GLAUK KONJUFCA: Nëse ndodh kjo, atëherë do të ishte një shkelje e Rregullores së Kuvendit, për arsye se ju e keni caktuar për të mërkurën në orën 10:00 seancë, e cila do t'i kushtohet votimit të rekomandimeve tona për rastin e Astrit Deharit. E para është kjo. E dyta, edhe dy gjëra desha...

KRYETARI: Pa e ndërprerë, është edhe ajo në vazhdim, ta keni parasysh, e kemi bërë edhe në të kaluarën këtë si praktikë, ta kemi parasysh.

GLAUK KONJUFCA: Ajo duhet të ndodhë dhe duhet të përfundojë, është e para. E dyta, mendoj që deputeti nuk mund t'i nënshtrohet asnjë presioni, siç po synohet të bëhet këtu, që të orientohet vullneti i tyre, sepse në mandatin e tyre janë të lirë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës që të vendosin me vullnetin e tyre dhe pa kurrfarë presioni, siç na pati ndodhur me rastin e Gjykatës Speciale, ju kujtohet edhe juve.

E treta, unë mendoj që vetë mungesa e deputetëve sonte këtu tregon për vullnetin e tyre të vërtetë. Ata janë kundër demarkacionit, sepse po të ishin aq shumë që të vinin dhe ta votonin demarkacionin, unë mendoj se vullneti i tejkalon të gjitha, edhe orën 24:00 nuk është shumë vonë sa për të ardhur në Kuvend e për ta dhënë votën e tyre.

Kështu që pak a shumë e kemi edhe disponimin e deputetëve me mungesën e tyre sonte këtu, gjë që tregon se kjo marrëveshje nuk e ka mbështetjen e duhur për të kapërcyer, sigurisht për arsye se deputetët e dinë se në të vërtetë është marrëveshje e dëmshme dhe e cila duhet të hidhet poshtë.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, po e shoh derisa e vazhdoja seancën një propozim për në orën 11:00. Vetëm ta shoh qëndrimin e LDK-së dhe të PDK-së.

Nesër në orën 11:00, po e shoh se po e vënë në propozim, po...

Sot, po! Më falni, çdoherë flasim për ditën e mërkurë, vazhdimi i kësaj seance në orën 11:00. Edhe seanca, e cila është vazhdim, në orën 10:00, siç e kemi përcaktuar më herët, vazhdon pas përfundimit të votimit. Ta kemi parasysh, në qoftë se shkojmë në orën 11:00. Vetëm pak, mos lëvizni, ju lutem!

Shkojmë, Dardan Sejdiu nga Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur, ora 11:00 është propozimi, Dardan!

DARDAN SEJDIU: Kryesues, faleminderit!

Në fakt, unë dhe përgjithësisht Grupi i Deputetëve të Pavarur sot nuk është deklaruar edhe aq shumë, për shkak se ju u shprehët kur e thirrët këtë seancë për sot, për dje në orën 16:00, u shprehët për rëndësinë e votimit të kësaj marrëveshjeje. Dhe, na keni ftuar sot, dje në orën 16:00, tani ora është 1:00 pas mesnate dhe e keni ftuar këtë seancë për ta hedhur këtë projektligj në votim.

Nëse është kaq e rëndësishme, e nëse pretendohet se ka vota, atëherë pse kanë shkuar deputetët? Ju na keni ftuar neve. Ju e keni bërë këtë seancë, prandaj nuk ka kuptim, më falni, nuk ka kuptim të ftohemi në seancë dhe pastaj të na thuhet “të ecim për një ditë tjetër”.

Ju kisha lutur, kryesues, që...

KRYETARI: Ju kisha lutur, vazhdoje propozimin tuaj!

DARDAN SEJDIU: Pra, kryesues, nuk është në rregull të ftohen deputetët kështu dhe më pastaj të siguroheni, meqë nuk i keni numrat, ta prisni njëlloj të themi numri të nevojshëm për votë e konstant kështu për tre vjet ta shtyni këtë votë.

Kjo marrëveshje tash e tre vjet nuk e ka votën dhe nuk do të sigurohet kjo votë duke e shtyrë kështu çdo ditë nga 15 a 20 minuta, por hidheni në votim dhe të ecim tutje, se edhe vota kundër e zhbllokon këtë punë.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Në fund do të kemi votim formal me ngritje dore për propozimin. Ta kemi parasysh. Për atë arsye, i lus kolegët... Ahmet Isufi, urdhëro!

AHMET ISUFI: Meqë tash është ora 1:00 e natës, në orën 11:00 të mërkurën pajtohem që të mbahet votimi.

KRYETARI: Lista serbe nuk është. “Nisma për Kosovën”, Bilall Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se është krejt normale, që nëse nuk janë deputetët që janë zotuar se do ta votojnë demarkacionin, është krejt normale të mos e hedhim në votim.

Edhe një lutje e kam për zotin Sejdiu. Na ndihmo neve politikanëve të brezit të ‘90-ës, të cilët nuk mund të mbijetojmë ndryshe pa Serbinë, tash edhe Malin e Zi si armiq në politikë, na ndihmo që t’i tejkalojmë këto duke e votuar demarkacionin dhe pastaj u hapet rruga juve që të vazhdoni të merreni me politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! “6+”-i nuk është këtu. Administrata, në qoftë se ka mundësi të konstatoi sa deputetë janë, se po shkojmë në votim formal.

Aktualisht në sallë janë 69 deputetë. Kush është që seanca parlamentare për ratifikimin e Marrëveshjes me Malin e Zi të mbahet ditën e mërkurë, në orën 11:00. Ngriheni dorën kush është për. Ju kisha lutur, vetëm për kush është? Ngriheni dorën, ju kisha lutur për hir të korrektësisë, s’ka nevojë të shkojë në Gjykatë Kushtetuese.

69 deputetë janë aktualisht. A mund të procedoj më tutje? Sa deputetë janë kundër? 46 janë për që të mbahet nesër. Kush është kundër? Më falni, prej 69 deputetëve kush është kundër, në qoftë se doni të votoni? Arbeni! A ka kundër tjetër? Abstenim, a ka?

Nesër, në orën 11:00 vazhdon seanca për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Sot do të thotë, të mërkurën, në orën 11:00.

Edhe një herë, të mërkurën, në orën 11:00. Faleminderit!

* * *

E mërkurë, 21 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 22, 23, 28 shkurt dhe më 20 mars 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Në sallë aktualisht janë të pranishëm 95 deputetë.
Vazhdojmë me punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,
Diskutimet për Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi kanë përfunduar.

Ndërkohë e kemi një kërkesë për fjalë nga zoti Avdullah Hoti dhe Glauk Konjufca. Urdhëro zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar amendamentin që ka kaluar në Komisionin për Politikë të Jashtme më 28 shkurt 2018 dhe me qëllim që t'i japim zgjidhje përfundimtare të kësaj çështje, propozojmë që në këtë amendament, pika 2, ku shkruan "dokumentacioni zyrtar i Komisionit Shtetëror për shënimin e kufirit shtetëror për orientim" të renditet si pika 1.3.

Lus që të zhvillohen procedurat e nevojshme në Kuvendin e Kosovës dhe ky amendament me këtë ndryshim t'u silltet deputetëve për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hoti!

Kisha kërkuar nga Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni FunkSIONAL, të tërhiqet. Ndërkohë kryeministri i Republikës e ka kërkuar fjalën.

Urdhëro zoti kryeministër! Glauk bëhesh gati pastaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Do të thotë, për sqarim e dakordojmë pra propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, ashtu siç e tha që është edhe qëndrim i Komisionit, edhe sponsorizuesi, në këtë rast Qeveria, e dakordon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, kryetarja e Komisionit, është sqarim procedural.

VJOSA OSMANI: E lus Administratën që anëtarët e Komisionit t'i njoftojë lidhur me përmbajtjen e amendamentit të ri dhe ta shpërndajë këtë amendament para se ne ta fillojmë diskutimin në Komision, në mënyrë që të mos ketë pastaj akuza banale, siç ka pasur herën e kaluar.

KRYETARI: Faleminderit! Gjithsesi! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Edhe një herë, sa i përket demarkacionit.

Ju e dini që rasti i krijimit të shtetit të Kosovës ka të bëjë me procesin apo përmbylljen e procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe ju e dini që një komision shumë i rëndësishëm që e patën quajtur Komisioni i Badinterit i ka dhënë ato instruksionet e përgjithshme se si do të shkohet me krijimin e shteteve të reja nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.

Dhe, njëra prej argumenteve më të fuqishme të Komisionit të Badinterit ka qenë që vijat administrative të republikave faktikisht duhet të kthehen në vija shtetërore, pra automatikisht. Ky është argumenti i parë.

Argumenti i dytë, sipas Komisionit të Arbitrazhit në rastin ndërmjet Kroacisë dhe Sllovenisë ka thënë qartë që nëpër disa pjesë të kufijve ndër-republikanë në rastin e ish Jugosllavisë nuk ka përputhje kadastrave, domethënë ka shpërputhje kadastrale ndërmjet republikave.

Dhe, njëri prej pasuseve aty të vendimit të Arbitrazhit në rastin Kroaci-Slloveni thotë kështu: “Në rast ku ka shpërputhje, ku nuk përputhen kadastrat, ku nuk e mbulojnë kufirin krejt, duhet të ngadhënjëjë, të mbizotërojë vija administrative, vija republikane”.

Kur Komisioni ka qenë në raportim në Komisionin për Legjislacion, ku edhe unë jam anëtar aty, njërit prej anëtarëve që ka qenë ekspert i kadastrës unë ia kam shtrua një pyetje dhe pyetja ime ka qenë: A ka mbulueshmëri kadastrale për çdo pjesë të territorit të cilin e kontrollon Kosova aktualisht?

Dhe, eksperti i kadastrës më është përgjigjur “jo, nuk ka, për disa pjesë nuk ka”.

E kam pyetur: Sa është hapësira e cila nuk ka mbulueshmëri kadastrale nga Republika e Kosovës? Ai më ka thënë “diku 70 kilometra katrorë nuk kemi mbulueshmëri kadastrave”.

Tash, edhe sipas këtij vendimi të Gjykatës së Arbitrazhit në rastin Slloveni-Kroaci është bërë fare e qartë që aty ku nuk ka mbulueshmëri kadastrale, Komisioni, i cili është i mandatar për përcaktimin e vijës kufitare, nuk ka nevojë të pajtohet patjetër me kriterin kadastral. Ky ka qenë gabimi i Komisionit tonë dhe këto kabime do të na kushtojnë, mbajeni në mend.

Pra, Komisioni ynë në momentin që e ka pasur informatën, siç ma tha atë ditë në Komisionin për Legjislacion ekspertit i kadastrës së Komisionit, kur kanë qenë të bindur që nuk ka mbulushmëri kadastrale dhe nuk ka përputhshmëri të plotë kadastrale ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës, nuk është dashur ta bëjë këtë gabim, sepse ky gabim na ka ardhur në votim tash dhe për këtë gabim do të votoni.

Pra, edhe një herë po bëjë thirrje që, duke i pasur parasysh këto dy argumente, të cilat i prezantova, t'i thirrni edhe një herë mendjes: liberalizimi i vizave është efekt anësor, nuk është efekt esencial. Efekti esencial është se çka do të ndodhë me territorin e Kosovës, çka do të ndodhë me sovranitetin? E vizat mund të jenë efekt dytësor, ato vijnë nëse e bëjnë këtë gjë.

Mirëpo, e para nuk vijnë menjëherë, nuk ka viza para vitit 2019, dhe, e dyta, ne do ta kuptojmë se sa e kemi korrupsionin të pranishëm nëpër institucionet tona pikërisht nëse kalon kjo marrëveshje fatale.

Pra, do të na bëhet një kusht tjetër shumë më esencial se ky tjetri.

Pra, them të mos ngutemi, t'i thërrasim edhe një herë mendjes dhe ta shpëtojmë territorin e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në...

Atëherë jemi në pauzë të nderuar kolegë deputetë, presim derisa ta kryejë Komisioni. 10 minuta a 5 minuta, po më mirë e presim derisa ta përfundojë Komisioni.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Regjia, ndërkohë i ftoni deputetët të futen në sallë, jemi në proces të votimit. Ju lutem, ziles!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në qoftë se ka mundësi, i zini vendet!

E ftoj kryetaren e Komisionit, zonjën Vjosa Osmani që ta marrë fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Komisioni ynë u takua dhe meqenëse propozimi i ri në amendament ishte një ndryshim krejtësisht teknik nga ai që e kemi kaluar më herët, njëzëri u votua që të kalojë. Faleminderit!

A ka nevojë ta lexojmë, apo e keni para vetes të gjithë, kolegë deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Duhet 2/3 e votave. Votojmë tash!

(Në sallën plenare hidhet gaz lotsjellës nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”)

Po shoh reagime... Pauzë pesë minuta, veç pastrohet, 5 minuta pauzë ju lutem.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në proces të votimit, kryetarja e Komisionit e ka lexuar amendamentin.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Në sallën plenare hidhet gaz lotsjellës nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”)

Votoni ju lutem se gaz është, kemi pasur edhe tjera herë. Votoni.

Rrethanat e rënda, edhe një herë pauzë! Vijnë prapë për votim, për arsye se po shoh reagim, rrethana të rënda... prapë vijnë në votim.

10 minuta pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

(Në sallën plenare hidhet gaz lotsjellës nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

(Në sallën plenare hidhet gaz lotsjellës nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: TË nderuar kolegë deputetë,

A ka mundësi për vëmendje? E kemi pasur një problem me kartela, në qoftë se ka mundësi para se të futemi në votim, vetëm ta provojmë nëse funksionojnë kartelat.

Lus regjinë dhe deputetët, vetëm i prekim kartelat që ta shohim nëse funksionojnë, për arsye se ka qenë defekti i tillë. Mundësisht sikur në votim, shkojmë në votim për, kundër, abstenim, vetëm në votim të gjithë.

Sa deputetë janë aktualisht? Janë 92.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash teknikisht.

89 deputetë kanë votuar, tre deputetë do të thotë nuk kanë dashur të votojnë.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit të propozuar nga Komisioni Funkcional për Punë të Jashtme.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

91 deputetë kanë votuar, 80 për, 11 kundër, asnjë abstenim.

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, së bashku me amendamentin e miratuar.

Regjia e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Duartrokitje)

Konstatohet se kanë votuar 91 deputetë, 80 për, 11 kundër, asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-060 për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së sotme. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*